



**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**FAKULTETI I SHKENCËVE SHOQËRORE**

**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

**SHKODËR**

**DOKTORATURË**

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**

**"GJUHA NË VEPRAT E AUTORËVE VERIORË  
TË SHEKULLIT XIX"**

**(Ëngjell Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi)**

**KANDIDATE:**

**MA. ARJOLA HOTI**

**UDHËHEQËS SHKENCOR:**

**PROF.DR.TOMOR OSMANI**

**SHKODËR ,2021**



**UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"**

**FAKULTETI I SHKENCËVE SHOQËRORE**

**QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE**

**SHKODËR**

**DOKTORATURË**

**PËR MBROJTJEN E GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"**

Udhëheqës shkencor: **Prof.dr. Tomor OSMANI**

Përgatitur nga: **M.Sc. Arjola HOTI**

**Për marrjen e gradës shkencore: "DOKTOR"**

Mbrohet më datë: \_\_.\_\_.2021 para jurisë së përbërë nga:

1. \_\_\_\_\_ **Kryetar**
2. \_\_\_\_\_ **Anëtar (oponent)**
3. \_\_\_\_\_ **Anëtar(oponent)**
4. \_\_\_\_\_ **Anëtar**
5. \_\_\_\_\_ **Anëtar**

**Shkodër, 2021**

## **PËRMBAJTJA**

Objekti dhe qëllimi.....	f.6
Metodologjia.....	f.7
Parathënie .....	f.9
Shkurtesat .....	f.11
Hyrje: Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë botuese dhe në dorëshkrim të autorëve : Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi.....	f.12

### **KREU I**

<b>Kushtet historike e shoqërore të gjysmës së dytë të shekullit XIX.</b>	
<b>Lëvrimi i gegërishtes në këtë periudhë.....</b>	<b>f.16</b>

### **KREU II**

<b>Shkodra, qendër e rëndësishme kulturore dhe arsimore në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Gjendja e studimeve gjuhësore gjatë kësaj periudhe.....</b>	<b>f.18</b>
---	-------------

### **KREU III**

Sistemi grafik i tre autorëve.....	f.21
Ndikimi i sistemit grafik të autorëve të vjetër .....	f.27
Përfundime të kreut të tretë.....	f.28

### **KREU IV**

<b>Rreth disa dukurive fonetike të veprës së tre autorëve.....</b>	<b>f.30</b>
Theksi	
Zanoret e gjata dhe dyfishimi i tyre	
Togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve	
Zanorja ë dhe përdorimi i saj	
Veçori të tjera fonetike	
Përfundime të kreut të katërt.....	f.36

### **KREU V**

<b>Disa veçori të leksikut të tre autorëve</b>	
Neologjizmat .....	f.38
Shtresimi i fjalëve me burim të huaj.....	f.41

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

(Disa krahinorizma).....	f.58
Përfundime të kreut të pestë.....	f.61

### **KREU VI**

<b>Mënyrat e formimit të fjalëve.....</b>	<b>f.62</b>
Formimi me parashtesë	
Formimi me prapashtesë	
Formimi me parashtesë dhe me prapashtesë	
Kompozita	
Përngjitja	
Përfundime të kreut të gjashtë.....	f.72

### **KREU VII**

#### **Veçori morfologjike të veprës së tre autorëve.**

Emri.....	f.75
Kategoria gramatikore e gjinisë.....	f.75
Shumësi i emrave.....	f.83
Kategoria gramatikore e rasës.....	f.91
Rënia e treguesve të shquarsisë në rasat gjinore dhe dhanore të shumësit dhe njëjtësimi formal me të pashquarën.	

#### **Mbiemri.**

Klasifikimi kuptimor e morfologjik.....	f.100
Kategoria gramatikore e shkallës.....	f.101
Formimi i mbiemrave.....	f.104

#### **Përemrat**

Përemri dhe llojet e tij.....	f.107
Përemri vetor, vetvetor e dëftor	
Përemrat pyetës, lidhorë e të pacaktuar	

#### **Folja**

Kategoritë gramatikore.....	f.117
Mënyra dëftore	
Formimi i kohëve sintetike dhe analitike të mënyrës dëftore	
Mënyra lidhore	
Formimi i kohëve sintetike dhe analitike të mënyrës lidhore	
Mënyra habitore	
Formimi i kohëve sintetike dhe analitike të mënyrës habitore	

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

---

Mënyra kushtore	
Formimi i kohëve sintetike dhe analitike të mënyrës kushtore	
Mënyra dëshirore	
Formimi i kohëve sintetike dhe analitike të mënyrës dëshirore	
Mënyra urdhërore	
Format e pashtjelluara foljore.....	f.153
Pjesore	
Paskajore	
Përcjellore	
Mohore	
<b>Pjesët e pandryshueshme të ligjëratës</b>	
Ndajfolja.....	f.166
Parafjala.....	f.167
Lidhëza.....	f.170
Përfundime të kreut të shtatë.....	f.171
<b>PËRFUNDIME</b> .....	f.174
<b>BIBLIOGRAFI</b> .....	f.189
<b>ABSTRAKT</b> .....	f.195

### **Objekti dhe qëllimi**

Në këtë punim do të vështrojmë dhe do të nxjerrim veçoritë gjuhësore të gegërishtes në krijimet e autorëve: *Ëngjëll Radoja, Pashko Babi dhe të Ndue Bytyçit*, si dhe do të pasqyrojmë gjendjen dhe zhvillimin të gjuhës shqipe, veçanërisht të shkrimeve në gegërisht, në shekullin XIX.

*Objekti dhe qëllimi i doktoraturës konsiston në :*

1. Njohjen dhe analizimin e larmisë së formave dhe kuptimeve gramatikore, sipas mënyrave të formimit, mbaresave të tyre që dalin sipas kategorive gramatikore, zhvillimeve të tyre të brendshme, që pasqyrohen në veprat e autorëve.
2. Evidentimin e disa rasteve të ndërtimeve me elemente fjalëformuese sipas dendurisë së përdorimit të tyre.
3. Sjelljen në vëmendje të disa prej karakteristikave të sistemit emëror, mbiemëror, përemëror dhe foljor, duke i ilustruar me shembuj, së bashku me kuptimet gramatikore që ato mbartin. Synojmë të analizojmë edhe ndonjë rast të veçantë që bën përjashtim në krahasim me standardin e sotëm.
4. Paraqitjen e sistemit shkrimor të këtij grupi shkrimtarësh shkodranë që lëvruan me shkrimet e tyre në shekullin XIX.

*Arsyet pse zgjodhëm këtë temë janë :*

1. *Së pari*, për vlerat gjuhësore që kanë këto vepra të dokumentuara në gjysmën e dytë shekullin XIX.
2. *Së dyti*, menduam të sjellim një kontribut në lëmin e studimeve albaologjike.
3. *Së treti*, veprat e tyre karakterizohen nga një korpus i larmishëm i përdorimit të fjalëve në kontekste të ndryshme.

Studimet e ardhshme lidhur me veprat e autorëve shkodranë të shekullit XIX, jemi të bindur që do të japin të dhëna të reja, mbështetur në materiale burimore dhe dokumente studimore. Shpresojmë që dhe punimi ynë të shërbejë si një bazë që mbart një pasurim të dhënash në lidhje me studimin e vazhdueshëm të këtyre autorëve dhe të veprës së tyre.

### **Metodologjia**

Studimi ynë është mbështetur kryesisht në metodat përshkruese, krahasuese analizuese dhe ilustruese, sipas veçorive të kapitujve. Këta metoda të gërshetuara me njëra – tjetrën sjellin një tablo më të gjerë të historikut të zhvillimit të shqipes në gegërishte në këtë periudhë shkrimore.

Pasi kemi strukturuar materialin në skedarë, fjalët janë ndarë në klasa përkatëse. Më pas, secila prej tyre është analizuar sipas veçorive fonetike, leksikore, temës fjalëformuese dhe veçorive gramatikore.

**Metoda përshkruese:** Bazuar në të dhënat historike arritëm që nëpërmjet kësaj metode të paraqitnim të dhëna mbi historinë e zhvillimit të shqipes gjatë shekullit XIX. Kjo metodë u shfrytëzua edhe me përshkrimin e realitetit gjuhësor ilustruar me shembuj nga teksti për të folme e arealit gegë gjatë shekullit XIX. Me metodën përshkruese arritëm të jepnim edhe një pasqyrim të mendimit gjuhësor.

**Metoda krahasuese:** Nëpërmjet kësaj metode u përpoqëm të krahasonim shkrimet shqipe të autorëve: Radoja, Bytyci, Babi, të shekullit të nëntëmbëdhjetë me të përbashkëtat dhe të veçantat e tyre, të cilat bëhen të dukshme nëpërmjet ilustrimeve me shembuj.

**Metoda analizuese:** Kjo metodë mundësoi të konkludonim në një analizë të përgjithshme me karakter fonetik, leksikor, fjalëformues dhe morfologjik të gjuhës shqipe të autorëve veriorë: Radoja, Bytyci, Babi. Nëpërmjet analizës së të dhënave gjuhësore të veprave, u listuan tipare të karakterit gjuhësor, si edhe ndonjë rast i izoluar në përdorim të klasave të fjalëve.

**Metoda ilustruese:** Një metodë e tillë na ndihmoi që ta bënim sa më të besueshme dhe të prekshme çdo të dhënë që ilustruam me shembuj të vjelë nga veprat.

Ndërthurja e këtyre metodave na ndihmoi natyrshëm të sillnim, gjatë trajtimit të punimit, të dhëna përshkruese, krahasuese, analizuese, ilustruar me shembuj. Për realizimin e këtij punimi shkencor jemi mbështetur në një literaturë të gjerë të studiuesve shqiptarë.

**Korpusi** i analizuar është nxjerrë nga vjelja tërësore e veprave të autorëve.

Për realizimin e objektivave të përcaktuar në këtë studim, e kemi ndarë atë në shtatë krerë.

U ndalëm posaçërisht në shkrime e fakte që njihen për këta shkrimtarë, në rrethanat kur u shkruan veprat, në trajtimin e çështjeve të ndryshme, lidhur me studimin e këtyre veprave në kohë të ndryshme, gjithmonë duke pasur kriter që të mos largoheshim nga qëllimi bazë i këtij punimi.

Në **kreun e parë** është bërë një paraqitje e përgjithshme e kushteve historike-shoqërore në Shqipërinë e gjysmës së dytë të shekullit XIX, ku interes paraqet lëvrimi dhe inkuadrimi i gjuhës shqipe dhe sidomos i gegërishtes, realizuar për këtë periudhë shkrimore.

Në **kreun e dytë** është dhënë një pasqyrë e zhvillimit letrar, kulturor e arsimor në Shkodër gjatë shekullit XIX. Trajtuar një sërë aspektesh e të dhënash që lidhen me zhvillimin e qytetit të Shkodrës si qendër kulturore dhe gjendjen e studimeve gjuhësore gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX.

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

---

Në **kreun e tretë** jemi ndalur në përshkrimin e grafisë së përdorur në veprat e tre autorëve duke vënë në dukje të përbashkëtat dhe dallimet si dhe ndikimin e sitemit të autorëve të vjetër, ku ka vazhdimësi dhe risi, duke i ilustruar nga vepra.

Në **kreun e katërt** është përshkruar leksiku i gjuhës së përdorur në veprat e autorëve të lartpërmendur. Mes të tjerash spikat një pasqyrë jo e detajuar, por thjesht ilustruese e përdorimit të neologjizmave, e shtresëzimit të fjalëve me burim të huaj dhe disa krahinorizmave gjurmuar në vepra.

Ky trajtim ka një rëndësi të veçantë, pasi pasqyron historinë e huazimeve në shqipe, për sa i përket atyre nga turqishtja, latinishtja dhe disa italianizma, ndikimin që kanë pasur në shkrimet shqipe, si dhe përdorimin e disa neologjizmave dhe krahinorizmave nga autorët.

Në **kreun e gjashtë** trajtohen çështje që lidhen drejtpërdrejt me tipat e fjalëformimit të ilustruara me shembuj, si dhe një klasifikim sipas dendurisë së përdorimit të elementeve fjalëformuese.

Në **kapitullin e shtatë** do të realizohet një analizë përshkruese-krahasuese të sistemit emëror, mbiemëror, përemëror, foljor si dhe e pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës të cilat do të ilustrohen me shembuj nxjerrë nga veprat e këtyre shkrimtarëve gegë.

Le të shpresojmë që ky punim do të sjellë një ndihmesë të vlefshme në fushën e punimeve morfologjike, por edhe për historinë e gjuhës shqipe.



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

### **Parathënie**

*Studimi dhe njohja me shkrimet e vjetra të autorëve veriorë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, më nxiti dëshirën të nis formësimin e kësaj teme disertacioni "Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit të nëntëmbëdhjetë".*

*Originaliteti i veprave që përzgjedhëm për këtë studim, ishte objektivi parësor që më inkurajoi të ndërmarra zbatimin e kësaj teme doktorale. Hapi i parë që ndoqëm për të nisur këtë punim, ishte grumbullimi dhe skedimi i materialit të nevojshëm. Natyrisht që, së pari, siguruam veprat e autorëve me të cilët u njoha më nga afër, pasi këto të fundit nuk ishin bërë ndonjëherë objekt i studimeve të mia të deritanishme dhe ishte hera e parë që do t'i studioja gjuhësisht.*

*Natyrisht, ky studim nuk do të ishte i plotësuar nëse nuk do t'i referoheshim materialeve studimore të botuara më pare për gjuhën e këtyre shkrimtarëve. Fillimisht, më së shumti studimet i përkisnin temave të dimensionit kohor kur këta autorë botuan veprat e tyre. Në studimet shkencore të kohëve të fundit, interes të madh shfaqte edhe gjuha e lëvruar nga autorët: Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi. Këto punime u bënë udhëzuese në rrugën që do të ndiqnim më tej në zbatimin e kësaj teme studimore, duke u ndalur krahasimisht me të përbashkëtat dhe të veçantat që i karakterizonin në përdorimin e sistemit grafik, njësisive fonetike, leksikore, fjalëformuese dhe morfologjike të shkrimeve të autorëve të lartpërmendur.*

*Në këtë drejtim, punimi ynë ka si qëllim të realizojë një studim të gjuhës së veprave: "Dotrina e kerscten me msime e scpiegime" e Ëngjëll Radojës, "Vakinat e t'ligs herscme e t'ligs ree" e Pashko Babit dhe "Urçnimet e Teneot e t'sceites kisc" e Ndue Bytyçit, të gjysmës së dytë të shekullit XIX, mbështetur në origjinalitetin krijues të këtyre shkrimeve.*

*Para fillimit të analizës gjuhësore të punimit, strukturuam punën në skedarë të rrafshit fonetik, leksikor, fjalëformues e sipas veçorive të klasave të fjalëve. Ishte një punë shumëdimensionale, por bashkë me vështirësinë u integrua domosdo edhe dëshira e kënaqësia e njohjes së dialektit të cilit i përkas, në një periudhë kohore më të hershme.*

*Një material i bollshëm për t'u skeduar, normalisht ka qenë një sipërmarrje e vështirë, që kërkonte një punë serioze dhe këmbëngulëse, por që njëkohësisht ka lënë shumë hapësira për interpretim dhe dyshime, të cilat janë sqaruar në konsultim me udhëheqësin shkencor.*

*U përpoqëm që materiali të ishte i qartë dhe i plotë, madje guxuam të trajtonin edhe ndonjë rast të veçantë.*

*Njëkohësisht, për çështjet e trajtuara shfrytëzuam edhe një literaturë mjaft shteruese. Dëshiroj që me kryerjen e këtij punimi disertacioni, të jap një ndihmesë, qoftë edhe modeste, në nxjerrjen në pah të disa çështjeve gjuhësore, në shërbim të studimeve albanologjike.*

*Ky punim ka si qëllim të parë t'i shërbejë studimit të historisë së gjuhës shqipe dhe të kulturës shqipe në shekullin e nëntëmbëdhjetë.*

*Nëpërmjet këtij punimi jemi përpjekur t'i plotësojmë duke studiuar më gjerë sistemet gjuhësore të veprave të këtyre autorëve.*

*Nuk do të ishte i mundur realizimi i kësaj teme disertacioni pa pasur mbështetjen e prof.dr.Tomor Osmanit, udhëheqësit shkencor, ndaj të cilit, dua të shpreh mirënjohjen*

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

*time. Që në fillim më nxiti në ideimin e kësaj teme disertacioni dhe sistematikisht më orientoi drejt materialeve burimore shkencore që duhej të shfrytëzoja për realizimin e plotë të këtij punimi.*

*Falënderoj Qendrën e Studimeve Albanologjike të Universitetit të Shkodrës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore, për mundësinë e ndjekjes së këtij programi studimesh dhe miratimin e kësaj teme doktorale.*

*Një falënderim i veçantë u atribuohet edhe pedagogëve të Departamentit të Gjuhës Shqipe për ndihmën e pakursyer, për këshillat e orientimet në disa çështje të trajtuara në këtë tezë.*

*Faleminderit familjes sime për mbështetjen dhe mirëkuptimin!*

*Në përfundim themi se interesi për të ndërmarrë një nismë të tillë, për kryerjen e këtij studimi, lidhet me thellimin e studimeve të mëtejshme për këto autorë dhe problematikat që shtron përdorimi i gjuhës shqipe nga lëvruesit e saj gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë. Sa më shumë të njihemi me shkrimet e vjetra shqipe, aq më shumë të shtohet dëshira të njohësh çdo aspekt gjuhësor që përfaqësojnë këto vepra. Prandaj, dëshira për studime të mëtejshme të veprës së autorëve të vjetër të shqipes, ngelet një aspiratë më vete për zbulime të mëtejshme që lidhen me veprat e këtyre autorëve .*

*Duke shfaqur admirimin dhe vlerësimin maksimal për këta autorë dhe veprat e tyre, shpresoj që studimi ynë të ofrohet edhe si një thirrje që gjuha e këtyre shkrimtarëve të mos lihet në harresë.*

**Shkurtesat:**

- DSH I, III = Dialektologjia shqiptare, I, III, Tiranë, 1971, 1975.**  
**FE=“Fjalori etimologjik“, G.Meyer, 1871.**  
**FESH= Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Tiranë,1985.**  
**FO=“Fjalori i orientalizmave“, T.Dizdari, Tiranë, 2010.**  
**FG= “Fjalori krahinor i Nikoll Gzullit, 2005.**  
**FGJSSH= “Fjalori i gjuhës së sotme shqipe“,1980.**  
**FGJSSH=“Fjalori i gjuhës së sotme shqipe“, 2006.**  
**SF1=“Studime filologjike 1“, Tiranë, 1975.**  
**SF2=“Studime filologjike 1“, Tiranë, 1967.**  
**AKSH=Akademia e Shkencave e Shqipërisë.**  
**D.C.= Dotrina e kerscten me msime e scpiegime, Shkodër, 1876.**  
**V= Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree, 1882.**

### Hyrje

**Të dhëna për jetën dhe krijimtarinë botuese dhe në dorëshkrim të autorëve :  
Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi.**

Vendin e parë, përta i përket prodhimtarisë letrare, e zë letërsia e lëvruar nga shkrimtarët e veriut. E iniciuar në shekullin XV, ku shkrimtarët kryesorë janë: Buzuku, Budi, Bardhi, Bogdani, Kazazi, arrin e kompletuar gjer në shekullin XIX me shkrimtarë : *Pjetër Zarishi , Ëngjëll Radoja , Dario Buçareli, Leonardo De Martino, Ndue Bytyçi, Pashko Babi, Preng Doçi, dhe Zef Jubani (Ndokillija).*<sup>1</sup>

Ky prodhim letrar u zhvillua nga pena e atyre shkrimtarëve, shumica e të cilëve botuan shkrimet e tyre nga Propaganda Fide dhe ishin nën patronazhin e kishës katolike që ishte e orientuar nga Italia. Katolikët e Shkodrës, në mesin e shekullit XIX, ishin edhe nën mbrojtjen e Austrisë, e cila nëpërmjet një pakti traktatesh me portën e lartë kishte fituar të drejtën e mbrojtjes së popullsisë katolike në Ballkan, ku ishte e përfshirë dhe Shqipëria.

Austria pati një impakt të fuqishëm në rindërtimin e shkollave dhe hapjen e kishave në zonat e veriut. Shpejt ajo do ta bëjë zonën e veriut një qendër kulturore e letrare.

Ndikim të fuqishëm në rindërtimin dhe lulëzimin e qendrës së veriut, do të kishin në fillim të shekulli XX edhe françeskanët dhe jezuitët. Në këto qendra formësuan intelektualitetin e vet edhe shkrimtarët e sipërpërmendur.

### ËNGJËLL RADOJA(1820-1880)

#### Jeta.


Ëngjëll Radoja lindi në vitin 1820 në qytetin e Shkodrës dhe vdiq në vitin 1880. Ai ishte klerik, mësues dhe shkrimtar që jetoi dhe lëvroi me shkrimet e tij në gjysmës së dytë të shekullit XIX. Njihet ndryshe me emrin dom Angelo Radoja, iniciuar nga shërbimi i tij si prift katolik. Studimet i kreu në kolegjin e Propoganda Fides në Romë. Pas përfundimit të studimeve do të kthehet në Shqipëri dhe do të shërbejë me devotshmëri si famullitar në qytetin e Shkodrës dhe më vonë si vikar i përgjithshëm i dioqezës po në Shkodër.

Radoja ishte një njeri me kulturë të gjerë, njohës i shkëlqyer i latinishtes dhe i shqipes, patriot i dalluar, e mbi të gjitha ai vlerësohet për përpjekjet për t'i dhënë një karakter letrar veprës së tij duke u afirmuar edhe në krah të autorëve të tjerë bashkëkohës të cilët shfaqën shqetësimin e tyre për përdorimin pa kriter të arabizmave e turqizmave.

*Pas Bogdanit, atë Ëngjëll Radoja është i pari shkrimtar, që dëfrehet t'u japë trajtë letrare shkrimeve të tij, madje mburret me zotësinë e tij të veçantë. Ai duhet konsideruar, prandaj, fillues i vërtetë i prozës letrare shkodrane të periodës së dytë.*<sup>2</sup>

#### Veprimtaria letrare.

Ai është i pari shqiptar i asaj periudhe që botoi në Romë, më 1862, librin shqip “ *Lajmtari i zemërs t'Jezu Krusctit*”. Më pas boton librin e dytë, po në Romë më 1872 “ *Koncili i dheut të Shqypnis bamun në vjetë 1703 në kohë të Papës Shqyptarit*



<sup>1</sup>R.Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997, f.164

<sup>2</sup>Dh.Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1852*, Rilindja, Prishtinë, 1978. FESH, III, Tiranë, 2009, f.2198.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

*Klement të Njimbëdhjetit*” dhe një përkthim i ri i materialeve të Kuvendit të Arbënit dhe “*Dotrina e kërscen me msime e me spiegime*” botuar në Shkodër më 1876, për të cilin thuhet se është katekizmi i vetëm i hershëm i shkruar drejtpërdrejt në shqip, meqë katekizmat e tjerë kishin qenë të gjitha përkthime nga gjuhët e tjera.<sup>3</sup>

“*Konqili i dheut të Shqypnis bamun në vjetë 1703 në kohë të Papës Shqyptarit Klement të Njimbëdhjetit*”, version në shqip, Radoja e ligjëroi me 14-15 janar në kishën e Shën Gjorit të fshatit Mërqi<sup>4</sup>. Këtë vepër autori do ta ribotojë sërish, kësaj here duke e përshtatur sipas dialektit të vet. Kjo vepër do të jetë fillimi i rrugëtimit që do të marrë më pas ky shkrimtar, pasi botimet e mëpastajme i shkruan në shkoderanishte, e cila kishte traditë të gjatë shkrimi. Dy ishin shtysat kryesore që e nxitën të shkruante: së pari edukimi fetar dhe së dyti angazhimi në çështje kombëtare. Në veprat e tij spikat *pikëpamja e tij patriotike*<sup>5</sup>, sidomos mendim që e shpreh hapur tek “Kuvendi i Arbënit”, pasi “*Doktrina e kërscen me msime e me spiegime*” mbështetet sidomos në subjekt laik. *Do jetë pikërisht ky angazhim me qëndrimin e tij antiaustriak, por mbi të gjitha qëndrimi antiturk, i cili do t’i marrë jetën në vitin 1880 nga një helmim i rëndë*<sup>6</sup>.

### **PASHKO BABI ( 1843-1905)**

#### **Jeta.**

Pashko Babi, lindur dhe rritur në qytetin e Shkodrës më 1843, reflektonte sjelljen dhe bujarinë e një shkoderani. Hyri në shkollë në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare dhe për pesë vjet kreu studimet në Kolegjin Papnore Shqyptare. Gjithë jetën e kaloi si famullitar nëpër katunde të ndryshme e sidomos në Sheldi. Për një kohë, Babi shërbeu në famulli, ku radhiste regjistra famullitare të Sheldisë, ku mbante shënim kronika të ndodhive të vendit. Më pas shërbeu si famullitar në vende të ndryshme të Shqipërisë. Letrat që shkruante Babi patën një vlerë gjuhësore për historinë e gjuhës shqipe.

---

<sup>3</sup> A.Haxhi,-T.Topalli, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 2007,f.106.

<sup>4</sup> Fshati Mërqi ndodhet tre kilometra në veri të qytetit të Lezhës.

<sup>5</sup> R.Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit 1706*, Prishtinë 1985, fq. 39

<sup>6</sup> Dh.Shuteriqi, *Nëpër shekujt letrarë*, Studime letrare, Tiranë 1973; Shkrimtarët shqiptarë, Tiranë 1941, f. 152.



### Veprimtaria letrare.



Botimi i parë i plotë i Pashko Babit është vepra “*Vakinat e lig's hershme dhe lig's ree*”, botuar më 1882. Ky libër realisht ishte shkruar me qëllim që të shërbente si tekst shkollor. Babi shkroi dhe dramën “*I biri i çifutit*”, duke e klasifikuar atë si një ndër dramaturgët e parë shqiptarë.

Pasuria e mrekullueshme e gjuhës, me një frazë “plot gjallëri ngjyrash”, është një rrëfimi (kallëzimi)

strukturuar mbi bazën e shpesh edhe me subjekt bashkëbisedimi.

Mbizotëron një ndërthurje klasike mes një rrëfimi klasik e popullor njëherësh, duke e bërë veprën e tij mjaft tërheqëse.

Me endje të madhe lexohet vepra e Babit, por mjerisht për shumë kohë ky autor kishte mbetur nën hijen e territ dhe nuk u vlerësua me kohën, pavarësisht faktit se shpesh thuhet që ky shkrimtar ishte pararojës i shkrimeve të mëvonshme. Gjithsesi Pashko Babi është dhe mbetet një ndër ata letrarë që denjësisht përfaqëson letërsinë shkodrane të shekullit XIX.



### NDUE BYTYÇI (1847-1917)

#### Jeta.

Ndue Bytyçi i përket grupit të shkrimtarëve të klerit të veriut, të cilët shkruan vepra fetare, por që trajtonin edhe tema nga jeta aktuale e kohës kur jetuan. Veçanërisht, tek ky shkrimtar fillon të trajtohet me nota të theksuara motivi patriotik.

Për jetën e Ndue Bytyçit ka fare pak të dhëna. Lindi në vitin 1847 dhe vdiq në vitin 1917. Për vendlindjen e tij jepen dy burime. Duke u mbështetur tek Historia e letërsisë shqipe<sup>7</sup> vendlinda e autorit është Kosova, ndërsa studiuesi Dhimitër Fullani<sup>8</sup> dhe Fjalori enciklopedik Shqiptar<sup>9</sup> përshkruajnë se vendlindja e tij ishte Shkupi. Mësimet e para i mori në vendlindje. Në moshën 12 vjeçare vazhdon mësimet në kolegjin Saverian të Shkodrës dhe ishte i treti nxënës i Kolegjit. Për dhjetë vjet i kreu studimet me rezultate të shkëlqyera dhe në moshën 22 vjeçare kthehet në vendlindje.

Gjatë jetës së tij sherbeu si prift në kisha të ndryshme të Kosovës, më së shumti në Pejë, Prizren e Shkup.

<sup>7</sup> HLSH I-II, Prishtinë, 1968 fq 417 dhe HLSH, Prishtinë, 1989, f.146.

<sup>8</sup> Dh.Fullani, Ndue Bytyqi, “Nëndori”, Tiranë, 1985, f 138.

FESH, III, Tiranë, 2008,f.352.

<sup>9</sup> Fjalori enciklopedik shqiptar, Tiranë,1985,f.138.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

### **Veprimtaria letrare.**

Ashtu si shumica e klerikëve të kohës, edhe Bytyçi lëvroi shkrime me tematikë fetare. Realizoi përkthimin e “*Psallmave të Davidit*”, që nuk është botuar dhe “*Urdhnimet e Tenzot e t’shejtes Kish*”. Bytyçi shquhet edhe si poet. Shkroi vjersha origjinale me tema laike, por të cilat mbartin edhe vlera estetike e mbi të gjitha ide përparimtare. Vjershat e tij gjenden të botuara në përmbledhjen e Junkut “*Kulshedra e shpirtit*” me 1887 në Shkodër.

U botuan vjershat: “*Lugati*”, “*Kastigimi*”, “*Barkaxhija*”, “*Peshkaxhija*”, “*Çobajt*”, “*Mymleqeti*”. Bytyçi shkroi dhe sonetin kushtuar poetit Leonardo de Martino, i cili u botua në përmbledhjen “*L’arpa d’un italo Albanese*”, më 1881. Gjitha këto poezi u bënë të njohura për lexuesin në vitin 1962, kur u botua në Tiranë “*Antologjia e poezisë shqipe të Rilindjes*” nga Dhimitër Fullani.

### KREU I

#### Kushtet historike shoqërore të gjysmës së dytë të shekullit XIX. Lëvrimi i gegërishtes në këtë periudhë.

Historia ka vërtetuar që çdo popull karakterizohet nga kronologjia dhe ngjarje që e shoqërojnë në zhvillimet historike, të cilat lënë gjurmë të thella në formësimin si komb. Edhe vendi ynë, në shekuj u shoqërua me ndryshime të mëdha, madje mund të themi rrënjësore. Në shekullin XIX u ndërmorën nisma të reja në kulturë, art e mbi të gjitha në lëvrimin e gjuhës shqipe, ku si pikësynim i përfaqësuesve ishte zhvillimi i gjuhës shqipe, krijimi i një alfabeti të përbashkët, rritja e ndërgjegjës kombëtare etj. Kushtet historiko-shoqërore filluan të ndryshonin dhe në këtë mënyrë i hapën rrugë dhe zhvillimit të mëtejshëm të gjuhës shqipe<sup>10</sup>.

Në kushte historike, krijimi dy pashallëqeve të mëdha, i Bushatlinjve në veri dhe i Ali Pashë Tepelenës në jug, ndikuan në një stabilitet politik, ekonomik dhe kulturor në vend. Në qytete dhe qendra të rëndësishme si: Shkodra, Prizreni, Elbasani, Berati, Janina etj pati një rritje e zhvillim ekonomik *ku përparësi mori zejtaria dhe tregtia*<sup>11</sup>.

Për shumë shekuj, synimi i perandorisë turke nuk ishte thjesht pushtimi territorial i vendeve shqiptare, por qëllimi parësor ishte asimilimi i plotë i gjuhës së kombit shqiptar, pasuar kjo me asimilimin fetar e kulturor. Për këtë lindi nevoja e një lëvizjeje të madhe me karakter politik kulturor e arsimor.

Ndërgjegjja kombëtare e popullit filloi të merrte përmasa madhore. Ndodhën ngjarje të mëdha politike si: *shkatërrimi i dy pashallëqeve të mëdha (1822-1831)*, *Reforma e Tanzimatit (1839-1850)*, *Lidhja e Prizrenit*<sup>12</sup> (1873-1881), *Themelimi i Shoqërisë së Skronjave Shqipe të Stambollit (1879)*, *Lidhja e Pejës (1899)*<sup>13</sup> që ndikuan te një rebelim i mbarë popullit shqiptar. Lufta që vazhdoi për një kohë të gjatë solli vetëm rrënim e humbje të thella dhe si pasojë do të demonstron me një rënie drastike dhe të thellë të ekonomisë së vendit. Si pasojë ndikimet do të ishin të pashmangshme edhe në sistemin kulturor, i cili nuk kishte zhvillimin e duhur në këtë shekull.

Në fillim të shekullit XIX, Shqipëria gjendej në një situatë shumë të rënduar arsimore. Nuk kishte libra shqip. Porta e lartë pengonte hapjen e shkollave ku të mësohej gjuha shqipe. Në këto rrethana, një pjesë e popullsisë ishte analfabete dhe një grup tjetër të rinjsh ishin të detyruar të ndiqnin shkollat turke, greke ose shkollat e klerit katolik. *Shqipja, po në këtë kohë, filloi të shkruhej edhe me alfabetet të veçanta*<sup>14</sup>. U përdoren alfabetet të ndryshme si: alfabeti latin, grek, turko-arab. Në këto kushte lindi nevoja i krijimit dhe përdorimit të një alfabeti të përbashkët.

Për të arritur këtë qëllim, më 12 tetor 1879 u themelua “Shoqëria e të shtypurit shkronja shqip” ose siç njihet ndryshe “Shoqëria e Stambollit”. Themeluesit e saj ishin personalitete më në zë të kohës me në krye Sami Frashërin. *U dha zgjidhja që*

<sup>10</sup> A.Haxhi,-T.Topalli, *Historia e gjuhës së shkruar shqipe*, Shkodër, 2007,f.89.

<sup>11</sup> T.Osmani, *Shkrimi i shqipes në shek. VIII dhe fillimet e shek.XIX*, Udhë e shkronjave shqipe, Shkodër,1999,f,87.

<sup>12</sup> Në rrethanat tepër të rrezikshme që u krijuan sidomos pas Traktaktit të Shën Stefanit, përpara shqiptarëve dilte një detyrë shumë e ngutshme kombëtare për mbrojtjen e tokave shqiptare nga copëtimi.Për t’ia arritur këtij qëllimi patriotët shqiptar thirrën një kuvend kombëtar, ku morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha krahinave shqiptare. Ku kuvend filloi punimet në Prizren, me 10 qershor 1878, nën drejtimin e Iljaz Pashë Dibrës. Që në fillim, kuvendi vendosi të formonte Lidhjen e Prizrenit dhe të njoftonte Kongresin e Fuqive të Mëdha. Kuvendi kishte organet drejtuese të Lidhjes: Këshillin e Përgjithshëm me kryetar Iljaz Pashë Dibrën dhe Komitetin Qëndror në të cilin bënin pjesë figura të ndritura të kombit si: Abdyl Frashëri, Sulejman Vokshi, Haxhi Shabani etj.

<sup>13</sup> A.Haxhi,-T.Topalli ,*po aty* ,f.90

<sup>14</sup> T.Osmani, *Shkrimi i shqipes në shek. VIII dhe fillimet e shek.XIX*, Udhë e shkronjave shqipe, Shkodër,1999,f,88.



## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

*gjuha shqipe të kishte një alfabet të vetin , i cili mbështetej ne alfabetin latin .Ky alfabet zbaton parimin fonetik që një fonemë të paraqitet me një shkrojtë. Me hartimin dhe botimin e alfabetit, afërmohej njëkohësisht edhe qënia e kombit dhe e gjuhës shqipe, forca dhe mundësia shprehëse e saj.*<sup>15</sup>

Reforma e nisur nga Vatikanë në vendet e Ballkanit, ku përfshihej edhe Shqipëria, i lejoi dhe i siguroi popullit shqiptar përdorimin e gjuhës shqipe në librat dhe shërbesat fetare, duke zëvendësuar kështu përfundimisht latinishten e italishten.

Nismëtarë të lëvizjes kulturore letrare, u cilësuan shkrimtarët që lëvruan me shkrimet e tyre në shqip gjatë shekullit XVIII-XIX, të cilët u shquan për idetë e tyre përparimtare drejt dhe përkrah zhvillimit të Rilindjes evropiane. Ky grup lëvruesish nxiten dhe brezat e ardhshëm drejt sensibilizimit për mbrojtjen dhe përsosjen e gjuhës amtare. Në shekullin XIX u zhvillua një letërsi artistike laike<sup>16</sup> ku përgjithësisht veprat shkruheshin nga etër françeskanë. Kisha katolike shqiptare, nën ndikimin e Italisë dhe Austrisë, do të jepte një kontribut të shquar në zhvillimin aktiv në fushën e arsimit e të kulturës. U hapën shkolla publike, u themeluan seminare e kolegje fetare të Urdhërit të Jezuitëve dhe Françeskanëve të cilët futën programe mësimore edhe për studimin e gjuhës shqipe. Doli ne qarkullim edhe botimi i revistës së parë në gjuhën shqipe “Lajmtari i zemërs t’Jezu Krisctit”( 1891). Kleri katolik ku bëjnë pjesë dhe autorët Ëngjëll Radojën (1820-1880), Leonardo De Martine (1830-1923), Ndue Bytyçin (1847-1917), Vinçenc Prenushi ( 1885-1949) Faik Konica ( 1875-1942) etj kanë luajtur nje rol inspirues në luftën për ruajtjen dhe zhvillimin e gjuhës shqipe, pavarësisht faktit se për një kohë të gjatë ato u përmenden vetëm si “... autorë të një letërsie hagiografike me karakter gati thjesht fetar, që shkruajnë në gjuhën e folur, plot turqizma të qytetit të Shkodrës.”<sup>17</sup> Autorët e veriut në veprimtarinë botuese përdorën alfabetin latin, si tek autorët e vjetër, por duke huazuar disa shkronja të veçanta.

Kjo lloj letërsie u pasua me veprat e humanistëve shqiptarë Marin Barleti e Marin Beçikemi. Veprat e tyre ishin të karakterit historik kronologjik bazuar në fakte reale të luftës së popullit të tyre.

Gjergj Fishta, misionari, famulltari, letrari, poeti që pati një jetë shumë aktive në trevat e veriut. E shohim duke shërbyer si famulltar në famullinë e Lezhës dhe më pas për shumë kohë shpërndan dije për brezat e rinj në kolegjin e Troshanit.

Në bashkëpunim me mikun e tij Preng Doçin krijuan shoqërinë letrare e kulturore “Bashkimi”. Drejtoi shkollën françkane dhe bëri përpjekje të arritshme për të futur gjuhën shqipe në shkollë. Aktiviteti i tij vazhdon me përgjegjësinë që merr si kryetar i komisionit të hartimit të alfabetit të gjuhës shqipe në Manastir (1908) si dhe për themelimin e revistës kulturore “Hylli i Dritës” (Shkodër 1913) në të cilën gjënden shumë botime, pasuar kjo dhe me hapjen e shtypshkronjës françeskane.

Vrulli i Gjergj Fishtës për mësimdhënie nuk resht, përkundrazi atë e shohim gjithnjë aktiv në çështjen e mbrojtjes dhe përhapjes së mësimit të gjuhës shqipe. Ky sukses konkludohet dhe me përrurimin e gjimnazit “Illyricum” në Shkodër, i cili do të mbajë edhe emrin e tij. Do të ishin këta prelude të kohës që do t’i jepnin emrin këtij shekulli.

<sup>15</sup> T.Osmani, Po aty, f.308-314.

<sup>16</sup> A.Haxhi,-T.Topalli , po aty, f. 90.

<sup>17</sup> Universiteti shtetëror i Tiranës, *Historia e letërsisë shqipe*, 1, 1959, f 274.

### **KREU II**

**Shkodra, qendër e rëndësishme kulturore - letrare e arsimore në gjysmën e dytë të shekullit XIX.**

**Gjendja e studimeve gjuhësore gjatë kësaj periudhe.**

Shkodra (Scutari), qyteti 2400 vjeçar, i shtrirë në pjesën jugore të Ultësirës së Mbishkodrës<sup>18</sup>, mbështetur në pozitën e favorshme gjeografike, ishte një lidhje me qytetërimin perëndimor e lindor përmes rrugëve tokësore e ujore<sup>19</sup>.

Shkodra, si qendër urbane ishte ndërtuar përreth kështjellës “Rozafa”, që u rikonstruktua nga venedikasit sipas stilit të tyre bashkë me katedralen e “Shën Stefanit”, të cilat edhe sot e kësaj dite tërheqin vazhdimisht vëmendjen e turistëve, duke i klasifikuar kështu në një ndër pikat më të veçanta turisike.<sup>20</sup>

Deri në gjysmën e shekullit XIX, ky qytet nuk ishte e zhvilluar si rezultat i një pushtimi të gjatë osman. Pas gjysmës së parë të shekullit XIX, Shkodrën do ta shohim si një qendër politike, administrative, kulturore. Familjet aristokrate shkodrane, si: Kamsi, Serreqi, Radovani, Suma etj, si rezultat i lidhjes së tyre me botën perëndimore, i shkolluan fëmijët e tyre në vendet evropiane si: në Romë, Trieste etj.

Në këtë periudhë zhvillohen edhe disa qytete, si: Shurdhahu (Sarda), Drishti (Drivastum), Shasi (Suacium), Danja (Dagnum), të cilat ndihmuan në zhvillimin ekonomik e tregtar të qytetit të Shkodrës.

Qyteti verior, shfaqet edhe si një qendër e zhvilluar juridike, pasi më 1346<sup>21</sup> hartoi dhe vazhdoi të funksiononte kodi i zgjeruar ligjor me 270 nene juridike bashkëkohore, të cilat përcaktonin qartë normat, detyrat, sanksionet, funksionimin e gjykatave etj. në këtë qytet verior, duke e bazuar këtë në funksionimin me vendet evropiane. Përdorimi i këtij kodi ndikoi si një “rregullator” në përmirësimin e funksionimit të shtetit dhe në një rritje të nivelit të mirëqënies shoqërore të Shkodrës.

Me zhvillimin ekonomik u zhvilluan edhe shkëmbimet tregtare, prodhimet dhe eksportimet e verës, prodhimet zejtare, zhvillimi i peshkimit etj.<sup>22</sup> U mundësua shitblerja në vende të ndryshme të Venedikut, Italisë, Dubrovnikut, të cilat ndikuan dukshëm në zhvillimin ekonomik.<sup>23</sup>

Bashkë me arritjen e një statusi të lartë ekonomik e juridik, ky qytet do të kishte dhe një status kulturor. Njëkohësisht ishte krijuar dhe shtresa e borgjezisë. Në shekullin XIX funksiononin konsullata angleze, italiane, austro-hungareze etj.

Binin në sy rrugica e Pijacës<sup>24</sup>, pazari i qytetit<sup>25</sup>, ndërtimi i shtëpive shkodrane me dekorime e me stil borgjez, me oborre të rrethuara me mure të larta guri, me çardak,

<sup>18</sup>W.Kamsi, *Shtrirja e qytetit të Shkodrës në kohën e lashtë dhe të mesme*, Monumentet, 1976, Nr. 11 f.117-123

<sup>19</sup> Qyteti i Shkodrës laget nga tre lumenj: Drini, Kiri dhe Buna si dhe nga liqeni i Shkodrës.

<sup>20</sup> W.Kamsi, *Shtrirja e qytetit të Shkodrës në kohën e lashtë dhe të mesme*, Monumentet 1976 Nr. 11 f.117-123

<sup>21</sup> Statuti di Scutari, Corpus Staturoidelle Venezia. A cura di Lucia Nadiu. Pellegrini Oliver Jens Schmitt, Viella, Roma 2002

<sup>22</sup> I.Zamputi, Regjistri i Kadastrës dhe i koncensioneve për rrethin e Shkodës 1416-1417, Akademia e Shkencave e Republikës të Shqipërisë, Insituti i Historisë, Tiranë 1977.

<sup>23</sup> E.Papa, Profili i një qyteti mesdhetar: rasti i Shkodrës mesjetare (shek. XIV-XV): Hylli i Dritës, XXVI, nr.2. Shkodër 2006 f.16.

<sup>24</sup> Ndërtuar në fillim të shekullit XX, projektuar nga Kolë Idromeno. Ideuar sipas modelit klasik, me punime të gdhendura në gur e dru, dekuruar me tulla.

<sup>25</sup> Pazari kishte 2500 dyqane, 3 km i gjatë. Ky Pazar ishte një urë lidhëse me brigjet e Adriatikut e më gjërë, lindjen e mesme e deri në Afrikën veriore. Kishte një zhvillim të madh tregtar.

me tavane druri me gdhendje, kopshte me lule e pemë të shumëllojshme ( me dy lulet simbolike që gjendeshin në çdo oborr shkodran: lulebora dhe shermasheku).

Shekujt XIX (gjysma e dytë e shekullit XIX) \ XX pasuan me një zhvillim kulturor me të civilizuar, ku u hapën, kisha, xhamia, katedrale, muze, dyqane, zyra konsullore, biblioteka<sup>26</sup>, shtypshkronja, studio fotografie, si ajo “Marubi”<sup>27</sup>, librari duke i dhënë një vlerë madhështore këtij qyteti.<sup>28</sup>

Letërkëmbimi ishte një formë tjetër për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe në shekullin XVIII-XIX, nga borgjezia shkodrane e sidomos tregtarët. Rreth kësaj vërtetësie mbështetemi edhe në citimin e prof. Tomor Osmanit, i cili thekson: “ *Shkrimi i shqipes në letërkëmbimin privat, ishte më i theksuar në Shkodër edhe për vetë qënien e një tradite të shkrimit shqip me shkronja latine, prej 3-4 shekujsh.* ”<sup>29</sup>

Për më tepër, Zija Shkodra shënon disa letra si: letrën e Jak Biankut drejtuar firmës tregtare me të njëjtën emër në Venedik 1865; letrën e Ejll Curanit për Jak Biankun në Shkodër 1865; testamentin shqip të një tregtari nga Shkodra me 1867; letër shqip e Gasper Çobës në Korfuz drejtuar vëllait të vet në Shkodër 1874; letra e tregtarëve Gjokë Rraboshta, Reshit Hoti, Zef Luli, Pashko Kraja e plot të tjerë.<sup>30</sup>

Gjatë shekullit XVIII-XIX mori zhvillim edhe gazetaria. Më 24 qershor 1879, botohet gazeta e parë “Iskodra”, një e përjavshme në gjuhën shqipe dhe turke. Kjo gazetë luante rolin e një organi zyrtar në vilajetin e Shkodrës. Më pas, kjo gazetë do të bëhej organ i Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në vitin 1880, kur dhe mori emrin “Shkodra”.<sup>31</sup>

<sup>26</sup> Fillimisht, në fund të shekullit XVIII, Mehmet Pashë Plaku themeloi bibliotekën në Shkodër, e cila kishte rreth 3000 volumi teologji, tekste shkollore, jurisprudencë etj. Në këtë bibliotekë gjendeshin edhe disa libra të shkruar në shqip. Të gjithë librat mbanin vulën e Mustafa Pashës.

H. Bushati, “*Shkodra dhe motet*”, vëll II, f. 97-98.

Pas saj vinte biblioteka e françeskanëve dhe ajo e jezuitëve u krijua në vitin 1875 të vendosura në dy nga dhomat e kuvendit të Gjuhadolit. Më pas, u dha një fond, i cili iu dha në administrim Gjergj Fishtës, që projektoi me 1935 bibliotekën e re. Kjo godinë e re u konceptua sipas një zgjidhje mjaft tërheqëse kulturore e arkitekturore, kur vihet re kombinimi i hapësirës, dritës, mobilimeve, siç estetikës klasike dhe asaj modern me dru gështenje në një hapësirë dykatëshe që lidhej me një shkallë hekuri. Fondi I saj arriti në mbi 15 000 volume në albanologji, histori, filozofi, teologji, pa anashkaluar letërsinë. Në vitin 1946 biblioteka u konfiskua nga shteti. Kjo bibliotekë u rindërtua sipas formës së mëparshme në vitin 2003 duke rimarrë emrin “ At Gjergj Fishta.” Mbështetur në shkrimin: Bardhyli (pseudonimi Llukë karafili), “ *Historia e bibliotekave në Shqipëri*”, Hylli i Dritës, vjeti XVIII\ 1942, Nr. 5-10, Maj –Tetor 1942, f.314-315

<sup>27</sup> Fotografia e dinastisë Marubi është ndër më të njohurat në fushën e fotografisë ballkanike, madje dhe evropiane në gjysmën e dytë të shekullit XIX dhe gjysmën e parë të shekullit XX. Fotografia e parë e “Hamzë Kazazit” u realizua me 1855 nga Pjetër Marubi (1834-1903). Trashëgimia e këtij arti u pasua më pas nga Kel Marubi (1870-1940), Gegë Marubi, e Kolë Idromeno 1860-1939). Ishte Kel Marubi që e ngriti fotografinë shqiptare në nivelin e artit duke hapur edhe një atelie. Këtë e vazhdoi dhe Geg Marubi, i cili studio në shkollën profesionale të Kinematografisë dhe Fotografisë në Paris. Kjo fototekë ka shënuar në kujtime shumë ngjarje historike të popullit si: “Kryengritja e Mirditës” ( 1876-1877); Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1889) si dhe foto të personaliteteve të shquara si : Gjergj Fishta, Ernest Koliqi, Migjeni, Ahmet Zogu, Dedë Gjo Luli, Azem Galica e shumë personalitete të kohës. Mbështetur në literature: Vrioni, Qerim, *150 vjet fotografi shqiptare*, Milosao, Tiranë 2009, f.120.

<sup>28</sup> W.Kamsi, *Kultura e Shkodrës për kombin shqiptar*, Shkodra në shekuj (16-17 Nëntor 1998), Vëll. I Shkodër 2000, f. 53-60.

<sup>29</sup> T.Osmani, *Tradita e shkrimit të shqipes në Shkodër*, “Shkodra në shekuj, vëll III, Shkodër, Rozafa “1”, 2004, f.31.

<sup>30</sup> Z.Shkodra, *Çështje të tregut shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare* “Studime Historike” Nr. 2, Tiranë 1978, f.83

<sup>31</sup> T.Osmani, *Komisia Letrare Shqipe në Shkodër (1916-1918)*, Shkodër, Camaj-Pipa, 2004, f.16.

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

Më pas, në shekullin XIX, me 1891 fillon botimi i revistës “Lajmtari i zemërs t’ Jezu Krisctit”, një e përkohshme mujore, në Kolegjin e Jezuitëve në Shkodër.

Në këtë periudhë edhe letërsia pati një hov të madh. Siç shprehet edhe Kolë Ashta në një studim të tij se “ *Gati të gjithë shkrimtarët, që jetuen në Shkodër, vetvetiu sollen një shej të veçantë në veprat e veta, u prirën në një “izëm” dallues, që mund ta emnojmë “shkodranizëm”.* Kjo rrymë nazi shkrimtarët të thellohen në shpirtin e popullit shkodran e në prodhimin e tij letrar, ku lulzuen të gjithë gjinit letrare popullore: valle, satira....kangë trimnije, dasdash, vaji, djepi. Ky popull krijues shtyni shkrimtarët gegë të zbulojnë mshehsit e popullit nordik ilir.”<sup>32</sup>

Kjo letërsi mori vlera të tjera, sidomos pas një shtyese të madhe pas arsimit të këtij brezi në kolegjet fetare të Urdhërit të Jezuitëve dhe Françeskanëve, të cilët dhanë një kontribut shumë të çmuar. Shaban Sinani shprehet: “ *Françeskanët shqiptarë, duke pasur një mjedis kulturor të përbashkët, një kryeqendër veprimi (Shkodrën), një tribunë shprehjeje (Hylli i Dritës), një mjeshtër (At Gjergj Fishtë) dhe një slogan që u shërbente si devizë (Fe e atme).*”<sup>33</sup>

Me 1859 hapin një seminar me emrin “Kolegji Papnuer Shqiptar”. Me 1870 lajmërohet hapja e shtypshkronjës e njëherësh shtëpi botuese e “Zojës së Papërlyeme”. *Dhe është fakt që gramatikat e para të gjuhës shqipe që u botuan në truall shqipfolës hedhin rrënjë pikërisht në Shkodër pas themelimit të shtypshkronjës së “Zojës së Papërlyeme” (1870). Dallojmë manualin “Regole grammaticali sulla lingua Albanese compilate da P.Giacomo Jungg d. C. d.G” që u botua në Shkodër në vitin 1880 dhe ka për autor P.Giacomo Jungg-un, I cili nuk mungoi të theksojë edhe bashkëpunimin kolegjal me At Ëngjëll Radojën*<sup>34</sup>. Me 17 tetor 1877 dhe me 1926 hapin Kolegjin Saverian<sup>35</sup>.

Me 1970 jezuitët hapin edhe shtypshkronjën me të cilën u bënë shumë botime të kohës.

Kjo periudhë luajti një rol të rëndësishëm në hapat e zhvillimit të letërsisë e kulturës së kombit tonë e në veçanti të qytetit të Shkodrës. Lëvizjet kulturore u shquan për frymën e tyre patriotike, liberale e zhvillimore të qytetit në vitet që pasuan. Në të vërtetë përfaqësuesit e kësaj shkolle përfaqësuan një grup shkrimtarësh që i bashkonte një doktrinë e caktuar, ndiqnin të njëjtin institucion studimi, me të njëjtat teori dhe platformë studimi.

<sup>32</sup> K.Ashta, *Bota lirike e Prenushit*, Hylli I Dritës, Vjeti XVI\ 1940 Nr 7-9, Korrik-Shtatuer 1940, f. 375.

<sup>33</sup> Sh. Sinani, *Besimi dhe kombësia një vepër të pabotuar të Gjergj Fishtës*, Mendimi shqiptar dhe shkolla shqipe, Aktet, Tiranë, 2009, QSA, Plejad, Tiranë 2009, f. 229.

<sup>34</sup>B. Demiraj, *Shkodra-qendër albanologjike në prag të pavarësisë*, Shkodra në shekuj, Shkodër, 2017, f.9.

<sup>35</sup> Kolegji Saverian ndër 50 vjetët e para 1877-1878; 1927-1928. Shtypshkronja “Zoja e papërlyeme”, Shkodër 1928, f.174.

### **KREU III**

#### **Sistemi grafik i tre autorëve: të përbashkëtat dhe dallimet.**

#### **Ndikimi i sistemit grafik të autorëve të vjetër.**

Me alfabetin latin u shkrua dokumenti i para i shqipes: “Formula e pagëzimit” (1462), dhe libri i parë shqip “ Meshari” i Buzukut (1555) dhe vazhdoi duke u përdorur nga të gjithë autorët e vjetër .

Përdorimi i këtij alfabeti lidhet edhe me faktin se autorët e kësaj periudhe shkrimore ishin klerikë që shkruanin ose mbanin kumtesa fetare në latinisht. Njëkohësisht, në këtë periudhë kishte dhe shumë përkthime nga latinishtja, por edhe nga italishtja, të cilat ndikuan në grafisë e përdorur.

Edhe në veprat e autorëve veriorë që kemi në studim Ëngjell Radoja, Pashko Babi dhe Ndue Bytyçi janë shkruar me alfabet latin. Alfabetin e përdorur nga autorët që po shqyrtojmë, po e paraqesim me pasqyrat e mëposhtme krahasuar me alfabetin e sotëm.

#### **Alfabeti i Ëngjell Radojës (1876 )**

Ëngjell Radoja, autori që i përket gjysmës së dytë të shekullit XIX, na la trashëgim veprën “Dotrina e kerscten me msime e scpiegime“ (1876). Me rëndësi për punimin tonë është edhe alfabeti i përdorur në këtë vepër.

Baza e alfabetit të Radojës është ai latin. Autori pasqyroi në veprën e tij, tinguj me të njëjtën vlerë fonetike si në alfabetin e autorëve pararendës: a, b, c, d, e, f, g, gi, h, i, l, m, n, o, p, r, s, sc, t, u, v, y, ε, z.

Mungojnë shkronjat xh dhe zh pasi nuk kemi ndeshur fjalë me këto dy fonema.

Në sistemin grafik të tij, Radoja ruajti tri shenja si : ξ për dh; ζξ për th; γ për y; dhe ε për z, të cilat dokumentohet tek autorët pararendës të shkrimit të shqipes, por që sipas studiuesit prof. Tomor Osmani<sup>36</sup> këto shkronja tek autorët pararendës karakterizohen nga stilizime përkatëse, veçanërisht shkronjat dh , th dhe y.

Shkronja dh, në këtë tekst jepet me dy vija paralele të prera në mes, me një të kthyer jo të rumbullakët në fund. Ashtu sikurse Bogdani e Budi autori për të shënuar shkronjën th dyfishon shkronjën dh (ξξ), gjë që nuk vihet re tek Buzuku i cili nuk i dallon grafikisht këto dy shkronja.

...me doren e diaξξt ξξam...(D.C.f, 19), ...na kaa ξan urçnimin me i dasct anmigt (D.C.f, 92)

Radoja nuk dallon grafikisht zanoren e nga ë. Pjetër Bogdani është autori, i cili për herë të parë në veprën “Çeta e profetëve“ dallon grafikisht zanoren ë nga e –ja duke e përdorur me një theks sipër. Këtë fenomen të shqipes Lekë Matrënga 100 vjet më parë e ka shënuar me dyshkronjëshin ae.<sup>37</sup>Në pasqyrimin e zanores ë, pohojmë se autori i kësaj doktrine, nuk ka ndjekur gjurmët e Bogdanit, por ka bërë hapa prapa në kohë duke i shënuar të dy shkronjat e dhe ë me grafemën e, ashtu sikurse identifikohen tek autorët e parë të shqipes Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Pjetër Mazreku dhe Frang Bardhi. nneper (D.C.f, 36) kunnersctue (D.C.f,36) perditscme (D.C. f, 138)

Në këtë botim nuk dallohen qartë shkronjat g-në dhe gj-në; i-në dhe j-në; r-në dhe rr-në, x-në dhe z-në.

Ky autor përvijon në gjurmët e alfabetit të Bogdanit gjë që duket edhe në përdorimin e shkronjës greke λ (landa) me të cilën shënon ll-në.

---

<sup>36</sup> T.Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër 1999, f.69.

<sup>37</sup> T.Osmani, *Udha e shkronjave shqipe*, Shkodër 1999, f.61.



## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

Me grafemën *c* autori shënon disa tinguj, konkretisht:

- grafema *c* shënon një ç: vec ( D.C.f, 96), me ciart (D.C.f, 101)
- edhe me dyfishimin e grafemës *c* (*cc*) autori Ëngjëll Radoja shënon sërish ç : moccme (D.C.f, 76)
- kur grafema *c* shoqërohet me zanoren *i* (*ci*), shënon bashkëtingëlloren qiellzore të shurdhët *q* : turcit (D.C.f, 92).
- kur grafema *c* shoqërohet me *s* (*sc*), shënon shkronjën sh: scium (D.C.f, 46), kerscten (D.C.f, 76), giyscin (D.C.f, 124), miesctri (D.C.f,124).

Përsa i përket grafemës *g*, Radoja e shpreh me një variacion shumëvlerësh si kur përdoret më vete, ashtu edhe në varësi të shoqërimit që ajo ka me shkronja të tjera.

- Kështu, përdorimi i kësaj bashkëtingëlloreje para një bashkëtingëlloreje tjetër shënon një bashkëtingëllore velare *g*...*c*'mcate rrahin n'grabitcii?(D.C.f, 122)
- Kur grafema *g* del e shoqëruar me *n* (*gn*), shënon bashkëtingëlloren hundore *nj*, e cila lehtësisht mund të identifikohet si shkronjë. nnogni (D.C.f, 122), gniofin (D.C.f, 62), gniat (D.C.f, 100), gnial (D.C.f, 117)
- Grafema *g* kur del e shoqëruar me *i* shënon shkronjën gj. asgiaa(D.C.f, 88), giaksiin (D.C.f, 125), magiçpt (D.C.f, 92).

Grafema *g* tek Ëngjëll Radoja shënon edhe shkronjën *q* : lig (D.C.f, 37), ligt ( D.C.f, 167), mig( D.C.f,131) .

Autori shfaq risi pasi dallon përdorimin e dy shenjave grafike *u* dhe *v* për shkronjat përkatëse. Nje pohim dhe mbështetje të një përfundimi të tillë gjejmë edhe tek gjuhëtari R.Ismajlit<sup>38</sup> i cili shprehet se:“... *shekulli XIX shënon momentin e qartësisim të këtyre shenjave, ku Ëngjëll Radoja në veprat e tij i dallon mirëfilli grafemën u nga grafema v të cilat mbartin secila dukuritë e veta. Pas tij të gjithë shkrimtarët e tjerë i dallojnë qartësisht.*“ Me lut Tenson me urat. (f.140) ...ai vet me door t'vet...t'hiescme e t'vyrtyscme...(D.C.f, 92).

Përdor grafinë hundore për të shënuar zanoret hundore :â,ê,î,û,ÿ-hundore.

Radoja: mâ (D.C.f.90), giâa (D.C.f.90) , scêite (D.C.f. 111), perbûeet (D.C.f. 114), mîi-emen(D.C.f.88),permiî (D.C.f. 89), t'lutûnit (D.C.f.60), syÿ (D.C.f.77).

Përsa i përket zanores *o*, autori e shënon në çdo rast si të theksuar (ó) dhe asnjëherë si hundore...dó, prighión, kalzón (D.C.f, 152)

Alfabeti i Ëngjëll Radojës në të dy veprat “ Kuvendi i Arbënit” dhe “ Dotrina e kerscten me msime e scpiegime”, është shumë i afërt me alfabetin e Bogdanit . Por, Radoja në botimin e doktrinës përdor një alfabet më të stabilizuar se në veprën tjetër. Shfaqet më e reduktuar polivalenca e shkronjave, dallon grafemat për shkronjat *l* dhe *ll*, *u* dhe *v*. Me këtë mund të themi se ky autor ndiqte një rrugë për zhvillimin dhe konsolidim e sistemit grafik të shqipes.

<sup>38</sup> R.Ismajli, *Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit* , 1706, Prishtinë 1985, f.98.

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

### Pasqyrë krahasuese e alfabetit të Ëngjell Radojës (1876)

<b>Alfabeti i gjuhës sotme</b>	<b>Alfabeti i përdorur nga autori Ëngjell Radoja në veprën "Dotrina e kerscten me msime e scpiegime" (1876).</b>	<b>Ilustrime me shembuj.</b>
a	a â á aa	gni nât, arka, scplaak,
b	b	bretkozat, barken
c	z	forzohei
ç	c cc ci cchi	arcin (e gjafs), kulecc, ka ciue fucchi
d	d	prei doret, dielt,
dh	ξ	triçet,
e	e ê é eé	déeti, perpin, ênt
ë	e	Perditscme, tieter perse
f	f	n'fagie,
g	g gh	ghrue, goje
gj	g gi	ghaæpe, gind (gjind)
h	h	pluhnin, hataja,
i	i ii	fiala, gni piik
j	j i	miesnates, jebrik
k	k c ch	arken, korrich, cundra
l	L	gni dial,
ll	λ	Popuλin, dieλin
m	m	ankimet,
n	n nn	babilone, nneroi
nj	gn,gni	foscgne, gneni, gnimenn
o	o oo	took, konaku
p	p	porositi,
q	c ci g	plegsiis, viec, kcia, turcit,
r	r	scpirti
rr	r rr	ejarr, refimi
s	s	Israelit, sikur
sh	sc sci	miscin, scinn,
t	t tt	t'lutena, kunescstarve
th	ξξ	kççei,
u	u û ú	siper drûuve,ghusctue,
v	v	vsctira, vieet
x	z	guzon,
xh	-	-
y	γ γγ	kryyt, kyved
z	ε z	Miæen, t'ææat, divozion
zh	-	

**Alfabeti i Pashko Babit ( 1882).**

Alfabeti i përdorur në veprën e Pashko Babit “*Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree*” (1882), nuk ka ndryshime dominuese nga alfabeti i përdorur nga bashkohësi i tij Ëngjëll Radoja. Autori ka përdorur alfabetin latin të cilin e plotëson edhe me shkronjën greke λ (landa) dhe me dy shkronjat sllave ε për z dhe γ për y.

Pashko Babi ndjek gjurmët e Bogdanit për shkronjat e veçanta: ξ për dh; ξξ për th; γ për y; dhe ε për z.

Nën ndikimin e alfabetit italian shoqëron disa shkronja me i si : ci, cci, gni, sci etj.

Me grafemën c autori, ashtu si Radoja, shënon disa tinguj, konkretisht:

-grafema c shënon një ç: ilaac (V.f, 125), cias ( V.f, 149)

-kur grafema c shoqërohet me zanoren i (ci), shënon bashkëtingëlloren qiellzore të shurdhët q : cieλen (V.f, 162),

-kur grafema c shoqërohet me s (sc), shënon shkronjën sh: kiscen (V.f, 163), scef (V.f, 279), gnasctû (V.f, 280)

Ndryshe nga Radoja, ky autor shënon shkronjën zh konkretisht me grafemën sε: *sεduk, sεghatrue*. Por gjejmë edhe shembullin ku zh shënohet me grafemën sc tek fjala: *scduk*. Në këtë mënyrë, mund të themi se autori nuk është konsekuent në dallimin e qartë mes shkronjave sh dhe zh.

Shkruesi i veprës “*Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree*” bën të dallueshme edhe shkronjat g dhe gj. Shkronjën g e shënon në çdo rast me grafemën gh, t’**gh**eume (V.f, 49)...gni **gh**ur (V.f, 9)...provve **gh**aεepit. (V.f, 162)...ndërsa gj me gi . pergieeeg (V.f,228), giarpit (V.f, 280), giuh, virgin (V.f, 280), giymtyrsc (V.f, 291)

-Kur grafema g del e shoqëruar me n (gn), shënon bashkëtingëlloren hundore nj, e cila lehtësisht mund të identifikohet si shkronjë: dyrgnân (V.f, 189) , gnimenn (V.f, 216), gni (V.f, 216), kignat ( V.f, 279)

Grafema g tek Pashko Babi shënon edhe shkronjën q : keg (V.f, 228), hysmetgiaar (V.f, 228), per scog (V.f, 228), hogen keg (V.f, 290), dig (V.f, 233)

Bashkëtingëlloren k, autori e shënon jo vetëm me grafemën k, por edhe me gh...do t’bahet ghadi plaghu per...(V.f, 102)

Ashtu sikurse Radoja, Pashko Babi nuk dallon grafikisht zanoren e dhe ë, të cilat i shënon të dyja me grafemën e.

Autori shfaq luhajtje në dallimin e shkronjave i dhe j, ndërsa dallon qartë shkronjat l dhe ll (λ), r dhe rr; u dhe v.

**l:ll**...e laghou n’Misir...por sa duel fmia atii reεikut.,(f.178-179) e si diiti ma hoλ, muer vesct prei ghojes tyne se n’c’εaman ju iscte duuk hγλi.(f.178)

**r:rr**...me keen **pri**isa e nats...e deçne **rreee** hγγi...(Vakinat, f. 8)

**u: v** ...vedin e kiscte n’reεik, por per at **pûn** kurr nuk diiti me ja looçç mennia...Davidi e **vûu** uεdajen e **vet** n’Cotin.(f.92)

Tek Babi, grafemat z, ε shënojnë bashkëtingëlloren fishkëlluese fërkimore z. maraε(V.f, 59), nnierεve (V.f, 100), kalzoi(V.f, 100).

Me grafemën z, Pashko Babi dallon edhe shkronjën x: zuer ( V.f, 125), zierr (V.f, 125).



## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

Ky autor bën të dallueshme zanoret hundore pavarësisht se nuk është konsequent në përdorimin e tyre: bâa (V. 36), ânrragia (V. f, 36), scêite (V., f. 70), regît (V.f. 97), pûn (V.f, 92), sÿÿ (V.f,71).

### **Pasqyrë krahasuese e alfabetit të Pashko Babit (1882)**

<b>Alfabeti i gjuhës së sotme</b>	<b>Alfabeti i përdorur nga autori Pashko Babit “Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree” (1882)</b>	<b>Plustrime me shembuj.</b>
a	a, â aa	bâan,raa,la,giâa,kaam
b	b	bâan, bakti
c	z	bretkozat,zofne,
ç	c ci	ilaac,cieËit,ciadra,hÿsmetcii
d	d	drûu,deeti
dh	ÿ	derÿi, eÿe
e	e ê ee	mrêna,eer,leciitne, veseve
ë	e	Kamen katerginn perse
f	f	furrave,fialet,festa
g	gh	breghut,ghema,scegha,ghruscti
gj	gi	giak, virgin,giÿÿ
h	h	scehri,hiin
i	i ii	baktii, viami
j	I j	digei,jebriku,fieet
k	k, gh	krânne,veksc,kmisc, plaghu
l	L	bile dal ,lufta
ll	λ	populit, maλkim,cieËet
m	m	motin,,mkatit, mman
n	n, nn	funnit, giemisunna,kunoor
nj	gn	gni, t’gnoom
o	o oo	krojjet,kunoor
p	p	pika,provet
q	c ci g	cinrrue, keg, hÿsmetgiar
r	r	scortar,resdiis,
rr	rr	gierre, varrueme,
s	s	saber,bisedoi,sebep
sh	sc	brescni,sciut, scok,
t	t	giit,t’vet
th	ÿÿ	ÿÿue, ÿÿupra ,ÿÿnegla
u	u û ú	ujit,ascûtû,pruú,ugni,kûnn,fuusc
v	v	vakt,vese,vesctira
x	z	zuer, guzoin
xh	-	-
y	ÿ ÿÿ	dÿÿ, sÿÿ, hÿsmetciare
z	ε z	buue,εemra,eierm, rezighoi.
zh	sε, sc	seduk, scduk, sεghatrue

## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

### **Alfabeti i Ndue Bytyçit .**

Pak kohë pas botimit të veprës “*Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree*” (1882) të Pashko Babit, botohet “*Urdhnimet e Tenzot e t’shejtes Kish*” e Ndue Bytyçit. Bytyçi në shkrimet e tij ndoqi traditën duke përdorur alfabetin latin të plotësuar me shkronja të veçanta ç për dh; çç për th; y për y; dhe ε për z si autorët pararendës. Mbështet fort tek alfabeti i përdorur nga Pashko Babi, me disa ndryshime të vogla.

Ndryshe nga Pashko Babi, Ndue Bytyçi dallon qartë fonemat *i* dhe *j*. Po kështu dallon edhe fonemat *l* dhe *ll* (*λ*); *r* dhe *rr*; *x* dhe *z*, por që jo gjithnjë ka qëndrueshmëri në përdorimin e këtyre shkronjave.

Ashtu sikurse Babi, Bytyçi bën të dallueshme edhe shkronjat *g* dhe *gj*, gjë e cila nuk vihet re tek Radoja. Shkronjën *g* e shënon edhe ky autor me grafemën *gh* hangher ...buken t’ghois, (Ξet urçnimet e Tenεotf. 10),...ndërsa *gj* me *gi* gii (Urçnimet.f, 4), giâan (e hui) (Urçnimet.f, 10).

Grafema *c*, në varësi edhe të shoqërimit me shkronja të tjera shënon disa fonema si:

- ç: acik (Urçnimet.f, 12), m’u cbûi (urçnimet.f, 6)
- kur grafema *c* shoqërohet me zanoren *i* (*ci*), shënon bashkëtingëlloren qiellzore të shurdhët *q*: ciiλ, kcija (Urçnimet.f, 13).
- kur grafema *c* shoqërohet me *s* (*sc*), shënon shkronjën *sh*. ta disc (urçnimet.f, 13), me prisc (urçnimet.f, 13).

Kështu dallojmë edhe rastet kur një tingull-fonemë jepet me variante shkronjash, pavarërisht që janë më të kufizuara si tek alfabeti i Radojës dhe i Babit. Kemi rastet: *gj* (*g, gi*); *nj* (*gn, gni*); *z* (*ε, z*).

Duke ecur në gjurmët e Pashko Babit dhe autorëve të tjerë pararendës, bashkëtingëllorja hundore *nj*, dallohet grafikisht me grafemën *gn* :dÿrgnâa (Urçnimet.f, 10).

Themi se alfabeti i Ndue Bytyçit është shumë afër atij të Babit, por shihet më i stabilizuar . Shfaqet më e reduktuar polivalenca e shkronjave si dhe përdorimi i disa grafemave për një tingull. Autori përdor shkronjën *k* me grafemën *k* ashtu sikurse Babi (vetëm një rast është identifikuar me *c* - corrin) dhe qëndron larg Radojës, i cili shkronjën *k* e shënojnë me grafemën *c*, *ch*, *k*. Mendoj se kjo ka të ngjarë se alfabeti i Pashko Babit ishte më afër në kohë dhe më i stabilizuar se ai i Ëngjëll Radojës.

### **Pasqyrë krahasuese e alfabetit të Ndue Bytyçi.**

<b>Alfabeti i gjuhës së sotme</b>	<b>Alfabeti i përdorur nga autori Ndue Bytyçi</b>	<b>Ilustrime me shembuj.</b>
a	a, â aa	Kaa, gâa, kta, batisun,âsct
b	b	n’saber, bee, bâan
c	z	Rrenz, kapuzarit
ç	ci	acik, ciue
d	d	Vedit, dit
dh	ç	urçime, eçë
e	e ê ee	Rrfe,bee,n’rrên,êmni,
ë	e	Terbiete, darsen per
f	f	me fikun, fara,

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

g	gh	ghoi, nghtres, saghlam
gj	g gi	gynahin, gaja, borg.gii
h	h	hak, hiekin
i	i ii	haimalii, saberlii, fmiive
j	j	lajikun, fmija,
k	k	korrin, kam, kamt, kyvetin. ( vetëm në një rast është përdorur grafema c per të shënjuar shkronjën k: s'due ci t'mieLin tiert e t'korrin / per me i maitun mun si corrin f. 12)
l	l	lscn, dal
ll	λ	diaλtin, maλkim
m	m	Medet, mkatit
n	n, nn	nner scortare, mnner, hatron, nep
nj	gn, gni	gni, dγrgnaa
o	o oo	rrenon, korpi, boot, plot,
p	P	Perse, per ghoi
q	c	Scocit (është përdorur vetem në një fjalë)
r	r	rahat, scortar
rr	rr	kurr, ferr, bierret, rrehet
s	s	aspak
sh	sc	Tasc, jan kscten, scok, jusc
t	t	t'true, inatet
th	ξξ	ξξue, ξξupra
u	u	sckannλurin,
v	v	vepra
x	-	-
xh	-	-
y	γγ	tγγ, sγγ, gγγg
z	ε z	Miεen, t'εεeat, zani
zh	-	-

### *Ndikimi i sistemit grafik të autorëve të vjetër, ku ka vazhdimësi dhe risi?*

Në këto botime konstatojmë veçori të përbashkëta, por edhe dallime me sistemin grafik të autorëve të vjetër.

1. Tek të tre autorët Radoja, Babi e Bytyçi përdoren grafemat e veçanta ξ për dh; ξξ për th; ε për z të cilat më pare ndeshim tek autorët e vjetër Buzuku, Budi, Bogdani etj. Radoja: ...me doren e diaξξt ξξam...(D.C.f, 19), ...na kaa ξan urξnimin me i dasct anmigt (D.C.f, 92)

Babi: ...εemra e Faraonit nuk u ξξye. / ...gi mluene ξeen giξξ ugnii.(V.f, 58)

Bytyçi: ...baba e nan i kan ξan jeten...per me t'rrit jan loξ e meten.(Urξnimet.f, 6)

2. Po kështu autorët e lartpërmendur përdorin λ (landa greke) për të shënuar bashkëtingëlloren ll. Por ndryshe nga autorët pararendës, Radoja, Babi dhe Bytyçi

dallojnë qartë grafemat *l* dhe *ll*, kjo pasi në shkrimet e vjetra me *λ* autorët shënonin edhe shkronjën *l* edhe *ll*.

Radoja: ...jena vλαεnue nner vedi..., e lutun per t'gial e per t'dekun. (D.C.f,93)

Babi: ...aso dite batisi halk i maξ n'at popuλ...u suel prei Aronit. (V.f, 66)

Bytyçi: ...me sckanuλ me ja marr/ tui scperpaaλ tui mormorue. (Urçnimet. f,9) / t'tana kto jan psctyma e dialit, ci na i lscn miedis te balit. (Urçnimet. f, 10)

3. Në përdorimin e grafemës *gn* për të shënuar shkronjën *nj*, autorët që po shqyrtojmë ecën në gjurmët e pararendësve Buzuku e Matrenga. Tek Budi e Bogdani janë identifikuar edhe raste ku shkronja *nj* dallohet edhe me *gni*, por që tek autorët tanë nuk shënohen raste të tjera.

Radoja: ...â gniaλ s'dekunit...(D.C.f, 116), ...i gnef t'bâamet...gni mennin t'kec.

(D.C.f, 156), ...gneti m'u largue prei sebetsc...(D.C.f, 157)

Babi: ...ather egnli Rafael cili ghoi...asct urat gi perzielet me gniees...gneni asi egneis...(V.f, 128)

Bytyçi: gni earar, gni derg, gni dek. (Urçnimet.f, 6) ...gni her ne' motmot. (Urçnimet.f, 14)

4. Radoja, Babi e Bytyçi nuk ndoqën shembullin e Bogdanit për të dalluar grafikisht shkronjën *ë* nga *e*-ja, pasi ajo ose është shënuar me grafemën *e*, ose ka rënë në fjalë e çdo pozicion të fjalës, sidomos në pozicion fundor.

Radoja: ...me msue discmit.(D.Cf, 93), ...fmiit e mir ci nneroin nanen...(D.C f, 124)

Babi: ..as nâat as diit gi ju kiscte arç mii krye... dor e mhyÿr per me e leciit. (V.f, 155)

Bytyçi: ...i kam kamt e durt e mija...(Urçnimet.f, 12)

5. Ndryshe nga autorët pararendës, shkrimtarët e shekullit XIX veprat e të cilëve kemi në studim, dallojnë në mënyrë grafike zanoret hundore. Tek autorët e vjetër, sipas studimeve të realizuara, shënimimi i zanores hundore nuk ka qënë gjithnjë i dallueshëm. Kështu tek Buzuku me veprën “Mëshari” (1555) dhe Bogdani me veprën e tij *Cuneus prophetarum* (1685), shënuan grafikisht hundorësinë e zanoreve me grafinë *a + n*. Kjo sipas Çabejt nuk mund të thuhet me siguri nëse do lexohej me *â* (hundore), apo me zanore + bashkëtingëllore *n*. Edhe në tekstin e Kuvendit të Arbënit (1706) nuk është përdorur ndonjë shenjë e veçantë për të treguar këtë tipar të hundorësisë<sup>39</sup>. Dallimi mund të arrihet vetëm duke parë pozicionin dhe mbi bazë të rindërtimit në mbështetje të teksteve të vjetra. Justin Rrota thekson: “Nuk kujdeset shkruesi i Kuvendit t'Arbnit të shënojë assesi zanoren hundore psh asct, bahej<sup>40</sup>etj. “ Por, në tekstin “Doctrina e kerscten “ autori e bën të dallueshme qartë zanoren hundore, ashtu sikurse dhe bashkohësit e tjerë Bytyçi, Babi.

### **Përfundime të kreut të tretë.**

Grafia e shkrimit tek autorët Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi, karakterizohet nga grafema polivalente dhe nga grafema të përbëra, të cila e bëjnë që kjo grafi të jetë e rënduar dhe të shfaqë vështirësi edhe në lexim.

Gjatë studimit, vihet re se autorët Radoja, Babi dhe Bytyçi japin 23 shkronja të alfabetit latin dhe shenjat e veçanta të cilat i ndeshim tek Bogdani. Autorët kanë

---

<sup>39</sup> E.Çabej. *Meshari*, vëll. I. f. 59.

<sup>40</sup> J.Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane, Shkodër 2006, f.115

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

---

përdorur shenja grafike e tinguj që nuk ekzistonin as në alfabetin latin, as në atë Italian, tingujt *ç* për *dh*, *çç* për *dh th* ishin huazuar nga alfabeti grek, ndërsa *γ(y)* nga sllavishtja. Këto shkronja të veçanta autorët i kishin ruajtur nga autorët pararendës.

Sipas Çabejt<sup>41</sup>, bazuar mbi të dhënat e historisë së gjuhës dhe shkrimit të shqipes, *shfrytëzimi i këtyre shenjave lidhet me një nismë individuale të autorëve dhe jo me një ndikim kulturor të mirëfilltë*. Mungesa e këtyre shenjave grafike bëri që këta autorë t'i huazonin nga alfabetet e tjera, konkretisht nga ai grek dhe sllav, duke ndjekur kështu traditën shkrimore mbështetur tek njeri-tjetri.

Ndryshe nga autorët pararendës, shkrimtarët e shekullit XIX veprat e të cilëve kemi në studim, dallojnë në mënyrë grafike zanoret hundore dukuri që tek autorët e vjetër, sipas studimeve të realizuara, nuk ka qënë gjithnjë i dallueshëm.

Dyfishojnë në mjaft raste zanoret <aa>, <ee>, <ii> <γγ> për të shënuar gjatësinë e tyre.

Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi në sistemet shkrimore që përdorin paraqiten shumë afër njëri-tjetrit, por vërehen dhe ndikime. Kështu Radoja është më afër alfabetit të Bogdanit. Babi dhe Bytyçi alfabeti paraqitet më i stabilizuar pasi autorët dallojnë qartë disa shkronja: *g* nga *gj*, *u* nga *v*, *l* nga *ll*, *r* nga *rr*, dukuri të cilën nuk e vëmë re tek Radoja.

Për grafinë e përdorur nga shkrimtarët e shekullit XIX shprehet edhe atë Justin Rrota: *" Mënyra e shkrimit të shqipes, që u përdor ndër botimet e Propagandës një herë dhe mandej me ato të shtypshkronjës së së Paplyemes në Shkodër d.m.th. që prej vjetit 1870...Ky alfabet mund të thomi, se vijoi në përgjithsi udhën që shekullin XVIII e djeri kahë fillimi i këtij shekullit tinë"*<sup>42</sup>

---

<sup>42</sup> J.Rrota, *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*, Botime Françeskane , Shkodër 2006, f.113.

### **KREU IV**

#### **Rreth disa dukurive fonetike të veprës së autorëve.**

Në kapitullin e fonetikës do të analizojmë ato veçori që na janë dukur më të rëndësishme si dhe që përcaktojnë tipare të shkrimit të autorëve.

#### **Ëngjëll Radoja.**

Ëngjëll Radoja lindur dhe rritur në qytetin e Shkodrës, do të shkruajë veprën e tij “Dotrina e kerscten me msime e spjegime” në dialektin e gegërishtes veripërimore. Evidentojmë disa elemente të këtij autori dhe veçori fonetike të cilat do të trajtohen sipas dukurive përkatëse.

#### **Theksi.**

Theksi shfaqet si një fenomen fonetik që ka qenë dhe është një tipar i gegërishtes. Ai është i dukshme në të shkruar. Në, ‘*Rregulla mbi orthografinë e gjuhës shqipe të shkrueme*’, hartuar nga Komisia Letrare Shqipe, u pranuan dy variante të drejtshkrimit të gjuhës shqipe. Në këto rregulla pranohet theksi hundor me kufizime dhe jepen rregulla se ku duhet të përdoren.<sup>43</sup>

#### **Theksi hundor.**

Në këtë vepër janë shënuar dhe janë bërë të dallueshme zanoret hundore si: â, ê, î, û, ŷ-hundore . Përsa i përket zanores o, autori e përdor gjithnjë me një theks sipër: ó dhe jo me theks hundor.

Ëngjëll Radoja në veprën e tij ka përdorur mjaft dendur theksin hundor: mâ (D.C.90), giâa (D.C.90), scêite (D.C. 111), perbûeet (D.C.114), mîi-emen(D.C.88),permiî (D.C.89), t’lutûnit (D.C.60), sŷŷ (D.C.77)

#### **Theksi i mprehtë**

Ky autor është përpjekur të jetë koherent në të shkruar, pasi përdor mjaft shpesh edhe theksin e mprehtë për të theksuar zanoren.

Theksin e gjejmë në fjalë njërrrokëshe:: atá (D.C. 66), jó (D.C. 85), tá (D.C. 122)

Në fjalë dyrrrokëshe:ascû (D.C. 67), msón (D.C. 85), libró (D.C. 85)

Natyrisht që janë vënë re edhe luhatje në të shkruar, që janë të paevitueshme, duke marrë parasysh për kohën kur autori shkroi veprën .

#### **Zanoret e gjata dhe dyfishimi i tyre.**

Në rrafshin fonetik, ajo që bie menjëherë në sy në këtë botim, *duke përbërë një tipar, i cili gjendet rëndom edhe në tekstet e shkrimet e tjera të vjetra, që nga Buzuku*<sup>44</sup>, është ruajtja e dyfishimi i zanoreve për të shënuar gjatësinë. Gjatësia e zanoreve kryesisht është shënuar me dyfishim të shkronjës së thjeshtë. Dallimi i zanoreve të gjata e të shkurta vërehet edhe sot si një dukuri në të folurën në gegërishte. Mbështetur në vëzhgimet tona në veprën “Dotrina e kerscten me msime e spjegime” rezulton dyfishimi i grafemave a, e, i, γ ( y) në pozicion të patheksuar: kaa (D.C.36) bree ( D.C.142) truun (D.C.130) fatkcii (D.C.101) , tγγ (D.C.7), dγγrt (dyrt) ( D.C.37) Në pozicione të tjera kur njëra zanore është e theksuar autori shfaq një parregullsi në shënimin e gjatësisë dhe dyfishimit të zanores.

#### **Togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve.**

<sup>43</sup> *Rregulla mbi orthografinë e gjuhës shqipe të shkrueme*, Komisia Letrare, Shkodër, 1917, f. 7.

<sup>44</sup> Sipas Çabejt kjo është një dukuri pak e studiuar gjer më sot. Cit. Studime gjuhësore VI, Prishtinë 1977, f. 87.

**Togu ue** është mjaft i përhapur dhe i gjetur në shumë fjalë të veprës që kemi në studim, por veçanërisht më shumë ndeshet të foljet. Bazuar në studimet e shumta që janë realizuar për këtë çështje, është arritur përfundimi se togu *ue* ka zënë vend në të folmet gegërishte, ndërsa *ua* në toskërishte, ndërkohë që burimi gjendet tek diftongu më i hershëm *uo* dhe ky i fundit akoma më i hershëm nga *ou*. Në shqipen e dokumentuar, deri në shekullin XVII, pra në shkrimet e Buzukut<sup>45</sup> e Budit<sup>46</sup>, gjendet i përdorur grupi *uo*. Transformimi përfundimtar në *ue* geqe dokumentohet që nga Bardhi<sup>47</sup> e Bogdani<sup>48</sup> e në vazhdim në shkrimet e dialektit gegë, përfshirë këtu edhe shkrimet e autorëve të shek. XIX.

Radoja këtë tog zanor nuk e asimilon. Dendurinë më të madhe të përdorimit e konstatojmë tek pjesoret e foljeve, më pas tek mbiemrat e më rrallë tek emrat : *scelbue*(D.C.32), *latuescme* (D.C.32), *paa-gabuëscme*(D.C.36), *levdue*(D.C.63), *pusctuescmia* (D.C. 77)

**Togjet ie, ye**, në gegërishte dhe konkretisht të autori i shekullit XIX, Ëngjëll Radoja, gjenden të plota. Në varësi të studimeve, shihet se grupet *ie, ye* ruhen të pandryshuara edhe në fillim të shekullit XVIII, tek Bogdani. Madje, mund të dëshmojmë se raste gjenden edhe tek teksti i Kuvendit të Arbënit<sup>49</sup>, duke pohuar se ende nuk kishte ndodhur tkurja e plotë e këtyre diftongjeve deri në këtë periudhë.

Radoja: *sctie* (D.C. 32), *perëie* (D.C.96) *diele* (D.C. 116), *krye* ( D.C.36).

Te Radoja ndeshim si rast të izoluar togun *ie* që është reduktuar në një fjalë: *dilli* (dilli). Nuk mendojmë se është gabim shtypi pasi autori e ka përdorur disa here këtë fjalë.

Munnena me marr nnegni *scemλyr prei diilit*. Gni âsct natyra e paa-daame *e diilit*, e *diiili* ka n'vehte riten e t'zeetit.Por *diiili* nuk viën as *prei dritet* as *prei t'zeetit*; drita viën *prei diilit* (D.C.16)

**Grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ng**, të cilat në gegërishte kanë shkuar drejt asimilimit në disa vepra të autorëve gegë, konkretisht në *mb >(m \ mm)*, *nd >(nn)* kamt, me *mmet*, *knnoiscin*, *nei*. Deri tek Bogdani, këto grupe bashkëtingëlloresh gjenden të plota. Asimilimi mendohet se i përket shekullit të XVII. Por këtë nuk mund ta themi me vërtetësi, pasi po të vështrojmë në tekstin e “Kuvendit të Arbënit” që i përket fillimit të shekullit XVIII, gjejmë raste të përdorimit të plotë të grupit të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng*, psh. ( duhet me u *mbaruem* (f.5) ; mos te *nderrohet* forma....\ ... mbe *vend* becuem (f.20-21) ; po ngremog<sup>n</sup>en (f.40)

Autori ynë, nuk është i koherent në përdorimin e grupeve të bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng*, pasi ato herë i shkruan të plota dhe shpesh i asimilon.

**Grupin e bashkëtingëllores mb** autori, e asimilon në *m* që grafikisht e shënon me *m* ose me dyfishimin e bashkëtingëllores *mm*: *per-mî* (D.C. 37) *mramet* (D.C.37) *mmar* (D.C.59) me *mrrîit* (D.C.80) *mmahet* (D.C. 80) *mmúsci* (D.C. 84)

**Grupin nd** te Radoja e gjejmë edhe të asimiluar në *n* ose në *nn* por edhe të plotë *nd*: *mèn* (D.C. 27) *munnët* (D.C. 36) *nnèr* (D.C. 62) *gind* (D.C.101) *cundra* (D.C.63) *tunnimët* (D.C. 67). Rastet e asimilimit të grupit *nd* në *nn* janë më shpesh të përdorura.

<sup>45</sup> Te Buzuku vërejmë: *dishipujtë* e *leshuonë* ( 2\ f.207) ; E ashtu u *firmuoshë* (2 \ f.19) ; e *scruosite* e *popullit* (2\ f.9)

<sup>46</sup> Te Budi vërejmë: qeshë *detour* (poezi f. 185) ; tashti *mbaruom*...e *ligjëuom*. ( f . 255)

<sup>47</sup> Te Bardhi vërejmë: *Zotynë* ka me *ggykuem* (f. 204) *menguem* (f. 25)

<sup>48</sup> Te Bogdani vërejmë: paç *dëshëruem* (Parathënia) ; ka me *paguem* gjithë anëmiqtë (pj.1.\ f. 122)

<sup>49</sup> Vërejmë: *smundet* me *pelchijem* (f.1)



**Grupi i bashkëtingëllores ng,** ruhet i plotë, edhe pse numri i rasteve të përdorimit është i kufizuar: munghuem (D.C. 32), kungohet (D.C.191)

### Zanorja ë dhe përdorimi i saj.

Shkrimtari Ëngjëll Radoja nuk dallon grafikisht zanoren /ë/ dhe /e/. Kështu edhe përdorimi dhe dallimi i kësaj zanoreje në fjalë është i vështirë. Autorët pararendës Bogdani e më pas Gjon Kazazi përoren shenja të veçanta për të shënuar këtë tingullfonemë. Sipas studiueses A.Omari “ *Gjysmë shekulli pas Bogdanit ky tingull ruhej në gegërishten veriore, përderisa është ndier nevoja e një shenje të posaçme për të. Mirëpo në shkrimet shkodrane të shekujve të mëvonshëm (shek.XIX, fillim i shek. XX) nuk ndeshim më një shenjë grafike për zanoren /ë/ dhe në përgjithësi vërejmë një shkëputje nga ajo lloj koineje e konsoliduar me Bogdanin<sup>50</sup>.*” Zanoren /ë/ të patheksuar shpesh nuk e përdor në trup ose në fund të fjalëve. Konstatojmë raste nga kategori të ndryshme leksiko-gramatikore: emër: fial (D.C.62), fright ( D.C.8); prov (D.C.184); mbiemër : t’verbt ( D.C.132); ndajfolje: kurr (D.C.22); përemër: un ( D.C. 104).

Kur autori e redukton zanoren ë në pozicion paratheksor si : mson (D.C.32), fmiit (D.C. 97).

Vihet re përdorimi i zanores ë, të cilën grafikisht e shënon me e, e ndeshim në disa fjalë shërbyese e në ndajfolje. Nneper (D.C.36); tieter ( D.C.76); perditcme (D.C.138); perpara (D.C. 48).

A.Omari e lidh zhvillimin e zanores /ë/ me ndikimin e të folmeve krahinore të qytetit të Shkodrës në shekullin e XIX. Studiuesja shprehet: “*Pikërisht gjatë kësaj periudhe ndërprerjeje relative të traditës shkrimore shkodrane kanë ndodhë me sa duket edhe zhvillimet e mëdha në të folmen qytetare shkodrane që, ndoshta nën ndikimin e prurjeve të të folmeve krahinore rrethëqark, i dhanë kësaj tiparet gegërishte veriperëndimore që ka sot. Një nga këto zhvillime është edhe ai i zanores /ë/ që çoi pjesërisht në rënien e saj në pozicion të patheksuar e, atje ku nuk ra, në shqiptimin e saj drejt /e/ -së<sup>51</sup>”.*

### Veçori të tjera fonetike.

Tek Ëngjëll Radoja dallohen edhe disa dukuri të tjera fonetike me karakter dialektor. Si një veçori e qytetit të Shkodrës dallojmë edhe tek vepra e Radojës se faringalja **h** buzurizohet në **f**. p.sh. ....Ligen e Krisctit giçç-ugnii, e *i gniöfin( njoöfin)* e i marrin...(D.C.33) / Papa i Roms, e t’Paar tier, e kerscten ci *scifen* ( shifen)...(D.C.36) / Ai e *gnief* ( njef) eçe Kristin. ( D.C.42)

Radoja në veprën e tij e ruan edhe grupin *vo*, ndryshe nga norma standarde që e pasqyron me grupin *va*. Edhe këtu kemi të bëjmë me një dukuri fonetike të gegërishtes.

...pse giçç jena t’vorfen perpara Teneon? ( D.C.66)

...Me i vorrue me nneer, me i kuitue me urat...(D.C.124)

### Apostrofi.

Apostrofi zakonisht përdoret:

1. Tek emrat me parafjalë të rasës kallëzore të shoqëruar me parafjalë n’ : n’menn, n’Betlem, (D.C. 82) n’pun (D.C.f, 102) n’gryk (D.C.114).

<sup>50</sup> A.Omari, *Pjetër Bogdani ‘‘Cuneus Prophetarum’’*, Tiranë, 2006, f.41.

<sup>51</sup> Po aty, f.41.



2.Njëkohësisht dallohet përdorimi i apostrofit edhe në përemrin vetor unë në rasën kallëzore: m'do, m'kaa ( D.C.114)

Apostrofohet edhe formanti t' i mënyrës lidhore: ci t'diim se scka do t'lypim..t'jena nighiue..(D.C.59), duke shënuar rënien e zanore /ë/.

### **Pashko Babi.**

**Pashko Babi** shkroi veprën e tij “ *Vakinat e lig's hershme dhe lig's ree*” me një gegërishte veriperindimore. Gjatë trajtimit të disa dukurive fonetike vihen re edhe elemente të përbashkëta me dy autorët e lartpërmendur. Duke u nisur nga periudha kur u shkrua kjo vepër, duhet të pranojmë se autori shkroi në dialekti i tij, në të folmen e vendlindjes por duke ruajtur edhe disa trajta arkaike.

### **Theksi.**

Pashko Babi ka përdorur në veprën e tij “*Vakinat e t'lig's hershme dhe t'lig's ree*” theksin hundor dhe theksin e mprehtë. Theksin hundor e përdor për të shënuar zanoret hundore *â-në, ê-në, î-në, û-në, ŷ-në* hundore: *bâa* (V. 36), *ânragia* (V. 36), *scêite* (V. 70), *regît* (V. 97), *pûn* (V.92), *sŷŷ* (V.71) .

Autori nuk është gjithnjë i rregullt në përdorimin e theksit të mprehtë, madje atë e përdor mjaft rrallë. Zakonisht vihet re në fjalë njërrrokëshe: *jó* (V.101) *ásct* (V. 229) *lée* (V. 233) . E gjejmë të përdorur këtë theks edhe në rrokjen e fundit të fjalës: *lajú* (V. 117) *dobíí* (V. 219), *ŷeè* (V.262).

Përsa i përket zanores o, autori nuk e shënon as me theks hundor as me theks të mprehtë, ndryshe nga Radoja. Pasqyrohet si zanore e thjeshtë, ose e dyfishuar p.sh. *took* (V. 9), *kułoos*(D.C.21), *gnoftne* (njoftne) (D.C.79), *focgne* (foshnje) (D.C.121).

### **Zanoret e gjata dhe dyfishimi i tyre.**

Një tipar i shkrimeve gege, është ruajtja e dyfishimi i zanoreve për të shënuar gjatësinë. Autori shënon zanoret e gjata me dyfishimin e zanores a, e, u, i, γ (y) duke ndjekur shembullin e shkrimeve të pararendësve dhe duke u ndikuar edhe nga bashkohësit. Kemi rastet: *t'ciaart* ( V. 60), *deeti* (V. 61), *kuur* (V. 90), *pruu* (V. 170) *giáa* (V. 171), *mrríini* (V.179) *kee*(V. 199), *per ti μυγλ* (V. 48), .

### **Togjet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve.**

*Togun zanor ue*, Pashko Babi e shkruan të plotë. Ky tog zanor gjendet jo vetëm tek pjesoret e foljeve, por edhe në tajtat foljore: *duel* (V.70), *munvue* (V. 82), *diftuen* (V. 85), *varrueme* (V.163), *sckuene* (shkuene)(V. 138); tek përemri *mue* (V.83); tek disa emra prejfoljor: *t'sckruemit* (t'shckruemit) (V.226), *t'bessuemit* (V.247).

*Togjet e zanoreve ie, ye* autori i shkruan të plota. Ai nuk e redukton në *i* siç ndodh tek një grup autorësh veriorë p.sh. *mieł* (V.f, 112), *diełin* (V.f, 119), *kŷŷyene* (V.f,71), *krye* (V.f, 70), *nrryeme* (V.f, 136), *scperblÿe* (V.f,163).

Nuk kemi gjetur fjalë që e redukton këtë grup zanoresh.

### **Grupet e bashkëtingëlloreve mb, nd, ng .**

**Grupin e bashkëtingëllores mb** shkrimtari Pashko Babi, e asimilon në m. E redukton në fillim të fjalës : *mleŷŷ* ( mledh) (V. 82) *mraames* ( mrames) (V. f83) , në mes të fjalës: *kamt* (V.134), *pesmŷet* ( pesmdhet) (V.137)

**Grupin nd** te “Vakinat e t’ligs herscme dhe t’ligs ree” e gjejmë edhe të asimiluar në : mennen (V. 137) lanns (V.105) vennin (V. 163) prinnia (V.162). Siç vihet re, ky autor, ndryshe nga Radoja nuk e asimilon grupin *nd* në *n* dhe nuk e shkruan në asnjë rast të plotë.

**Grupi i bashkëtingëllores ng**, ruhet i plotë, edhe pse numri i rasteve të përdorimit është i kufizuar: munghuem (V. 39) ngahtres (V. 108)

### Zanorja ë dhe përdorimi i saj.

Pashko Babi sikurse bashkohësi i tij Ëngjëll Radoja nuk dallon grafikisht zanoren /ë/ dhe /e/.

Zanoren /ë/ të patheksuar shpesh nuk e përdor në trup ose në fund të fjalëve. Konstatohet raste nga kategori të ndryshme leksiko-gramatikore: emër: me e fool gni fial (V. 40), rrugh (V. 41) mkatin (V.74); gni prov (V. 120) përemra : un (V.44), jon (V. 63); ndajfolje githmon (V.219).

Vihet re përdorimi i zanores *ë*, të cilën grafikisht e shënon me *e*, e ndeshim në disa fjalë emra, fjalë shërbyese e në ndajfolje. Pelhuur (V.90) , perpara (V. 29); kerkunn (V.97); permennunat (V.97);perse (V. 48).

Në konkluzion vëmë re se ky autor nuk bën dallim nga pararendësi i tij duke mos sjellë asnjë risi përkundrazi ku autor ka ecur në gjurmët e Radojës dhe autorëve të tjerë veriorë që shkruan në gegërishte.

Nga materiali i trajtuar mund të rënditen edhe disa dukuri të tjera fonetike në veprën e Pashko Babit.

### Bashkëtingëllorja -j.

Këtë bashkëtingëllore e hasim si një veçori fonetike e gegërishte tek vepra e Babit. Kjo bashkëtingëllore fundore del në shumësin e fjalëve me *-j* që autori e shënon grafikisht me *i* : per kunnra per to cioi *giarpii (gjiapij)* t’eeherlatisun.(V. 74)

...me mleeç *kañii (kallij)* mas korrearesc...(V. 82)

...me krye t’mluem jug nit tui kiaa koders *uñliive (ullijve)* .(V.100)

Ku mahescin t’nnryym sctat *luai (luaj)* t’eger fort.(V. 148).

Te numërorët ndeshim rastet ku autori nuk i shkruan me këtë bashkëtingëllore -i (-j) : ...e derçi scii n’fagie t’toks per *katerçet (katerdhet-katedhjet)* dit, e *katerçet* nét. (V. 16)

...sypri maleve ma t’neltave *triçet (tridhet-tridhjet)* płaam. (V.16)

...ner hysmegiar t’vet treginn e *tetmçet (temdhet-tetmdhjet)* veet..(V.21)

Ashtu si Radoja edhe Babi përdor dukuritë fonetike me karakter dialektor si:

Faringalen *h* e buzurizon në *f* p.sh.

...i çëxon misiirlit Nilo emnit, e se po *scef (shef)* ka po dalin. (V. 40)

...t’delte per jascta e ta *scofin (shofin)* çeu...(V.41)

...e me dit a e kan *gnooft (njoft)* ghabimin e vet. (V.45)

### Ndue Bytyçi

Ndue Bytyçi autori kosovar, për vendlindjen e të cilët ka kundërshtime, na ofron një vepër të shkruar në dialektin verior. Të folmet e qyteteve të Kosovës bëjnë pjesë në grupin e arealeve të gegërishtes. Edhe në veprën e këtij autori ndeshim disa dukuri fonetike të përbashkëta me dy autorët e tjerë veriorë Radojën dhe Babin si: grupet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve, përdorimi i theksit hundor dhe atij të mprehtë,

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

rënia e zanores /ë/ e ndonjë veçori tjetër të fushës fonetike që do ti paraqesim gjatë shtjellimit të mëtejshëm.

### **Theksi hundor.**

Theksi ka të bëjë me zanoret të cilat u përkasin rrokjeve të fjalëve. Vëmë re se edhe tek Bytyçi gjejmë të përdorur edhe theksin hundor edhe atë të mprehtë. Theksi hundor gjendet në rrokje që kanë në përbërje të tyre një zanore â, ê, î .

Bytyçi: zâan ( Urçnimet.f,5), mâarre (Urçnimet.f, 10), rrêiscem (Urçnimet.f,5), parrîeit (Urçnimet.f, 7)

Me zanoret û, ô,ÿ, nuk kemi identifikuar shembuj.

### **Theksi i mprehtë.**

Në tekstet e vjetra theksi mbetet një mjet ndihmës për të dalluar zanoret e theksuara. Theksi i mprehtë përdoret më dendur se theksi hundor .

Theksin e gjejmë në fjalë njërrokëshe: véen (Urçnimet.f, 6) kió (Urçnimet.f, 9) rrén(Urçnimet.f, 12)

Në fjalë dyrrokëshe: persé (Urçnimet.f, 5) rréhet (Urçnimet.f, 5) ghabó (Urçnimet.f, 12)

### **Zanoret e gjata dhe dyfishimi i tyre.**

Dukuri tjetër që vihet re tek Bytyçi është edhe dyfishimi i zanoreve të gjata. Gjatësia e zanoreve kryesisht është shënuar me dyfishim e shkronjës së thjeshtë që është tipar i gegërishtes. Kemi rastet: cbíi (Urçnimet.f, 6) insaan (Urçnimet.f, 7) vraa (Urçnimet.f, 7) ruun (Urçnimet.f, 13)

### **Grupet e zanoreve dhe të bashkëtingëlloreve .**

Ndue Bytyçi në veprën e tij i shkruan të plotë grupet e zanoreve *ue* dhe *ye* . Grupi i zanores *ue* gjendet në fjalë që i përkasin klasës së foljeve dhe mbiemrave, ndërsa grupi *ye* gjendet tek një folje dhe një emër.

**Togu ue:** maλkue (Urçnimet.f, 81), msue (Urçnimet.f, 9), mkatnue (urçnimet.f,10), t'truem ( Urçnimet.f, 11), fitue (Urçnimet.f, 11), reghulue (Urçnimet.f, 13)

**Togu ye:** E kemi ndeshur vetëm tek fjala: krye (Urçnimet.f, 9), krye (Urçnimet.f, 12)

Përsa i përket grupit të bashkëtingëlloresve, grupet *mb*, *nd* i asimilon në *m*, *n* ( *nn*), ndryshe nga Radoja dhe Babi. Shënojmë se tek ky autor është bërë asimilimi i plotë I grupeve të bashkëtingëllorev *mb*, *nd*.

**mb:** mî (Urçnimet.f,8) meten (Urçnimet.f,6) myt (Urçnimet.f, 9) mleçun (Urçnimet.f, 11)

**nd:** nnÿta (Urçnimet.f, 9) munnohem (Urçnimet.f, 5) nnêr (Urçnimet.f, 5) nnókusc (Urçnimet.f, 8) nighiue (Urçnimet.f, 6) rann(Urçnimet.f, 11)

Shkruan të plotë grupin *ng*.

**ng:**hangher (Urçnimet.f, 11) ngharkohi (Urçnimet.f, 11)

### **Zanorja ë .**

Zanoren ë në fund të fjalëve dhe shpesh edhe në trup të tyre, shkrimtari i shekullit XIX Bytyçi nuk e shkruan fare. Kështu kemi rastet ku kjo zanore ka pësuar rënie në pozicione të ndryshme në fjali: mkat ( Urçnimet, f 8) ather ( Urçnimet, f 8) rrzon ( Urçnimet, f 8) kamt ( Urçnimet, f 12) dnim ( Urçnimet, f 7) rrzue ( Urçnimet, f 7)

dnnue ( Urçnimet, f 7) nat ( Urçnimet, f 8) dit ( Urçnimet, f 8) scum ( Urçnimet, f 10)  
pun ( Urçnimet, f 12)

Bytyçi shënon shkronjën /ë/ me zanoren /e/, dukuri që e vëjmë re edhe tek autorët Radoja e Babi. Kjo është e dukshme në disa fjalë të cilat i përkasin pjesëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës si: (parafjalët) per ( Urçnimet, f 8); neper ( Urçnimet, f 6); ( mbiemri) i vaiscem( vajshem) (Urçnimet, f 8)'; (emrat) terbiet ( Urçnimet, f 10) darssem ( Urçnimet, f 14)

### Bashkëtingëlloret th/dh.

Këto dy bashkëtingëllore përgjithësisht ruhen mirë dhe nuk alternohen me njëra-tjetrën në asnjë rast në veprën e Ndue Bytyçi. Grafikiqsh autori i shënon *th* me grafemën ξξ dhe *dh* me grafemën ξ.

**Th/dh** : Me gni ççuper ( *thuper*) scikia briëit (Urçnimet. 7); me flictit giçç ( *gjith*) c'kan t'perpiekun. (Urçnimet.11)

ci pat Kami t'maç ( *t'madh*) dnim (Urçnimet.7); gni konop e m'e liç ( *lidh*) n'fyt (Urçnimet. 9)

### Përmbyllje të kreut të katërt.

Gjatë analizës së dukurive gjuhësore të veprave “ Dotrina e kerscten me msime e scpiegime” e Ęngjëll Radojës, “Vakinat e t'ligs herscme e t'ligs ree” të Pashko Babit, “Urçnimet e Tenzot e t'sceites kisc” të Ndue Bytyçit vumë re se kanë shumë elemente të përbashkëta mes tyre, duke qenë se autorët shkruajnë në dialektin e gegërishtes.

Por, nuk duhet veçuar edhe fakti se mes këtyre autorëve , ka edhe dallime të veçorive fonetike që karakterizojnë shkrimet e tyre. Arritëm në konkluzionet:

Theksi i cili shfaqet si një fenomen fonetik që ka qenë dhe është një tipar i gegërishtes është i përdorur tek të tre autorët. Ata përdorin në veprat e tyre theksin e mprehtë dhe atë hundor. Tek Pashko Babi vërehet një reduktim i përdorimit të theksit të mprehtë. Nuk mund të themi të njëjtën gjë për theksin hundor i cili përdoret dendur si tek Babi dhe Radoja. Bytyçi përdor më rrallë theksin hundor dhe më shpesh teksin e mprehtë.

Dyfishojnë zanoret për të shënuar gjatësinë fatkci ,pâa ,bree ,truun ,kee, viin etj.

Zanoren ë të patheksuar shpesh nuk e përdorin në trup e në fund të fjalës: prov ,mbiemër , t'verbt, kurr, un , mson etj.

Përgjithësisht shkruajnë të plota grupet e zanoreve të cilat shfaqen më shumë tek foljet, mbiemra: *munnue, diftue, varrueme ,sckuene, mue* si dhe tek disa emra prejfoljor: *t'sckruemit , t'bessuemit* .

*Togu zanor ie, ye* autorët i shkruajnë të plota. Ata nuk i reduktojnë në *i* siç ndodh tek një grup autorësh veriorë *mieλ, dieλin, kççyene, krye, nnrçyeme ,scperblye* etj. Këtu përjashtojmë vetëm fjalën *dili* tek Radoja që autori e asimilon. Nuk mund të themi me siguri në kjo është një veçori e autorit apo një gabim gjatë kohës kur vepra është shtypur.

Grupet e bashkëtingëlloreve *mb, nd, ng* Radoja herë i shkruan të plota dhe herë i asimilojnë *mleçç , mrâames, kamt , pesmççet, ngahtres , cundra* etj. Pashko Babi dhe Ndue Bytyçi grupin *mb* e asimilojnë në *m* dhe nuk e paraqesin me dyfishimin e kësaj bashkëtingëlloreje *mm* siç e paraqet Radoja; grupin *nd* e asimilojnë në *n, nn*. Grupin *ng* të tre autorët e shkruajnë të plotë.

Tek Radoja dhe Babi dallohet dukuria fonetike me karakter dialektor ku faringalja *h* buzurizohet në *f*.

Radoja në veprën e tij e përdor edhe grupin *vo* si veçori e dialektit të veriut.

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

---

Bashkëtingëlloret *th/dh* përgjithësisht ruhen mirë dhe nuk alternohen me njëra-tjetrën në asnjë rast në veprën e Ndue Bytyçi. Dy autorët e tjerë nuk janë të kujdesshëm në shënimin e kësaj bashkëtingëlloreje.

Ndryshe nga autorët pararendës, tek këta tre autorë të shekullit XIX, ndeshet dy veçori:

1. nuk ndeshim më një shenjë grafike për zanoren /ë/ dhe në përgjithësi vërejmë se në disa pozicione shënohet me grafemën /e/.
2. tek këto autorë bëhet i dukshëm asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve mb, nd. Që realizohet i plotë tek Babi e Bytyçi.

Në këto vepra kemi të bëjmë me disa veçori fonetike të gegërishtes që përgjithësisht shfaqen me elemente të përbashkëta tek të tre autorët.

**KREU V.**

**Disa veçori të leksikut të autorëve.**

**Neologjizmat.**

Duke lexuar me vëmendje veprat e autorëve Ëngjëll Radoja, Pashko Babi e Ndue Bytyçi hetojmë se shkrimet e tyre karakterizohen nga një leksik, ku një vend të dallueshëm në fjalësin e tyre e zënë edhe neologjizmat. Duhet të sjellim në vëmendje se është një punë shumë e guximshme dhe aspak e lehtë të përcaktosh saktë fjalët e reja që kanë krijuar autorët, duke kujtuar distancën e gjatë kohore që kur janë shkruar këto vepra. Në kushte të tilla, normalish ka fjalë që janë bërë pjesë e fondit të shqipes dhe të tjera kanë kaluar si shtresë pasive e leksikut. Autorët përdorin edhe leksema krahinore duke na e veshitirësuar edhe më shumë përcaktimin e qartë të këtyre ndërtimeve. Duke u mbështetur në “Fjalorin e gjuhës shqipe“ 1980, “ Fjalorin e gjuhës shqipe“ 2006 kemi nxjerrë disa neologjizma që mendojmë që mund të jenë krijime të vetë autorëve, pa përjashtuar mundësinë se ndonjë fjalë mund të hetohet edhe tek ndonjë shkrimtar tjetër.

**Ëngjëll Radoja**

**B**

**Báamirt**, *mb*-...per print ton, per t' bâmirt, e per scpirtnat Burgatórit.(D.C.58)

**Báa-kciit**, *mb*-(që bën keq ,keqdashës)...me ciortue *bâa-kciit* e mcatnort...(D.C.93)

**Bestáar-i**, *m*, (ndërmjetës) - ...bâa *bestáart* e Krisctit...(D.C.23)

**D**

**Detors-it.em** –(fajtorët)...sikurse eçè na i nni *detorsit* ta ? (D.C.67)

**Demel-isct.ndajf** ...do me ççan me nnêi paa pun e *demeliscit*. ( D.C.117)

**E**

**erel-isct.ndajf**. (me nder)- ...ky far komit a jeton *ereliscit*. (D.C.50)

**F**

**Flak-a(r)-esh.mb**-(shuplakë)- ...Ipesckvi i bie *flakaresc* faqes. (D.C.184)

**G**

**gaemen-êsc.ndajf**. ( gëzim i madh; hare)-...plot me giçç far *gaemênêsc* ci s'kan t' maruem kurr (D.C.48)

**Gj**

**giççneve**, *pr*.(të gjithëve)- Eoja âsct Nana e giççneve...( D.C.77)

**giççkusc-i-m** – Liir âsct *giççkusc* mîi ket essap. (D.C.112)

**H**

**Haps-it**, *m*-(hajnat) ...me paa *hapsit* ata ci jan ean n'burgh.(D.C.93)

**Hatercii**, *m*-( i mbet hatri; hidhërohet)- ...me ktò fial t' malkueme bâin Eotin t' paa-dreit, hatercii...(D.C.114)

**Hailoëa mb**. –...Jo gind malkuum, giaksor, haina, zuba e *hailoëa*...( D.C.182)

**K**

**Kéciena**,*ndajf*. (me kuptim që behemi keq)...per t' zilin *kéciena* me tê. (D.C.72)

**M**

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

**Miraë-cia**, *m*, ( që ka maraz; inat)- ...i biri i tii n'sciirt, e *miraë-cia* e Reginnis Parriëit. (D.C.22)

...*miraëccit* e tiert ci ciassin fialen. (D.C.147)

**P**

**paëáanfiiλ,mb-** ...te tre jan t'giëëherscm e *t'paazâan-fil* e t'pasosun...(D.C.16)

**T**

**Terrscm**, *mb.-errësirë* ...ci iscin n'at vén t'terrscm...(D.C.30)

### **Pashko Babi**

**A**

**Annragia**, *f.* -...Tek po na vien *annragia*...( V.36)

**Anneiscem**, *mb*, ( formim nga ndajfolja anei (andje)+ prapashtesën –shem). - ...u ciue Israeli prei breghut *anneiscem*. (V.62)

**D**

**Dasctnim-i**, *m-* ...perse scum kaa pass *dasctnim*...(V.205)

**Dieghzim-i**, *m* ( djegësi)- Ëoti cioi gni eer gi *dieghzim* epte. (V.121)

**E**

**Errnesen**, *f.* (jetesen)-...sghoë maa par deken per nner se *errnesen* me turp. (V.156)

**F**

**Funscmet**, *mb.-* ...mii scëiten kiisc jan kto *t'funscmet*. (V.97)

**Fygyrote**, *f.*(perfytyronte)- ...e s'ja date sÿÿt e n'gni *fygyrote* me vetvetdi..(V.28)

**G**

**Ghoitar-i**, *m.*( flet bukur e rrjedhshëm )- ...Jÿt vÿlaa Aronni âsct *ghoitaar*. (V.57)

**Gj**

**Gjaktbamt**, *m.*( *gjak +me ba- ato që derdhin gjak* ) - ...Por sa duel fmia atii reëiku, ja mrrÿine me t'sceit *giaktbamt* n'Betlem. (V. 179)

**Giarpnusc**, *f.* ( gjiarpen + ush ) ...gi vuela kunnra Sefit ajo *giarpnusc*. 9V.38)

**H**

**Haλ-ëëë**, *mb.* – Tieter t'mir ato haλ- ëëë nuk kiscin n'at robni...( V.140)

**Haλ-pak**, *mb.* - ...iscte nieri *halpak*. (V.175)

**Hakikatlii**, *mb.* - ...por ai, si desct vedin per nieri *hakikatlii* me e diftue...(V.229)

**I**

**Inadscem**, *ndajf.* (me inad)...nuk dote me e paa as pak e kgiÿrte *inadsem*. ( V. 33)

**J**

**Japiscme**, *mb.* (e hijshme)-...duul Rebeka, vaie e *japiscme*. (V.27)

**K**

**Kailis**, *f.* 9 u bind)- ...e nuk *u kailis* eëe aso here me e lirue populin...(V.58)

**Kamzii**, *m.* (këmbësor)N'at luft metne por triëet mii *kamzii* e me to eëe dÿ t'birt Eli..(V.85)



## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

---

**Kemtar-i, m.** – Ju keni per t’nnêi nesor me *kemtar* tuei...(V.72)

**Kymetscem, mb.** - ...sctini e ghoditi Davidi gni toprak *t’kymetscem.* ( V. 95)

### M

**maræue, f.**( i erdhi maraz;inat)- ...Davidi *u maræue* m’te. (V.100)

**Mentar, mb.**( i zgjuar) - ...ka per t’keen vûu n’rubaa me nnieri *menntar*...(V.200)

**Menne diemnuemit, mb.**- ...Ather eçe ata giçgtar *menne diemnuemit* ciune eân e vet. 9V.139)

**Mene-hoλ, mb.**- ...e kag *menne hooλ* gi kerkusc tçç nuk mund t’asct afrue as perpara. (V.102)

**mielcgii, m.**( mizor)-...gni *mielcgii* ja cioi me t’scepit haberin Davidit. (V.100)

**mielihuni, m.**- ...mannei t’giçç atii *mielihunit.* (V.101)

### N

**Nnimitar, m.** – ...me ju keen *nnimitar* dymçet apuistive...( V. 228)

### P

**Perspieek, ndajf.**- ...me i çan haber Sefit se po ja *perspieek* i jati.( V.49)

Permencem-

**peemtare-ve, m.**( *person që zemërohet a preket thellë*) - ...tui daai prei menniet *peemtarve* e periesve birve Israelit. ( V.73)

### R

**Ruscatin, m. vjet. etnogr.**( *mergjur*) - ...e s’ja merr *ruscatin* t’pafajit... (V.96)

### Sh

**Shuit-en- f,** ( heshtjen) ...ka per ta çan *shuiten* tanne. (V. 12)

### T

**Trimnon, f.**( bëhet trime; tregon trimëri)- ...e motra e atii fmiis e *trimnon* vedin. ( V.55)

**Trimaac, mb.**( trim, i fortë)- ...si pak kusc mir eçe asct *trimaac.* (V.88)

### Z

**Zajen** (zanatin)- ...âsct i baam buurr luften e ja ka *zajen* c’n’fminni t’vet. ( V.89)

**æelnen, f.**(zellin)- Ani giçç sa her ai scpirt i maλkuem i epte eori e *æelnen* t’fort t’mierit Saul. ( V.88)

**æeltari, m.** - ...Jeeu-Kriscti e Ungniλi scêit *æeltari* mâa i maçi...(V.293)

**æeherlatisun, mb.**- ...per kunnra ner to cioi giarpi *æeherlatisun.* (V.74)



### **Shtresimi i fjalëve me burim të huaj.**

Gjatë shekujve, gjuha shqipe ishte vazhdimisht nën presionin e huazimeve, nga vendet fqinje. Kjo si pasojë ka dhënë ndikim të gjerë, jo vetëm në aspektin kulturor, por mbi të gjitha në leksikon e një gjuhe.

*Fjalë nga turqishtja nisin të hyjnë në gjuhën shqipe që nga shekulli XV. Si dihet, pushtimi osman në Shqipëri zgjati pesë shekuj, deri me 1912. Gjurmët e këtij pushtimi mbetën edhe në gjuhë.<sup>52</sup> Duke jetuar dhe lëvruar shekuj më pas, tek shkrimtarët që kemi në shqyrtim, patjetër që do të ndihet dukshëm prania e këtyre fjalëve me burim turk të cilat kanë një përdorim të dendur në vepra.*

**Prapashtesa -im.** Zakonisht janë emra të prejardhur që vijnë prej foljeve si: tunnim, përqaftim, dnnim etj Në këtë format ndërtohen emra prej foljesh –o. Këto emra që identifikohen në shkrimin e Radojës, nga pikëpamja e strukturës morfologjike, kanë si temë fjalëformuese temën e kohës së tashme të foljeve si: dnnim (-dën(o)). Kjo prapashtesë dokumentohet që nga shkrimet e autorëve të vjetër.

Për këtë studiuesi Sh. Demiraj shprehet: “... *kjo ndajshtesë haset që tek autorët e vjetër, te Buzuku ( ku janë identifikuar 13 emra prejfoljor të përdorur 94 herë), te Budi (gjenden 25 emra prejfoljor të përdorur 233 herë), te Bogdani (59 emra të tillë të përdorur 203 herë)*<sup>94</sup>. Ndërsa gjuhëtari E. Hysa për lidhjen e kësaj ndajshtese me temën fjalëformuese, thekson, se “...*prapashtesa -im bashkohet me tema foljore të kohës së tashme të mënyrës dëftore, pra ajo bashkohet kryesisht me tema foljore që mbarojnë me –o dhe mjaft rrallë dhe me tema foljore me fundore të tjera*”.<sup>95</sup>

...e kur kena nnogni *tunnim* o *turbullim*... (D.C.f. 58)

...ci zēhen n' *uržnimet(urdhnimet)* e Tenēot (D.C.f 11)

...n' scēitin sakramen t' Lterit eže m' sceitin *kunghim*(D.C.18)

...pse i kerscteni per pun t' *Pagheimit(paghzimit)* āsctnieri i béekuem...a per *dnim* a per *scelbim(shelbim)*? (D.C.22)

...t'a keen *bessimin* e scēites Fee (D.C.26)

...ci iscin n' at vén t' terrscm e n' kto koh tona t' lotuescme *scpieghimi(shpiegimi)* i atii asct fort inevoiscm. (D.C.32)

...tui citt jssct važžet me *małkim( mallkim)* (D.C.38)

<sup>94</sup>Sh.Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, f. 205-208.

<sup>95</sup>E.Hysaj, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 110.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Sic vihet re edhe nga shembujt kjo prapshitesë është shumë prodhimtare në vepër.

**Prapashtesa –ar\–tar.** Këto prapashtesa që shërbejnë për të formuar njësi leksikore me kuptim të ri ose plotësues shprehin zakonisht profesion a mjeshtëri, formojnë emra vepruesish prej emrash ose edhe nga folje, si dhe mbiemra prej emrash si: *skollari/i* (< *shkoll+ar*) ; *mortari* (< *mort +ar*); *këshilltar* (<*këshill +tar*) *kundërshtar* (< *kundërshto*). Gjuhëtari E. Hysa gjatë trajtimit të formimit të emrave thekson faktin, se “*ato tregojnë origjinën....ose shënojnë mjeshterinë e një personi, i cili merret me atë që tregon tema fjalëformuese*”.<sup>96</sup>

...jam i zoti me i çan *gevap kunnersctarit( kunnershtarit)* t’Fees. (D.C.51)

...*sckolart( shkollart)*, *sidomos t’riit m\zilin scëit bain mir* (D.C. 88)

.. e<sup>ç</sup>e i pari *giygtaar(gjyqtaar)* ... (D.C.99)

...ci nuk e diin me t’vertet, se asct i paa-fai, ata bain mcat *mortar?*(D.C.109)

...po e<sup>ç</sup>e rescpeert, eanatlit, *katunnart* e *malzort* (D.C.110)

.. e<sup>ç</sup>e faideccit jan *grabitciar*.(D.C.143)

**Prapashtesa –(i)sht** është prapashtesa që u paravijet temave jo të parme që mbarojnë me –i: *haini-sht*, *sceitni-sct*. Ndërsa prapashtesa –*isht* u prapavijet temave të parme apo jo të parme që mbarojnë me bashkëtingëllore: *divan-isct*, *marr-isht* etj. Për analogji me këto janë formuar ndajfolje edhe nga tema fjalëformuese që nuk mbarojnë më –i, duke u zgjeruar prapashtesa në –*isht*”.<sup>97</sup>

Vërejmë edhe formimin e ndajfoljeve prej temave emërore psh : *shenjtërisht*, *vllaznisct*, *gabimisht*, *maçniisct*, *turqisht*, etj. Xhuvani e Çabej, shkruajnë, se “*prapashtesa -isht u bë produktive në gjuhë të shkrimit, duke formuar me të ndajfolje mënyre prej emrash e mbiemrash*”.<sup>98</sup>...

...s’gabón kur flet *divanisct (divanisht)* prei selies sceit.(D.C.43)

... nnér gi<sup>ç</sup> t’kersctent e d<sup>y</sup>gnâs , ci i gheoin *basckarisct (bashkarisht)*(D.C.45 )

...per eacon s’jeton as *erelisct*(D.C. 50)

ci t’na apin nnim me jetue *ksctenisct (kshtenisht)* e *scëitnisct (sheitnisht)*. (D.C.54)

...porsi amanetciar t’foort, i ruin *sceitnisct*...(D.C 44)

...prei asso *maçniisct (madhnisht)*kur Zoti i scéf...(D.C 71)

...na *vllaznisct (vllaznisht)*t’gj<sup>ç</sup> mbliçena n’Kisc tenzot.(D.C.92)

...kan vie<sup>ç</sup>, e grabit, e kan fitue *hainisct (hajnisht)*...(D.C. 148)

**Prapashtesa –scm (–sh(ë)m).** Me këtë prapashtesë ndeshen në vepër një sërë mbiemrash me prejardhje emërore e foljore që tregojnë një gjendje a një mënyrë si: *kujtuescm* (*kujtue+scm*), *menduescm* (*mendue+scm*), *ghzuescm* (*ghzue+scm*)etj Nisur nga karakteri dialektor i përdorimit të fjalëve në gegërisht, në çdo rast dallojmë se zanorja ë nuk shkruhet, duke dalë si mbaresë në formën –scm (-shm)

...e sot n’ciell asct i *ghzuescm* e i *lumnuescm*...(D.C.236)

... e ata ci sciogin mescen *habitscm*..(D.C.163)

Çot i vetem n’tre Vet *hyinuscm(hyinusshm)* . (D.C.14)

...kta tre Vet *hyinuescm* a jan gi<sup>ç</sup> gni barabar? (D.C.15)

...asct e<sup>ç</sup>e Ati i *miscrirmscm (mishrirshm)*– i t’kerstenvet t’mir (D.C.27)

...si múnnet nieri i *arsyescm (arsyeshm)* me gnioft.... (D.C. 34)

<sup>96</sup> E.Hysaj, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 159.

<sup>97</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë, 2002.

<sup>98</sup> A.Xhuvani- E.Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*(1962), në “Vepra I”, Tiranë, 1980, f. 484.

...tui scndrit n'ket scekul t'terrscm (t'terrshm)per pun t'Fees. ( D.C.39)

**Prapashtesa -i.** Është një prapashtesë e vjetër në gjuhën shqipe. Në shqipen e shkruar ajo dokumentohet që në veprën e Buzukut.Me këtë prapashtesë formohen prej emrash, mbiemrash, foljesh e ndajfoljesh emra abstraktë të gjinisë femërore.

Në materialin e vjelë prapashtesa -i bashkohet edhe me tema fjalëformuese emërore të parme duke formuar emra, si psh.:

...per n'maçsctii een fiił giçç far rughet...(D.C.124)

...kioft *lumnii*, Atit e Birit e scpirtit Sceit dicc sckoi me scpiir e me *Hyinii* n'Limb. (D.C. 30)

...si ai vet n'maçnii e n'lumnii e n'pusctet. (D.C. 31)

Merret-vesct gni *sciocnii* gindsc, t'zilt discmoin Feen. (D.C. 33)

...I kaa çan kto pês çuntii( *dhuntii*). (D.C 36)

...ma teper se gneti *maçniin* (*madhnin*)e bukuriin e vet. (D.C 61)

### **Prapashtesa/t -o/ -or,-/tor.**

Gjuhëtarët shqiptarë duke e trajtuar këtë dukuri shprehen, se “*Prapashtesa -o është ndajshitesa më prodhimore në sistemin foljor të shqipes. Me të janë formuar një numër i madh foljesh nga tema: emërore ( bes+o), mbiemërore (shkurt+o) , ndajfoljore (larg+o)*”<sup>99</sup>. Numrin më të madh të formimit me këtë prapashtesë e zënë fjalë që i përkasin klasës së foljeve, më pak emrave dhe mbiemrave. Pësa i përket prapashtesave –or/-tor , në vepra nuk janë shumë prodhimore.

...Duhet me besue eççe giçç scka *beson* e na *mson* Scëitia Am kisc katolik e Roms’ ( D.C. 15)

Ti e *levdon* Scëiten Trinii. (D.C.17)

A s’jan nner ta scium t’eee mcatnor? (D.C.46)

...sikurse i nniin eççe na faitort ton. (D.C.59)

...ci je fort i dasctuni *paitori* em (D.C.88)

Kjo prapashtesë paraqitet në dy variantet, konkretisht –uur, -or edhe në shembullin:

...na m’tieter n’*Burgatuur*. (D.C.47)

...per t’bamirt e per scpirtnat *e Burgatorit*. (D.C.f.58)

**Prapashtesa -na.** Kjo prapashtesë gjendet e prapangjitur emrit i cili del në numrin shumës.

Jan ata ci bain e apin *barna*\_(D.C.127)

**Prapashtesa –esh(ë).** Kjo prapashtesë është pak e përdorur në veprën e analizuar. Formon ndajfolje që tregon mënyrë veprimi de që mendojmë të jetë një neologjizëm i autorit.

...i bie eççe *flakarésc* t’leer facies. ( D.C.184)

**Prapashtesa(çi-).** Prapashtesë turke, e cila nuk ka një përdorim të madh në vepër. Autori e shënon këtë prapashtesë me grafemen ci me të cilën grafikisht ai ka shënuar shkronjën ç ( kpuzzarciit).

...sikur atá ci mihin ...voetart, *kpuzzaciiit*(*kpuzarçit*). (D.C.63)

### **Formimi me parashtesë dhe prapashtesë.**

Zakonisht me anë të parashtesimit dhe prapashtesimit formohen një grup foljesh, por që nga përdorimi ku lloj formimi nuk është shumë i përdorur .

<sup>99</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë, 2002, f. 344.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Na do t'i kiam e do t'i *perbûeim* (*perbuzim*) mcatet tona. (D.C.200)

Teper e ligscetòn, e turpnòn e *scnierèòn* (shnierzon) e perciudnòn. (D.C.138)

### Formimi me nyjëzim dhe parashtesim ose me nyjëzim parashtesim dhe prapashtesim

Është një mënyrë prodhimtare që identifikohet më së tepërmi tek mbiemra të nyjshëm por edhe tek emra.

Jo te tre jan t'giççherscm, e t'pazaanfiil, e t'paa-sossun, ...pse sikurse ççacc, te tre jan giççggni e kan gni natyr t'paadaame e me na çan jeten e paasosme. (D.C. 18)

...Ati e Biri i pusctuescm, i giççherscm, i paa-munghuem kurr. (D.C. 32)

...me ken e paame, e giççherscme e paa-gabuescme. (D.C. 36)

..má scium t'paa-gihiaascme punohen prei disa t'kersctenc. (D.C.119)

### Kompozitat.

Për klasifikimin e kompozitave kemi parasysh përkatësinë leksiko- gramatikore të temave të fjalëve, pra nga ç'pjesë e ligjëratës janë formuar ato. Zakonisht ndeshim formimin e fjalëve të përbëra nga këto struktura:

- **Emër + emër**

**emër + guur**... e nesser balt e pluhun e cielbsina e çeut, ne *emër guur* dona me ken. (D.C. 68)

- **emër + mbiemër.** (Gjuhëtari A. Kostallari shprehet, se: “Në këto kompozita si element përcaktues shërben elementi i dytë, pra tema mbiemërore, ndërsa elementi i parë përbëhet nga një emër çfarëdo që emërton një pjesë përbërëse të sendit të karakterizuar nga kompozita e dhënë.<sup>100</sup>”Ky tip është mjaft prodhimtar për të krijuar mbiemra e më pak emra.

**Fat + kcii** ... gnitá ci jetojn faret pa gaile e pa kuides t'scirtit e acc *fatkcii* jan. (D.C.f.101)

**Facie+ eæt**...*Facieeæt!* Vrassin nierin me hiekszii. (D.C.114)

### Përngjitja.

Një mënyrë tjetër të fjalëformimit që ndeshim në vepër, është edhe përngjitja. Kjo mënyrë nuk është shumë prodhimtare. Pjesa më e madhe e fjalëve i përkasin pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës dhe numërorëve.

..t'zilit *kurrgni* giâa-sen si asct vstiir. (D.C.47)

Ci ajo spat kurr *nnógni* far mcatit. (D.C.76)

...sikuur flak eiarmit *giççher* me na nnighiue. (D.C.84)

...vepra t'miscirirscme ci jan *katermçet*. (D.C.192)

\*\*\*

### **Pashko Babi**

Interes për studimin tonë paraqet edhe përdorimi i mënyrave të fjalëformimit të veprës së Pashko Babit. Vërehen dukuri të ngjashme fjalëformuese si tek autori Ëngjell Radoja, me ndonjë të veçantë të cilën do ta trajtojmë si më poshtë:

<sup>100</sup> A.Kostallari “Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe” në: Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve malëve në gjuhën shqipe 1, Tiranë 1972 f. 83.



### Formimi me parashtesë.

**Parashtesa pa-** Pashko Babi nuk e përdor shpesh këtë parashtesë dhe autori nuk është i njëtrajtshëm në të shënuarit e kësaj parashtesë, të cilën herë e identifikojmë të ndarë nga tema fjalëformuese dhe herë të bashkangjitur asaj. Parashtesa *pa-* u ngjitet temave emërore ose mbiemrave .

Larghonu prei ciadrave t'ktyne t'pa scpitve (V.72)

Coti i sciste n'dor gins huei e t'pascpirt...(V.79)

.. ne ato sckret me gin t'pa eot.(V.122)

... per hater e nneer me regì t'pa fee...(V. 152)

...si u perzje me martes me t'pa fee. (V.179)

**Parashtesa për-** . Nuk është një parashtesë shumë prodhimtare. Identifikohet më së shumti tek foljet, ndajfoljet, duke i dhënë atyre një kuptim të ri plotësues.

...dγγ viet *permrapa* pat gni annêrr...(V.40)

...raa ziermi prei cielet e *perpini* docaustin.(V. 106)

...ci ne mram e *perlieu* katerçet viet... ci e kiscte *perlye* giaku...(V.116)

...kiscte n'dor me e *perhap* avrimin. (V. 163)

**Parashtesa shpër-** është joprodhimtare. Kjo parashtesë përdoret tek Pashko Babi tek folja të cilën autori e përdor disa herë me të njëjtën formë : ...prei asi vënnit *scperdau* per giçç ne drit. (V. 18)

**Parashtesa z/s-** u ngjitet foljeve me rrënjë të lidhur, me funksione të ndryshme, ose pa ndonjë funksion të dukshëm.Trajta *z-* përdoret para bashtingëlloreve të zëshme. Një tipar karakteristik i alomorfi *t- /z-*, që e dallon atë nga alomorfi *s-*, është se *z-* formon edhe folje të prejardhura me rrënjë të lidhur. Numri i shembujve në tekste është mjaft shterrues.

E si *zbardhi* drita...(V. 32)

...ai soi turpit syÿve tyne nuk iu *eblohei*. (V. 11)

...e t'gith scka ka mennia ai e *zblon*. (V.101)

...e *zbukuroi* e forzoi Gerusalemmin n'kaq sa perpos...(V.107)

...si ta kesc *sprovue*. (V. 158)

**Parashtesa zh-** Kjo parashtese u ngjitet temave te fjalëve, zakonisht folje, të cilat i japin fjalës kuptim të kundërt. Ky autor shënon shkronjën *zh* konkretisht me grafemën *se*: *seduk*, *seghatrue*. Por gjejmë edhe shembullin ku *zh* shënohet me grafemën *sc* tek fjala: *scduk*. Në këtë mënyrë, mund të themi se autori nuk është konsekuent në dallimin e qartë mes shkronjave *sh* dhe *zh*.

...*seduki* mennen nëltit n'kuitime. (V. 172)

...ju isc *scduuk* sa kiene n'Ruzalem. (V. 178)

...po na gi jemi *seghatrue* prei scekulit . (V. 241)

### Formimi me prapashtesë.

**Prapashtesa –im.** Kjo prapashtesë është shumë prodhimtare në veprën e Pashko Babit. Me anë të kësaj prapashtese formohen një sërë emrash të prejardhur nga folje si: bekim ( beko), paitim ( paito), kursim ( kurse) etj.

...e m'ty kam per t'paas *bekim*. (V. 20)

...Giakobbi senn s'kie me raa n'*paitim* e tha ...(V.37)

...e si i bani Kailit *urimet* e veta...e s'diti *kursim* per asgnisenn. (V.49)

...e me nnighiue *mallkimet* (*mallkimet*) e tija...(V.76)  
...as kurr far *kunnersctimit*. (V. 10)  
...u bâa sebet si *scgnereimit* i robit.(V. 166)  
...gith ktii morie *ghatimit*...(V. 33)

**Prapashtesa –ar\ -tar.** Kjo prapashtesë është prodhimtare në formimin e emrave dhe mbiemrave nga tema emërore dhe mbiemërore.

...mloç ku kien scortar e *dietart* e Misirit. (V.40)  
...kiscte zan ghruue e kisct *hysmegiare hysmegiare*...(V. 33)  
...e prei sghoç por kater *kaghtar* (V. 90)  
... kerkusc asisc gi iscte *scefitaar* (V. 107)  
... *ksciltart* Çot, kçvet maçi. (V.135)  
... ti kee per t\keen *guitar* nnierëisc . (V.194)  
... me ju ken *nnimtar* dymçet apostuive. (V. 228)  
... i duln gni *letraar* ligiet per me i sprovue. (V. 229)  
Po, o nieri, kusc m'ka vûu mûe *giygtaar*.(V. 236)

**Prapashtesa –es.** Në ligjërimin e sotëm kjo prapashtesë ka humbur prodhimtarinë e saj, por që në shkrimet e Pashko Babit konstatojmë të kundërten, duke dëshmuar që kjo prapashtesë është mjaft produktive.

...fee e vertet e scpnesen n'at *scperblyes* gi kiscte .( V. 20)  
...edhe n'ket konak *harresa* e eotit...(V. 20)  
...*martesen* e tÿne e prunu per s'marit. (V. 83)  
...e bani *scerbesen* me hoscnuut t'ëemres...(V.101)

**Prapashtesa –(i)sht** Ndesht sidomos tek formimi i ndajfoljeve prej temave emërore . Prapashtesa –sht u paravihet temave jo të parme që mbarojnë me –i, ndërsa prapashtesa –isht u paravihet temave të parme apo jo të parme që mbarojnë me bashkëtingëllore.Xhuvani e Çabej, shkruajnë, se “*prapashtesa -isht u bë produktive në gjuhë të shkrimit, duke formuar me të ndajfolje mënyre prej emrash e mbiemrash*”.<sup>101</sup>  
..e hogne mas *mrapscitiisc, legiisc* eëea t'vetat (V.110)  
.. me ja lÿpp proven *marrisct*. (V.183)

**Prapashtesa –scem (-shem).** Formohen fjalë që u përkasin klasës së mbiemrave formuar nga emra dhe folje që tregojnë gjëndje e mënyrë. Babi në këtë prapashtesë shënon zanoren *ë* me grafemen *e*, ndryshe nga Radoja ku kjo zanore ka rënë duke dalë në formën: *scm* (*shm*)

Misirliive iscte kag e *terrsce* ...Moiseit u ciue Israeli prei breghut *anneiscem*...(V.62)

Eçe âsct trimassc e i *kuituescem* (V.88)  
Profezzit e Davidit ma t'permennunat si per mi scelbues *t'hynuescem* .(V. 97)  
...ent e *scughuruescme* i çaa eçe harten e Kiiscs...per hÿsmet t'sai *t'laeemscme*.  
( V. 101)  
...prei Israelit *sÿyt e mscircsem* ... (V.122)  
... e iscin kaap mas Çotasc *t'ghgnyescem* (V. 122)

<sup>101</sup>A.Xhuvani – E.Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe* (1962), në “Vepra I”,Tiranë, 1980, f. 484.



## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

**Prapashtesa -i**, është një prapashtesë e vjetër në gjuhën shqipe. Në shqipen e shkruar ajo dokumentohet që në veprën e Buzukut. Me këtë prapashtesë formohen prej emrash, mbiemrash, emra abstraktë të gjinisë femërore.

Në materialin e vjetër prapashtesa **-i** bashkohet zakonisht me tema fjalëformuese emërore të parme duke formuar emra, si psh:

...ku me e nñeërue zotin as *priftniin* 'vedi.(V. 66)

...fulia ktii populit t'kegien e mkatit me at *maçni* ci ka...(V.71)

...ja kiscin hatrin e i bascin hitatin e i cioiscin *çuntii*...(V.108)

### **Prapashtesa -si**

“Prapashtesa -si është e vjetër, ajo gjindet që te Buzuku e te Budi. Kjo prapashtesë është një zgjerim i emrave vepronjës më -ës me anë të prapashtesës -i, veçse si një zhvillim i brendshëm i shqipes. Me këtë prapashtesë formohen emra abstraktë e kolektivë, prej emrash. Për krijimin e këtyre fjalëve- pohon gjuhëtari E. Hysa “*Numrin më të madh të tyre e përbëjnë ata emra që janë formuar nga tema emërore të parme*”<sup>102</sup>.

...mos prei *micsiet* ci ka me te...(V. 236)

...o me ba nér juu *plecsii*.(V . 237)

**Prapashtesa -ushë**, me funksion përkëdhelës haset vetëm një here tek Pashko Babi në fjalën giarnusc:

...eehrit gi vueł kunnra Sefit ajo *giarpnusc* nuk bñani aspak saber. ( V. 38), si emër i gjinisë femërore që ka kuptim si: grua zemërligë, ngatërrestare, dredharake.

Si rast të izoluar ndeshim **prapashtesa ( cgi-)**. Realisht kjo prapashtesë shtron pyetje për diskutim nëse me grafemën *cg* autori ka shënuar një *xh* apo *gj*? Sipas studimit shkronjen *xh* ne nuk e ndeshim në asnjë rast tjetër, gjë na lejon të shkojmë drejt mendimit që autori mund të ketë shënuar një *gj*. Këtë grafemë nuk e ndeshim në fjalë të tjera, që sërish na shtron problemin nëse mund të jetë një gabim shtypi.

Sipas mendimit tonë, kjo prapashtesë përdoret me ngjyrim zvogëlues a përkëdhelës. Identifikohet në shembullin:

*Barkacgiit* I ççane scogi-scoit...(V.119)

### **Formimi me parashtesë dhe prapashtesë.**

Ky lloj formimi nuk është shumë produktiv në vepër. Zakonisht ndeshim fjalë emra dhe folje .

...ma fort i lakmohet e i *sbukurohet* reëiku. (V. 11)

..por eçe veet i ça vedit n'*scperblees* t'makit.(V. 98)

### **Formimi me nyjëzim dhe me parashtesë ose me nyjëzim parashtesë e prapashtesë.**

Në krahasim me formimin parashtesë dhe prapashtesë, ky lloj fjalëformimi është më produktiv në formimin e mbiemrave të nyjshëm e mbiemrave të emëruar.

...deri tu jeta e *pasosune*. (V. 190)

...zinte trima t'mçai e t'*perspirtscm*. ( V.79)

<sup>102</sup>E.Hysa, *Formimi i emrave me ndajshitesa në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2004, f. 147.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

...travaít t'pa praiscme kurr. (V. 166)  
...fial fort t'permałscme perpara.(V. 309)

### **Kompozitat.**

Formimi i fjalëve me kompozim nuk është shumë prodhimtar tek Pashko Babi, dukuri që vihet re edhe tek autorët e lartpërmendur. Pavarësisht se kemi të bëjmë me një vepër voluminoze, vihet re se autori nuk shfaqet shumë i sigurt në përdorimin e fjalëve të përbëra. Ndeshim me këto struktura :

#### ➤ **Emër + emër**

**hał+εεεve** Por prep e prep €oti as prei atyne hał+εεεve dor fart nuk hog. (V.122)

#### ➤ **emër + mbiemër.**

**pûn+mažž** ...atij ju duk si ma *pûn mažž* ner ta. (V.22)

**εemer + trim** Isaku e kiscte n'hater Esaun se iscte ma *εemer trim*(V.29)

**εemer +dasctun** dor-žan fort e *εemer dasctun*. (V. 50)

**ghoi+žunues.** E kso doret ai ghoi žunues...(V. 164)

**už+εεεt.**...patne vooit dikuur *už+εεεt* vënnaliit. (V. 166)

**εemer+ buut** Vëne vedit εghiežen teme e zeni prei gi jam *εemer buut*. (V.229)

**menne+trasc**

**εemer +ngusctuem ... ..menne traasc** e *εemer ngûsctuem* ka besa e atyne prove gi patne laan profett si fial! (V. 277)

#### ➤ **emër+folje**

**dor+žan....** *dor-žan* fort e *εemer dasctun*. (V. 50)

**ghoi+lscuem...**do fmii *ghoi lscuem* i vuune ghaein. (V.117)

**giak +bâam....***giak-bâam* i paa kurr gni žiim *εemer*...(V. 164)

### **Përngjitja.**

Karakteristikë e kësaj mënyre fjalëformuese lidhet me faktin se autori përzgjedh që në veprën e tij të përdor shumë rrallë formimin e fjalëve me përngjitje. Madje shumë fjalë që tek autorët e tjerë e gjejmë të përngjitur , Pashko Babi preferon ta shkruajë ndaras si:

...ruute *gižž se si* me muui me i daal hakut. (V. 33)

Nuk do te me e pa *as pak*. ( V. 33)

Gjatë studimit ndeshim ndajfoljet lidhëzat dhe numërorët me përngjitur në këtë vepër.

...ka per tug nit tyğ, e barkut t'ğt sot e *pergižžmon*. ( V. 118)

Takam ma t'mirin gi kiscte *porsi* regin. (V. 153)

...popułi muer *dymçet* ghur...(V. 114)

...pa iu baa scğğbe per keg as *kerkûnn*. (V. 13)

Në formimin e kompozitave hyjnë edhe **numërorët** .

...si u mûscne tamam *sctatçet* viet...(V. 150)

...n'fagie t'toks per *katerçet* net. (V. 15)

Kaluene sypri maleve ma t'neltave triçet płaam. (V. 16)

### **Ndue Bytyçi.**

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Që në krye të rradhës duhet të sqarojmë, se duke u nisur edhe nga botimi i autorit, i cili nuk është shumë voluminoz, edhe format e fjalëformimit nuk janë të shumta. Do të përpiqemi të jemi sa më shterrues në analizimin e materialit të vjelë nga vepra.

### **Formimi me parashtesim.**

Ka një përdorim shumë të kufizuar. Ndeshim vetëm rastet e poshtëcituar.

**Parashtesa për-**Ka një përdorim të reduktuar tek Bytyçi. Kjo parashtesë i bashkangjitet temës foljore *piek* në shembullin e vjelë.

Me flicitit giçç c’kam perpikun. ( çet urçnimet e Scêites Kisc .11)

**Parashtesa ç-** Kjo parashtesë gjendet tek folja *fryn*, duke formuar kuptimin antonimik.

Ci me vraas inaat kee *çfryç*! (çet urçnimet e Scêites Kisc.8)

**Parashtesa shpër-** Gjendet tek një fjalë e vetër, që ndoshta sot ka dale nga përdorimi. Tui *scperpaaλ* , tui mormorue. (çet urçnimet e Scêites Kisc.9)

### **Formimi me prapashtesim.**

**Prapashtesa –im.** Kjo prapashtesë identifikohet në formimin e emrave nga tema foljore. Është shumë prodhimtare në vepër.

Jet me t’mira e me *béekim*

E ne ciil saghlam *scelbim*

...

Kan me pas saλ gnat *malķim*

Ci pat Kami per t’maç *dnim* . ( çet urçnimet e Scêites Kisc. 6-7)

### **Prapashtesa –ar/ -tar.**

Gni *εaraar*, gni derg, gni dek. (f.6)

E me sckuemun nuk kan marre

Me pevetun nner *scortare*. (f.4)

**Prapashtesa –o.** Kjo lloj prapashtese gjurmohet tek një sërë foljesh me temë të parme.

E gaa tieter si *tepron*

Vecse mkati ci *denon*.

...

N’kioft ci prinnen e *hatron*

E s’e do e s’e *nighon*. (çet urçnimet e Scêites Kisc f.6)

**Prapashtesa –or.** Përsa i përket kësaj prapashtese gjurmohet vetem tek fjala *gjaksor*, e cila na del në dy forma; giaksur/gaksor.Një dukuri të tillë e vumë re edhe tek Babi tek fjala burgatuur/burgator. Por theksojmë se autori në rastin e parë dyfishon zanoren u ndërsa Bytyçi nuk e dyfishon.

Vet *giaksurit* kryyt ja sctyp

Jam *gaksort* maλkue εotit. (çet urçnimet e Scêites Kisc.8)

**Prapashtesa –i.** Me këtë prapashtesë formohen emra abstrakt dhe mbiemra të cilat formohen nga tema të ndryshme, zakonisht tema emërore e foljore.

T’maçe fees e bain *çunii*

Nner t’pafee per *haimalii*.

...

Saberli eoti vonon  
Ato loina ato *mahii*

...

Ato msime *skannuüii*  
Por eçe me pas lakmii (çet urçnimet e Scêites Kisc f. 4,10,12)  
Per pun t'kece a mcat.

### **Përngjitja.**

Një ndër mënyrat që ka përdorur në vepër Ndue Bytyçi, është edhe përngjitja. Kjo mënyrë e fjalëformimit paraqitet mjaft prodhimore në raport me mjetet e mënyrat e tjera fjalëformuese. Zakonisht formohen ndajfolje, permemra të pacaktuar dhe lidhëza nënrënditëse.

Mos n'*kurrnenen* dam

...

Nner syq t'eot jan *giççmon*

...

N'feast t'urçnueme t'giçç *motmotin*

....

Saλ kuur do *nnokusc* me t'pree.

...

*Perse* çā eoti at amanet.

...

mos *kurrnenen* dām me I bāa .

Une kam liç me ciiλ *perpieet*. (çet urçnimet e Scêites Kisc. 7-9-11-12-13)

### **Përmbledhje e kreut të gjashtë.**

Analiza e tekstit në aspektin gjuhësor sigurisht ka nxjerrë në pah një varg çështjesh të rëndësishme, që lidhen me rrafshin fjalëformues. Autorët kanë shumë elemente të përbashkëta.

Elementi i parë që vihet re është se në vepra e tyre është se formimi me prapashtesim paraqitet parësor. Prapashtesat, kompozimi, përngjitja kanë një përdorim të zbehur.

**Ëngjëll Radoja.** Shumë produktiv ky autor ka formimin prapashtesor. Me prodhimore është prapashtesat -im, Në këtë format ndërtohen emra prej foljesh -o; emra veprimi. Këto emra që identifikohen në shkrime, nga pikëpamja e strukturës morfologjike, kanë si temë fjalëformuese temën e kohës së tashme të foljeve si: dnmim (-dën(o)). Po kaq produktive është edhe prapashtesa -ar\ -tar që shërbejnë për të formuar njësi leksikore me kuptim të ri ose plotësues shprehin zakonisht profesion a mjeshtëri, formojnë emra vepruesish prej emrash ose edhe nga folje, si dhe mbiemra prej emrash si: skollar/i (< shkoll+ar); mortar (< mort +ar); këshilltar (<këshill +tar) kundërshtar (< kundërshto). Një dukuri të veçantë ndeshim edhe në përdorimin e prapashtesës -(i)sht që u paravijet temave jo të parme që mbarojnë me -i: haini-sht, sceitni-sct. Ndërsa prapashtesa -isht u prapavijet temave të parme apo jo të parme që mbarojnë me bashkëtingëllore: divan-isct, marr-isht etj.

Një vend të rëndësishëm zë përdorimi i prapashtesës -shëm. Specifikë është se me këtë prapashtesë gjurmohen në vepër një sërë mbiemrash me prejardhje emërore e foljore që tregojnë një gjendje a një mënyrë si: kujtuescm (kujtue+scm), menduescm (mendue+scm), ghzuescm (ghzue+scm)etj Prapashtesa të tjera janë edhe prapashtesa

–i, me të cilën formohen një sërë emrash abstract të gjinisë femërore; parapashtesat –o/-or/-tor me të cilat formohen folje, emra e mbiemra.

Me pak të përdorura janë formimet parashtesore. Citojmë përdorimin e parashtesave pa- që ndeshet e përdorur në shumë fjalë, duke iu ngjitur emrave, mbiemrave, ndajfoljeve. Parashtesa pa- vendoset zakonisht para temave emërore të parme, duke i dhënë fjalës kuptim mohues, dhe duke formuar një klasë tjetër fjalësh, zakonisht mbiemra të nyjshëm. Parashtesa për- nuk është shumë prodhimtare në krijimtarinë e Ëngjell Radojës. Ajo u ngjitet ndajfoljeve e foljeve , duke u dhënë kuptime të ndryshme. Parashtesa shpër- është joprodhimtare, i jep fjalës kuptim intensive.

Nyjëzimi është shumë prodhimtar në vepër duke formuar mbiemra të nyjshëm , emra të rasës gjinore dhe emra farefisnie.

Kompozitat.Radoja ka formuar një numer të reduktuar kompozitash Emër + emër

(εemer + guur); emër + mbiemër (Fat + kcii) (Facie+ εεεt)

Në formimin me përngjitje pjesa më e madhe e fjalëve i përket pjesëve të pandryshueshme të ligjëratës dhe numërorët me përngjitje

**Pashko Babi.** Formësimi i këtij autori nuk i shkëputet rrugës së dy autorëve të sipërpërmendur, përkundrazi ndjekin të njëjtat kritere, por që duhet theksuar që Pashko Babi ndjek rrugë më të larmishme fjalëformimi.

Kemi veçuar dhe studiuar këto parashtesa : Parashtesa pa- që u ngjitet temave emërore ose mbiemrave të emëruar.(t’pa scpitve , t’pa εot, t’pa fee); Parashtesa për- që identifikohet më së shumti tek foljet, ndajfoljet, duke i dhënë atyre një kuptim të ri plotësues( *permrapa*, *perpini*, *perlieu* ,perhap ).

Parashtesa shpër-, z/s-, zh, që nuk janë prodhimtare dhe u ngjiten zakonisht foljeve .

Formimi me prapashtesë është shumë prodhimtar në veprën e Babit. Prapashtesa më prodhimtare është prapashtesa –im. Me anë të kësaj prapashtese formohen një sërë emrash të prejardhur nga folje në temë bekim ( beko), paitim ( paito), kursim ( kurse) etj. Po aq produktive është edhe prapashtesa –ar\–tar në formimin e emrave dhe mbiemrave nga tema emërore dhe mbiemërore (dietart, *hysmegiare*, *hysmegiare* kaghtar , *ksciλtart* , *nnimtar*). Prapashtesa të tjera kemi edhe prapashtesën –es. që është mjaft produktive (scperblyes ,martesen); Prapashtesa –(i)sht që gjurmohet sidomos tek formimi i ndajfoljeve prej temave emërore( *mrapsctiisc*, *legiisc.marrisct*). Prapashtesa –shëm. Që formon fjalë që u përkasin klasës së mbiemra formuar nga emra dhe folje që tregojnë gjëndje e mënyrë. (e terrscme i kuituescem) .

Më pak produktive kemi prapashtesat –i (*priftnii maçni*), –si (*plecsii*) me anë të të cilave formohen prej emrash, mbiemrash, emra abstraktë të gjinisë femërore a emra kolektiv.

Mes tyre na tërheq vëmendjen prapashtesa –ushë, me funksion përkëdhelës që haset vetëm një here tek Pashko Babi në fjalën *giarnusc*: ...εehrit gi vueλ kunnra Sefit ajo **giarpnusc** nuk bâni aspak saber. ( Vakinat, 38), si emër i gjinisë femërore që ka kuptim si: grua zemërligë, ngatërrestare, dredharake.

Po kështu Prapashtesa xhi- ( *cgi-*)..Identifikohet në shembullin:**Barkacgiit** I ξξane scogi-scoit...(Vakinat 119)

Formimi me nyjëzim. Shfaqet mjaftueshëm prodhimtar ku pjesën më të madhe të mbiemrave Pashko Babi i përdor me nyjëzim, po ashtu edhe mbiemra të emëruar dhe emrat e farefisnisë, emra asnjajës që formohen nga folje (i jati, t’birin, e bija, i foluni, i εemers).

Formimi i fjalëve me kompozim nuk është shumë prodhimtar tek Pashko Babi,por në krahasim me autorët e lartpërmendur prezenca e tyre është më e dukshme tek

formimet: emër + emër (haλ+εεεve), emër + mbiemër (pûn+maξξ / εemer + trim) , emër+folj (dor+ξan / ghoi+lscuem), në formimin e kompozitave hyjnë edhe numërorët (*sctatçet* viet / *katerçet* net).

Përngjitja. Pashko Babi nuk është konsekuent në përdorimin e fjalëve me përngjitje. Shumë prej tyre ai preferon ta shkruajë ndaras si: ..ruute **giçç se si** me muui me i daal hakut. (Vakinat. 33)/ Nuk do te me e pa **as pak**. ( Vakinat. 33) Por gjatë studimit u ndeshën, pa dyshim edhe fjalë me përngjithje ndajfoljet\_(pergiççmon) lidhëzat (porsi) dhe numërorët me përngjitur( dymçet).

**Ndue Bytyçi.** Autori ynë është shumë i reduktuar në përdorimin e fjalëve me parashtesa dhe prapashtesa. Janë analizuar parashtesa për-. që gjendet e bashkangjitur temës foljore *piek* (perpiek); Parashtesa ç-, e cila gjendet tek folja *fryn*, duke formuar kuptimin antonimik (çfryy) ;Parashtesa shpër- e cila gjendet tek një fjalë e vjetër, që ndoshta sot ka dale nga përdorimi (tui *scperpaal*).

Vëmë re se autori shfaqet tepër i kursyer në përdorimin e parashtesave gjë që nuk ndodh tek formimi prapashtesor. Analizuar prapashtesën –im. Kjo prapashtesë identifikohet në formimin e emrave nga tema foljore. (béekim, scelbim, maλkim etj)

Prapashtesa –ar/ -tar, prapashtesa –o prapashtesa –or, prapashtesën –i, të cilat gjurmohen tek disa folje, mbiemra, emra.

Përsa i përsa i përket formimin me nyjëzim, konstatuam disa mbiemrash të nyjëzuar dhe mbiemra të emërzuar.

Përngjitja paraqitet mjaft prodhimore në raport me mjetet e menyrat e tjera fjalëformuese. Zakonisht formohen ndajfolje, permemra të pacaktuar dhe lidhëza nënënditëse( kurrngenen ,giççmon, motmotin, nnokusc, perse ).

Në veprat që kemi shfrytëzuar në punimin tonë, natyrisht që mungojnë larmi të tjera mjetesh fjalëformuese, por gjithnjë duhet marrë parasysh koha kur u shkruan dhe u botuan shkrimet e këtyre autorëve. Duhet vënë në dukje që autorët tanë dhanë një kontribut mjaft të çmuar, pavarësisht formimit të tyre gjuhësor, duke na ofruar një traditë gjuhësore të gegërishtes në gjysmën e dytë të shekullit XIX.



### KREU VII

#### Veçori morfologjike.

#### Emri. Kategoria gramatikore e gjinisë, numrit dhe rasës

Emri si klasë fjale në veprat e studiuara do të vështrohet në aspektin morfologjik. Kështu në vazhdimësi të punimit do të përshkruhen dhe do të trajtohen veçoritë morfologjike të gjinisë, formmit të shumësit dhe të rasës së emrave.

#### 8.1. Kategoria gramatikore e gjinisë.

Përshkrimi dhe shpjegimi i kategorisë gramatikore të gjinisë së emrit në veprat e tre autorëve tonë përbën një çështje të rëndësishme në punimin e kësaj teme doktorale. Gjinia është vlerësuar si një ndër kategoritë gramatikore që listohet si kryesore dhe karakteristike për klasën e emrave. Përmes shembujve të ilustruar do të pasqyrojmë veçoritë e kësaj kategorie të emrit dhe do të përshkruajmë mjetet me të cilat ndërtohet gjinia e emrit. Disa nga këto emra vështrohen në përjasje me përdorimin e tyre në gramatikat e sotme, duke trajtuar çështjen e evoluimit të formimit të kësaj kategorie. Problemet e kategorisë së gjinisë janë bërë prej kohësh objekt studimi për shumë studiues, duke kontribuar kështu, me hulumtimet e tyre në një vëzhgim të zhvillimit historik, të pasurimit dhe të ndryshimeve që ka kjo kategori e emrit në gjuhën shqipe.

*Me problemin e shqipes dhe me vendin që zë ajo në grupin e gjuhëve indoevropiane ja në marrë shumë gjuhëtarë, ku çështja e gjinisë së emrave dhe veçanërisht ruajtja e tri gjinive të emrit në gjuhën shqipe ka qenë bazë për të vërtetuar karakterin indoevropian të shqipes. Dijetari i parë, që vërtetoi karakterin i.e të shqipes, ka qenë Rasmus Rasku, i cili këtë konstatim me vlerë shkencore e mbështeti pikërisht në ruajtjen e tri gjinive në sistemin nominal të shqipes.*<sup>103</sup>

Letërsia shqiptare në shekullin e nëntëmbëdhjetë u përfaqësua me një grup autorësh shkodoranë si: Pjetër Zarishi, Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi, Leonardo de Martino etj. *Ishin këta shqiptarë me shkollim katolik e deri diku edhe klerik italiaë të vendosur tani me banim në Shqipërinë veriore, që filluan në mesin e shekullit të nëntëmbëdhjetë të vendosnin bazat e një letërsie të re shqiptare*<sup>104</sup>.

Në mesin e tyre, si e pamë gjatë punimit tonë, kemi veçuar Ëngjëll Radojën me “Dotrina e kerscten me msime e scpiegime”, Pashko Babi me “Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree”, Ndue Bytyçin me “Urdhnimet e Tenzot e t’sceites kisc”. Në veprat e këtyre autorëve, që u bënë objekt i studimit tonë, na ranë në sy disa veçori të sistemit emëror, që vendosëm ti sjellim në vëmendje.

Dimë që gjuha shqipe ka të zhvilluar sistemin emëror me prezencën e klasifikimit të emrave në tri gjini: mashkullore, femërore dhe asnjajëse<sup>105</sup>. Me ndryshimet që pësoi gjuha jonë ndër vite vihet re një mbizotërim i gjinisë femërore e mashkullore dhe me një reduktim të gjinisë asnjajëse.

Edhe në veprat e shkrintarëve veriorë të shekullit XIX, vihet re një mbizotërim i gjinisë mashkullore dhe femërore e më pak i asaj asnjajëse, gjë të trajtohet si më poshtë vijon.

Përdorimin dhe klasifikim e gjinisë së emrit e kemi dalluar morfologjikisht:

a-nga mbaresat që ato marrin në trajtën e shquar të rasës emërore

b-nga mbiemrat a fjalët përcaktuese që i shoqërojnë.

Por, ashtu gjininë e emrave e dallojmë së pari nga një kundërvënie mashkullore-femërore.

<sup>103</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore VII*, Prishtinë, 1986, f. 93.

<sup>104</sup> R. Elsie, po aty, f. 170.

<sup>105</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë, 2002.



### **Ëngjëll Radoja**

#### **Gjinia mashkullore e emrave.**

Emrat e gjinisë mashkullore hasen me një denduri të madhe përdorimi në vepra. Shtrirjen më të gjërë e kanë ato emra të cilët tema u mbaron me bashkëtingëllore dhe në trajtën e shquar marrin mbaresën -u si : plak, kamçgik, esc, mik, shok etj.

...ci jee kriue n' *bark* t'Nans sate. ( D.C.74)

Asctú Ati nuk asct mâ *plak* as mâ i maçç ... me *giak(gjak)* t'vet t'paa-scmuem tui dek n'druú... (D.C.15)

...tui dasct me gith scpiirt e *sciokun(shokun)* per hater t'tii.(D.C.100)

Po kështu të gjinisë mashkullore janë edhe emrat që në trajtën e shquar në numrin njëjës marrin mbaresën -i , karakteristike e emrave të gjinisë mashkullore.

I maçi *Perennii(perëndi)*... ai asct giçç *scpiirt (shpirt)*...(D.C.7)

... ep t'mirve *Parrisin* e t'këciive funin e *ferrit* per giççmon. (D.C.14)

...gni asct natyra e paa-dame e *dilit / e dili (dilli)* ka n'vehte driten. (D.C.16)

... me na zierr prei robniet t'*diaiit* (diallit) maλkuem e prei munnimesc t'funit t'*ferrit* (D.C.18)

Sie laan ti *borcin (borxhi)* e ktii *Urçnimit ( urdhnimit )* (D.C.100)

... e godissin iñuit prei *drunit, gurit, arit* ci i kan per eota (D.C.103)

Mes shembujve të listuar më sipër veçojmë emrin e gjinisë mashkullore lig-i, i cili tek Ëngjëll Radoja e ndeshim të përdorur si emër të gjinisë femërore, vetëm në rasën kallëzore, si një emër të përveçëm, në trajtën:

...nuk e ruin sceiten *Ligen* e tii...(D.C.23)

...ci discmoin gith-ugnii Feen e *Ligen*...(D.C.33)

Vëmë re që tek Radoja gjendet e përdorur trajta arkaike korp-i dhe jo trajta më e re trup-i. Por që të dyja format e emëtuara përfshihen në emra të gjinisë mashkullore.

...kuur Çoja e bekueme me *korp* e me *scpiirt basck*...(D.C.84)

#### **Gjinia femërore e emrave.**

Tipar kryesor per identifikimin e gjinisë femërore të emrave është mbaresa -a\ -ja që marrin këto emra në trajtën e shquar në numrin njëjës psh:

Gni asct *natyra* e paa-dame...(D.C.16)

...por tui vuu n'ball *doren* ...masannei tue vuu n'*zemer*...per gni her buen...(D.C.19)

...e kie mlue me rrasa...(D.C.30)

...janë të nevojshme kater *pun: Feja* e zila menohet si Bessoim; *Scpnessa(shpresa)* e zila zehet n'Atyn...(D.C.11)

...t'zilt massi sdrypi nner ta *rreia (rrezia)* e *drita* e scpiirtit sceit...kuur t'nniim se bie *kumona* na sctie n'menn me e ççan cistú...(D.C.78)

...kuur Krisctin giuçit e liçne per gni *sctyl (shtyll)* n'oborr... kuur i vúune n'krÿe gni *cunor ferrasc( kunor ferrash)* ... kuur scpiirti scéit *diten* e Rreiaivet sikuur *flak* eiarmit /...e t'munohet me i perghiaa me *vepra* t'mira.(D.C.83-84)

Mes tyre veçojmë emrin i cili ndryshe nga klasifikimi i sotëm në gjini, në vepër del si i gjinisë mashkullore.

...scum prei tamahit e prei *discirit (dishirit)*.(D.C.39)

### **Gjinia asnjane.**

*Emrat e gjinisë asnjane në lakim dallohen nga emra e dy gjinive të tjera vetëm në emëroren e kallëzoren e shquar njëjës, ku nyja –t ndryshon prej nyjeve përgjegjëse të gjinive mashkullore e femërore. Ndërsa në emëroren e kallëzoren e pashquar njëjës ato nuk kanë ndonjë dallim prej emrave të dy gjinive të tjera.*<sup>106</sup>

Më së shumti dallojmë:

a- emra jofrymorësh, që i përkasin gjinisë asnjajëse si:

...tieter s'ascht vec *t'ruitunit* Lig (D.C. f.64)

... per t'mir ton *t'visctirat(vishtirat)* na i bain me fitue meritim. (D.C. 64)

b-mund të veçojmë asnjane të mirëfilltë të shqipes si: uj, mish etj, por që shumë prej këtyre emrave sot kanë kaluar në emra të gjinisë mashkullore si mjalti, uji mishi, djathi etj. ne formen që i gjejmë edhe ne veprat tona:

...m'duket me hangher *misc(mish)*.(D.C .113)

...s'kiscim me diit me than *ui, akulli* e bora..(D.C. 15)

### **Dygjinisia.**

Shfaqet si një dukuri e vjetër e gjuhës shqipe, që sot vepron në një grup emrash jofrymorë të gjinisë mashkullore që marrin në numrin shumës prapashtesat –a dhe –ra.

Duke ndjekur këtë dukuri në vepër, vëmë re se ajo është shtrirë tek të gjithë emrat e gjinisë mashkullore.

Pra,karakteristikë është se këta emra kur ndërrojnë numrin nga njëjësi në shumës ndërron edhe gjinia nga mashkullore në femërore.

*Kështu formohet një grup i veçantë emrash të dygjinishëm ,që qëndron midis gjinisë femërore dhe mashkullore. Dukuria e ndërrimit të gjinisë së këtyre emrave në numrin shumës është e vjetër, ajo është përgjithësuar në gjuhën letrare dhe është bërë e detyrueshme nga norma.*<sup>107</sup>

Duke u mbështetur në klasifikimin që bëhet në Gramatikën e Gjuhës Shqipe emrat me përdorim të dygjinishëm i klasifikuam:

a)*Emra mashkullorë që e formojnë temën e shumësit me prapashtesen trajtformuese –e, në numrin shumës e duan përcaktorin të gjinisë femërore.*

...me tiera fial *çet temelet(dhet temelet)* e sceites Fee? (D.C.14)

...as s'ka me gabue *n'essape tiera t'sceites Fee* ... (D.C.137)

...Kriscti i ka dhan *dy pusctete(pushtete)* fort t'nalta.(D.C.37)

b) *Ndërrimi i gjinisë dëshmohej edhe me shumësin e disa emrave të lëndës me prapashtesën –na.*

Këtu duhet vënë në dukje se autoret veriorë, ashtu si edhe te shkrimtarët e tjerë të gegërishtes, emrat e kësaj kategorie shënohen me –n ndërzanore. Më poshtë janë listuar disa shembuj:

...faroj me *uina t'mça* gith *çeen* maar.(D.C.137)

...Jan ata ci bain e apin *barna* (D.C. 127)

### **Pashko Babi.**

### **Gjinia mashkullore e emrave.**

---

<sup>106</sup> Sh.Demiraj,*Çështje të sistemit emëror të shqipes*,Tiranë, 1972,f. 95.

<sup>107</sup> ASHSH, Gramatika e Gjuhës Shqipe I, Akademia e Shkencave,Tiranë, 2002,f.92.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Dukuri që vihët re edhe tek Babi lidhet me dendurinë e madhe në përdorim të emrave të gjinisë mashkullore tema e të cilëve u mbaron me zanoren –u.

Kiscin per t'keen prei *barkut* t'tii...del prei *çeut(dheut)* tann, e prei ilakajet tanne e prei *konakut* tyt tet. (V. 34)

Po ky asct *vllau(vllau)* gi kemi ma t'voghlin? (V. 45)

A ka se si na me e paas scetrii doren me viceë *konakun* e tann *Çot* (V. 46)

Ju treti *giaku(gjaku)*, ju hîni hataaja (V. 47)

... e po ûn i kam iik *reëikut(rrezikut)* me ta *çan* haberin (V. 51)

...ti kee per ta priit ma Aronnin *buusbreghut(bregut)* (V. 58)

...me keen nafaka e atii *çeut(dheut)* sakt e pa derman...preu *ulukun(ullukut)* e ujit (V. 136)

Mardokeut si scote per pa u sieł para *prakut* ders saai (V. 152)

...asctû scka âsct prei *barkut* robıt (V. 162)

Po kështu të gjinisë mashkullore janë edhe emrat që në trajtën e shquar në numrin njëjës marrin mbaresën –i, karakteristike e emrave të gjinisë mashkullore.

Abrami ghoditi gni elteer me *ghur(gur)* e sypri uidisi drûut... per mas vedi scef *gni \*dasc(nji dash)* gi kiscte meet n'gni morrie(morriz). Egnli( enjlli<ëngjëlli) i *Çotit* per s'dytit briti prei *cielët*. (V. 26) ...se c'giâa t'ëeee ka prûu *fati* em n'konak! (V.38)

Mannei zuer prei *ghiscitit(gishtit)* ...kee per t'vûu eçe scêje per reçç malit...Manei kuur t'usctoin *ëani* (zani) i buriave ather *populi* (populli) t'sctyhet prei *malit*...sçeesc e maçe, diget eierm, giet *tym* (tym). / Mos merr bosc neper ghoi *emnin* e *Çotniis* (V. 64)

...per me fool per kunnra per to cio *giarpni (gjarpni)* t'ëherlatisun, gi ku bascin ato varr si *eiermi* (ziermi) digte (V.74)

...e mlue prei *barit* keg sikur me keen gni *pyll(pyll)* malit (V. 163)

Një grup më vete listojmë edhe disa emra që përfundojnë me togun zanor –ua(ue) si krue, grue etj karakteristike për dialektin gegë.

...u ciue e sçoi e i nnei mrapa tu kamt e tija, filoi me ja lagh me lod, gi i derçescin si *krue*. (V. 204)

I bieł sckamıt me celıt, e ka per t'daal *krue* ujit (V. 63)

...gi mos me pas daal gni *ghrue* (grue) me ghairët si mos kusc. (V. 136)

Krahas shembujve që listuam më sipër veçojmë disa emra që nuk dalin në vepër në të njëjtën gjini që janë sot. Kështu emri i gjinsë mashkullore lig-i në veprën e Pashko Babit nuk e formon trajtën e emrit me mbaresën –i por me mbaresën –a psh

.... po *ligia(ligjia)* si thot? (V. 229)

... nee *ligia* (ligjia) jon nuk na ep...(V. 160)

Po kështu me trajtat e gjinisë femërore del edhe emri lot-i me formën lodja psh:

... e kriscti i sçoi *lodja* ... (V. 244)

...Mannei ja Isçoi duert gıafs Beniaminit e e mor n'gryk e sçoi *lodja* per ... (V. 47)

Në analogji me emrat e mësipërm edhe emri profeti del në formën profeta

.... asct ai *profeta* qı ka paas per t'arç...(V. 217)

Shembuj të tjerë listojmë: .... aty nuk dihei scka asct *dergia( dergjia)*...(V. 10)

... me i ba vennit sceit hysmetin... si t'ju bite *scordja* (shordja)...(V. 96)

... sikur ban giymyri prusc e *druja* zierm (V.105)

...ka pak, ka pak u mçç *cıla( qilla)* e mannei derçı sci. (V.114)

Mos t'ju marre *droja* (V.47)

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

... perse n'ciel ka per t'keen e maçe *scperblesa* ( shperblesa) gi keni per t'gieet (V.146)

Persa i përket emrit pyll , po tek shkrintari Babi, vëmë re se pavarësisht faktit që ai përdoret në gjininë mashkullore, përcaktuesit e saj i merr në gjininë femërore. Mendojmë se kjo mund të ketë ndodhur në një pikë të zhvillimit historik kur në gjuhën shqipe po ndodhte procesi i kalimit të këtyre emrave nga gjinia femërore në atë mashkullore.

Lufta u zuu n'gni *γγλ( pyll) t'madhe*, asgierit Assalonit ju ça mrapscta e u ξξye. (V.100)

Emri pushteti, i cili në një pikë të zhvillimit historik ishte përdorur si emër i gjinisë femërore, tek Babi e gjejmë të standardizuar në trajtën: ...e ja ka ξan *pusctedin( pushtedin)* me ba giygin m'si Biri i nierit asct (ka niersia).

### **Gjinia femërore e emrave.**

Përdorimi i gjinisë femërore nuk përbën ndonjë risi dhe nuk karakterizohet nga ndonjë rast i veçantë. Kemi vjelë nga vepra shembuj që ilustrojnë mirëfilli përdorimin e emrave në gjininë femërore ashti sikurse i kemi edhe në gramatikën e gjuhës shqipe. E paa *annërr (anderr)* gni *sckaaλ (shkall)*... ktu tieter s'ken ka por topraku i Cotit e *dera* e *cielσ*. E si ebarçi *drita* mûer ghurin...tui e kuitue *m'εemer* (zemer) t'vet...(V.32)

Une *ânnra (andrra)* kam paa, e nuk giëi, kusc di me m'vûu per *rrugh(rrug)*...por scka po nniëi se *γγ t'vien* fort maar *puna* e *tyne* ...sctat *lopt* ligha por n'asct e elkur. (V.41)

*Drrasat* i vesci n'pafta t'aarta...e zan *deren* me gni tieter... u vûu *arka* e Cotit...(V. 67)

E si nnieni *drita* u lscuene kunnra Assirliive tui bâa vrrîim t'forta. Kuur i pane tu *ciadra* e *baiscin seurm* t'maçe (Vakinat. 138)

Me rëndësi është të përmendim edhe disa emra tema e të cilave del në zanore *-i*, në trajtën e shquar marrin mbaresën *-a*.

Parsia ....ani ξan *parsia* e Israelit...(V.85)

Shpia .... Ather Gedeoni i nisi t'giçç tiert *n'scpia* t'veta...(V.80)

Madhnia ....e *maçnia* e lumniis otit e eaptoi...(V.68)

Lumnia ...por gn'aq sa pat maçniia e lumniia si ne part...(V.107)

Por herë të tjera emra të tipit të tillë gjenden edhe me mbaresën *-ja*, duke treguar se autori nuk është konsekuent në përdorimin e kësaj mbarese.

Parija....*Parija* si ka natyra, si ka e mira gi patne prei Cotit... (V. 9)

Zija ...*εija* mûer hapt per giçç *ξee*(V. 42)

Baktija...po scko, e kgiyri a e kan mir pûnen tuu *vlaeen*, e si jan *baktija*. (V. 36)

### **Gjinia asnjane**

Gjinia asnjane është prezente në veprën e Pashko Babit, edhe pse jo me një denduri përdorimi. Pjesën më të madhe e zënë emra jofrymorësh, që i përkasin gjinisë asnjane si: t'folurit, si dhe asnjajës prejmbiemëror si : të zezat, të thatët, etj

...mos t'iu afrohet e *ligha( e liga)* asa kurr far kunnersctimit. ( V. 10)

...e kiscin kaap *t'driçunat( t'dridhunat)* ugni trupin e tii...( V. 145)

...*t'vsctirat ( t'vshtirat)*e provt ...( V. 150)

...sikur e lypscin *t'εεeat* (t'zezat) e *tyne*, e ju bate por gni brim (V.84)

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

...t'din me i raa arpes , ti bin para tejet, t'daaisc t'kegien(t'keqen) (V. 88)

I ça t'maren giççkunn,e i çabesen (V. 97)

Tuk maroi s'folunit u nis e ççirri t'motren (V.240)

... e lumnia e bardha ti ge besove. ( V.172)

Krahas emrave të mësipërm, mund të veçojmë asnjës të mirëfilltë të shqipes por që shumë prej këtyre emrave sot kanë kaluar në emra të gjinisë mashkullore ne formen që i gjejmë edhe ne veprat tona:

...gi kisc fillue m'u korr *elb*. ( V. 82)

...deri gi maroi elbi, e *ghruni* e hini n'hamaar.(V. 83)

Skote hysmegiari i tyne, e me gni pirûu tre ghemasc zirte *miscin(mishin)* e kurbanit. (V. 84)

Veçojmë emri krye, që dokumentohet në vepër dhe që e ka ruajtur karakterin asnjës edhe në ditët e sotme.

Eli ather uli *krÿyet* (kryet) e vet, e ju vûu puns. (V. 85)

### **Dygjinisia.**

Dygjinisia është një dukuri relativisht e vjetër e shqipes. Ajo zë një vend të konsiderueshëm në vepër, gjë që na orienton drejt asaj që në gjysmën e dytë të shekullit XIX në dialektin e gegërishtes vazhdonte të kishte një përhapje dhe përdorim të gjërë. E pohojmë këtë duke u mbështetur edhe në citimin e Shaban Demiraj i cili thekson se në dialektin verior kjo dukuri duhet të ketë qenë përhapur që në periudhën paraletrare të shqipes, d.m.th që përpara shekullit XVI.<sup>108</sup>

Këtë dukuri e bën të dukshme mbaresa –e që marin keto emra në shumës, por edhe përcaktuesit që ato marrin si:

...i pari atyne gi kiscin n'dor *essapet* e sarajit ja cioi perpara Nabucodonosorit. ...sckoiscin tuk ai eçee dy veet gi kgiÿrscin *ankimet e sai* gi kiscte...(V. 142)

Ndërrimi i gjinisë dëshmohej edhe me shumësin e disa emrave të lëndës me prapashtesën –na.

Këtu duhet vënë në dukje se autori ynë, ashtu si edhe te shkrimtarët e tjerë të gegërishtes, emrat e kësaj kategorie shënohen me –n ndërzanore. Më poshtë janë listuar disa shembuj:

... t'giçça vennet e *uinave* cieł e derççi (derdhi)...(V.16)

...me dal prei s'rahunasc gi ja rannuene tepri *n'esctna (n'eshtna)* t'tija. (V. 160)

...kan per t'meet *esctnat (eshtna)* tueja . (V. 71)

...e fryyn *ernat* e ju rescne si kie maa mrapsct.(V. 200)

Por gjendet edhe shumësi me prapashtesën –a, tek emri *petka* i cili në gramatikat e vjerta është klasifikuar si emër i gjinisë asnjës, por tek autorët e shekullit XIX e hasim të formuar me prapashtesën trajtformuese –a.

...u stolis me *petka* e icgii t'mira sikur eogn e rann...(V. 137)

### **Ndue Bytyçi**

Në veprën e Ndue Bytyçit “çet urçnimet e Scêites Kisc“ dallohen kryesisht dy gjini: mashkullore dhe femërore. Duke u mbështetur edhe në faktin që nuk kemi të bëjmë

<sup>108</sup> Sh.Demiraj, *Rreth ndërrimit të gjinisë së emrave në numrin shumës, vështruar edhe në përjasje me rumanishten*, “Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe,” Tiranë, 1972, f. 56.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

me një vepër voluminoze, normalisht që edhe prezenca e formave dhe trajtave të emrave nuk do të jetë e larmishme. Ilustrojmë si më poshtë vijon:

### Gjinia mashkullore e emrave.

Siç vihet re, autori përdor emra të gjinisë mashkullore tema e të cilave mbaron me bashkëtingëllore dhe në trajtën e shquar marrin mbaresat përkatëse –u dhe –i .

Ai me Eotin n'gak(gjak) ka ra

Puscka cit me marrun gakan(gjakun)

E fiton prei Eotit lakun. ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 12)

\*\*\*

T'tana kto jan psctyma e diallit (diallit)

Ci na i lscan miedis te balit (ballit)

Kreit kymkat prei jusc le t'cbihet

E kurr êmni mos t'i nihet. ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 8)

Krahas shembujve që listuam më sipër veçojmë emrin scnneden (shneden) që nuk del në vepër si emër i gjinisë mashkullore, por si emër i gjinisë femërore. Ky emër identifikohet në rasën kallëzore në trajtën scnneden:

: E kam *scnneden*, kam kyvetin ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 12)

### Gjinia femërore e emrave.

Tipar kryesor për identifikimin e gjinisë femërore të emrave është mbaresa –a\ -ja që marrin këto emra në trajtën e shquar në numrin njëjës . Nuk ndeshim ndonjë formë të veçantë për t'u trajtuar.

S'due me lypun te hainija,

I kam kamt e durt e mija

Prei puns eme e due medetin.

Mysafir kusdo me m'arç

Ja nap buken t'faces barç. ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 12)

### Gjinia asnjansë e emrave.

Në gjithë materialin e vjelë gjejmë vetëm një emër të gjinisë asnjansë përdorur si asnjajës prejmbiemëror.

Scocit vet me i dasctun t'kecen (t'keqen) ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 8)

Me shembujt e cituar u vërtetua një çështje tjetër me rëndësi për sa i përket klasës së emrit dhe përdorimit të tij. Njëkohësisht u dëshmuua se disa emra në gjuhën shqipe e kanë ndërruar gjininë në numrin njëjës duke kaluar nga gjinia e tyre mashkullore në gjininë femërore. Kështu emra të tillë që listuam më sipër si : pushtetja, nderja, druja, ligia etj na dokumentohen në vepër si emra femërorë. Karakterin gjinor të këtyre

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

emrave e vërtetojnë në ndonjë rast edhe fjalët përcaktuese që ato marrin . Këto emra gjatë zhvillimit historik të gjuhës shqipe kanë kaluar sot në emra mashkullorë.



### Shumësi i emrave

Numri i emrit, si një nga kategoritë gramatikore kryesore është një nga çështjet shumë të studiuara të morfologjisë së kësaj gjuhe qoftë në aspektin sinkronik apo atë diakronik<sup>109</sup>. Rreth kësaj çështjeje diskutuan gjuhëtar të shquar si: Eqerem Çabej<sup>110</sup>, Aleksandër Xhuvani<sup>111</sup>, Shaban Demiraj<sup>112</sup>, Idriz Ajeti<sup>113</sup> etj, të cilët parashtruan mendimet e tyre. Shumësi i emrave në gjuhën shqipe paraqet interes të veçantë sidomos për vetë karakterin e gjuhës shqipe. Gjuha shqipe siç dihet është një gjuhë analitike-sintetike e cila për dhënien e formave të reja përdor gjërësisht trajta gramatikore të veçanta.

Duke qenë se trajtimi i shumësit të emrave në vepër përbën një dimension të gjërë studimi, ne jemi përpjekur që në një mënyrë sa më të shkoqitur të paraqesim disa raste të shumësit ilustruar me shembuj nga veprat e autorëve. Do të përpiqemi të trajtojmë edhe raste të shmangies nga norma standarde, mendime të gjuhëtarëve rreth kësaj çështjeje etj.

Temat e shumësit të emrave janë të dallueshme qartë nga ato të njëjësit, dhe kjo duket kur formalisht këto emra i vendosim përballë njeri-tjetri si: zog-zogj; mal-male; kallam-kallama; etj.

Dimë se emrat e formojnë shumësin duke marrë prapashtesa të ndryshme trajtëformuese, duke ndërruar tingujt e temës, duke ndërruar tingujt e temës e duke marrë prapashtesë njëkohësisht apo duke ruajtur të njëjtën formë si për njëjës ashtu edhe për shumësin. Mjeti me të cilin ndërtohet forma e shumësit specifikohet vetëm si tregues i kategorisë së numrit dhe jo i ndonjë kategorie tjetër.<sup>114</sup> Shumë më i pasur paraqitet shumësi i emrave të gjinisë mashkullore.

### Ëngjëll Radoja

#### Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore:

**Shumësi me prapashtesën -a.** - Këta emra që e formojnë shumësin me këtë format gramatikorë kanë një përdorim më të dendur në veprat që kemi në shqyrtim. Veçoria e tyre është që emrat e tipit të tillë nuk e ndryshojnë gjininë në numrin shumës, pavarësisht se marrin prapashtesën -a, dhe këtë e vërtetojnë edhe përcaktorët e gjinisë mashkullore që ata marrin psh: lis-a t'gjat, grusht-a t'fort, kallam-a t'vozzer, ghem-a t'gnoom etj Psh.

...t'jeen **kraila**, mretna...e vec se kryma t'vozzer (kryma t'vocer) ... (D.C. 98)

...Kurbanat qe baheshin n'lig t'mocme... (D.C. 161)

...e u nnezim *ccirra* e *kannila* perpara... (D.C. 104)

Përveç këtyre emrave që e kanë formuar shumësin në përputhje me ligjërimin e sotëm, është me interes të vëmë në dukje se në veprën e Ëngjëll Radojës ndeshim emri **Zot-i** që klasifikohet zakonisht si emër i përveçëm e gjejmë në formën shumës me trajtën Zot-a.

...sceitnit nuk i bessoim, se jan *Ëota* (Zota) por micct e eotit... (D.C. 104)

...o disa niere t'dekun porsi *Ëota* (Zota)... (D.C.102)

5F. Agalliu, *Çështje të morfologjisë së sotme shqipe*, Tiranë, 1988, f.133

<sup>110</sup> E. Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë 1967

<sup>111</sup> A. Xhuvani, -E. Çabej, *Prapashtesat e gjuhës shqipe*, Studime gjuhësore, Prishtinë, 1976.

<sup>112</sup> Sh. Demiraj, *Gramatika historike e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1969

<sup>113</sup> I. Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1969, f.130

<sup>114</sup> Këtu duhet të theksojmë se mjeti identifikon vetëm numrin e emrit dhe jo ndonjë kategori tjetër gramatikore.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Te vepra e autorit në shqyrtim ndeshim shumësin e emrit petku të formuar me prapashtesën trajtëformuese –a petka psh.

...rrobet e kisc, *petkat* e mescs.(D.C. 102)

...dy egnei *petka\_t'*bardha.(D.C..225)

**Shumësi i emrave me prapashtesën e.** - Edhe prapashtesa e është shumë prodhimtare në veprën e autorit. Me këtë prapashtesë e formojnë shumësin një grup emrash të gjinisë mashkullore. Këto emra karakterizohen nga fakti që në numrin shumës kalojnë në emra të gjinisë femërore. Kjo dukuri morfologjike shfaqet shumë e vjetër te shkrimtarët e veriut. Sipas albanologut Shaban Demiraj “...te autorët shkodranë, që nga Buzuku emrat mashkullore që e formojnë shumësin me prapashtesën e i përdorin rregullisht si emra ambigjenë, dmth në shumës i shoqërojnë me mbiemra e fjalë përcaktonjëse të gjinisë femërore.”<sup>115</sup>

Kjo dukuri morfologjike që ruhet edhe sot në gjuhën shqipe si një fenomen i trashëguar që nga shkrimtarët pararendës shfaqet edhe tek veprat e autorëve që morëm në shqyrtim . Kështu dalin të gjinisë mashkullore emra si:

...as s'kaa me *gabue n'essape t'fees* e t'scirtit...(D.C.35)

...kaa çeu *dy pusctete( pushtete)* fort t'nalta...(D.C. 37)

...nnina nee *fajete mcatet (mkatet)* tona... (D.C. 59)

...prei Zotit t'nniemit e *mcatevet( mkatevet)*...(D.C 88)

Vëmë në dukje faktin se këtë mbaresë marrin edhe shumë emra prejfoljor formuar me prapashtesën –im si: kujtim-e, urdhnim-e, discrim-e, meritim-e, spieghim-e, etj.

...me marr mrapa *urçnimet* (urdhnimet) e tia...(D.C.62)

...traçtiit, *nneerlikimet, dreçimet* (dredhimet)ci bahen tui scit e tui ble.(D.C. 141)

...edhe gjçççi *kuitimet* e *discrimet( dishrimet)* tona...(D.C. 136)

**Shumësi me prapashtesën-na.** - Zakonisht formojnë shumësin me këtë prapashtesë:

a)një grup emrash të gjinisë asnjajëse si ujna, barna psh

...faroj me *uina t'mça* gith çëen maar.(D.C.137)

...Jan ata ci bain e apin *barna* (D.C. 127)

b)disa emra mashkullore si mallna, dhena , shina , scirtna, etj si:

... kuur baim kryq, nuk thona n'*emna* por n'emen...(D.C.25)

...urçnat ( urdhna)e tii i puççscin e i veiscin n'bał...(D.C.42)

...per ciobant e *scirtnavet* (shpirtnavet) tona... (D.C 47)

**Shumësi me ndërrim tingujsh k përkatësisht në q.** - Ekzistojnë në veprën e autorit në shqyrtim emra që e formojnë shumësin me qiellzorizimin e bashkëtingëlloreve k,g në numrin njëjës në q,gj, në numrin shumës. Të këtillë listojmë shembujt:

**k:q**

...e per t'paa- fee per *micc* (miq)e per *anmicc( anmiq)*...(D.C. 58)

...asctu mir do t'i duen *turcit* ( turqit)...(D.C.92)

**Shumësi me palatalizimin e tingullit ll në j.** Është një tjetër formim shumësi i emrave me palatalizimin e ll-së në j, pavarësisht se si formim del shumë i reduktuar në vepër.

...ci açroin *içuit* (idhujt) n'venn Teneot...(D.C.62)

<sup>115</sup> Sh.Demiraj. Po aty. f. 208

Në këtë rast veçojmë emrin *qiell* i cili nuk e formon shumësin me palatalizim por ai del me të njëjtën formë si për njëjës ashtu edhe me prapashtesën –a si:  
...n'ma t'neltin e *ciellve*(qiellve)...(D.C. 175)

### **Shumësi i emrave femërore.**

Jo më pak produktiv na shfaqet shumësi te një grup emrash të gjinisë femërore, por në këtë studim nuk do të ndalemi në të gjitha rastet e formimit. Përcaktimi më i qartë i gjinisë femërore të një emri është kur ky emër merr mbaresën –a në trajtën e shquar të numrit njëjës.

### **Shumësi i emrave femërorë me prapashtesën –a.**

Por me këtë format gramatikor formojnë shumësin edhe disa emra të gjinisë femërore si psh:

...scka nuk diin prej *letrasc*(*letrash*) mrrin me e marr...(D.C.104)

...o tui citt fial, e *prra*λa (*prralla*) permennim Zotin ( D.C. 106)

...me i pas n'hatet *rrenat* e t'kciat ...(D.C.117)

...nner ditt ci atii jan sciugurue e jan t'diilat e *festat*...(D.C. 116)

Emrin *rroba-t* e gjejmë të formuar me mbaresën –e:

...giaan e viedhun e *rrobet* e takam...(D.C. 146)

### **Shumësi i emrave me prapashtesën e.**

Si emra të gjinisë femërore dalin edhe disa emra tema e të cilave në trajtën e pashquar njëjës përfundojnë me -ër, -ull, dhe në numrin shumës marrin prapashtesën –a. Listojmë shembuj si më poshtë:

letër-letra: ...letrat e Teneot jan plot me k'so premtimesc....(D.C.53)

vepër-vepra: Veprat e mira ci jan gith scka ua ban....(D.C.11)

shpatull-shpatulla: ...ci u zaan bess n'scpatulave(shpatullave) tii.(D.C.103)

### **Shumësi i parregullt.**

Nuk mund të lëmë jashtë këtij studimi pa përmendur një element të rëndësishëm rreth shumësit të emrave në veprat e cituara. Krahas formave të lartpërmendura ndeshim në këto shkrime edhe disa emra të cilët e formojnë shumësin duke ndërruar temën e njëjësit dhe që Kristaq Cipo ndryshe e quan edhe shumësi i thyer<sup>116</sup>. Veçojmë mes tyre emrat derë, dorë të cilët e formojnë shumësin me zberthimin e zanoreve – -o, -e të temave të fjalëve në togun zanor: ue\ye si:

Emri *derë* e formon shumësin duke zberthyer zanoren *e* në togun zanor *ye* psh:  
...*dyyert* (*dyer*) e ferri, tha kriscti n'ungniill.(D.C. 37)

Ndërsa emri *dorë* zberthen zanoren *o* në togun zanor *ue* në shumës psh:

...me i la *duert* e veta n'giak t'tii.(D.C.19)

Tek Radoja gjejmë edhe rastin tjetër kur tek fjala *dorë* nuk kemi zberthimin e zanores o ne ue por në u si:...jan porsi dyy *duur*...(D.C .54)

<sup>116</sup> Cipo, Kristaq, Morfologjia, 1949.

Pashko Babi

**Shumësi i emrave të gjinisë mashkullore.**

**Shumësi me prapashtesën -a.**

...se po kisc n' krye *tre eymyla* (zymyla) buket...(V.39)  
...nner miet t'*kaamave* (kallamave) e coi gni asosc...(V.55)  
...t'pa kurr behane edhe dele dhie, *pluma* (plluma)... Moisiu nisi *dymçet burra*...(V.70)  
...me i ra c'heret mrapa *burrat e miir*.(V. 163)  
...tiert thescin *ghema t'gnoom* (gema t'njoom)e i lsoiscin rrughs...(V. 247)  
iscin n'at venn *giasct giypa* (gjasht qypa) ghurit...(V.186)

Shumësi i emrit *det-i* dëshmohet i formuar me prapashtesën –a, pra det-a.

...e t'mbleçunat e uinave i emnoi *Deeta*.(V.8)

Ashtu sikurse edhe tek Ëngjëll Radoja edhe tek Pashko Babi gjejmë formimin e shumësit : zota.

...me aso for dhunc nneeroiscin *zota* (zota)...(V.19)

ciou e ghoditna *zota* (zota) sikurse i kan.(V. 65)

...ka dy paar *petka* t'mira...(V.f48) \ ...zaptoi *petkat* e vuu në eëea vedin...(V.37)

Ky emër në gramatikat e sotme klasifikohet si një emër i gjinisë mashkullore, ndërsa në gramatikat e vjetra është klasifikuar si emër i gjinisë asnjajëse. Kjo bën që ky emër të trajtohet si një emër i dygjinishëm që vepron te një grup emrash të gjinisë mashkullore që marrin më shumë prapashtesën –a. Sipas Shaban Demirajt : "...kjo dukuri duhet kërkuar në prirjen e përgjithshme të shqipes për të zhdukur vijën e kufirit midis gjinive tek emrat e jofrymorëve sidomos në këtë numër".<sup>117</sup>

Ndërsa përse i përket emrit *nip-i* i cili shumësin e formon me prapashtesën–a, vëmë re se në vepër nuk gjendet asnjëherë në këtë trajtë, por përkundrazi autori Pashko Babi përdor format t'nip\ nipniin psh

...Giakobbi i puççi t'*nip* e vet...(V .49) / ...e *nipniin* e vet...(V .49);

**Shumësi i emrave me prapashtesën e.** - Kjo prapshtesë gjurmohet më së shumti në emra konkret dhe abstract si dhe tek disa emra të formuar me prapashtesën –im.

...tui maarr majet e *maleve ma t'nelta*...(V.16)

...n'kisc t'zotit me fal *kusctet e veta*.(V. 110)

...se aso heret *kurbanet* e baktiive kiscin per tu hieek. (V. 167)

...e jo me i lakmue *essapeve tiera*....(V.49)

...me eemer e *permaime* (permallime) fort ja kççei i biri (V.125)

...kuur i knnon *ankimet* gi derton ghoja.(V.140)

...e si i bani krailit *urimet e veta*...(V . 49)

**Shumësi me prapashtesën-na.** Në vepër dallojmë emra të gjinisë asnjajëse, që formojnë shumësin me prapashtesën na- (ujna, barna) , ashtu edhe disa emra mashkullore si eshtna.

... t'giçça vennet e *uinave cieł* e derçi...(V.16)

...kan per t'meat *esctnat(eshtna)* tueja . (V.71)

...e fryyn *ernat* e ju rescne si kie maa mrapsct.(V. 200)

Sh. Demiraj thekson se ka shume të ngjarë se kjo mbaresë e shumësit te ketë zanafillën te shumësi i emrave gjana\gjëra, zana\zëra.<sup>118</sup>

<sup>117</sup> Sh.Demiraj, *Gramatika historike*, Tiranë, 1986,f 206.

<sup>118</sup>Sh. Demiraj, *Çështje të sistemit emëror të gjuhës shqipe*, f. 208.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Në veprat në shqyrtim gjejmë të dokumentuar edhe emrin **krye** që e formon shumësin me këtë mbaresë në trajtën krena: ...për t'keen *krenat* e gñinahijes...(V.54)

**Shumësi me metafofi.** - Dukuria morfologjike emërtuar si metafofi bën që zanorja a e temës së emrit në gjininë mashkullore në numrin njëjës të kthehet në e në numrin shumës.psh. nat-net, thes-thas, rreth-rrath, dash-desh etj. Tek emrat thes-thas, rreth-rrath sipas profesor E.Çabejt janë forma të singularizuara që janë përfutuar nëpërmjet metafonisë a:e.<sup>119</sup> Në veprën e autorit dokumentohen një numër i reduktuar shembujsh:

...kuur murne me scpraaz *ççast (thast)* \_...(V. 43)

...kerkoi n'gjççt *ççast ( thast)* e eu fiA n'ççes (thes) ma t'maçin.(V. 46)

...duul prei atyne *reççeve* (rretheve) e cio zann.(V.223)

... un *n'ata net* kam per t'ra..(V.60)

Nga të dhënat rezulton se ky fenomen morfologjiko-fonetik del i stabilizuar që në periudhen paraliterale pasi del e dokumentuar edhe në shkrimet e pararendësve tanë si Buzuku, Budi e Bogdani, dhe si i tillë dokumentohet edhe tek këta dy autorë shkodoranë.

**Shumësi me ndërrim tingujsh g, k përkatësisht në gj.q.** - Ka një grup emrash të gjinisë mashkullore që formojnë shumësin zakonisht në përputhje me rregullin gramatikor, në përjashtim në formimin e shumësit të emrit peshk që autori shënon pescke. Nuk mund të konkludojmë një pohim të përfundimtar nëse Pashko Babi shënon me këtë grafemë shkronjën q apo thjesht në formim dialektor. Një çështje e tillë mund të gjejë një sqarim detajues në punime të tjera me bazë shkencore.

**k:q**

...e si *migt(miqt)* e vet kiscte per ta hatrue.(V.162)

...deri sa gi ti vee une *enmigt* (enmiqt) tuu sctooi per kam tua.(V. 98)

...ato dy *pleqt* cline goi...(V. 142)

...e voit me gieet kokra *figsc* (fiqsh) e nuk jan giet.(V. 236)

Shënim: Dallojmë rastin kur autori emrin e gjinisë mashkullore peshk-u në numrin shumës një herë e përdor me ndërrimin e tingujve k në q si në rastin : ... e si e hogene prei breghut, e gietne mûusc me 153 *pescg*. (V. 279), dhe një herë në formimin e shumësit peshkve : ...e lieu me zyft e *pesckve* (*peshkve*) basck...(V. 55)

**g:gj(dhe mbaresë)**

..e *zogt* (*zogjt*) e ciells kan per t'lscin..(V.40)

...ghrehet vet para syyve *zogve*(*zogjve*) n'flead.(V .104)

...gi ja vuite *t'githa sctigiet* (shtigjet) me i sctii n'dor.(V . 92)

**Shumësi me palatalizimin e tingullit ll në j.** Tek vepra e Pashko Babit ndeshim edhe formimin e shumësit të emrit me palatalizimin e ll në j, mes të cilave ilustruam shembujt:

...e kan per t'raa prei cielet *hyyt* (*hyyt*). (V. 252)

Kriscin me giçç *discepuj* ( dishepuj) gi kiscte e ççirrne...(V .220)

Është me interes të vëmë në dukje se në veprën e Pashko Babit ndeshim edhe ata emra që në mënyrën e formimit i kanë devijuar rregulla e formimit të shumësit të emrit.

<sup>119</sup>E. Çabej, *Shumësi i singularizuar në gjuhën shqipe*, Tiranë, 1967.

Emri **ishull-i** i cili në pajtim me fenomenin fonetik duhet ta formojnë shumësin me palatalizimin e l-së në -j ashtu siç e formojnë këtë shumës një grup emrash si : shekull-shekuj; mashkull-mashkuj; grumbull-grumbuj etj. në veprën e Pashko Babit ky emër e formon shumësin me prapashtesën -a vetëm në një rast tek shembulli :

...e *ishullat* ( ishullat) atii kan per t'i ciue t'falunat e veta...(V. f.97)

Po kështu edhe emri **qiell** e formon shumësin në ndonjë rast<sup>120</sup>, me këtë prapashtesë si:

...N'at cias u cline *ciełat* ( *qiellat* ).(V.182)

...kur *ciełat* ( *qiellat*) nuk munnen me i paa..(V.106)

**Shumësi i emrave mashkullorë me prapashtesën-j.** - Patjetër që këto autorë do të përfaqësojnë të folurën e trevës së vendlindjes gjë që vihet re edhe në formimin e shumësit të disa emrave me prapashtesën perkatëse : -j,por karakteristikë është se Pashko Babi e shënon këtë mbaresë me dyfishimin e zanores -i. Psh

...per kunnra per to cioi *giarpji* (*gjiapij*) t'eeherlatisun.(V. 74)

...me mleeç *kałii*( *kallij*) mas korrearesc...(V. 82)

...me krye t'mluem jug nit tui kiasa koders u*łliive* ( *ullijve*) .(V.100)

Ku mahescin t'nrrym sctat *luai*( *luaj*) t'eger fort.(V. 148)

Sipas vlerësimeve të gjuhëtarëve Enver Hysa, Tomor Osmani formimi i shumësit të emrit me prapashtesën -j dhe jo -nj ofron me një tendencë të realitetit gjuhësor , duke arritur edhe një zgjidhje përfundimtare per formimin e këtij shumësi.

Po kështu Ethem Lika në një punim të tij thekson: “ ...*sot ka një anomali për këtë shumës dhe për këtë janë botuar disa shkrime duke theksuar se prirja me sa duket shkon drejt menjanimi të prapashtesës -nj dhe përgjithësimi të -j-së.*<sup>121</sup>

### **Shumësi i emrave femërore.**

#### **Shumësi i emrave femërorë me prapashtesën -a.**

Me këtë format gramatikor formojnë shumësin edhe disa emra të gjinisë femërore si psh:

...e mrenna *furrave* tyne e *sofrave* tyne...(V.58)

...ato morii *mieasc* ( *mizash*) n'tars t'*musciave* ( *mushizave*)...(V.58)

...e ju bisedoi *annrat* ( *andrat*) e veta.(V. 40)

...n'kto *trii festa* t'gçç'i sa t'jen *masckułi* ner ju...(V. 163)

...*tri varzea* ( *varza*)e sctat dielm kiscte....(V. 50)

...*dy rrasa* n't'cilat iscin zier fialt.(V . 65)

#### **Shumësi i parregullt.**

Tek Pashko Babi ndeshim emrat të cilët e formojnë shumësin duke ndërruar temën e njëjësit. Veçojmë mes tyre emrat kalë, dorë, derë , grua të cilët e formojnë shumësin me zberthimin e zanoreve -a, -o, -e të temave të fjalëve në togun zanor: ua, ue\ye si:

Emri **kalë-i**, tek Pashko Babi e formon shumësin me zberthimin e zanores a në togun ua, por pa palatalizimin e l-së në j, pra kemi formën *kualt*.

...*kualt* e skelne, egieit i haghne miscin.(V.116)

<sup>120</sup> Theksojmë se ky emër e formon shumësin edhe në formën ciellt.

<sup>121</sup>E. Lika,*Për dysorët morfologjik dhe format jogramatikore*, Gjuha jonë 3-4, 2002, f.84.



Shumësi kuaj nuk ndeshet asnjëherë në veprat e mëparshme dhe me të drejtë Shaban Demiraj thekson se kjo mund të jetë një trajtë e re përftuar në kohë më të vona të shqipes.<sup>122</sup>

Emri **der|ë** e formon shumësin duke zbërthyer zanoren *e* në togun zanor *ye* ...*dyert* ( dyert) e tija jan ciaart. (V.140)

Ndërsa emri **dor|-ë** zbërthen zanoren *o* në togun zanor *ue* në shumës : nuk munn ju psctoi *duerve* tuja...(V.142)

Gjejmë edhe rastin tjetër kur tek fjala **dorë** nuk kemi zberthimin e zanores o ne ue por në u, ashtu siç ilustruam edhe tek autori Ëngjëll Radoja:

...ather ja gnitne *duurt* e e zuun .(V. 264)

Mes të tjerave , këtu do të veçojmë trajtën e shumësit te emrit **grua** që formohet me mbledhjen e togut zanor ua në a , formë si e mbarë shqipes por që nga ana grafike shënohet me dyfishimin e zanores a.

...parsia tieter si *ghraat*...(V.145) / ...e *ghraat* e dielmve tuu(V. 15)

### Ndue Bytyçi

Ndue Bytyçi shfaqet tepër “i kursyer” në përdorimin e emrave në numrin shumës. Raporti i përdorimi të emrave në numrin njëjës, në vepër, është shumë i madh në krahasim me emrat në numrin shumës që kanë një përdorim të reduktuar. Kjo për vetë faktin se në urdhëresat e tij, autori drejtohet gjithnjë në vetën e dytë dhe të tretë njëjës. Nga një vjelje tërësore e emrave në numrin shumës dalluam vetëm këto përdorime:

#### **Shumësi i emrave mashkullore.**

**Shumësi i emrave me prapashtesën e.** – Kjo prapashtesë shfaqet prodhimtare në formimin e shumësit të emrave të gjinisë mashkullore. Këto emra kur formojnë shumësin kalojnë në emra të gjinisë femërore, sipas përputhjes edhe me trajtat morfologjike. Dallojmë rastet:

Ato *msime* sckannulii

ato *ghaee*(gaze) e *niscarete*(nisharete)

ato nnéina t’pa’terbiete

faidia e ran me baa *εολυμε*(zollume)

o n’*teftere* me nghatrue

t’tana *mkate* jan t’hainiis . ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 11)

#### **Shumësi i emrave femërore.**

##### **.Shumësi i emrave femërorë me prapashtesën –a.**

Si emra të gjinisë femërore kemi identifikuar emrat vepër, festa, të cilat në numrin shumës marrin prapashtesën –a. Siç shihet një pjesë e këtyre emrave, në trajtën e pashquar njëjës përfundojnë me –ër. (vepër, thupër)

N’*vepra* t’mira e nner uraat

nner dit *festa* kusc punon. ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 5)

Se rri *ççupra*(*thupra*) n’deer Parriëit . ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 7)

#### **8.6.Emra përmbledhës.**

<sup>122</sup> Sh.Demiraj, vep.cit.f.203



## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

---

Në një grup më vete jemi përpjekur të paraqesim disa emra përmbledhës të cilat i kemi ndeshur gjatë studimit, të cilat po i listojmë nëpërmjet shembujve:

*Radoja:*

...e jo si e bain *ginnia* ( *gjinia*) ma t'sciumen...(D.C.106)

...ata ci u kaa hypp *pleccnia*( *pleqnia*) ... (D.C. 167)

*Babi:*

Tek po na vjen *annragia* ( *annragjia*) (V . 36)

...a e kan mir punen tuu vllazen e si jan *baktija*...(V. 36)

...t'gjith *parsia* e Israelit, *prifnia* n'takame t'vetat...(V. 96)

...para t'rzuemit priin *maçshtia* ( *madhshtia*) e para. (V. 104)

Kemi vënë re se në formë të tillë këto emra përdoren ende në dialekte e nëndiaekte në të folmet e gegërishtes.

Duhet thënë se në këtë çështje u përpoqëm të trajtojmë dhe të pasqyrojmë çështje të sistemit emëror, konkretisht të formimit të shumësit të emrave në veprat “Dotrina e kerscten” „çet urçnimet e Scêites Kisc” dhe “Vakinat e t'ligs herscme e t'ligs ree” të shkrimtarëve shkodranë të shekullit të nëntëmbëdhjetë Ëngjell Radoja Ndue Bytyçi dhe Pashko Babi. Duke i shqyrtuar këto emra për nga formimi i shumësit të tyre del se në vepra numri i këtyre emrave është relativisht i lartë. Më prodhimtare listohet shumësi me prapashtesat –a dhe –e , por pa anashkaluar rastet e tjera të formimit të shumësit të këtyre emrave.

Na u duk e rastit që të trajtonim veçanërisht disa raste ku autorët i janë shmangur ligjërimin të sotëm të gjuhës shqipe. Nëpërmjet një vëzhgimi të hollësishëm arritëm në konkluzionin që në këto katekizma ndeshim një shumëllojshmëri përdorimi të formave të shumësive të emrave, të cilët i analizuam. Dallojmë shumë emrave që nga përdorimi i tyre i kanë rezistuar kohës në ruajtjen e trajtave geqe, por nga ana tjetër shohim një përpjekje të autorëve për pasurimin e gjuhës dhe ruajtjen e saj. Një vëmendje iu kushtua në këtë punim edhe formave të parregullta dhe një sërë emrash përmbledhës.

Këto vepra përbëjnë pasurinë e çmuar të shkrimeve geqe. *Pa dyshim ky prodhim verior është më i rëndësishmi i prodhimeve të letraturës shqipe, si nga pikëpamja e sasisë dhe gjërësisë si dhe nga pikëpamja e lëndës dhe mbrendësisë.*<sup>123</sup> Këta autorë tregojnë pikëpamjet e tyre prej intelektualësh duke realizuar një komunikim me lexuesin e gjuhës shqipe e në veçanti në dialektin gegë.

---

<sup>123</sup> N.Ressuli, *Shkrimtarë shqiptarë* 1, Tiranë 1941 f.12

### 8.7.Kategoria gramatikore e rasës. Lakimi.

Në fushën e morfologjisë interes të veçantë kanë trajtat e ndryshme gramatikore që merr emri sipas rasave. Në këtë pjesë të punimit do të analizohet sistemi rasor në veprat e autorëve Ëngjëll Radoja, Pashko Babi dhe Ndue Bytyçi. Numri i rasave paraqitet i reduktuar në pesë të tilla : emërorja, gjinorja, dhanorja, kallëzorja dhe rrjedhorja. Krahas tyre, duke qënë tekste që i përkasin gjysmës së dytë të shekullit XIX, bie në sy disa forma rasore ku mund të përmendim formën e rasës rrjedhore të shquar njëjës, ku në gjininë femërore, në vend të nyjës së prapme –s përdoret nyja –t , togfjalëshin emër +emër në rrjedhore me mbaresë –ve ( por në ndonjë rast edhe me –sh), përdorimin e rasës rrjedhore pa parafjalë.

#### **Ëngjëll Radoja.**

##### **Sistemi rasor në lakimin e pashquar.**

Sistemi rasor i emrave në lakimin e pashquar në veprën e Radojës përfshin pesë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore.

##### **Emërorja dhe kallëzorja e pashquar.**

Këto dy rasa në trajtën e pashquar dalin me mbaresë zero në të dy gjinitë, në të dy numrat njëjës dhe shumës. Emrat në rasën emërore dhe kallëzore të pashquar nuk kanë një formant gramatikor që i dallojnë morfologjikisht nga njëra-tjetra. Funkcionalisht dallohen duke u përdorur rasa emërore në funksionin e kryefjalës dhe rasa kallëzore në funksionin e, kundrinorit të drejtë dhe të zhdrejtë me parafjalë. Për ilustrim listojmë shembujt e mëposhtëm:

##### *Emërore numri njëjës.*

...*ky scekul* i eii me t'kcia me discire...t'paa-uça, e *ky korpi* yn i helmuem ( D.C. 63)  
...te *gni Miester* i mir me iu çan me koh nnogni eanaat. (D.C.125)

##### *Kallëzore numri njëjës:*

...kudo t'jeen n'dyrgnâ discmoin *gni Fee*, e *gni Lig*( *nji ligj*) barabar (D.C. 34)  
...tu'e marr per t'kec *gni pun*(*nji pun*) t'sciocit (D.C. 153)  
A sckón nieri n'Ferr *per gni mennim* ( *nji menim*) t'kec? (D.C. 156)  
Kuur i vién nnér men *gni mennim* i kec? (D.C.157)

##### *Emërore , numri shumës:*

... *ato festa* ci i kaa vuu Kiscia...(D.C.117)  
*Giçç nieret* ( gjith njerzt) t'scelbehen. ( D.C. f 22)  
*Giçç hiret* e t'mirat a s'ns vin prei Eotit? (D.C.85)

##### *Kallëzore numri shumës:*

...i kaa çan któ *pês çuntii* ( *dhunti*) (D.C.36)  
... I kaa çan *dy pusctete* ( pushtete) fort t'nalta (D.C.37)  
...kiscte pass me borc me e bâa me diit ci t'i lán *ato lafe* ( *llafe*) o bised (D.C. 154)  
...e *ato mennime* t'mcatit, ci nieri munnohet me i pereân (D.C.f. 157)

##### *Gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja e pashquar.*

Rasa gjinore, dhanore e rrjedhore marrin të njëjtat mbaresa, por nyja e rasës gjinore e parafjalët e rasës rrjedhore, janë identifikuesit kryesorë bashkë me funksionet gramatikore.

.....porsi *gni drit* e maçe vûumun n'maje *t'gni malit* (D.C. 37)

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

...jo prei paa-diet merr sckannuλ *prei gni punet* ci âsct e mir n'vet-vedi. (D.C.132)  
Te Radoja emrat e gjinisë femërore që dalin me zanore të theksuar në rasën rrjedhore të pashquar marrin mbaresën *-je*.

.....sepse *Ëoti prei gni rejet* foli me Moisëin n;mal t'Sinait...(D.C.96)

### **Sistemi rasor në lakimin e shquar**

Rasa emërore në trajtën e shquar shfaqet si në mbarë shqipen pa asnjë ndryshim. Emrat mashkullorë që në trajtën e pashquar mbarojnë me një bashkëtingëllore, përveç k-së dhe g-së, kur shquhen marrin nyjen e prapme *-i* ndërsa në femërore me mbaresë *-a/-ja*:

#### *Emërorja njëjës:*

...*mënnia* e kerkui s'mrriin ktu n'scekuλ...(D.C.6)

...arçt *Reginia* jote...(D.C.59)

...ksctú praa, *hiri* i Tenëot m'gnên ân e vepra e mira tona...(D.C.54)

...ci jan *diali* i maλkuem, ky scekuλ i eii me t'kcia...(D.C.63)

Vëmë re se autori nuk është konsekunt në përdorimin e kësaj mbarese tek disa emra, pasi herë përdor mbaresën *-a* në vend të mbaresës *-ja* dhe herë të tjera mbaresën *-ja*.

...tui nëi n'Kisc, ci asct *sctpia* e Tenëot...(D.C.110)

...massi sdrypi nner ta *rreeia*, e drita e escekuλit...(D.C.27)

...e *davaja* âsct kput e marue...(D.C. 43)

...s' âsct *nevoja* me lut Tenëot (D.C.46)

#### *Emërorja shumës:*

Psë ksctù na kan urçnue *Apostuit*...(D.C.116)

*Fmii*t bâamun eçe t'mçai...(D.C.122)

#### *Kallëzorja njëjës:*

...se giçç mon ka pass *nnimen* e *driten* prej scpirtit scëit (D.C. 37)

...E kusc i lscion *paret* e veta me faide (D.C. 143)

... E ai , ci s'e paguun *borcin*, o teper largh (D.C.145)

...kusc nuk e prët *hainiin* e *damin* . (D.C.147)

#### *Kallëzorja shumës:*

..e pse kaa *nniere* scëiten ; asctu kaa Feen, Ligen e *Sakramenet* ci t'giçça jan per t'maçç fryt (D.C. 35)

Jan *puntort*, *eanatli* e *terei* ci jan pague me dit..(D.C. 145)

...ai ksctú kaa urçnue me na i bâa jassak deri *mennimet* e nnyta, e *discrimet* e kcia t'ëemers son. ( D.C.155)

#### *Gjinorja, dhanorja njëjës:*

Rasa gjinore e dhanore për nga funksioni që shprehin, dallohen qartë mes tyre, konkretisht gjinorja duke emërtuar përkatësinë ndërsa dhanorja në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë. Emrat në këto dy rasa kanë mbarese të njëjta, por emrat në rasën gjinore dallohen nga ato të rasës dhanore me anë të nyjës së përparme që marrin dhe që u mungon atyre të rasës dhanore.

#### *Gjinorja:*

...tui scndrit n'ket scekuλ t'terrscm per pun *t'Fees*, t' rsimeve e t'scëitniis (D.C.135) . Psee kaa me mmet giççmón e foort e scnosct deri n'marim *t'scekuλit* (D.C. 37)

...i kaa gabue kûn kurr, as s'kaa me gabue n'essape t'Fees e t'scirtit (D.C. 37)  
...ata ascú piin giakun e fukaraas (D.C. 145)  
Ata n'ciartscin fialen e t'dekunit (D.C. 147)  
..Po persé ai hin n'hishe t'mcatit t'atynve (D.C. 153)

*Dhanorja:*

Medet *scekulit* per sebet t'sckannuliive? (D.C.133)  
Kuur nnokusc plot me scerri prighion e scka scef a nnin...e tine e kalzón t'parit ,  
*eatniis* , *miescrit* o tieter kui per me-i-a bier atii stamen a nnéeren . (D.C.152)

*Rrjedhorja :*

*Rasa rrjedhore* ndërtohet me mbaresë –t dhe me parafjalë.  
...s'munnet me psctue *prei dnimit* paa-sosun. (D.C.39)  
...kan me hatrue korpin scium *prei kreniet, mažsctiet, e marriet.*(D.C.39)  
...kan dal *prei gojet* t'Birit tii. (D.C.39)

### **Rënia e treguesve të shquarsisë në rasat gjinore dhe dhanore të shumësit dhe njëjtësimi formal me të pashquarën.**

Në gjuhën e sotme standard ndeshet një dukuri me karakter morfologjiko-drejtshkrimor: *rënia e tingullit –t pas mbaresës –ve dhe njëjtësimi formal i gjinores dhe dhanores së shquar shumës me gjinoren dhe dhanoren e pashquar.*<sup>124</sup>  
Kështu lakimi i emrave në numrin shumës në gjinore dhanore dalin me mbaresën –ve të cilët mbështetur në rregull e marrin ata emra që dalin me temë në zanore.  
...ci i scerbein gni hisse t'fryteve e t'dobiive t'kcija i scerbein (D.C. 171)  
Ati i miscriscm i kerctenve t'mir (D.C.24)

Emrat në gjinore, t'fryteve e t'dobiive i kerctenve nga kuptimi janë të shquar dhe qëndrojnë në vend të formave më të vjetra t'frytevet e t'dobiivet i kerctenvet .

Ky fenomen nuk ndodh gjithnjë në vepër pasi dallojmë edhe rastet e emrit me mbaresën –vet:

...me gheue Sciocniin e Scêitnavet (*sheitnavet*). (D.C.36)  
...Per Ciobant e scpirtnavet (*shpirtnavet*) tona, per print ton...(D.C.58)

...nima e giçç *mcatnorvet* (*mkatnorvet*), atyne, ci t' kççehen me giçç emer .(D.C.77)  
...m'gni scpeλ n'miedis dy *sctaevet*(*shtazvet*). (D.C. 82)

Në raport vihet re se emrat me mbaresën –vet janë më të përdorur se ato me mbaresën –ve. Kjo na rezulton se fenomeni i njëjtësimit të rasave gjinore e dhanore nuk ishte kryer sht në këtë periudhë.

Lidhur me rasën rrjedhore, emrat në numrin shumës mbarojnë me zanore mbaresën –sh si për emrat me temë në bashkëtingëllore ashtu edhe në zanore.

...ci jee fort i dásctuni paitori em, m'prúei *prei tñimesc*, m'largó *prei mcatesc*(D.C.88)  
...e na ruun *prei giçç reiciesc* e na largo *prei giçç mcatesc*. (D.C.87)  
...difùem *prei fuguresc* tynve...(D.C.104)

**Pashko Babi**

**Sistemi rasor në lakimin e pashquar.**

---

<sup>124</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 131.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Sistemi rasor i emrave në lakimin e pashquar edhe ky autor në veprën e tij përfshin pesë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore dhe rrjedhore.

### **Emërorja dhe kallëzorja e pashquar.**

Emrat në rasën emërore dhe kallëzore të pashquar nuk kanë një formant gramatikor që i dallojnë morfologjikisht nga njëra-tjetra. Është funksioni gramatikor ai që i dallon këto dy rasa nga njëra tjetra si dhe përcaktuesit që marrin këto emra. Listojmë shembujt :

#### *Emërore numri njëjës:*

Po kujta asct *kio vaiε?* / ...*kio* asct *ajo bija* e ζeut. (V.82)

...*ky nieri* po ban mrekuλι t'mζaa.(V.245)

#### *Kallëzore numri njëjës:*

Rasa kallëzore përdoret mjaft shpesh gjatë gjithë veprës në raport me ratat e tjera.

... muer e ghoditi *gni εγmyl* zughξξit (V.55)

...ani e mûer e i sckrini , e zuer *gni form* vicit e para si ghrehi *gni elterr* (V.65)

reξξ asi toprakut sceit iscte lsciuε *gni hajat*. (V.67)

...ja pat n'hater kusctin e i fali *gni dial* (V.84)

Çoti iu liξξ mos me e preek, giëen dyafer *gni giarpen* (V.11)

Godit *gni bark* per vedi t'maζεe fort...*gni ark* drujet sdrukξξueme (V.15)

Une jam *gni krym* i toks, e jo *gni nieri* (V.97)

Trupin e tii e gitne n'*gni ghroop* t'maξζεe e ciune mi te *gni ghrumuul* t'maξξ ghursc. (V.100)

#### *Emërore , numri shumës:*

*Dγγ motrat* e ζeut Betamies, Mria e Mara kiscin *gni vγaa*. (V.239)

*Gni nat* para, *do ghraa* t'persciprtscme kiscin pas blee balcm...(V. 275)

#### *Kallëzore numri shumës:*

...e dulne perjascta giξξ *ato morii miεasc* (V.58)

...i ξξα Moseit *dγγ rrasa* (65)

... e neper to persckohescin *dγγ drûu*...(V.67)

... e vuune arken e Çotit n'gni gierre, e sgheξune *dγγ loop* (V.85)

### *Gjinorja, dhanorja dhe rrjedhorja e pashquar.*

Në lakimin e pashquar njëjës, këto tri rasa, dalin me këto formante:

Dalin mbaresën *-i(t)* në gjinore, dhanore e pashquar tek Babi e marrin emrat mashkullorë të lakimit të parë me *-i*: populli-i. Me mbaresëm *-i* del edhe emri njeri (njiri) që klasifikohet në lakimin e dytë.

...gi je pignoλι *i gni nierit* miir. (V.127)

...deh fiaλα *ktii populit* (*ktij popullit*), t'kegien e mkatit...(V. 70)

Me mbaresë *-u(t)* dalin emrat e gjinisë mashkullore të lakimit të dytë.

...por u lscue vrep perpara e ju kap *gni fikut egher* (V. 245)

...e mloξ gninen e *gni konakut* ...(V. 39)

Emrat në rasën gjinore e dhanore të pashquar, njëjës janë shumë pak të përdorur në vepër.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Në numrin shumë gjinorja e dhanorja dalin me mbaresën –ve, ashtu si tek Radoja.  
Asct Reginia *cielve*, ju çëça n'ghiasim t'kokers faars (V.211)  
E ajo me syg t'zanun prei turpit e me çëçim t'fajëve veta n'ëemer. (V.190)

Rrjedhorja e pashquar shumë gjendet e përdorur me mbaresat –sh, dhe –ve.  
... por si t'rritet ju del per syfri t'gicëçvave *bariscteve*. (211)  
Per ne kiosk ti i biri i Eotit çëçuju *ktÿne ghurve* t'sielen buk (V.183)  
... pse me tasc e per mrapa ti kee per t'keen guitar *nnierëish* (V.194)  
...Runiu *prei nnierëisc* (gi jan si ugg) perse kan per t'ciu e per t'ju marr n'kuvenne t'veta. (V.215)  
... kuur gni asi rood ghruejet duul *prej atÿne reççëve* e cioi eaan e briti (V. 223)  
...Kriscti prei punet *discepuive* pat keg eçe fort (V.226) /  
...ti kalzoin *pês vlaeneve* mii(V.227)  
...gni râaz fikut n'venesct t'vet, e voit me giet *kokra figsc*. (V.227)

### Sistemi rasor në lakimin e shquar

*Emërorja njëjës :*

Rasa emërore në trajtën e shquar shfaqet si në mbarë shqipen pa asnjë ndryshim.  
Emrat mashkullorë që në trajtën e pashquar mbarojnë me një bashkëtingëllore, përveç k-së dhe g-së, kur shquhen marrin nyjen e prapme –i dhe –u .

*Malikimi* i raft toks per pun t'ëëë gi punove (V.12)

...*barku* i Adamit u daa *dÿgsc*; *korbi* nuk dreçoi...*plumi* si nuk giet ku me zâan vënn, dreçoi prep....(V.16)

M'ka arç n'vesc *ankimi* i Israelit...(V.62)

Saulit i duel *giumi* prei brimet (V.92)

Ti bekue kiosk *diali* em David...Pak per mprapa *populi* i Israelit e Filisteit zuune luften (V.93)

Ndërsa në femërore me mbaresë –a/-ja:

... per sa t'jen dit e toks, s'ka per t'mûghue kurr as *fara*, as *dita*, as *nata* (V.17)

*emra* e tii rrënohei...deri sa i punoi forza e i ezi fiala u maait giççmon prei ânnet vet (V.55)

...e si çëça *ghoja* e tii per kunnra mejet (V.62)

... por per at pûn kurr nuk diti me ju looç*mennia*, o me e Iscue *emra* (V.92)

Fort e voghel asct çç*neghla* por i kalon me dije (V.104)

Sikur ban giÿmÿri prusc, e *druja* eierm gnasctu nieri peemtaar nneëë scamaten (V.105)

Vihet re se autori nuk është konsekuent në përdorimin e kësaj mbaresë. Kështu gjejmë emra femërore me temë në zanore –i, në trajtën e shquar marrin mbaresën –a por edhe –ja.

... ani çane *parsia* e Israelit...(V.85)

...t'gicëç tiert n'*scpia* t'veta... (V.80)

...e *maçnia* e lumniis Eotit e eaptoi.(V. 68)

*Parija* si ka natÿra, si ka e mira ... (V.9)

...scko e kÿÿri a e kan mir pûnen tuu vlaëen e si jan *baktija* (V.36)

*Emërorja shumë:*

*Loopt* sckuene fiiil n'Betsomes, e arka prep duel n'çëë t'Israelit (V.85)

... pse eamanit t'tii eermi nuk kiscte kuur far kÿmetit e *barkt* e tija..(V.107)

... me deek prei edjet na e ginnia jon, e *baktiit* tona? (V.63)

... me degħ kag gi *eoĝt* e ciełs sckoin, e zan vëen (V.211)



## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Nuk ken ipse gheohe se ju posctnohen *scpirtnat*..(V.229)

*Kallëzorja njëjës:*

Me diers t'balit tann kee me e higher ti *buken* tanne...pse ti *pluhun* je...si ja *ça laikun* se t'zilit (V.12)

...içane *Çotit kusctin* e giâas vet.... *Besen* teme po e liçe me ju...( V.17)

Në rasën kallëzore, në numrin njëjës, gjejmë emra që dalin të asimiluar por edhe me mbaresë si:

... hysmeciari jyt *gial asct alaa*, e e ka *scnneen*. (V.45)

Por gjendet edhe në trajtën : ...gnai gi m'ça *scnneden*. (V.207)

...duul prei reççeve e ctoi *ëaan* e briti...(V.223)

Por edhe ...e ctoi *ëanin* prei ghaepit gi e reççoi..(V.13)

*Kallëzorja shumës:*

...e cioe *duert* e veta prei cielët (V.106)

...per ket soi iscin t'scegnuem *gije* t'pa kurrngni behane, eçe *dele*, e *çii*, e *pçuma* (V.68)

...Liroje populin tem t'sckoin, e t'm'falin mue *kurbanet* screti (V.57)

...sctatçet mii per hamalii, e tetçet mi per me latue *ghurt* e *drûut* pa...(V.105)

*Gjinorja, dhanorja njëjës :*

Rasa gjinore e dhanore për nga funksioni që shprehin, dallohen qartë mes tyre, konkretisht gjinorja duke emërtuar përkatësinë ndërsa dhanorja në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë. Emrat në këto dy rasa kanë mbaresa të njëjta, por emrat në rasën gjinore dallohen nga ato të rasës dhanore me anë të nyjës së përparme që marrin dhe që u mungon atyre të rasës dhanore.

*Gjinorja njëjës:*

Un hysmegiari jyt cioisce m'kuuloos delet e *babs* em me paas lsciue o nnoi luâa(V.87) Samueli ap brinen e *vojit* e ja deerç mi krye ner *syç* ...( V.88)...

Nieri i mir ka kasavet *giaan e gial* t'veten, e *ëmra e mkatnorit* s'ka ççim ...( V.105)

Mieli i *vekscit* nuk ka per menghue ...( V.112)

*Gjinorja shumës:*

miku i *budalve* ka me vooit n'haltyne. Merre karghiin gi e ka afer tu kryet, eçe kupen e ujit... (V.93)

...e mrenna si iscte elteri i *olakautve* kurbane gi digescin kreit prei eiermit (V .67)

... vûni Moisei eçe dit e *festave* (Vakinat f.69) Fagiet e *mureve* permrenna iscin vescu me drrasa drujet (V.105)

...un s'kam kader me *eghiiç* as liçzat e t'*maççunave* (V.182)

... e me të zûur jascta vënit kiiscs t'ëotnit e *gijeve* . (V.188)

*Dhanorja njëjës:*

...per ne ju ruiscim *mkatit*, e per ne punoiscim mir ...(V.125)

Po ççuji populit:...(V.71)

...i bie *arpes* si kusc e mir...( pak V.88)

*Dhanorja shumës:*

..kur ju çça Kriscti *mkamzve* (V.186)

..e ju çane *soldetneve* pare t'maçe me ju *mçç* ghojen (V. 275)



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

Po pi e<sup>ç</sup>e devevet tuja tasc po u nap me pi ( V. 27). Por autori nuk është konsekuent në përdorimin e kësaj mbarese, pasi disa fjali më tej gjejmë po të njëjtin emër : deve , të ndërtuar me mbaresën –ve; po u ziri e<sup>ç</sup>e deveve deri sa t’doon. (V.28)

*Rrjedhorja njëjës.*

Rasa rrjedhore në trajtën e shquar njëjës tek vepra e Pashko Babit formohet zakonisht me mbaresën –t dhe me parafjalë.

...del *jasct barket* me gînn tane...(V.17)

...epmi gînnen gi kee zier *prei robniet* ...( V.22)

Ai Ëot gi m’ka zier *prei gojet* luâive ... ( V.90)

Disa prej këtyre emrave të gjinisë femërore në rasën rrjedhore i gjejmë edhe me mbaresën –s.

Haλku bînni *prei msimit* gi delte *prei gojes* tii... ( 193)

*Prei dores* kyvet maçit un as per t’gial as per dekun nuk mûnn iku.(V. 160)

Shumë e përdorur në vepër është edhe rrjedhorja pa parafjalë. Kemi rastet:

...i fali gni paar vâax<sup>ç</sup> florinit...(V.28)

...zuer *takame sermit, florinit*... (28)

...kuur cioi pa e prit *gni duhi eret*... (V. 62)

...e Krisctit gni fial si delte *ghojet* ...( V.268)

...po ju viin asait do rescper çeut leergh me deve t’veta... (V. 36)

### **Rënia e treguesve të shquarsisë në rasat gjinore dhe dhanore të shumësit dhe njëjtësimi formal me të pashquarën.**

Dukuria e rënies së treguesve të shquarsisë në rasat gjinore dhe dhanore të shumësit dhe njëjtësimi formal me të pashquarën është present në veprën e Pashko Babit, ndryshe nga Radoja që shfaq luhatje në përdorimin e mbaresave me –vet dhe –ve.

Kemi rastet:

Pos *t’diilave* a do t’mmahen tiera festa? (V. 116)

...jo me i lakmue *essapeve* tiera.(V.27)

...nuk pescion ag rân sa e kegia *e mkateve* tona. (V.137)

Fagiet *e mureve* permrenna iscin me drasa...(V. 105)

...mannei ju x<sup>ç</sup>a *discepuive* tii...(V.242)

### **Ndue Bytyci**

Pavarësisht se materiali burimor që na ofron ky autor nuk është shumë voluminoz, gjejmë rastin të analizojmë edhe këtu emrat e përdorur sipas rasave. Vërejmë se Ndue Bytyçi parapëlqen përdorimin e emrave në trajtën e shquar. Si rezultat edhe analiza jonë do të jetë e fokusuar tek emrat në trajtën e shquar, ndërsa ata në trajtën e pashquar u identifikuan vetëm në rasën kallëzore.

### **Emërorja e shquar njëjës dhe shumës.**

Rasa emërore në trajtën e shquar shfaqet si tek dy autorët e lartpërmendur ashtu siç e gjejmë të përdorur në mbarë shqipen. Emrat mashkullorë që në trajtën e pashquar mbarojnë me një bashkëtingëllore, përveç k-së dhe g-së, kur shquhen marrin nyjen e prapme –i ndërsa në femërore me mbaresë –a/-ja:

*Fara e tÿne kaa m' u cbii*  
*Emni i tÿnes' kaa m' u ni (f.6)*  
*Se me t' nÿmne e t' trume msimi*  
*Jo nuk nepet, nepet dnimi*  
*N' kioft se fmija kec punoin*  
*O per s' marit nuk nighion*  
*Me gni ççuper scikia briëit*  
*Se rri ççupra n' deer t' Parriëit (f.7)*  
*Puscka e ççika korbin rrzon*  
*Deka e Ferri sic et tuten (f.8)*

**Rasa gjinore e dhanore e shquar njëjës dhe shumës.**

Rasa gjinore për nga funksioni që shpreh, dallohen qartë me rasën dhanore, konkretisht gjinorja duke emërtuar përkatësinë ndërsa dhanorja në funksionin e kundrinorit të zhdrejtë pa parafjalë. Emrat në rasën gjinore dallohen nga ato të rasës dhanore me anë të njëjës së përparme që marrin dhe që u mungon atyre të rasës dhanore.

**Gjinore:**

*Rrfeja e eotit do t' kerset*  
*E vec vrases âsct po mkat (f.8)*  
*Jeta e scpirtit âsct e par*  
*Mos me sckannuÿ me ja marr*  
*Jeta e korpit âsct e dyt*  
*Mos ti kenn praa kurr me myt*  
*Jeta e ereit âsct e tret*  
*E kio merret kec kuur flet (f.9)*  
*Ja nep buken t' faces barç*

**Dhanore:**

*Perse deri m' gnac po sckoin*  
*Ku por diemni u ghuzoin (f.4)*  
*Ci s' i tutet kapuzarit*  
*Me kuitue pun te kece*  
*T' vnnon scpirtit t' maççe lece. (f.12)*

**Rasa kallëzore e shquar njëjës dhe shumës.**

Emrat në të pashquarën njëjës, në rasën kallëzore nuk dallojnë me rasën ermërore për nga ana formale e mbaresave, por është funksioni i tyre në fjali që i bën të dallueshëm.

*Puscka cit me marrun gakun*  
*E fiton prei eotit lakun*  
*Ai ci vret me cfryym inatet*  
*Fiton mkat ci kunn sun matet (f.8)*  
*Borgin kui me ja vanue*  
*O n' teftere me nghatrrue*  
*Buken t' ghois o haina t' true*

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

T'εott nuk jeni me fitue.  
E ngharkohi plot me marre  
Me pun s'doni *gaa* me maarre (f.11)  
I kam kamt e *durt* e mija  
E kam *scneden*, kam *kyvetin*  
Prei puns eme e due *medetin* (f.12)

### **Kallëzorja e pashquar njëjës.**

Jo *gni rrfee*, gni cinn, gni mii  
Me I batisun n'ferr te εii  
A εεεue s'di si e nep lajikun  
Kuur do εoti kenn me fikun?  
*Gni εaraar*, *gni derg*, *gni dek*  
*Gni εoλum*, *gni εierm* me e preh  
Per gni dit a bier e sckue  
Nner dit festa ca u fitue( f. 6)  
Kan me pas saλ *gnat maλkim*  
Ci pat Kami per t'maε dnim. ( f. 7)

### Mbiemri.

#### Klasifikimi kuptimor e morfologjik.

Mbiemri në aspektin kuptimor përkufizohet si pjesë e ligjëratës që emërton një tipar ( cilësi, veti, marrëdhënie) të sendit dhe përshtatet në gjini, numër dhe për një pjesë edhe në rasë me emrin e këtij sendi<sup>125</sup>.

Në të tri veprat rezulton që autorët përdorin mjaftueshëm këtë klasë fjale duke na dhënë mundësinë që të studiojmë veçoritë morfologjike të mbiemrave. Në rrafshin morfologjik dallojmë mbiemra të nyjshëm dhe të panyjshëm, veçoria strukturore e të cilave do të trajtohet në vijim të punimit .

Sipas albanologut Shaban Demiraj, “Mbiemrat me forma të këtilla dypalëshe ( të nyjshëm dhe të panyjshëm) të shqipes nuk kanë analogji me asnjërën nga gjuhët e tjera të familjes indoevropiane , prandaj këta të gjuhës sonë konsiderohen se janë zhvilluar brendapërbrenda gjuhës sonë<sup>126</sup>.

Gjatë vëzhgimit konstatohet se mbiemrat me nyje të përparme janë përdorur më shpesh në veprat e studiuara të tre autorëve.

Një dukuri të përbashkët që vëmë re në tri veprat e studiuara të shkrimtarëve Radoja, Babi e Bytyçi rezulton se mbiemrat e nyjshëm, këto shkrimtarët veriorë të shekullit nëntëmbëdhjetë, i kanë shënuar shpeshherë përpara emrave, siç duket kjo dukuri e ndikuar nga latinishtja. Autorët ishin të detyruar, që si kusht për t’i botuar librat e tyre, duhet ti përkthenin nga latinishtja në shqip dhe anasjelltas. Po japim disa shembuj ilustrues nga të dy autorët, Radoja e Bytyçi aty ku i kemi ndeshur.

Radoja:

*I maçi Perennii,*( i madhi Perenni) *Єотын kriuesi I ciełs...*(D.C.7)

*...o e amla Virgini ( Virgini)Mrii* (D.C. 80)

*...Permii gniat t’maçç urçnim( t’madh urdhnim)* (D.C. 89)

*.. t’kcia (t’kqia)scium t’scpirtit (t’ shpirtit) e t’korpit.* (D.C.96)

*...T’mira scum t’scpirtit ( t’mira shum t’shpirtit)e korpit* (D.C.96)

*Єотын a s’e difton t’maççenn mniin ( t’madhen mnin)e vet* (D.C.138)

Bytyçi:

*T’maçe fees* (t’madhe fees)i bain çunii

*Nnen t’paa fee per haimalii ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 14)*

...

*Ka prei Єotit t’maçe rrfee* (t’madhe rrfе) ( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 5)

*Ci pat Kami per t’maç dnim(per t’madh dnim)*( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 7)

*I vnnon scpirtit t’maçe lece.*(t’madhe leqe)( çet urçnimet e Scêites Kisc f. 12)

Gjatë trajtimit të çështjes së mbiemrave, në aspektin morfologjik do të ndalemi në trajtimin e veçorisë së shkallës së mbiemrit në veprat e të tre autorëve ndërsa në aspektin fjalëformues do të hetohen disa modele dhe mënyra të formimit të mbiemrave.

Përshtatja e mbiemrit me emrin që përcakton, në gjini numër dhe rasë ndodh vetëm tek mbiemrat e nyjshëm. Këtë dukuri ata e realizojnë në veprat që kemi në studim përmes trajtave rasore të nyjës së përparme dhe mbaresave që ata marrin. Mbiemrat e panyjshëm përshtatjen në gjini dhe numër e realizojnë me anë të mbaresave dhe formanteve mbaresore, ndërkohë që kategorinë e rasës e kanë humbur. Nga këto kategori gramatikore, interes të veçantë paraqet kategoria e shkallës me kundërvëniet e saj: pohore, krahasore e sipërore. Kategoria e shkallës është veçori tipike mbiemrit.

<sup>125</sup>Akademia e Shkencave të Shqipërisë Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë 2002, f.153.

<sup>126</sup> Sh.Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1988,f.417.

Kjo është dhe arsyeja që në studimin tonë do të trajtojmë shkallët e mbiemrave, pasi dy kategoritë e tjera gjinia dhe numri janë të varur morfologjikisht nga emri dhe studiohen në përshtatje me të. Kështu përsa i përket gjinisë së mbiemrave në përshtatje me emrin, përgjithësisht krijohet me anë të nyjave të përparme si dhe mbaresave përkatëse, siç pohuam dhe më lart. Tek mbiemrat e nyjshëm mjeti më i rëndësishëm i cili dallon gjininë është nyja *i* Radoja: *i* i sctreit(f.34 ); Babi: *i* mir (f.188) për mbiemrat e gjinisë mashkullore dhe nyja *e* Radoja: *e* foort(f. 37) Babi: *e* madhe (f.233) Bytyçi: *e* sckret(f.13) për mbiemrat e gjinisë femërore.

Një dukuri tjetër është përdorimi në gegërisht i gjinisë asnjajëse të mbiemrave foljor në vend të emrit abstrakt si: të ardhunit tand,etj.Edhe në këtë rast po ilustruam shembujt:

Radoja:

...t'biirt e Teneot, e basc *t'dasctunit* (t'dashtunit)e *Jeeu Krisctit*. (D.C .27)

...cundra dy t'parave e jam peemetimet e scpirtit e *t'vsctirat*(*t'vshtira*) e *korpit* (D.C.67)

Babi:

Emnat e nnierëve e *t'perbuεunit* e *vogliis*( *t'perbuzunit* e *voglis*) (Vakinat.97)

...pa fye kurr gni her to memneer t'foort t'tyne, e *me t'plast t'emers* kur ja mrrine (Vakinat. 135)

Enmiku gi I múeξ asct Diali...εamani i malkuem i epte εoori e εelnen t'foort *t'mierit Saul*. ( Vakinat. 88)

Edhe përsa i përket numrit të mbiemrave në gjuhën e tre autorëve, kundërvënja krijohet me ato mjete gramatikore si të mbarë shqipes: me anë të nyjave të paravendosura dhe formanteve të shumësit.

### **Kategoria gramatikore e shkallës.**

Kjo kategori gramatikore tregon një shkallë të caktuar të cilësisë së sendit.

Mbiemrat e skeduar nga veprat shoqërohen në shkallë të ndryshme: pohore, krahasore dhe sipërore. Konstatuam se autorët përdorin shkallën pohore dhe sipërore dhe më rrallë shkallën krahasore.Në tekstet e autorëve ndeshet e konsoliduar vetëm në format analitike, dukuri kjo edhe e teksteve të vjetra. Shkallët krahasore e sipërore të mbiemrit ndërtohen me elemente analitike, siç janë pjesëza *ma* dhe me ndajfoljet e sasisë *aq kaq, fort*. Këto mjete leksikore të gramatikalizuara ndërtojnë shkallët krahasore e sipërore mbi bazën e shkallës pohore.

### **Ëngjëll Radoja**

Ëngjëll Radoja përdor mbiemra të nyjshëm e të panyjshëm në shkallën pohore, krahasore e sipërore.

#### **Shkalla pohore.**

Në tekst ndeshim shumë mbiemra në shkallën pohore, që për nga formimi mund të jetë të pamë a të prejardhur. Si shembuj po ilustruam një pjesë të tyre.

Ather kuur ban giξξ atò pun *t'mira*.../...fialsc o mennimesc *t'kcia*...(D.C.10)

...prej robniet t'diañit *ma/kuem*...( D.C.18)

...jeten e *ghiat* me t'mira enguscñime...(D.C.124)

...kan kater borce *t'mçaa*. (D.C. 125)

### Shkalla krahasore e barazisë.

Mbiemri në shkallën krahasore të barazisë ka karakteristikë që krahasimin e shfaq të njëjtë për të dy krahet. Ndërtohet duke i paravendosur mbiemrit në shkallën pohore pjesëzën trajtëformuese *ma* dhe ndajfoljet sasiore *aq e kaq*.

Ah medet per ata ci e kan msue ghojen *acc eii?*(D.C.113)

Coti ci asct *acc i maçç!*(D.C. 68)

... *mâ i kêc e ma i scemtuum* asct mcati. (D.C.72 );

Kio e mir *cacc e maççe* me scka i merret sciocit? (D.C.160)

...gnitá ci jetoin faret pa gaile e pa kuides t'scirtit e *acc fatkcii(fatqqi)* jan. (D.C.f.101)

### Shkalla krahasore e sipërisë relative.

Autori përdor shkallën krahasore të sipërisë relative, e cila e dëfton se cilësia e sendit të dhënë është në një shkallë më të lartë se cilësia e sendit tjetër. Në veprë dallojmë shembuj në numër të reduktuar ku kjo shkallë ndërrohet duke i paravendosur mbiemrit në pohore pjesën trajtëformuese *ma* ndërsa gjymtyra kryesore lidhet me lidhëzen se...sesa.

...bile s'kaa keen n'scekuł kreatyr *ma e dliir se* kio (D.C.19 )

...s'asct tieter *mâ i dêi e mâ e pusctetscem* se ne cieł e n'çee. (D.C.76)

### Shkalla krahasore e sipërisë absolute.

Sikurse do të ilustron nga shembujt vjelë në tekst, kjo shkallë tregon se cilësia e dhënë është në një shkallë më të lartë se grupi ku bën pjesë. Ndërtohet me formantin krahasues *ma* ndërsa gjymtyra e dytë mund të jetë një emër në gjinore ose kallëzore ose raste kur mungon gjymtyra e dytë.

Asct gni mcat fort i ran n'vetvedi e *mâ i maçi mcat* ci muun t'bahet cundra scocit. (D.C.133)

Ata jan *mâ t'dasctunit micc* t'Jeeu Krisctit.(D.C.13)

### Shkalla sipërore.

Shkalla e tretë, sipërore, shprehet duke e dhënë cilësinë e emrit në shkallën më të lartë. Këtu gjendet i shoqëruar me ndajfoljen përforcuese *fort* psh:

Asct gni temel *fort i nelt* (D.C.15)

I kaa çan dy pusctete *fort t'nalta* e *t'mçaja* (D.C.37 )

ai do t'jeet nieri *fort i kec* (D.C. 49 )

Pse Cotyn âsct *fort i mir, e i miscirscm, fort i dreit e besnik*(D.C. 53).

## Pashko Babi

### Kategoria e shkallës.

Pashko Babi në veprën e tij përdor mbiemrin në shkallën pohore, krahasore e sipërore. Këto mbiemrat janë të nyjshëm e të panyjshëm, të parme ose të prejardhur.

### Shkalla pohore.

Mbiemrat cilësorë që tregojnë tiparin e sendit kanë një përdorim të konsiderueshëm në veprë. Pjesa më e madhe e mbiemrave janë me formim të prejardhur. Sa për ilustrim po japim disa shembujt, pasi kjo shkallë e mbiemrit është shumë e përdorur në veprë:

...gni duhii eeret e mnerscme, i sciетуun errfee t'flakueme...prei berghut anneiscem Deetit kug...(V.62)

...iscin kurbane t'pergiakuna, ani mâa per ket soi iscint'scgnuem gijet'pa kurr gni behane....me maje miłit t'pa mrūtuna ...(V. 68)  
...do fmii ghoi lscuem i vuune ghaein. (V.117)

### Shkalla krahasore e barazisë.

Karakteristikë e mbiemri në shkallën krahasore të barazisë është që krahasimin paraqitet i barazvlefshëm për të dy anët. Ndërtohet nga formimi: a) pjesëz ma + mbiemër në shkallën pohore b) ndajfoljet sasiore aq e kaq + mbiemër në shkallën pohore.

...*ma i mažnuem* per giáa e pass si per dije.(V. 108)

...i zili kiscte trupin e vet *kag t'nelt*...(V.88)

...lscoi mrenna gni duhii *kag t'fort*.(V. 119)

Por urimi *ma i maž* iscte ruit per ginden. (V.49)

Prova e ghaepit *ma e foorta*.(V. 159)

...atij ju duk si ma pùn mažž ner ta. (V.22)

Isaku e kiscte n'hater Esaun se iscte ma eemer trim (V.29)

### Shkalla krahasore e sipërisë relative.

Shkalla krahasore e sipërisë relative dëfton se cilësia e sendit të dhënë është në një shkallë më të lartë se cilësia e sendit tjetër. Ashtu si edhe tek Radoja kjo shkallë paraqitet e ndertuar nga pjesën trajformuese *ma* e cila i paravendoset mbiemrit në pohore ndërsa gjymtyra kryesore lidhet me lidhëzen se...sesa.

Nuk mûnn scifei ghaep ma i fort me syq per eemer t'robit , e ma i tristuescem *se* kuur u permyene ...e t'delscin per marifete ma t'viefscme ner tier *se sa* me i daa...(V. 120)

### Shkalla sipërore.

Shkalla e tretë, sipërore, shprehet duke e dhënë cilësinë e emrit në shkallën më të lartë. Këtu gjendet i shoqëruar me fjalën përforcuese fort e cila ndryshe nga Radoja, tek Pashko Babi e gjejmë të paravendosur mbiemrit të nyjshëm në shkallën pohore dhe here tjetë pozicionohet pas tij psh:

Bab *fort i dasctun*... / ...e me gni soi fiet tieter *t'kusctuescme fort*...(V. 70)

...pes pesca *t'lumnueme fort*...e i takamisun mir fort...(V. 92)

...gni toprak *t'kymetscem fort*..(V.95)

### Ndue Bytyçi

Nga vjelja tërësore e materialit të autorit, rezulton se Bytyçi në veprën e tij "Ëzet urçnimet e Scêites Kisc" përdor mbiemra të nyjshëm vetëm në shkallën pohore. Dallohen mbiemra të nyjshëm duke dhënë thjesht tiparin e sendit pa bërë ndonjë krahasim të këtij tipari a të një tipari tjetër.

Por tasc nnrysce tui punue

Jan, do t'kscten te eee, e true.

\*\*\*

Jo gni rrfec gni cinn gni mii

Me i batusun n'ferr te ei.

\*\*\*

Mos me i lan me scok t'kcii

Ci me marrun vest e eii. (Ëzet urçnimet e Scêites Kisc)



### Formimi i mbiemrave

Mbiemri, si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, sipas pikëpamjes së strukturës, del më së shumti i përdorur në dy trajta: në të parme e të prejardhur, e shumë më rrallë si të përbërë. Mbiemrat e parmë, sipas pikëpamjes së strukturës së tyre paraqiten në dy trajta: të panyjshëm dhe të nyjshëm.

### Ëngjell Radoja

#### Mbiemra të thjeshtë (të parmë)

Mbiemrat e parmë përdoret dendur në veprën *.A tyre nuk mund t'u hetohet as tema fjalëformuese, as ndonjë formant fjalëformues*<sup>127</sup>. Si të tillë ata japin vetëm cilësinë e emrit me të cilin lidhen. Mbiemrat cilësorë janë në masë të konsiderueshme.

i mir (D.C.7 ); t'mira (D.C.10); t'kcia(D.C.11 ); t'sceit(D.C.17 ); t'maže (D.C. 23); vorr t'rii (D.C.30 ); me eel t'maž(D.C.30 ); i sctreit(D.C.34 ); e paame (D.C. 36); ghru e foort(D.C.37); e scnosct (D.C.37 ); e dliir (D.C.43); t'foort (D.C. 44); idet e mira (D.C.48 ); pun t'verteta (D.C. 52); grig e voghel (D.C.53); fial t'hola (D.C.59)

#### Mbiemra të prejardhur :

##### Me prapashtesën –shëm (-scm) dhe me nyjëzim.

*Në gramatikën e gjuhës shqipe pranohet prapashtesa e re –ueshëm nga foljet me temë në –o, ku si temë fjalëformuese shërben vetë tema e foljes, duke rënë prapashtesa –o.*<sup>128</sup> Por shënojmë se disa nga këto mbiemra janë formuar jo vetëm nga tema foljore + prapshesë por edhe nga tema të tjera që nuk i përkasin prejardhjes me prapashtesim. si në shembujt: i hyinue-scm ( hyjnie-sh(ë)m) (D.C.17 ); e kulue-scme (kullue-shme) (D.C. 19); e scëitnue-scm( shejtnue-sh(ë)m) (D.C. 30); t'pusctue-scm ( pushtue-sh(ë)m) (D.C . 31); t'lotue-scme (lotue-shme) (D.C.32 ); t'paa-arsye-scme(paa-arsye-shme) (D.C.56); e pelciye-scme( pelqye-shme) (f.56 ); i arsyescm(arsye-sh(ë)m) (f. 34 ) ;

##### Me prapashtesën –m (dhe mbaresë).

Mbiemrat e formuar me nyjëzim ndërtohen nga tema e pjesores që del me –m. B.Bokshi<sup>129</sup> *pohon se ky fenomen ishte i përhapur në të folmet gege të kohës dhe më i preferuar në traditën e shkrimit të teksteve fetare të shqipes veriore. Sipas Bokshit këtë formant e marrin foljet e tipit të tretë me temë në zanore ( bekue-m). Nga vepra ilustruon shembujt:*

i béekue-m (D.C.22 );e béekue-m-e (D.C.14 ); i maalkue-m (D.C.18 );

##### Me parashtesën pa-

Parashtesa *pa-* nderton mbiemra të nyjshëm me kuptim mohor nga tema mbiemërore dhe emërore. Një pjesë e këtyre mbiemrave që formohen nga parashtesa *pa-* shënohen të ndarë nga tema fjalëformuese.

t'paazaanfiiλ (D.C. 16); jeten e paa-sosme (D.C. 18); me giak t'paa-scmuem (D.C. 18); e paa-gabuescme (D.C.36 ); prei deket s'paa-pritun (D.C. 72)

<sup>127</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f.184.

<sup>128</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f.193.

<sup>129</sup> B.Bokshi, *Pjesorja e shqipes* (veshtrim diakronik), ASHAK, Prishtinë, 1998, f 31.

### **Formimi i mbiemrave kompozita.**

Duke u nisur nga fakti se kompozimi është shumë rrallë i përdorur në vepër, ndeshim vetëm kompoziten mbiemër: Fat + kcii ... gnitá ci jetoin faret pa gaile e pa kuides t'scirtit e acc *fatkcii* jan. ( D.C.101)

### **Pashko Babi**

#### **Mbiemra të parmë.**

Ashtu si dy pararendësit tij, edhe Pashko Babi përdor shumë shpesh mbiemrat e parmë, por ndryshe nga bashkohësit e tij, Babi përdor mbiemrat e nyjshëm jo vetëm si cilësorë por edhe ato marrëdhëniorë.

(fmii) t'gnom (t'njom) (V.104); t'εεεa(t'zeza) (V.121); t'buut (V.190); e mscehta( e mshehta) (V.198); t'amlá (V.231);t'lergh (V.233); t'raan (V.233); e maçe (e madhe) (V. 233); i mir (V .188)

#### **Mbiemra të prejardhur :**

##### **-Me prapashtesën –scm (-sh(ë)m) dhe me nyjëzim.**

Mbiemrat e formuar me këtë prapashtesë vijnë nga temat ndajfoljore, foljore ose emërore . Prapashtesa –shëm u bashkangjitet edhe temave të pjesoreve që dalin me – ue, ye të gegërishtes.

e terscme ( e terrshme) (V.61); e mnerscme ( e mnershme) (V.62) ; i kusctuescme (i kushtueshëm) (V.67); t'schyhretscem (t'shyretshëm) (V.77); e εorscme (e zorshme) (V.101); e scuguruescme ( e shugurueshme) (V.101) t'hakikatcscme (t'hakikatshme) (V.102); t'vrascme (t'vrashme) (V.124); (borg) t'herscme (t'hershem) (V.125) i maçnuescem (i madhnueshem) (V.147); e kanscme (e kanshme) (V.228); e afruescme ( e afrueshme) (V.232); e koláiscme ( e kollajshme) (V.239);

##### **-Me prapashtesën –m (dhe mbaresë).**

Kjo prapashtesë u bashkangjitet foljeve të tipit të tretë me temë në zanore. kuáue –m ( kullue-m) (V.67);t'scegnue-m (shenjue-m) (V. 68); t'ghatue-m-e (V.70); ,i punue-m (V.70); t'kusctue-m-e(t'kushtue-m-e) (V.70) t'ghabue-m-e (V.74); i viettrue-m ( e vjettrue-m-e) (V.84); i maákcue-m (I mallkue-m) (V.86); t'çunue-m-e ( t'dhunue-m-e)(V. 87) t'lmue-m-e (V.87) ;t'mlue-m (Vakinat.99); e scughurue-m-e (e shugurue-m-e) (V.101) t'turpnue-m (V.110) : t'sckurtue-m (t'shkurtue-m) (V.161) t'sakatue-m (V.161); t'rezighue-m (t;rrezikue-m) (V.213)

##### **-Me parashtesën pa-**

Mbiemrat e formuar nga parashtesa *pa-* janë zakonisht me kuptim mohues ose përjashtues. Këto mbiemra nuk janë shumë të përdorur në vepër.

t'pa scpirt (V.72) ;t'pa εot (V.122);t'pa hile (V.158) ; Pasosun (V.228);

#### **Formimi i mbiemrave me nyjëzim .**

Në veprën e Babit dallojmë edhe disa mbiemra të nyjshëm që janë formuar nga tema foljore e në disa raste edhe nga togjet e përngjitura parafjalë +emër. *Si temë fjalëformuese për mbiemrat prejfoljor shërben pjesorja e foljeve*<sup>130</sup>: i muscun( i

---

<sup>130</sup>Akademia e Shkencave të Shqipërisë Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f,195.

## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

---

mushun) (V.67) (i)vescun (i veshun) (V.67) t'pergiakuna (t'pergjakuna) (V.68) t'pa mruituna (V.68) (i)ghulun (V.71) t'dalun (V.72); t'cioroditun(V.84); t'ghoditun (V. 86) ; (i)sghie<sup>xi</sup>un ( i zgjedhun) (V. 88); t'dekun(V.214);

### **Formimi i mbiemrave kompozita**

#### **Kompozita me vlerë mbiemërore në veprën e Babit kemi ndeshur:**

**pûn+ma<sup>xi</sup>** ...atij ju duk si ma *pûn ma<sup>xi</sup>* ner ta. (Vakinat.22)

**emmer + trim** Isaku e kiscte n'hater Esaun se iscte ma *emmer trim*(Vakinat,29)

**ghoi+<sup>xi</sup>unues**. E kso doret ai ghoi <sup>xi</sup>unues...(Vakinat. 164)

**emmer+ buut** Véne vedit eghie<sup>xi</sup>en teme e zeni prei gi jam *emmer buut*. (Vakinat,229)

**menne+trasc**

**emmer +ngusctuem ... ..menne traasc e emmer ngûsctuem** ka besa e atyne prove gi patne laan profett si fial! (Vakinat, 277)

**ghoi+lscuem...do fmii ghoi lscuem** i vuune ghaein. (Vakinat.117)

### **Ndue Bytyçi**

Në gjithë materialin e vjelë në shkrimin e Bytyçit prej 12 fletesh kemi arritur të veçojmë vetëm mbiemrat :

**1)të parmë:** te eee( te zez), te true, t'ma<sup>xi</sup>e ( te madhe),te eii (te zii) , t'mira ( f. 4-5) e fsctir ( e fshtir) (f.6) t'kcii (t'kqi) (f.7); t'sckret (t'shkret) (f.9); fial t'kcija ( fjal t'kqija) (f.11); e ran (f.11); t'sctremta (t'shtremta) (f. 12); e sckret ( e shkret) (f.13)

#### **2)mbiemra të prejardhur :**

a)me prapashtesën –scm (–sh(ë)m), tema fjalëformuese e së cilit mendohet të jetë emërore. Gjendet tek mbiemri : t'vaiscem ( t'vajshme) (f.9);

Me parashtesën *pa-* që i jep fjalës kuptim antonimik :t'pa-terbiete (f.10)

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

### Përemrat.

Përemrat, si pjesë të ndryshueshme e ligjeratës tregojnë tipare ose sasi të pacaktuar. Karakteristikë e përemrave është funksioni tregues dhe jo emërtues. Duhet theksuar se në trajtimin e përemrave nuk ka dallim të veçantë nga e folmja e gegërishtes veriore. Në veprat e tre autorëve do të analizojmë disa tipare të përemrave vetorë, vetvetorë, dëftorë, pronor, pyetës, lidhor e të pacaktuar.

### Ëngjëll Radoja.

#### Përemri vetor.

Përemri vetor është ai lloj përemri që në fjali përdoret si fjalë më vete, pa përcaktuar fjalë të tjera ose pa u përcaktuar nga fjalë të tjera. Ky përemër tregon veta të ndryshme<sup>131</sup>.

*Pasqyra e përemrit vetor sipas vetave, numrit dhe rasës që pasqyrohen në veprën e Ëngjëll Radojës.*

VETA I		
Rasa	Njëjës	shumës
E	Une /un	Na
Gj.	---	---
Dh.	mue	Ne na
K	mue	Ne na
Rrj.	mejet	Prei nesc

VETA II		
Rasa	Njëjës	shumës
E	Ti	
Gj.	---	---
Dh.	?	ju
K	Τγγ (ty)	?
Rrj.	Prei teje	?

VETA III		
Rasa	Njëjës	shumës
E	Ai/ajo	ata
Gj.	i atii(i atij)	?
Dh.	Atii (atij) Assai (asaj)	Atyne (atyne) Atynve(atynve)
K	Atê e	Ato/ata
Rrj.	Prei ssi	?

Te përemrat vetor , numri njëjës në vetën e parë, paraqitet në dy forma apo trajta të ndryshme si : *un* dhe *une*.

...ban ci *un* munn t'ezzi...(D.C.88)

*Une* s'jam acc faituer (D.C.114)

Në rasën kallëzore dhe dhanore ky përemër del në formën *mue*. Në pjesën më të madhe të rasteve në rasën kallëzore del e shoqëruar me parafjalë.

..nuk kaa ççim e kudes *per mue*. (D.C.114)

Nuk ççona epna *mue* por epna nee. ( D.C.66)

Në rasën rrjedhore del në trajtën :mejet.

<sup>131</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f, 218, 220.

T'mos keesc tieter *Ëot pos mejet.* (D.C.95)

Veta e parë shumë, që në shqipen standarde del *ne*, tek Radoja ndeshet në trajtën *na* si tipar i të folmes geqe:

A kee vuû-orôe ci *na* t'kersctent.. (D.C.23)

*Na* tui e diit se uça....(D.C.63)

Në rasën dhanore përemri i vetës së parë shumë del në trajtën *ne na* duke mos e dalluar grafikisht nga rasi kallëzore, por vetëm nga funksioni sintaksor.

...e *ne na* i diftoin me t'sakt, e me t'dreit.(D.C.44)

Mbizotëruese në përdorim gjatë gjithë veprës është dhanorja dhe kallëzorja që del me trajtë të shkurtër dhe që ka formën e përemrit të vetës së parë *na*, por që dallohen funksioni sintaksor që ata kanë .

( rasi dhanore)...*na* apin me besue gnato senne. (D.C.43)

Scka âsct ci *na* mma giaal scpirtin? ( D.C.64)

(rasi kallëzore)...*na* paitoi e na miksoi me te. (D.C.55).

Por rasën dhanore në vetën e parë shumë e kemi ndeshur edhe në formën *nee*, të pashoqëruar me trajtë të shkurtër.

Nuk ççona epna mue por epna *nee*. (D.C.66)

Në vetën e parë shumë në rasën rrjedhore kemi rastin *nesh* që shoqërohet me parafjalë.

..atá t'misciriescmit syy tuu siełin *prei nesh* miscirien....( D.C.80)

Teneon içnue *cundra nesc*.(D.C.56)

Përemrat e vetës së dytë njëjës e shumë nuk ndeshen shpesh në vepër.

Përemri vector *ti* ndeshet si në normën e gjuhës shqipe por si rast të izoluar kemi ndeshur përdorimin e këtij përemri edhe në trajtën *tine*: Si bân *tine* kryg? (D.C.19)

Karakteristikë këto përemra kanë që në rasën dhanore e kallëzore përdoren pa trajtë të shkurtër.

*Tyy t' ççrassim* na t'sekret Birt e Evs.(D.C.79)

Une *tyy* po t'pagheói n'emen t'Atit...(D.C. 180)

Rasi rrjedhore del me trajtën *tejet*: Pse *prei tejet* kaa marr misc e giak. (D.C.75)

Përemrat e vetës së tretë njëjës dhe shumë dalin pa ndryshime nga norma e gjuhës shqipe:

Pse *ai* âsct i pari Urçnues. (D.C. 99)

e para asct *ajó* me t'zilen e ban vet krisctin m'u ul. (D.C.37)

Pse *atá* asctu s' besoin. (D.C.33)

Pesmçet temelet a nuk dahan eçe *ató* n'tri piess? (D.C.91)

Përemrin vector të vetës së tretë ata, në rasën dhanore e gjejmë në dy forma: *atyne* dhe *atynvet*.

Tui daa Nniest *atyne* (atyne). (D.C.38)

..ai ci ia ven vescin *atynvet* (atynvet) ci promscmoin. (D.C.153)

Radoja përdor formën e vjetër të rrjedhores së përemrit vectorë: *prei ssi*:

...munna me i pass *ató* t'mira ci lypim *prei ssi*. ( D.C. 55)

...ci t'kççehen me giçç eemer *prei ssi*. ( D.C.77)

...premtói sc'Pietri, e Papve , ci vin *mrapa ssi*...(D.C.43)

Përemrat e vetës së tretë njëjës dhe shumë rasi kallëzore dhe rrjedhore përdoren edhe pa a-nistore, por të shoqëruar me parafjalë.

...ci ti mos t'gabisc m'u perëie *me tá* (D.C.141)  
...m'u largue prei sebetsc, n'ciłoft *nner tó*. (D.C.157)

Në përdorimin e trajtave të shkurtra të bashkuara (*i+e*), apo qofshin këto edhe me pjësëzën *u* të formës joveprore, autori shkruan me vizë në mes.

...nguscłim ci pat kuur Engnłi *i-u* fal prei ânes Teneot. (D.C.77)

Psè *i-a* ǵǵona Țois ket urat?(D.C.80)

...me *i-u* lutun per dit, e me *i-u* falun-nnèrs (D.C.100)

Sa her ci *i-a* lut morden prinds...(D.C.121)

...Âsct bâa-jassak prei Țotit me *i-a* marr jeten e scpirtin...(D.C.131)

Nó tu' *i-a* marr kui giâan me per Țun. (D.C.141)

### Përemri vetvetor.

Përemri vetvetor tregon vetën mbi të cilin ushtrohet një veprim dhe atë që e kryen këtë veprim. Ai zakonisht përdoret vetëm për të treguar veta dhe nuk ka formë të veçantë për të dalluar gjininë.<sup>132</sup> Përemri vetvetor del në format: *vetvehten*, *vet-vehten*, *vethen*, *vedi* nën ndikimin e dialektit të gegërishtes. Kryesisht kemi ndeshur përdorimin e këtij përemri në rasën kallëzore shoqëruar osë jo me parafjalë. Autori në disa raste shënon në trup të përemri vetvetor faringalen *h*: *vethen*, *vetvehten*, *vet-vehten*.

A munnet nnokusc me vraa, o me mmyt *vethen*? (D.C.128)

...ci asct e mir *n'vet-vedi*, ather o na duhen me e lãn. (D.C.132)

Teneon giǵǵher tui lyp miscicriiven e tii *per vedi* e per ata. (D.C.134)

...ligen e tii, ata ǵǵam, t'kiaain *vetvehten* pse dnohen. (D.C.22)

...me bâa eap giǵǵ *vetvehten*, me ba krq. (D.C.77)

*vet-vehten*....asctu eǵe me e dasct sciocin porse *vet-vehten* (D.C . 89)

### Përemri dëftor.

Tek Ëngjëll Radoja dallojmë më shpesh të përdorur përemrat dëftorë *ky* (*ky*), *kjo* (*kjo*) kur përdoren për të treguar persona ose sende që ndodhen afer folësit, por mjaftueshëm zënë vend në përdorim edhe përemrat dëftor *ai*, *ajo* për të treguar persona a sende që ndodhen larg. Nuk gjenden të përdorur përemrat *i* tillë, *i* atillë, *i* këtillë.

*Ky* far komit a jeton erelisc? (D.C. 50)

Scka do me ǵǵan *ajo* fial , Amen? (D.C.72)

N'kisc katolik kusc e kaa *at* pusctët. (D.C.39)

Në rasën rrjedhore përemri *i* gjinisë mashkullore, njëjës, përdoret në formën *ktii* (*ketij*) : ...mniin e vet cundra *ktii* mcati (*ktij* mkati)? (D.C.137)

Radoja përdor edhe formën e vjetër të rrjedhores së përemrit dëftor, por duhet përmendur që nuk ndeshet shumë shpesh .

...mos me bâa as nnogni *assó punsc* ci Scëitia Am kisc *i* ka bâa – jasad. (D.C.116)

...me lakmue gniassó sennesc, ci e helmoin ket scpirtin ton.( D.C.70)

A jan n'scekuł *asisc niere* ci apin sckanuł? ( D.C.133)

### Përemri pronor.

Në veprën e Radojës nuk janë identifikuar të përdorur të gjithë llojet e përemrave pronorë. Dallojmë këto forma:

Veta e parë njëjës në gjinisë mashkullore del në trajtën dialektore: *em*.

<sup>132</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002, f, 228.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Ati γn e jo Ati em. (D.C.61)

Veta e dytë e përemrit pronor në gjininë mashkullore del në trajtat *yt (yt), tyyt* ndërsa në femërore *jote*.

Scëitnî kioft emni *yt(yt)?* (D.C.63)

Jeeu-Kriscti ci âsct ver e verte fryti *yt (yt)*. (D.C.75)

E Jeeu bèekuemin frytin e barkut *tyt*. (V.80)

..u baft vulnessa *jote*. (D.C.59)

U baft n'mue, si ççat fiala *jote*. (D.C.78)

Përemri vetor i vetës së dytë njëjës, në gjininë mashkullore, rasa kallëzore tënd në vepër e ndeshim në trajtën *tyt* edhe *tann* .

E beekuem fryti i barkut *tyt!* (D.C. 75)

T'dûesc sciocin *tann*. (D.C. 91)

Edhe përemrin e vetës së tretë te Radoja e ndeshim në formën *tynve*.

I gniof si ççot Kriscti prei veprasc *tynve*. (D.C.49)

...biim n'ghiûi perpara fugûreve *tynve*. (D.C.104)

Shohim se autori nuk përdor shumë përemra dëftorë. Në vepër nuk i ndeshim të përdorur të gjitha format e përemrave.

*Pasqyra e përemrit pronorë sipas vetave, numrit dhe gjinisë që pasqyrohen në veprën e Ëngjëll Radojës.*

Veta I				Veta II			
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
M	M	F	M	M	M	F	M
em	?	mii	e mia	γt /tyt	jote	e tuu	?
γn	jon	ton	tona	?	?	tuu	tua

Veta III			
Njëjës			Shumës
M		F	M-F
i tii			e tia
		e saj	e vet
tynve			e tynve

### **Përemriat pyetës, lidhor e të pacaktuar.**

Autori pëlqen që në vepër të përdorë më shumë fjalë pyetese ose ndajfolje pyetëse. Pavarësisht kësaj, ne do të analizojmë disa përdorime të përemrit pyetës.

Përemri më i përdorur është përemri : kusc (kush) në rasën emërore që drejtohet për të identifikuar frymorë.

*Kusc praa na tunnón per t'kec?* ( D.C.70)

*Kusc jan atá ci vehen n'reeik...*(D.C.103)

Në rasën gjinore, dhanore përemrin pyetës *kush* ndeshet në trajtën i/e kui, kuive si trajtë dialektore.

E bía e *kui* kie εoja? (D.C.70)



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

*Kuive* n'scekuł dona ksctu me ú ghiaa? (D.C.73)

Një përemër tjetër pyetës që përdor autori, është edhe përemri : *Scka?* (*shka?*) që ndiqet pas nga një folje.

*Scka* besson ti n't'žetin *Artikuł?* (D.C.46)

*Scka* do me žžan ajo fial *Amen?*(D.C.48)

Përemrin *cili*, *Radoja* e përdor në të shumtën e rasteve në numrin shumë.

*Zilat* Uržnime kien sekruie n'rراس t'par'? (D.C.97)

Përemri pyetës çfarë del i shkruar me apostrof, ndryshe nga norma standarde. Kjo siç duket është nën ndikimin e dialektit gegë.

Prei **c'far** punsc mâ fort duhet m'u ruit n'ató diit?

Kemi edhe formën ç' cili është më shumë i përdorur se përemri çfarë.

C'pun bahen me mûnn t'korpit, ci jan baa jasak?

C'mcat âsct giaksia e baame me vulness e postafat?

### **Përemri lidhor.**

Ky përemër me funksion lidhës dhe që shërben për të lidhur gjymtyrë në fjali të varur përcaktore. Përdoret tek Ëngjëll *Radoja* jo rrallë. Zakonisht gjendet përemrat lidhor të caktuar që (*qi/ ci*), i *cili*.

Jan t'Eignlit *Gabriel*, i *zili* foli ksctú ather. (D.C.74)

Jan t'scêites *Elieabet*, e *zila* kie kuscrina...(D.C.75)

Prei drunit, gurit, arit a rgianuit, *ci* (*qi/që*) kan per eota?. (D.C.103)

### **Përemrat e pacaktuar.**

Veçoria themelore e kuptimore e përemrave të pacaktuar është pacaktuesia.

<sup>133</sup> Përgjithësisht autori përdor përemra të pacaktuar që tregojnë frymorë ose që përjashtojnë një frymor a send të pacaktuar.

Jo s'guzon **askusc** n'scekuł por gižž t'zilit i duhet. (D.C.43)

...mos me i baa kec **askui**. (D.C.43)

...pa i baa kec **kurkui** bile me niet. (D.C.109)

E mos me mmûit **nnokusc** per nnogni arsyi..(D.C.112)

## **Pashko Babi**

### **Përemri vetor.**

Përemrat vetor është përemri që tregon veta të ndryshme. Kuptimi i vetës te këta përemra përkon me kuptimin e tyre leksikor<sup>134</sup>.

Në analizën e përemrave vetor kemi ndeshur përdorimet të cilat po i paraqesim të strukturuar në tabelë por edhe me ilustrime përkatëse.

*Pasqyra e përemrit vetor sipas vetave, numrit dhe rasës që pasqyrohen në veprën e Pashko Babit.*

VETA 1		
Rasa	Njëjës	shumës
E	une /un	Na

<sup>133</sup> Akademia e Shkencave të Shqipërisë Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë 2002, f, 249.

<sup>134</sup> ASHSH Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë 2002, f, 220.

## *Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX*

Gj.	---	---
Dh.	mue m´	ne na
K	mue m´	?
Rrj.	mejet	(prei) nesc(nesh)

VETA II		
Rasa	Njëjës	shumës
E	ti	ju
Gj.	---	---
Dh.	Tγγ t´	Juu ju
K	Tγγ t´	juu ju
Rrj.	(prei) tejet	(prei) juve (prei) jusc

VETA III		
Rasa	Njëjës	shumës
E	ai/ajo	ata/ato
Gj.	---	---
Dh.	atii assait	atyne ju
K	atê e	?
Rrj.	(prei) atii (prei) assai	(prei) tyne (prei) sisc

Përemri vetor, në numri njëjës në vetën e parë, paraqitet në dy forma apo trajta të ndryshme si : *un* dhe *une*.

*Un* po t'hii dorzan per te (V.44)

*Une* po e scof, por jo per tasc, *une* po e daai por jo per afer. (V.76)

Në rasën dhanore dhe kallëzore përemri i vetës së parë njëjës kanë edhe trajtën e shkurtër m´. Këto përemra dallohen nga njëri-tjetri vetëm nga funksioni sintaksor.

(dhanore)... *mue m´*veheni mrapa jó prei mrekuiliisc gi ju paa syri por giçç prei buket..(V.218)

(kallëzore) ..ti *mue* nuk *m´kee* puuçç. (V.205)

Në rasën rrjedhore del në trajtën *mejet* .

...kusc m´ha *mue*, ka jeten *prei mejet*. (V.219)

Në vetën e parë shumës në rasën emërore kemi trajten dialektore *na*.

..me deek prei edjet *na* e ginia jon. (V.63)

Kemi ndeshur përdorimin e këtij përemri në rasën dhanore në trajtën *ne na* ndryshe nga gjuha standard neve na, ndërkohë që nuk ka gjurmë të përdorimit të këtij përemri në rasën kallëzore.

*Ne t´na* apin nrim me jetue (V. 54)

*Ne na* pat bâa bee ai...(V.44)

Rrjedhorja del në dy trajta *nesh* që në të shumtën e rasteve, shoqerohet me parafjalë të ndryshme.

Çoti âsct *prei nesc* (V.77)

Në vetën e dytë njëjës përdoret trajta *ti* në rasën emërore, ndërsa gjatë paradigmes së lakimit në rasën dhanore e kallëzore *ty* dhe në rrjedhore *tejet*.

Po si *ti* masi jee ciudeisc (Vakinat. 190)

...t´apin scpirti em *tγγ* (tyy) bekimin . (V.30)

Nuk t´mastoi *tγγ* (tyy)...(V.146)

...*prei tejet* ka per t´m´arç gnaï gi do t´jeet εotnûes n´Israel...(V.178)

Veta e dytë shumës *ju* nuk ka ndryshim nga gjuha e sotme shqipe.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

*Ju* po do t'mleni pa dielm. (V.43)

Autori nuk dallon për nga forma përdorimin e këtij përemri në rasën dhanore e kallëzore.

...S'juu lóa juu kurr me m'dal para. (V.44)

Rasa rrjedhore ndeshet me dy forma: *juve* dhe *jush*.

...gni niscan i ksai bees gi po vëe *ner miet* mejet e *juve*. (V.23)

...pagia e juei ka per tu sieλ prep *prei jusc*. (V.215)

Përemrat e vetës së tretë njëjës dhe shumës i përdor si në gjuhën e sotme: ai, ajo, ata, ato.

Kurr gni diit i afrohet *ai t'vlaas*... (V. 13)

E *ajó* e bani evλad n'scirt... (V. 55)

*Ata* do τυγ datri t'sckoi un eta giêej (V. 55)

*Ato*, gi iscin barkut Giakobbi, mrapa do eamanit u bane n'vedi... (V. 54)

Në rasën dhanore hasen në përdorim format *atii* për përemrat e gjinisë mashkullore ndërsa në gjininë femërore ndeshen forma *assait*. Theksojmë se autori nuk dallon grafikisht *i* nga *j*. Në këtë rast zanorja e temës *i* te përemri *atii* është e dyfishuar që ka gjasa që -i e dytë mund të jetë një -j.

...e cionia *atii* pescgiesc. (V.44)

...po ju viin *assait* do rescper. (V.36)

Në rasën kallëzore del trajta *atê* e ndërsa në rrjedhore kemi trajtën *prei atii/ assai*.

...e hatron *atê* gi m'ka niis mue. (V.216)

...tremniu *prei atii* e *prei assai* gi munn ju rezighoin scirtin. (V. 216)

Veta e tretë shumës ata/ato del në formën *atyre ju*: Ju ξξa atyne (atyne). (V.228)

Përemri vetor i vetës së tretë shumës pas parafjalë e në rasë rrjedhore përdoret pa a-nistore.

...me ju gieet ner nevooi gi ka pa priit *prei tyne*. (V.258)

Megjithatë shpesh hasen në përdorim edhe format e vjetra të rrjedhores në gjininë mashkullore: pa a-nistore *sinh*, *si*.

...ai vet kiscte mnêi n'kaam per *afër sisc* (*sinh*).

pse iscte gnimenn per tu nnerue *prei sisc*. (V.203)

...e ju sckote per vulnet giξξ si discin *prei si*. (V.180)

E *prei* peemit gi mûer *kunnra si*, ai eotni e ξa n'dor t'cgeletneve. (V. 228)

Ndeshen edhe trajta e shkurtër *i* që bshkohet edhe me format e formës joveprore *u* e cila shkruhet *ju*.

Esau *ju* prue per mos me ja naal... (V.34)

...e engli i εotit *ju* duk prap ânner Sefit. (V.179)

Trajta e bashkuar e përemrit vetor ia (i+e dhe i+i) shkruhen me trajtën *ja*.

Por Eliseu *ja* priti. (V.117)

E Natan *ja* priti. (V.98)

...e per n'mos *ja* pac dertin e tii, ai *prei* vedit giξξmon ka per t'sctγγ. (V.100)

Trajtëne shkurtër e bashkuar me lidhoren (t' +i) autori e shkruan pa apostrof.

...e lutiu *ti* nnregin per s'marit. (V.124)

...e kan per *ti* ξξan i Biri t'Nêeltit. (V. 171)

### **Përemri vetvetor.**

Përemri vetvetor del në format: *vedin*, *vedvedi*, prej *vedit* nën ndikimin e dialektit të gegërishtes. Ndryshe nga pararendësi i tij Radoja, ky autor përdor përemrin vetvetor

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

pa faringalen *h* në trup të fjalës. Më së shumti ku përemër gjendet në rasën kallëzore e rrjedhore.

- ... a i gi e psctet *vedin* n'nnim t'Çotit asct rahat (V. 92)
- ...sctierja duert ner vereã, e mos u trem e higie *prei vedit* (V. 125)
- Giakobbit tui u biinn n'vedvedi...( V. 32)

### Përemri dëftor.

Si përemra dëftore shërbejnë *ky, ai, ajo, ato* me kategoritë gramatikore përkatëse. Po ilustruëm disa shembuj.

- Ai* ciark i sckelzým gi kam vuu ner rëe...(Vakinat. 17)
- ...*ksai* pûn mos me i raa mrapa aspak..(V.27)
- ...po nalen n'kulos t'breghut *atii* ujit. (Vakinat. 40)
- ...t'giçça *ato* çuntii...(Vakinat. 48)
- ...*ato* eotniit e rii t'tiit e mûrne me vedi...(V.37)
- ...*kto* vënn t'ghulun per kateçet viet....(Vakinat. 71)

Ndeshim edhe formën e vjetër të rrjedhores së përemrit dëftor.

- ...po scek ka po dalin *prei asi ujit* sctat loop.(Vakinat. 40)
- ...une jam Raffaele, gneni *asi egnêisc.* ( Vakinat.128)
- ...*dý asi fmisc* i baane misc. ( Vakinat. 71)
- ...kaa per t'u uul deri *aso ditet* gi ka per t'ciue Çoti. ( Vakinat. 112)
- ...t'm'zierrina sa ma par *ksi hapsaniet.* (V.39)

### Përemri pronor.

Dukuri tipike të përdorimit të përemrit pronor në këtë vepër, lidhen me disa forma të veçanta të përemrit të vetës së parë dhe vetës së dytë njëjës të të dyja gjinive im\ime, të cilat dalin në formën *em, eme* ndërsa në rasën kallëzore në trajtën *tem\teme*.

- ...jam n'kabahet kççeu diali *em* David (V.93)
- ...per me ba me u prisc krypa *eme*... (V. 190)
- ...e dona takamin e sctatit *tem* e petkun *tem* (V.97)
- ...Assalonnin *tem* biir mos ma prisni! (V.100)
- T'giçça *kto* dora e Çotit i ka sckrue n'ëmer *teme* (V.101)

Përemri i vetës së parë në rasën dhanore del në trajtat: *mii \ mia*. Ky përemër në gjininë mashkullore përdoret me dyfishimin e zanores *i*, që mendoj se *i* e dytë shënon një *j*.

- ...birue duert *e mia* e kamt *e mia*, kan gneeh t'giççesctnat *e mii* per vedi. (V. 97)
- Kam per t'ja temelue taftin per n'mos u ççeft me i ciart urçnimet *e mia* . (V. 101)

Përemrat e vetës së dytë **yt, jote** tek Babi dallohen në gjininë mashkullore me trajtën **yt** dhe me trajtën e vjetër **jyt** psh:

- Emni *yt* (yt) s'ka per t'keen Giakob. (V.34)
- Rodi *i jyt* (*jyt*) ka per t'keen si pluhuni i toks...(V.32)
- Trajtën e vjetër autori e shoqëron me nyje.

Në rasën kallëzore del në trajtën *tann\e* (tand/e) , *yt*( yt).

- .. e ti Salomon biir, gnife Çotin e babs *yt* (V.101)
- Ne i arç ûu enmikut *tann* epi t'hann (V. 105)
- Une para ja gitsce Çotit uraten *tanne* (V.128)

## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

Përemri pronor i vetës së dytë njëjës në gjininë mashkullore përdoret me nyje të përparme, jo në përdorim me normën e sotme.

Ai baba *i juui* i vietruem n'mot. (V.45)

...pa ju gieet giâa e kegie , tu baba *i juui*..(V.46)

Një dukuri të tillë të shoqërimit me nyje të përparme e gjejmë në disa raste edhe tek përemri i vetës së dytë njëjës të gjinisë femërore: ...po m'ven porosii ghoja *e jote*. (V125).

Përemrat pronorë të vetës së dytë shumës në gjininë mashkullore e femërore dalin me dy forma: tuu/tuei; tuja/ tueia.

...s'ÿve *tuu* une kam me iu mscèhun. (V.14)

...po e liççi me juu e me t'giççi barkt *tuei*. (V.17)

...po pi eçe devevet *tuja* tasc po u nap t'piin...(V.27)

...m'kalzoni se si kien ânrrat *tueia*. (V.39)

Përemrat e vetës së tretë shumës të gjinisë mashkullore e femërore përdoren me mbaresën –a: *e tija, e saja*.

...kiscin zaan per ghraa t'dy bijat *e tija*. (V.24)

...kamt *e saja* prekscin n'tok...(V.32)

Ndeshim të përdorur edhe përemrin *pronor vetvetor e vet*:

...masannei kççi n'Nazaret n'scipi t'vet. ( Vakinat. 72)

E mlueç nipiin *e vet*, e se t'zilin n'vedi e uroi.(Vakinat. 49)

*Pasqyra e përemrit dëftor sipas vetave, numrit dhe gjinisë që pasqyrohen në veprën e Pashko Babit.*

Veta e parë				Veta e dytë			
Njëjës		Shumës		Njëjës		Shumës	
M	F	M	F	M	F	M	F
em	eme	e mii	e mia	yt / jyt	iote /jote	?	tua
?	jon	ton	tona	i juui	juei	Tuu/tuei	Tuja/tueia

Veta e tretë				
Njëjës				Shumës
M		F		M -F
i tii		e tii		e tija
i saj		e saj		e saja
i tyne	?	e tyne	e vet	e tynia
				E veta

### **Përemrat pronorë në bashkëvajtje me emra farefisnie.**

Në vepër dallojmë edhe raste kur autori përdor përemrat pronorë në bashkëvajtje me emrat e farefisnisë.

Përemri i vetës së dytë njëjës, të gjiniisë mashkullore, rasa emërore e jep në trajtën *jÿyt (jyt)*, ndërsa në rasën gjinore në trajtën *tyt (tyt)*.

*Jÿyt aat* na ka vûu gni barr fort t'rânn. (V. 109)

Sefi *jÿyt biir*, fial t'ka ciue. (V.47)

..por ti e konaku i *tyt tet* pse e keni giit n'gnen aan urçnimet e Eotit...(V.115)

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

Shpesh autori përdor edhe përemrin e vetës së dytë të gjinisë mashkullore e femërore në formën *tuu*:

Scpeito, mere fatin tann e dγγ *tuu* bijave. (V.24)

...kgyri a e kan mir pûnen *tuu* vλαæen...(V.36)

### **Përemrat pyetës, lidhor e të pacaktuar.**

Përemri pyetës nuk janë shumë të përdorur në vepër. Autori përdor ligjëratën e drejtë, duke përdorur lloje fjalish dëftore, nxitëse e dëshirore e më pak ato pyetëse. Si rezultat edhe përdorimi i këtyre emrave është i reduktuar. Përdor më shumë përemrat pyetës *kush, çfarë dhe ç'*.

Po *kush* âsct ky Filisteu gi ja baar ghoja me marrue aλajet e Ëotit jets?(Vakinat.89)

*C'far* giajet iscte? ( Vakinat. 70)

Por per *c* 'pun...jee tui ma kuitue t'kegien mu...?( Vakinat. 93)

### **Përemri lidhor.**

Ky përemër me funksion lidhës dhe që shërben për të lidhur gjymtyrë fjalie, përdoret tek Pashko Babi jo rrallë. Zakonisht gjendet përemrat lidhor të caktuar *që ( gi ) , i cili/ e zila*, dhe përemri *kush* që përdoret me vlerën *ai që*.

...kiscte paa mrekuλit t'zilat bani...( V. 79)

Dobi asct urata *gi* perzilet me gninees. ( V. 163)

*Kusc* t'keet εεελ per ligg, t'viin mas mejet. (V. 163)

### **Ndue Bytyçi.**

Në shkrimin e Ndue Bytyçit nga një vjelje tërësore e materialit, kemi nxjerrë përdorimin e këtyre përemrave:

Ky autor përdor shpesh përemrin lidhor *ci ( qi / që)*, përemrin *kush* me funksion përemër lidhor dhe disa përemrat e pacaktuar *kui ( kuj-dikujt)* dhe përemrin *kuscdo( kushdo)* .

### **Përemra lidhorë.**

Si përemër lidhor autori përdor trajtën dialektore *ci (qi)* si dhe përemrin *kush*.

E scain Krisct, e kryc, e Fee

Eξ' at Gak **ci** ( qi – te cilin) ξa për ne; ( ξet urçnimet e Scêites Kisc. 8)

Përemri *kush* përdoret me vlerën *ai i cili* guzon me rrzue, i mjeri.

Kusc ( *kush*) m'e rrzue ghuzon, i mieri!

Kusc ( *kush*) ghuzon insaan me vraa!

Ai ci ( ai qi) vret per asghanni

I hin Ëotit fort ne mnii. (ξet urçnimet e Scêites Kisc 7-8)

### **Përemri e pacaktuar.**

Dallojmë të përdorur përemrat e pacaktuar : , *kui, kuscdo ( kushdo)* .

Me i bâa kui scka s'do me t'bâa

....

Mysafir kuscdo ( *kushdo*) me m'arç .(ξet urçnimet e Scêites Kisc. 11-12)

### **Folja**

#### **Njohuri të përgjithshme. Kategoritë gramatikore.**

Në këtë kapitull do të vështrime sistemin foljor në veprat e shkrimtarëve shkodranë të shekullit të XIX.

“Folje quhet një pjesë e ligjëratës që emërton një veprim si proces dhe që ka kategorinë gramatikore të vetës, numrit, mënyrës, kohës”<sup>135</sup>. Sistemi foljor paraqitet sintetiko-analitik. Format sintetike i ndeshim në kohët: të tashme, të pakryerën, të kryer e thjeshtë dhe me format analitike: në të kryerën, më se të kryerën, të kryerën e tejshkuar, të ardhmen dhe të ardhmen e përparme.

Në veprat gjejmë të përdorura keto trajta foljore, por me një denduri më të madhe përdoren e tashmja, e kryera dhe e ardhmja e dëftores. Përdorim mjaft të shpeshtë kanë edhe format e pashtjelluara. Mbizotëruese janë foljet që përdoren në vetën e tretë njëjës e shumës. Kjo është dhe arsyeja që numri i shembujve ilustrues është më shterues në këtë vetë.

Në klasifikimin e bërë, vetëm foljet e kohës së tashme të mënyrës dëftore i kemi ndarë sipas zgjedhimeve e vetave përkatëse, nisur nga përdorimi i dendur i tyre.

#### **Mënyrat e foljes.**

Një ndër kategoritë që mund ta emërtojmë si më kryesoret në sistemin foljor është kategoria e mënyrës, e cila shpreh modalitetin, thënë ndryshe qëndrimin e folësit ndaj asaj që kumton. Kjo realizohet nëpërmjet një larmie formash të cilat i kundërvihen njëra-tjetrës edhe nga pikëpamja e modalitetit.<sup>136</sup>

Jemi përpjekur që në një mënyrë sa më të kodifikuese të vëmë në dukje disa ndërtime foljore të mënyrave dhe kohëve përkatëse ndeshur në veprat që kemi në studim, si dhe te formave te pashtjelluara të foljeve ilustruar me shembuj nga teksti.

#### **Mënyra dëftore.**

Në mënyrën dëftore folësi e paraqet si të vërtetë veprimin e emërtuar nga folja.<sup>137</sup> Themi se mënyra dëftore me kohët e saj është ndër më prodhimtare në veprat të autorëve shkodranë të shekullit të XIX që ne kemi në studim, duke pohuar se denduria e përdorimeve është e pranishme në tri kohët themelore të kësaj mënyre, në të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen, duke paraqitur kështu dhe një kundërvënie kohore.

Në paraqitjen e kohës së tashmes të mënyrës dëftore, kemi bërë një klasifikim sipas zgjedhimeve dhe vetave përkatëse, përkatësisht folje të zgjedhimit të parë, të zgjedhimit të dytë dhe të zgjedhimit të tretë.

Në zgjedhimi e parë dokumentohen foljet:

- Me temë në zanore përkatësisht –e si punue, rrëfye etj, të cilat në të kryerën e thjeshtë e zërthejnë zanoren fundore të temës në ue.
- Foljet me temë në zanore që nuk zërthejnë mbaresën fundore të temës në tog zanor psh.lai(j), fshii(j).

Folje të zgjedhimit të dytë ku dallojmë:

- Folje që dalin me të njëjtën temë në të tashmen, të kryerën e thjeshtë psh. hap, mbyll.
- Folje të cilat në të kryerën e thjeshtë pësojnë ndërrimin –e në–o-; -a- në –e-; si njof-njef; dal-del.

---

<sup>135</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I Morfologjia, , Tiranë 2002.f.259

<sup>136</sup> Sh.Demiraj , *Morfologjia historike e gjuhës shqipe II*, Tiranë, 1985, f.698.

<sup>137</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë, 2002,f.306



## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

- Folje të tipit përkas që pësojnë ndërrimin e zanores a në e në vetën e dytë e të tretë njëjës në të tashmen e mënyrës dëftore: përket.

Zgjedhimi i tretë ka përfshirë :

- Folje që në të tashmen dalin me temë në zanore: *ze, ve, pii* dhe që në vetën e dytë e të tretë njëjës por edhe në shumës marrin mbaresën –n *zen, ven, piin*.
- Folja *pi* që në dy vetat e para në numrin njëjës të së kryerës së thjeshtë marrin mbaresat vetore –*va, -ve*: piva.

### Foljet e parregullta supletive.

Foljet jam, kam dhe tham që quhen folje të zgjedhimit në –mi<sup>138</sup> kanë një përdorim të dendur në vepër prandaj morën përsipër të paraqesim ndërtimet që kanë këto folje në kohën e tashme të mënyrës dëftore që përdoren sipas vetave përkatësë si më poshtë:

NJËJËS			
Veta I	jam	kam	tham
VetaII,	jee	Kee\kii	thue
Veta III	asct	kaa	Thaa\thot
SHUMËS			
Veta I	jena	Kena\kemi	thona
vetaII	jeni	keni	Nuk dokumentohet
vetaIII	jan	kan	Thon

Në temat e këtyre foljeve vihen re disa dukuri të veçanta, si:

- ❖ Në radhë të parë vihet re metafoia -a > –e në foljet jam e kam në vetën e dytë njëjës dhe në vetën e parë e të dytë shumës.
- ❖ Folja tham në vetën eparë dhe të tretë shumës del në trajtë me zanoren me temë në –o, ( thona, thon).
- ❖ Foljet jam , kam ,tham në vetën e dytë njëjës, dalin me mbaresë zero.

Në parantezë theksojmë se në shkrimin e Bytyçit ,duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me urdhërime të shkruara ,veta më e perdorur është veta e e dytë dhe e tretë njëjës e shumës, personi a personat kujt i drejtohen këto urdhnime.

Më konkretisht po i paraqesim me shembuj përkatës vjelë nga vepra në fjalë.

### **Ëngjell Radoja**

#### Koha e tashme e foljeve të parregullta supletive

Veta e parë njëjës e foljeve ka mbaresën –m, ashtu si përdoret sot në gjuhën shqipe.

...mas Krisctit **kam** ma t’maç divizion m’sc’Joëfin...(D.C. 86)

...kec **kam** prei gninessct.(D.C.113)

...Teneot **jam** i kerscten...( D.C.22)

...tui vuu n’bàaλ doren e djaççt çç**am**( *tham*)...(D.C.19)

<sup>138</sup> Sh.Demiraj, *Morfologjia historike e gjuhës shqipe*, Tiranë,1976,f.47.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

veta e dytë njëjës zakonisht del me temë në *e* (jee/kee/thue) si psh:

...ci *jee* fort i dāsctuni paitori em, m’prúei prei tnimesc...( D.C.88)

...ti *kee* eàkon me i lut Sceitnit.( D.C.85)

Ah medet *žžue(thue)* se sciumizza e nierreve tieter s’mennòn vec se me helmue...(D.C. 133)

...e scka *žžue(thue)* per ata ci vrasin.(D.C. 112)

Por në vepër folja *kam* në vetën e dytë na del e përdorur edhe me temë në *i* (kii).

...o zot *kii* misciriir, na nnighio,na libro...( D.C.85)

Veta e tretë njëjës e foljes *jam* del e përdorur me formën *asct*.

...pse dasctnia *asct* e para ...(D.C .89)

...pse tieter *asct* eoti, e bascka jan sceitni.( D.C85)

....pse dasctnia *asct* e para e gith žuntive...(D.C. 89)

Scka *asct* Urata? (D.C.54)

Në këtë formë del e ndërtuar edhe te dokumentuesit e parë të shqipes së shkruar, Buzuku, Bogdani. Por këto të fundit përdorin edhe formën *ansct* që tek këta autorë nuk ndeshet asnjëherë. Eqerem Çabej në një studim shpjegon se kemi të bëjmë me variante të gegërishtes por me sa duket tek forma *ansct* ka ndodhur procesi fonetik për të shënuar hundorësinë e zanores a, dhe që me kalimin e kohës kemi një rënie të tingullit *n*.<sup>139</sup>

Ndërsa folja *kam* del në formën *kaa Psh*

...por eotyn *kaa* adet hemt’mirat me na i fal...( D.C.85)

...kio fort ran e *kaa* divoeionin.(D.C.77.)

Ashtu sikurse edhe folja *tham* që në këtë vetë del në formën *thaa* por edhe *thot*.

...prannei Kriscti *žžaa(tha)*:...( D.C.133)

...e scpirti Sceitžžot (*thot*): Largoniu prei mejet...(D.C.129)

...por bile si žžot (*thot*) Paali Feja...(D.C. 89)

...per fai t’zilit vien sckannuáti, tha Kriscti (D.C.133)

Veta e dytë shumës e këtyre fojeve në të tashmen e dëftores ndërtohet me mbaresën – ni(jeni\keni) .

...t’na dal eot gžžimòn saa *jeni* giaa...( D.C.76)

... me c’far gikimit gikoni, *keni* m’u’gikue.(D.C.155)

Veta e tretë shumës del me mbaresën –n.

Psè ata *jan* divizioni m’tier Sceiten?( D.C.84)

...psè s’*kan* kurr far t’pereiemit...( D.C.46)

mi baa mir atyne ci na *kan* mni; me lut tyn (D.C.192)

...jeta ci ižžon (*thon*)e sckekuáti...(D.126)

...kto t’kcia jan tri sojesc: jan tunnimet e sebetet ... e jan peemetimet.(D.C.67)

.... N’sceitin sc’Luig ci i žžon(*thon*) mi-emen Giozagha.(D.C.88)

<sup>139</sup> E. Çabej, "Studime gjuhësore", Prishtinë, 1976, f.120.

**Koha e tashme.** Foljet në kohën e tashme të mënyrës dëftore tregojnë një veprim që kryhet në të tashmen dhe përfshin edhe çastin e ligjërit<sup>140</sup>.

Të shohim si paraqiten foljet e kësaj kohe sipas vetave e zgjedhimeve. Në përgjithësi mbaresat e kohës së tashme dalin me mbaresa: *ban*, *kungon*, *maron* (Zgj.I); *merr*, *përket*, *padiss* (Zgj.II); *dii*, *rrii* (Zgj.III).

Ky autor ka shënuar vetën e parë të foljeve në zgjedhimin e parë në formën e thjeshtuar *-j*, të cilën grafikisht e shënojnë me *i*. Përdorimin e foljeve me mbaresën *-j*, e gjejmë në shkrimet e të gjitha periudhave kohore të mëvonshme deri më sot.

Veta e dytë dhe e tretë njëjës e këtyre foljeve merr mbaresa me *-n*.

Veta e parë merr mbaresën *-im*, foljet në vetën e dytë shumës nuk përdoren në këtë kohën, ndërsa veta e tretë merr mbaresën *-in*.

Njëjës			
	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë
Veta e parë	<i>Ba<math>\underline{i}</math></i> \ <i>duroi</i>	Marr (zero)	Dii (zero)
Veta e dytë	<i>Baan</i> \ <i>duron</i>	Merr (zero)	Dii (zero)
Veta e tretë	<i>Baan</i> \ <i>duron</i>	Merr (zero)	Dii (zero)
Shumës			
Veta e parë	<i>Ba<math>\underline{iim}</math></i> \ <i>duroim</i>	<i>marrim</i>	<i>diim</i>
Veta e dytë	Nuk ndeshet	Nuk ndeshet	Nuk ndeshet
Veta e tretë	<i>Ba<math>\underline{ain}</math></i> \ <i>duroin</i>	<i>marrin</i>	<i>diin</i>

**Folje të zgjedhimit të parë të kohës së tashme.**

Foljet që grupohen si të zgjedhimit të parë në *vetën e parë njëjës* dalin me *-i*:

- ...jam i kerscten t'linin e *bai* paa marre. (D.C.22)
- ...e me giçç forz t'scirtit tem *bessoi*... (D.C. 27)
- ...un *bài* kryg ciscutú... (D.C. 19)

**Veta e dytë njëjës** del me mbaresën *-n* që dëshmohet në fojet me temë në zanore por njëkohësisht edhe me mbaresë zero:

- ...acc i maç po *duron*.. (D.C.44)
- ... por m'*kaleon* si *ban* tine kryg? (D.C.190)
- Si e *difton* ti perjascta... ..(D.C.101)

**Veta e tretë njëjës** del me mbaresën *-n*.

- ...ai ci *laan* korpin... (D.C.175)
- ...ai ci *blèn* n'munnet me... (D.C.142)
- ...acc i maç ai po *duron* e na *nnin*..(D.C.33)
- Si e *difton* Kiscia pusctèen e vet... (D.C.37)
- ... c'açrim *kerkon* Eotyn prei nesc? ..(D.C.100)

**Veta e parë shumës** del e ndërtuar me mbaresën *-im*.

---

<sup>140</sup>ASHSH,Gramatika e gjuhës shqipe I,Morfologjia, Tiranë 2002,f.306

Scka *kerkoim* mâ përpara me ktò fial.( D.C.62)  
...prei mnogni s'kec josse e *levdoim* e *nneeroim*...( D.C.54)  
...scka *kerkoim* ma përpara.( D.C.62)  
...me ket fial n'emèn *diftoim* ascicciare,(D.C.123)

Foljet e *vetës së dytë* shumë s nuk i kemi ndeshur të përdorura në vepër.

**Veta e tretë** shumë s del me mbaresën –in. Theksojmë së autori nuk dallon grafikisht *i* nga *j* pasi në sistemin grafik nuk është shënuar kjo bashkëtingëllore si dhe në fund të mbaresës nuk shënon ë-në veçori e disa shkrimeve të kësaj periudhe.

...kto na *msoin* mos me i baa kec. ....(D.C.97)  
...nuk *nnighioin* me i scitì n'menn...(D.C. 140)

### Folje të zgjedhimit të dytë të kohës së tashme.

Foljet e zgjedhimit të dytë shfaqen me temë në bashkëtingëllore dhe në tre vetat e para të njëjësit zakonisht dalin me mbaresë zero. Por në një klasifikim më të detajuar, foljet që i përkasin këtij zgjedhimi mund t'i ndajmë në dy grupe:

a) folje të tipit marr, mbyll, të cilat në të shumtën e rasteve dalin me temë në bashkëtingëllore në tri vetat e njëjësit.

b) foljet shof, dal, flas, etj që në dy vetat e njëjësit të së tashmes së dëftores pësojnë metafoninë o:e ; a:e, pikërisht shef, del, flet, etj

Veta e dytë dhe e tretë njëjës e foljeve të zgjedhimit të dytë, del me mbaresë zero.

Të vetmet tipare dialektore të këtyre foljeve i ndeshim në ndryshimet fonetike që mund të kenë.

### Veta e parë njëjës

Alternimin s/t autori e ka zëvendësuar me dyfishimin e bashkëtingëllores përkatëse.

Po *padiss* vehten...( D.C.208)  
...un nuk *marr* vèsct...(D.C.51)  
...ai ci nuk e *prêt* kuur munnet ...o i *nep* nnim.....( D.C.127)

Folja *nep* në strukturë merr kuptimin e foljes *jap*.

### Veta e dytë njëjës:

...ca kee ci nuk *scef* e s'*del* jasct...(D.C. 116)

### Veta e tretë njëjës

Si në ligjërimin e shkruar të kohës edhe autori e realizon nëpërmjet metafonisë

a > e dukuri që e vëmë re edhe në vetën e tretë njëjës.

...ci kaa fol giççmon e *flet* per goi t'Sceites ...(D.C. 101)

...e ci *scef* e i *del* zot t 'vertets (107)

...ai ci i *merr* nneeren tui i muhue nnogni çunti .(f.113)

E ai ci *vret* nierin eççot: ...(D.C.114)

### Veta e parë shumë s

...*flasim* edhè me gni Bab..(D.C.60)

...me mennue mir se kè *marrim* n'ëmër...(D.C.193)

Siç shihet nga shembulli foljet në vetën e parë shumë s nuk kanë ndonjë dallim nga ligjërimi i sotëm, qoftë i folur apo i shkruar.

### Folje të zgjedhimit të tretë të kohës së tashme.

Në grupin e foljeve të zgjedhimit të tretë, përfshihen ato folje të cilat në tri vetat e njëjësit dalin pa mbaresë vetore, por vihet re se ruhet zanorja e gjatë e cila del si zanore e dyfishuar në të shkruar për të shënuar gjatësinë e vokalit. Njëkohësisht në vetën e dytë e të tretë njëjës ndeshim edhe format di(n), pi(n). Përdorimi i këtyre foljeve në tri vetat e njëjësit pa mbaresë janë përdorur qysh në shkrimet e vjetra si : tek Buzuku, Budi, Bogdani, Kazazi, Matrënga etj, dhe një përdorim të tillë kanë edhe sot. Përsa i përket mbaresës së shumësit -ë nuk shfaqet, pasi ajo shmanget në shkrimet e dialektit gegë.

Që në krye të herës theksojmë se përdorimi i foljeve në zgjedhimin e tretë nuk është shumë i përdorur, prandaj dhe shembujt ilustrues nuk do të jenë të shumtë.

Në veprën e Ëngjëll Radojës folja më e përsorur në zgjedhimin e tretë është folja *di*, gjë që vërtetohet dhe në shembujt e vjelë.

### ***Veta e parë njëjës:***

...une e *dii* se Kiscia s'gabon...( D.C.51)

...nuk *dii* bile m'u ghzue, saa m'perket.(D.C.22)

Në këtë rast zanorja e temës -i është dyfishuar që ka gjasë që i e dytë mund të jetë një -j por që nuk e përdor gegërishtja.

Në vetën e dytë dhe të tretë njëjës vërehet një evolim i autorit për të shkruar këto folje pa mbaresë.

### ***Veta e dytë njëjës:***

...A *di* ti se kusc âsct Ëoty ...a *di* ti nnogni urat tietet per me lutun Zojen?( D.C.7)

### ***Veta e tretë njëjës:***

...ci nyk e *di* mir, ai ban mcat...(D.C. 109)

...Ai nuk *di* scka asct Zotyn.(D.C.114)

### ***Veta e parë shumës:***

...ci nuk i *diim* e na bân t'mëncm...(D.C. 221)

### ***Veta e tretë shumës:***

..ata asctu *piin* giakun e fukaraas.(D.C. 145)

...ce *diin* ata se na i nneeroim...e *diin* pse sciofin...(D.C. 84)

### **Forma joveprore e foljeve në kohën e tashme të mënyrës dëftore.**

Përsa i përket formës joveprore në vepër ndeshet e formuar me mbaresat në vetën e tretë njëjës -(h)et dhe në vetën e tretë shumës-(h)en.

Më poshtë po paraqesim folje të të tre zgjedhimeve të cilat janë ndertuar me keto mbaresa:

Veta e parë dhe veta e dytë njëjës në joveprore nuk përdoren nga Radoja.

### ***Veta e tretë njëjës***

...Ruearia n'saa pies *dahet*?(D.C.81)

...Pse na *vehet* n'pagzim nnogni emen sceitnisct.(D.C.88)

...ci ajo giaa senn ci *premtohet* .(D.C.32)

...ci thue se i perketse i *pertrihet* ai gasmen (D.C.77)

Veta e parë dhe e dytë nuk përdoret në vepër.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

**Veta e tretë shumës** ndertohet me mbaresen –hen

...vec gni pies Ruzariet c'temele *kuitohen*? Si *premtohen* Ruzaria..(D.C.81)


Pse *dnohen* e nuk *scelbohen* ... (D.C. 23)

...atyne per t'zillt *premtohen* o *bahen* posace...(D.C.45)

### **Koha e shkuar.**

### **Koha e pakryer.**

Kjo kohë bën pjesë në kohët e së shkuarës, kuptimi themelor i së cilës është të tregojë një veprim në zhvillim e sipër në një çast të caktuar. *Ne këtë kohë veprimi i shprehur nga folja eshte i përfunduar.*<sup>141</sup> Përdorimi i foljeve në të pakryerën është relativisht i vonë<sup>142</sup> në përdorim në arealin gegë dhe dëshkohet në veprat që kemi në studim me tipin sigmatik të foljet në –mi dhe me tipin asigmatik me –(j)sh<sup>143</sup>, një trajtë e përfutur në gegërisht që dëshkohet tek të gjithë autorët e tjerë të vjetër të veriut. Foljet në të tre zgjedhimet paraqesin të njëjten mbaresë, prandaj po bëjmë klasifikimin vetëm sipas vetave, duke pasur parasysh se jo të gjitha vetat argumentohen nëpërmjet shembujve.



Trajta e imperfektit me –(j)sh, themi se është përfutur, pasi kjo përbën një risi morfologjike që ka ky dialekt. Përdorimi i foljeve në këtë kohë është shumë i reduktuar dhe si rezultat edhe shembujt nuk janë të shumtë.

### ***Veta e dytë njëjës***

Si i *porositshe* Eignllit Rois? (D.C.87)

### ***Veta e tretë njëjës:***

Pse Kriscti ia *premtonte* sc'Pietrit ... (D.C. 43)

...sikunder se dy kiene rrasat n't'zilat Zotyn i *skrote* me ghiset t'vet.(D.C.97)

...mas kriimit t'scekullit *faronte* me uin.(D.C.97)

<sup>141</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë, 2002, f.308.

<sup>142</sup> I.Ajeti, *Historia e gjuhës shqipe*, Prishtinë 1969, f.76.

<sup>143</sup> Po aty, f. 77

### Veta e tretë shumës:

...t'kerscent e moccm nuk *hascin* e nuk *piiscin*...(D.C. 166)

Me gjiçç eemër ia *kusctoiscin* Teneot...(D.C. 172)


...e ci *pritscin* me zeλ t'maç me páamun...(D.C.30)

...gijget e kui *lypscin* e kerkoiscin ... /...kuur scote nner ta eemrat e tyne *pagiohescin* e *biscin* n'faasce *cioscin* zaan nelt.../...per c'arsye t'moccmitt acc fort e *hatroiscin*.(D.C.42)

### Koha e kryer e thjeshtë.

Koha e kryer e thjeshtë tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës.<sup>144</sup> Në të shumtën e rasteve koha e kryer e thjeshtë ndërtohet nga tema e kohës së tashme dhe mbaresa e së kryerës së thjeshtë. Kjo kohë nuk ka një përdorim të dendur në këto vepra, madje themi se lista e shembujve të vjelë sidomos në vetën e parë njëjës dhe shumës janë marrë më shumë nga vepra e Pashko Babit dhe më pak ose fare nga autorët e tjerë. Ndërsa veta e tretë njëjës është produktive tek të gjithë autorët.

Foljet në të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore marrin mbaresat si më poshtë vijon:



Në foljet e zgjedhimit të parë dhe disa folje të zgjedhimit të tretë përfshihen ato folje që i përkasin formës së aoristit asigmatik mes temës së foljes dhe mbaresës, në dy vetat e para të njëjësit, vendoset një tingull antihiatizues –v, por që tek Radoja nuk e kemi ndeshur. Ndërsa në vetën e tretë njëjës marrin mbaresën –i/u. Më konkretisht po ilustruam me shembuj nga veta e tretë njëjës dhe shumës pasi folje në vetën e parë e të dytë njëjës e shumës që nuk ndeshen.

*Veta e parë dhe ë dytë nuk ndeshen në vepër.*

<sup>144</sup>ASHSH,Gramatika e gjuhes shqipel,Morfologjia Tiranë, 2002,f.310.



### Veta e tretë njëjës

...εoti *beekoi* t'sctaten dit.( D.C.116)

...ci *meritoi* m'u baa Reginnesca... (D.C.76)

Pse Kriscti ia *premtoi* sc'Pietrit...(D.C.43)

...sikunner se dy kiene rrasat n't'zilat εotyn i *sckroi* me ghisct t'vet (D.C.97)

...mas kriimit t'scekulit *faroi* me uina ... e mas 392 vietscs *lscoi* prei cielet eiarm.(D.C.138)

...po *lypi* peennessen...(D.C.208)

Folja lind në veten e tretë del në formën leu, me mbaresën –u.

...natën e kscnelavet *lèu* n'Betlem'...( D.C. )


### Veta e tretë shumës.

...e vuune e e *goditne* Bessoimen (D.C.26)

### Kohët e përbëra.

**Koha e kryer.** Kuptimi themelor i kesaj kohe është të tregojë një veprim të përfunduar që nuk i ka këputur lidhjet me çastin e ligjërimit e cila ndërtohet me anë të foljes ndihmëse *kam* në të tashmen e dëftores dhe me pjesoren gege që bart kuptimin leksikor të foljes përkatëse dhe që shërben për të treguar përfundimin e veprimit. *Nuk mund të përcaktohet me saktësi nëse forma analitike e së kryerës është shfaqur paralelisht me menjanimin gradual të së kryerës sintetike, apo pas përzierjes së saj me aoristin.*<sup>145</sup>

Më konkretisht kemi formimet:



Siç shihet dhe në paradigme, kategorinë gramatikore të vetës dhe numrit e shpreh forma vetore e foljes ndihmëse, pasi kjo ndryshon formë gjatë zgjedhimit.

### Veta e parë njëjës:

...i *kam braktiss* mcatet...(D.C.82)

<sup>145</sup> Sh.Demiraj, po aty 2002.f.337.

## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

---

...i kam *zaan* e i kam *sctii* n'menn...(D.C.82)

### **Veta e dytë njëjës:**

...si *kee zaan* ti prei prinve...(D.C.73)

...c' divozion ti *kee marr?* (D.C..80)

**Veta e tretë njëjës:** Siç do të shihet edhe nga ilustrimi i shembujve, foljet në këtë vetë janë të shumta .

...vet e *kaa temelue* n'scekuλ...( D.C.27)

...na e *ka msue*, e na *kaurçnue*...( D.C.5)

...ksctu *kaa fol* për gòoi t'sc'Pietrit.( D.C.42)

pse praa Zotyn *kaa kriue* ...( Dotrina e kerscten , f.22)

...papa i Roms ksctu *kaa fol* per gooi't'sc'Pietrit...(D.C.42)

... se Teneot, ci *kaa fol* gççimon...(D.C.101)

...ci eotyn atyne u *kaa premtue*...(D.C.124)

... pse na *kaa psctue* prei diaλit(D.C.99)

...pse vet eoti na e *kaaa msue*...( D.C.74)

### **Veta e parë shumës:**

Për ndërtimin e kohës së kryer ndeshim dy konstrukte. Autori nuk është konsekuent në përdorimin e foljes ndihmëse pasi e mdeshim në dy trajta ( kena + pjesore dhe kemi + pjesore). Trajta e fundit *kemi + pjesore* përdoret sot në ligjërimin e folur dhe të shkruar. Si edhe në rastet e tjera gjithnjë e dyfishon zanoren e theksuar.Kështu kemi :

...lypim giçç scka *kena nevoi* me jetue...(D.C.64)

...ci na vet i *kemi baa*, por edhe ata ci i *kemi scti* n'menn(D.C.63)

...ci na vet i *kemi baa* po edhe ato...(D.C.68)

### **Veta e tretë shumës:**

Apostuit e krisctit *kan besue e msue*...(D.C.33 )

...e t'keiit ci *kan jetue e kan dek* jasct kiscet....ci *kan lee* n'seekuλ...( D.C.48)

...cistu na *kan msue* print...(D.C.73)

...i *kan braktiss* mcatet...*kan jetue* sceitnisct...(D.C.82)

Ah mdet per ata ci e *kan msue* gojen acc zii(D.C.108)

### **Forma joveprore e foljeve në të kryerën e dëftores.**

Përsa i përket formës joveprore të foljeve në të kryerën e dëftore ndërtuar me foljen gjysmëndihmëse jam dhe me pjesoren e folje p.sh :

### **Veta e parë njëjës:**

...*jam kusctue* Zois me gninue...( D.C.113)

### **Veta e dytë njëjës:**

...ci *jee kriue* n'bark t'Nans sate.../... ti pas gith tierave jee beekue (D.C.74)

### **Veta e tretë njëjës:**

..kusc *asct msue (asht msue)* me baa bee paamenn(D.C.112)

... pse giçç prei mcatit diaλi *asct baa (asht baa)* i perciudscem....(D.C.72)

### **Veta e parë shumës:**

...ci me giçç arsye *jena liçç* (jena lidh) me e dasct plot eemer.( D.C.90)

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

... e nnèer divozione jan e *jena bâa* me giçç t' mirat prei ssi.( D.C.113)  
...e *jena ççirr* prej Zotit...(D.C.92)

### Veta e tretë shumës:

...me bessue gniata senne ci *jan fol* prei sen .. (D.C.43)  
...t'zilen urçnon gith ata ci *jan paghzue(jan pagzue)*...(D.C.37)  
... per pun't'fees *jan basckue* ( jan bashkue) me scioco-scioin...(D.C.45)  
... edhe pse *jan forzue* me bee t'mçaja.(D.C.112)

Shpesh, tek vepra e Radojës, ndeshim edhe inversionin e këtij ndërtimi, ku folja gjysmëndihmëse jam pozicionohet pas pjesores:

...*beekue jee* permii gjith graa..( Dotrina e kerscten .73)

### Koha e kryer e tejskuar.

Kjo kohë e mënyrës dëftore ndërtohet me anë të foljes ndihmëse kam në të kryerën e thjeshtë për diatezën veprorë, dhe me përdorimin e foljes jam në të kryerën e thjeshtë në trajten *qe(kie)* në diatezë joveprorë të foljes që bart veprimin. *Përsa i përket kuptimit kjo kohë është sinonime me më së të kryerën , por më se e kryera përdoret më dendur.*<sup>146</sup>. Ka një përdorim të kufizuar.

Koha e kryer e tejskuar e  
deftores

Foljet ndihmëse kam, jam  
në të kryerën e thjeshtë

pjesore

pat

kie

forzue  
than

Këtë kohë të ndërtuar me foljen ndihmëse dhe më pjesore, autori e ka përdorur më së shumti foljet në formën joveprorë edhe kur folja kam del ne kuptimin e saj të plotë. Në të dy rastet përdoret folja pa *-i*, *pat* jo *pati*.

...ci ajo s'*pat* kurr nnogni far mcatit.(D.C.76)  
...pse ky n' scekul e *pat* baft edhe me dek.(D.C.86)  
...tui vieç pakizz *pat* Mennen me vieç scium.(D.C.146)

Veta e tretë njëjës.

<sup>146</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipeI,Morfologjia, Tiranë, 2002,f.314.

*Pat forzue* edhe ma teper n'sceiten Fee.(D.C.31)

...sikurse ú *pat than* e mass nnër ato dit i *pat forzue* edhe mâ tepër n'scèiten fee...(D.C.31)

### **Koha e ardhme.**

*Kuptimi themelor i të gjitha kohëve të së ardhmes të së shkuarës është të tregojë një veprim që pritet të kryhet pas çastit të ligjërimit*<sup>147</sup>.

Kjo identifikohet si një kohë analitike që përcakton të njëjtin funksion kohor , por që ndryshon për nga modaliteti. Në vepra, si ndërtim i kohës së ardhme përdoret me një denduri më të madhe e ardhmja e formuar:

*me formën e ngurosur do dhe me të tashmen e mënyrës lidhore.*

...ai nuk *do t'gaboin* n'essape...(D.C.45)

...Scka praa *do t'kerkoim* prej εotit...( D.C.56.)

*të tashmen e dëftores të ndihmëses kam dhe me paskajore*

...Përsërii *kaa me ardhun* prej Cielet...( D.C.31)

...ai *kaa me na nnighue*...( D.C.57)

### **E ardhmja e përparme përdoret me dy trajta foljore:**

*Formë e ngurosur due(do) dhe me infinitivin e foljes tjetër.*

...*due me ççan*, kurr taman se ke dit...(D.C.43)

...scka *do me ççan* ajo fial...scium sënne *s'do me na i ççan*...( D.C.84)

*Ndërtimi kam dhe forma e paskajores për të baam*

...*kam për t'ken t'giçç* ditën jasct...(D.C.47)

### **Mënyra habitore.**

*Në gramatikën e gjuhës shqipe*<sup>148</sup> jepet përkufizimi që mënyra habitore bashkë me mënyrën dëftore shpreh modalitetin e vërtetësisë, por edhe ndjenjën e habitës.

Sh.Demiraj jep përkufizimin: “Përmes formave foljore të mënyrës habitore shprehet kryesisht habia e folësit për një veprim a gjëndje të papritur që është kryer në të kaluarën, ose që është në proces të zhvillimit në çastin e ligjërimit.”<sup>149</sup>

*Folësi nëpërmjet kësaj mënyre shpreh një qëndrim ironizues, mosmiratues, kundërshtues të folësit*<sup>150</sup>.

Mbështetur në këto dy përkufizime lind pyetja: Kjo mënyrë a ekziston si mënyrë më vete apo jo?

Si Demiraj ashtu dhe K.Cipo<sup>151</sup> e pranojnë mënyrën habitore si mënyrë më vete. Ndërsa E.Lafe e trajton duke pohuar se “...zgjidhja më e mirë do të ishte të flitej për trajta habitore te disa kohë të mënyrës dëftore, lidhore e kushtore.”<sup>152</sup>

Por, në vazhdimësi të përkufizimeve, qëndron edhe përkufizimi i Dozonit, sipas të cilit, trajtat e habitores formohen nga pjesorja e shkurtuar dhe prapavendosja e foljes ndihmëse kam. “*Forma foljore e habitores ka një strukturë të anasjelltë: derisa format foljore të dëftores në kohën e kryer formohen me foljen ndihmëse para*

<sup>147</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I,Morfologjia, Tiranë 2002, f.316

<sup>148</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë 2002,f. 318.

<sup>149</sup> Sh.Demiraj, vep.cit.f.146.

<sup>150</sup> Sh.Demiraj,vep.cit.Tiranë 1986.f. 509

<sup>151</sup> K.Cipo, *Gramatika e gjuhës shqipe*, Tiranë.1949.f.118-119

<sup>152</sup> E.Lafe, *Mbi habitoren dhe disa trajta të saj*,SF.2.1975.f.151

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

*pjesores së foljes që mbart veprimin psh kam punue, format foljore të habitores ndërtohen duke iu paravënë pjesores së shkurtuar.*<sup>153</sup>

Përdorimi i foljeve në mënyrën lidhore është present që tek vepra e Buzukut, duke vërtetuar lashtësinë e përdorimit të saj. Demiraj, për këtë çështje shkon dhe më larg duke theksuar se *trajtat e habitores e kanë zanafillën para botimit të veprës së Buzukut.*<sup>154</sup>

Në vepër paraqiten format foljore të përdorura kryesisht në kohën e tashme ( paskam, qenkam, hapkam etj) dhe në të kryrën (paskam ardhur, paske marr’). Kurse dy kohët e tjera kanë një përdorim shumë të rrallë, ose nuk përdoren fare.

### Koha e tashme.

Kjo kohë e mënyrës habitore del e ndertuar nga prapangjitja e pjesores së shkurtuar të foljes dhe formave vetore të së tashmes së ndihmëses *kam*.

...ti mir i *zanke* e i *sctike* n’menn punt e Fees.(D.C.49)

...t’zilt raał bain been ne dreit *kenkan* n’rezit m’u bier me scpirt.(D.C.110)

### Mënyra kushtore

Mënyra kushtore shpreh modalitetine mundësisë. Veprimi në këtë mënyrë mund të kryhet vetëm nëse plotësohet një kusht i caktuar. Në veprat e autorëve shkodranë të shekullit XIX, kjo mënyrë kryesisht është shprehur me dy kohë përkatësisht koha: e tashme dhe të pakryerën. Folje në të kryerën dhe më së të kryerën nuk kemi ndeshur.

### Koha e tashme.

E tashmja e kushtores (homonime me të ardhmen e së shkuarës), ndërtohet nga e pakryera e foljes ndihmëse *kam* dhe paskajorja e foljes themelore.

Mos me ken Zotyn me nee me hiir t’vet, t’kuive *kiscim me ken?* (D.C.63)


...*kiscite me ken* mcat mortar.(D.C. 123)

...e ma i maç*kiscite me ken* mcati i tii perpara.(D.C.13)

### Mënyra lidhore.

Mënyra lidhore shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por ka raste kur ajo mund të shprehë edhe modalitetin e dëshirës apo të detyrimit. *Mënyra lidhore ka dy kohë themelore: të tashmen dhe të shkuarën, ku e shkuara ka tri nëndarje: të pakryerën, të kryerën, më së të kryerën.*<sup>155</sup>

Këto forma kohore të mënyrës lidhore kanë të paravendosur formantin –t’, ku siç vihet re apostrofohet. Ashtu sikurse në arealin gegë, zanorja *ë* nuk përdoret në këtë pozicion.



<sup>153</sup>A. Dozoni, *Manuel de la langue chkiqë au albanaise*, 1878.f.226 ( cituar sipas studimit të Sh. Demiraj, *Haborja dhe mosha e saj*, SF 3, 1971. f.33.)

<sup>154</sup> Sh.Demiraj, *vep.cit.* Tiranë. 1971.f. 147.

<sup>155</sup>ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë, 2002,f.320.

### Foljet e parregullta në mënyrën lidhore.

Foljet jam, kam, thom në të tashmen e lidhore janë të dallueshme nga trajtat e dëftores nëpërmjet pjesëzës –të. Karakteristikë e foljeve jam, kam në këtë trajtë kohore është se dalin me temë në –e (jee-kee-), ndërsa folja thot shoqërohet me trajtë të shkutër të përemrit vetor : *t'i ççoot (t'i thot), t'a ççon (t'a thon)*.

Po ilustruam vetëm disa shembuj:

**(jam)** ... me mnogni t'urt, t'knuescem ci t'jeet i zoti me e citt n'rugh.(Doctrina e kerscten.f.144)

... kaa urçnue me çan si t'jeet adeti..(D.C.171)

...nnonse t'jeen plecc t'mmetun, t'lig e t'vorfen.(D.C.121)

...saa t'jeen nnen kyccm t'atynve me i-a-u baa vuλnetin.(D.C.122)

...pse t'gjiççt'jena t'vorfen.(D.C.67)

...giççmon saa t'jena giaλ ... (D.C.76)

**(kam)** ...e mos t'keen me sse m'u mmait.(D.C.123)

...per meritimet e tynve t'keet t'çimtum mii nee...(D.C.86)

**(thom)** ...ai ci t'i ççoot sciocit i marr..(D.C.155)

...atynve ci t'a ççon me divozion.(D.C.82)

...ci t'ççohet per gaε,por paa t'kecie t'kurkui; rrena ci t'ççohet per me i baa mir sciocit...rrena ci ççohet per me i baa kec scocit.(D.C.151)

### Koha e tashme.

*Kuptimi themelor i kesaj kohe eshte te tregoje nje veprim, kryerjen e te cilit folësi e paraqet si të mundshëm a të dëshirueshëm.*<sup>156</sup>

Format foljore të kohës së tashme të lidhore janë të njëjta me temën e së tashmes së dëftores. Gjatë paradigmës së zgjedhimit vihet re edhe disa ndryshime si:

Në veten e dytë e të tretë njëjës, mbaresat janë të ndryshme nga e tashmja e dëftores, duke marrë mbaresat –sh, -j.

Foljet e zgjedhimit të dytë, gjatë paradigmës, dalin pa ndryshime në temë si: t'dal, t'dalim etj.

Dy vetat shumësit ( veta e parë dhe veta e tretë) të zgjedhimit të dytë dalin me mbaresat –im,-in lypim, guzoim.

Këto folje përdoren edhe të shoqëruara me trajta të shkurta të përemrit vetor dhe me foljet modale mund, duhet.

### Veta e parë njëjës.

...por edhe ke t'sciof ( t'shof)se si kaa baa...(D.C.94)

Une po t'εbloi (t'zbloj) giçç far hainasc.(D.C.141)

### Veta e dytë njëjës:

...ci ti mos t'gaboisc ( t'gaboish) mi perzie me ta.(D.C.141)

### Veta e tretë njëjës:

...ci mos t'i sckoin (t'shkoin) paa mos m'u ul n'dyγ ghiuit... /...ather kuur t'mrrin me diit essapet e sceites Sakramenn? (D.C.189)

### Veta e parë shumës:

... ci t'i lypim me arsye...(D.C.56)

<sup>156</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I,Morfologjia, Tiranë,2002,f.321.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

...ci ta kuitoim per dit t'miscnuemit t'Krisctit.(D.C.79)  
... mos t'baim nnogni giaa-senn...(D.C.103)  
...per hater t'sceitneve t'zilt do ci na t'i nneeroim.(D.C.86)  
...ci mos guzoim me marr giaan e huei..(D.C.140)  
: ..e ma kolai mun t'i zierrim prei Zotit ato senne...(D.C. 73)  
...sc'Joef, e sceita Mrii, t'm'dal scpirti nner duer tuja.(D.C.87)

### ***Veta e tretë shumës:***

Si mos t'guzoin me ačrue...(D.C.102)  
...ci gith niereit ci jan n'scekuł t'a gniofin ( t'a njofin), t'a duun, t'ačroi (t'adhroj) e t'i scerbein ( t'i sherbejn) sikurse meriton.(D.C.62)

### **Forma joveprore**

Në veprën e Radojës ndeshim formime të tilla të formës joveprore:

...ci gičč i zili t'i lutet posace atii Sceitit ci baar emnin e t'munnohet me i perghiaame vepra t'mira.(D.C. 88)  
...s'munnet me kerkue, ci t'i paguhet ajo e mir.(D.C.143)  
...pse kto tri Sakramenne s'mun t'merren ma gni her?  
...prei mesnatet deri ci t'merret kunghimi.(D.C.193)  
...perpara se t'kungohetscka do t'bain?(D.C.189)  
...ci perpara t'kungohenado t't'rrim m'gni far kohet tui kuitue...(D.C.193)  
...tuk t'merret sceitia partikuł scka asct per t'u baa?(D.C.194)  
...nderi ci t'ruhena paa i fye me nnogni mcat mortar.(D.C.196)  
...por perpara se te t'mennohenmcatet o t'bahetnnogni tieter pun e nevoiseme...(D.C.197)

### **Kohërt ë përbëra të mënyrës lidhore.**

Përsa i përket përdorimit të kohëve të përbëra, është shumë më i reduktuar. Veta më e përdorur në këtë rast është veta e tretë njëjës dhe shumës, gjë që do ta shohim edhe nëpërmjet shembujve ilustrues.

### **Koha e kryer.**

Edhe e kryera, ashtu si format e tjera foljore të mënyrës lidhore, ndryshon nga e pakryera e dëftores nëpërmjet përdorimit të pjesëzës t', por njëkohësisht vihet re edhe dukuria e metafonisë që ndodh tek foljet ndihmëse si: t'kem meritue, t'jem baa etj. Kjo kohe deshmohej ne shume pak folje.

Veta e tretë njëjës

...t'a keet meritue me vepra t'veta.(D.C..31)

### **Mënyra dëshirore.**

Mënyra dëshirore është një nga mënyrat e foljes, që paraqitet me trajta të posaçme foljore, dhe ku folësi shpreh një dëshirë në formë urimi a mallkimi. Koha e tashme e mënyrës dëshirore formohet duke i shtuar temës së foljes mbaresat –a; zero; -t; im; -i;-in. Si temë e foljes shërben tema e së kryerës së thjeshtë ose pjesorja që marrin përkatësisht prapashtesat: -fsh, -sh, -ç.

Koha e kryer e dëshirores është një trajtë analitike që shpreh dëshirën e folësit në formë urimi a mallkimi në kohën e shkuar. Formohet nga e tashmja e dëshirores së foljeve ndihmëse dhe nga pjesorja e foljeve. Shpesh kjo formë dëshirore përdoret edhe me inversion në kohën analitike.

...mos kioft çčan e kaa mnii Teneot.(D.C102)



## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

---

..Ma<sup>1</sup>kie kioft kusc setie kec. (D.C.152)

Zoti e largoft! ( D.C.178)

### **Mënyra urdhërore.**

*Mënyra urdhërore përdoret për të shprehur modalitetin e dëshirës në formë urdhri, këshille, dëshire, porosie etj.*<sup>157</sup> E veçanta e kësaj mënyre është që nuk mund të krijojë kundërvënie kohore, kështu që foljet në këtë kohë nuk kanë kategorinë gramatikore të kohës.

Mënyra urdhërore ka formë gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës. Ato kanë të njëjtën formë si veta e dytë njëjës e shumës e së tashmes së dëftores, por në këto vepra trajtat foljore dalin pa mbaresë, mëso,lexo,rrëfe ose me mbaresë –ni msoni,lexoni rrefeni etj.

Duke u mbështetur tek Gramatika e gjuhës shqipe mund të dallojmë dhe të bëjmë një klasifikim të këtyre foljeve:

Folje të zgjedhimit të parë që dalin me temë në –o-, -e- , -i-, pa mbaresë si: meso, rrëfe, pi, por dhe mbaresë –ni.

*Nneero Print e tuu, n’do me jetue scium permi çee...mos lakmo, as mos scikio per t’kec nierin e huei...mos lakmo kurr nnogni kafsc t’huei...(D.C.95)*

Folje të zgjedhimit të dytë ku përfshihen edhe ato folje të cilat në vetën e dytë njëjës të urdhërores pësojnë ndërrime –e në –i. psh. dal-del; marr-merr;mbjell-mbill; etj

*Mos merr Emnin e Tenzot nne per goi... \ ...mos viç e mos kussro....( D.C.95)*

### **Pashko Babi**

#### **Foljet e parregullta në kohën e tashme.**

NJËJËS			
Veta I	jam	kam	tham
VetaII,	jee	Kee	thue
Veta III	asct	kaa	thot
SHUMËS			
Veta I	jena	Kena\kemi	thona

<sup>157</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002,f.330.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

vetaII	jeni	keni	Nuk dokumentohet
vetaIII	jan	kan	Thon

**Veta e parë.** njëjës e foljeve ka mbaresën –m.  
 ...nuk *jam* une Kriscti por ai...(Vakinat . 182)  
 ...une *jam* buka e giaλ , gi *kam* zdryçp prei cielet.(Vakinat .218)  
 ...e heiri i parris gi *kam*, mannei scka m'duhet(Vakinat. 28)  
 ...ci *jam* i eoti me i çan gevap.(Vakinat.51)  
 ...tasc une po ju ççam:(Vakinat..101)

**Veta e dytë** njëjës del me temë në *e* (jee/kee/ thue) si psh:  
 A *jee* ti ai veet gi do t'viin...(Vakinat .203)  
 eotnii ti nuk *kee* me scka muusch e pusi asct...(Vakinat f.190)  
 ...e *kee* edhe eemren tanne.(Vakinat f.198)  
 ...pse ti pluhun *jee*, e pluhun prep *kee* per tu kççye.( Vakinat .12)  
 ...permasi ti *jee* gni ghrue sceitnesc. (Vakinat.137)  
 ...ti *kee* per ta gieet.(Vakinat f. 101)  
 Mire po ççue( *thue*). (Vakinat.113)

**Veta e tretë njëjës** e foljes *jam, kam, tham* dalin të përdorura me format ka, asct (*asht*), thot.  
 ...*asct* reginia cieλve...(Vakinat . 211)  
 ... o ghrue e maçe *asct* feja jote! (Vakinat . 223)  
 ...ta dini ju se biri nierit *kaa* puscteden me fool...(Vakinat.195)  
 ...une me bee po ju zehem, ççot (thot)Eoti...(V.71)

**Veta e parë shumës** del me mbaresën –na(jena\kena),karakteristikë e dialektit gegë,  
 por folja kam del edhe në formën *kemi*.Folja *them* del në trajtën *thona*.  
 ...pse *jena* vλaenii ner vedi. (Vakinat. 21)  
 ...gnimenn na *kena* haλ pak, por giççmon *kena* per t'keen t'pasun.(Vakinat..125)  
 Scka *kemi* per t'hanger...(Vakinat .199)  
 ... nuk *kemi* pse binneni per ket pun (Vakinat . 207)

**Veta e dytë shumës** e këtyre fojeve në të tashmen e dëftores ndërtohet me mbaresën –  
 ni(jeni\keni) psh  
 ... vλazen , kah *jeni*? (Vakinat. f. 32)  
 A nuk *jeni* ju scum ma t'miir? (Vakinat f. 199)  
 ... ani Aati i juei e di se *jeni* n'idizaa t'tyne...(Vakinat f.200)  
 ...por scikioni me sa kyvet *keni*.(Vakinat.f.198)

**Veta e tretë shumës** del me mbaresën –n.  
 ... perse kto *jan* kahret e t'pafëve.(Vakinat f.199)  
 ...ato gi do t'korrin *jan* t'marr. (Vakinat f. 211)  
 ...e scka *kan* mçanii per paas e per paansi...(Vakinat f.183)  
 ...nuk *kan* ma vên.(Vakinat f.184)  
 ...i afrohen hysmegiart e vet e i ççon: (Vakinat.f.117)  
 Po i ççon ata: Prei Aran! ( Vakinat. 32)  
 Siç del edhe nga shembujt e sipërshënuar, në vepër këto folje të zgjedhimit në –mi,  
 me përjashtim të ndonjë rasti të rrallë, kanë ruajtur në veta të ndryshme formën ashtu  
 siç përdoret tek autori pararendës Radoja dhe si përdoret sot në dialektin gegërishtes.

## **Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX**

### **Koha e tashme.**

Tregon kryerjen e veprimit duke përfshirë edhe çastin e ligjërimit. Kemi paraqitjen e kohëve sipas zgjedhimeve:

Foljet e zgjedhimit të parë marrin mbaresat *-j* ( që shënohet me grafinë *i* ) , *-n*, *-n*. Foljet e zgjedhimit të dytë e të tretë në tri vetat e njëjës dalin me mbaresë zero. Veta e parë shumës merr mbaresën *-im*, veta e dytë e zgjedhimit të parë e të dytë merr mbaresën *-ni*, ndërsa veta e tretë shumës del me mbaresën *-in*.

Njëjës			
	Zgjedhimi i parë	Zgjedhimi i dytë	Zgjedhimi i tretë
Veta e parë	Bai \ <i>punoi</i>	Marr (zero)	Dii (zero)
Veta e dytë	Baan \ <i>duron</i>	Merr (zero)	Dii (zero)
Veta e tretë	Baan \ <i>duron</i>	Merr (zero)	Dii (zero)
Shumës			
Veta e parë	Baiim \ <i>duroim</i>	marrim	diim
Veta e dytë	-ni.	-ni	Nuk dokumentohet
Veta e tretë	Baain \ <i>duroin</i>	marrin	diin

### **Folje të zgjedhimit të parë të kohë së tashme.**

Foljet që grupohen si të zgjedhimit të parë në **vetën e parë njëjës** dalin me *-j* (-i):

...ati em deri me tasc punon, e eçe un *punoi* (Vakinat. 201)

...ather i çësai: un po *besoi*. (Vakinat.236)

**Veta e dytë njëjës** del me mbaresën *-n* që dëshmohet në fojet me temë në zanore por njëkohësisht edhe me mbaresë zero:

...e muer mnera e briti: Cotni ti po *lscion* n'muâ. ( Vakinat.112)

... gi ti *hîin* prei deret âsct... (Vakinat. 231)

...a *beson* ti n't'Brin e Cotit? (Vakinat.235)

**Veta e tretë njëjës** del me mbaresën *-n*.

Abrami *hatron* e don ma par... (Vakinat, f.21)

...se e kegia haÿit ton nuk *pescon* ag raan sa e kegia e mkateve tona. (Vakinat, f. 137)

... Zani i giakut tann vÿaa prei toket tuk une *kërkon* e lÿp ...kac *pescion* râann mkati em... (Vakinat.13)

Abrami *hatrôn* e dôn ma par... (Vakinat.25)

...por *kalon* me dije dijetart... (Vakinat.104)

...e ai ja *scperbylen* t'miren (Vakinat.105)

... e trupin t'pa krye e *rzôn* per took (Vakinat. 138)

... po ky kie sctri e nuk e *lâan* ... (Vakinat.222)

**Veta e parë shumës** del e ndërtuar me mbaresën *-im*.

Po i *baim* ktu trii plagne. (V. 222)

**Veta e dytë shumës** del me mbaresën *-ni*.

...ne paci menne tieter, prep ma *bisedoni*, munn ta mârr gni âan o ne diaççt o ne errmait. ( V.28)

Sckoni tu Sefi, e giçç si t'ju ççon gnascûtû *punoni*. (V.42)

**Veta e tretë shumës** del me mbaresën –in. Si një dukuri e gegërishtes edhe tek kjo mbaresë zanorja ë në pozicion fundor ka rënë, ashtu si dhe tek autorët e tjerë.

...ma ato gi *punoin* pa scerr (V. f. 104)

...e *laghoin* prei vedit...(V.126)

..e ato gi e *avroin* n'scirt...(V.190)

.. mos ti *skoin* kuui mennia kin se kam arç...(V.197)

...ma ato gi *punoin* pa scerr i ka n'hater.(V.104)

### **Folje të zgjedhimit të dytë të kohës së tashme.**

Në foljet e zgjedhimit të dytë që shfaqen me temë në bashkëtingëllore dhe në tre vetat e para të njëjësit zakonisht dalin me mbaresë zero ndeshim folje te tipit mbledh, mbush, korr etj, të cilat në të shumtën e rasteve dalin me temë në bashkëtingëllore në tri vetat e njëjësit si dhe foljet të tipit dal, marr, etj që në dy vetat e njëjësit të së tashmes së dëftores pësojnë metafoninë o:e ; a:e, pikërisht del, merr, etj

Të shohim si paraqiten foljet e kësaj kohe sipas vetave .

### **Veta e parë njëjës.**

Un jam gi me tyq po *flas*...(V.191)

...gnisctu tasc po *marr* e bai...(V.237)

### **Veta e dytë njëjës:**

... gien jeten e pasosune e ti nuk *del* n'giyyq...(V. 201)

...merr ciâten e scigietve, e arkun e *del*. ( V. 30)

### **Veta e tretë njëjës**

...tietri *del* para e ulet mren.(V.206)

...tietri *del* para ...e *ççret* ( *thret*) gnenin hysmegiarsch vet (V.234)

...e e *mijeçç* (mjedh) n'ar t'vet. (V.211)

... e ai per emen i *ççret* (thret) delet e veta...delet i *treèt* gni e nuk e len...(V.232)

### **Veta e parë shumës**

*Dalim* n'breg t'anneiscem...(V.212)

### **Veta e dytë shumës.**

Scghulniu e *delni* ktei, pse *Ëoti* ka per ta huup ket sceher. (V. 24)

### **Veta e tretë shumës:**

...as nuk *mieçin* , as nuk *korrin* as nuk *muscin* hamart..(V.199)

### **Folje të zgjedhimit të tretë të kohës së tashme.**

Që në krye të herës theksojmë se përdorimi i foljeve në zgjedhimin e tretë nuk është shumë i përdorur, prandaj dhe shembujt ilustrues nuk do të jenë të shumtë. Dallojmë rastet:

### **Veta e parë njëjës:**

...e *dii* se Mesia ka per t'arç.(V.191)

### **Veta e dytë njëjës:**

Ti e *dii* se Mesia ka per t'arç...(V.191)

### **Veta e parë shumës:**

E *diim* se ky asct diali i jon.(V.235)

**Veta e dytë shumë:**

...se ju gjaa nuk *dini* se ka vien ai.(V.235)  
...u scuitue gi nuk e *dini* ju.(V.191)

**Forma joveprore e foljeve në kohën e tashme të mënyrës dëftore.**

Përsa i përket formës joveprore në vepër ndeshet e formuar me mbaresat si të mbarë shqipes në vetën e parë dhe të tretë njëjës –(h)em ; -(h)et dhe në vetën e tretë shumësh(h)en.

Folje të zgjedhimit të parë të kohës së tashme.

Më poshtë po paraqesim folje të të tre zgjedhimeve të cilat janë ndertuar me keto mbaresa:

**Zgjedhimi i parë.**

**Veta e parë njëjës** ndërtohet me mbaresën *-hem*

Del e ndertuar me mbaresen – (h)em

Une po *largohem* ne errmaiten...(V. 44)

Une *betohem* n’Zotin...(V.138)

...ani ma kuur ti *afrohem* une...(V. 200)

**Veta e tretë njëjës** ndërtohet me mbaresën *-het*

...prei Zotit anner i *diftohet* e i tha:...(V. 174)

...po puna e Zotit nuk munn *rezighohet* prei nietit zii.(V.179)

...ju del per syfri t’githave bariscteve e *bahet* lande.(V.191)

...Simoni gi *emnohet* Zelote.(V.231)

...e para rrenimit *rritet* fort mennia.(V.104)

**Veta e tretë shumë** ndërtohet me mbaresën *-hen*

...se ju *pusctohen* scpirtnat.(V.229)

...Gnato i ka die*li* n’hygiym gi kuur *martohen*...(V.126)

...Discepuit prei eanit ghusctimit e drojet i *afrohen*.(V.212)

...t’gherbulunit po *pastrohen*, t’dekunit po gna*len*...(V.203)

...scum fial nuk *bahen* pa mkat.(V.104)

...me ket mnii n’eemer i *afrohen* hysmegiart...(V.117)

**Zgjedhimi i dytë.**

Foljet e zgjedhimit të dytë ndeshen vetëm në vetën e tretë njëjës e shumë.

**Veta e tretë njëjës.**

Haini nuk *niset* per me vieceç...(V.231)

...e para rrenimit *rritet* fort...(V.104)

...del para e *ulet*mrenn.(V.200)

...gith scenn e ghizm *nisete* scet scka t’keit gjaa...(V.211)

**Veta e tretë shumë.**

...pra nuk *kapen* per kto made fmija.(V.225)

...e *tresin* Zotin prei mennimesc veet.(V.126)

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

...e po *iluten* gnasctu si iscte...(V.128)  
...e si ti *zierrin* jasct delet e veta.(V. 231)

### Zgjedhimit të tretë.

Edhe foljet e zgjedhimit të tretë ndeshen vetëm në vetën e tretë njëjës e shumës. Shembuj janë shumë të paktë si më poshtë vijon:

### Veta e tretë njëjës.

Babi: ...e i pa gnoftun *rritet* Kriscti n'mot...(V.179)

E tashmja me pjesëzën po.

Krahas faktit që koha e tashme e mënyrës dëftore dokumentohet në vepër me mbaresat përkatëse të trajtuara më sipër, shpesh atë e ndeshim të shoqëruar me pjesëzën *po*, që paraqet *veprim të çastit në kuptimin që vijon të kryhet në çastin e ligjërimin* psh:


Ato *po filloin* ...e *po bisedoin* ner vedi...(V.44)  
...une *po des* prei ujet, e *po maroi*.(V. 29)

### Koha e shkuar.

#### Koha e pakryer.

E pakryera si kohë e së shkuarës paraqitet me mbaresat që i përkasin gegërishtes e konkretisht: *-jsha, -jshe, -(n)te, -shim, -jshi, -shin*.

Në të pakryerën, vetën e tretë njëjës Babi edhe në ato folje që në të pakryerën dalin me s/t në vepër marrin mbaresën tt ( pritte)



### Veta e dytë njëjës

...kuur ti e *thoisce* uraten...e dekunit i *vorroisce*.(V.128)

### Veta e tretë njëjës:

Nuk *dite* Sefi giaa alaa se si..(V.174)

....Erodit i ghiatei fort ajo diit gi *pritte* me paa Magit...(V.178)

...e se i zili *merrte* deri n'dyq e n'trii t'gni soi maset...(V.186)

### Veta e tretë shumës:

...e naten *rriscin* e *ruiscin* vaççnat e veta...e iççoiscin emnit Simeone...(V.175)

...e t'mirat e Zotit i *daiscin* n'nnierzii t'tii ...Per gith vieet Mria e Sefi *scoiscinn*'Ruzalem.(V.179)

### Forma joveprore në kohën e pakryer të mënyrës dëftore.

Përsa i përket formës joveprore në vepër kanë një përdorim shumë të rrallë, konkretisht përdoret vetëm veta e tretë njëjës-(h)ei, dhe shumës -(h)eshin tek Babi.

### Veta e trete njëjës:

...ai soi turpiti syqve tyne nuk iu *zblohei*.(V.11)

...fillote me raa n't'miir prep *kççehei* n'menne t'par...(V.58)

...e vooit n'Saraje t'Faraonit e *ççahei* e *bisedohei*.(V.48)

...emra e tii *rrenohei* e ma par dote...(V.55)

### Veta e trete shumës:

...gi *bahescin* sebep prei Zotit...(V. 145)

...gi deght *lscohescin*per tooq.(V.9)

### Koha e kryer e thjeshtë.


Koha e kryer e thjeshtë tregon një veprim të përfunduar në një çast të caktuar të së shkuarës.<sup>158</sup>

Në foljet e zgjedhimit të parë dhe disa folje të zgjedhimit të tretë përfshihen ato folje që i përkasin formës së aoristit asigmatik mes temës së foljes dhe mbaresës, në dy vetat e para të njëjësit, vendoset një tingull antihiatizues –v. Ndërsa në vetën e tretë njëjës marrin mbaresën –i/-u.

Në vetën e tretë, disa folje të parregullta marrin mbaresën –*shë*: *thashë*, *pashë*.

Folja *marr* në të kryerën e thjeshtë del në trajtën *muer* dhe jo *mori*.

...e muer e pveti per vulnet. (V.109)



<sup>158</sup>ASHSH,Gramatika e gjuhes shqipel,Morfologjia Tiranë,2002,f.310.



Më konkretisht po ilustruam me shembujt:

### **Veta e parë njëjës.**

Une *kuitova* se ai tasc po ciolet...(V.117)

...si kuur *kççeva* e per sa zuna veen...(V.138)

### **Veta e dytë njëjës**

...per pun t'eee gi *punove*.(V.12)

...małkimi i raft tōks per punt t'eee gi *punove*.(V.12)

### **Veta e tretë njëjës**

...e ciobannin e deleve nuk e *lscioi* kurr.../ ...e scitne Sefin n'Misir e e *bleu* putifare.(V.33)

prep e pa far e *zaptoi* kanagiet e Faraonit...(V.58)

...nei u vuu reg Jehu, e *sckoi* n'Jeerael.(V.116)

...e si *diiti* ma hoł, muer vesct..(V.178)

...masi bani gni rrugh t'giaat *preku* pa paas gni gieoter uji...(V.33)

Caini per kyvet ma i foort *kapi* huelgiin...(V.12)

...e *derççi* scii n'fagie t'toks per katerçet dit...(V.16)

...e muer e ama at fmii e *rriti* e si u ba...(V.55)

...pat kyvet per t'kegie t'tyne, e *iku*...egneli sckoi n'Rages veet e *foli*..(V.126)

...ka u bin, s'*priti*, por i ç'a eanit.(V.149)

...*kapi* fmiin e t'amen e tii gnaso natet...(V.179)

Folja lind në veten e tretë del në formën leu, me mbaresën –u.

...ati ci *leu* perpara ja gnitne emnin Esau. \ ...katerdhet dit masi *leu* Mria e Sefi ciuene Krisctin n.Kisc..(V.175)

### **Veta e parë shumës.**

I *sckuun* edhe do tier gi kiscin gni nieri t'marrun.(V.195)

### **Veta e tretë shumës**

Nuk ja *kççei* (*kthei*) aspak se e scifte...(V.115)

...e me t'amen e tii basck *kççei* (*kthei*) e zu veen...(V.179)

Kuur *prekne* tu gni sceher i tha egnelit...(V.126)

...si *dulne* ato, Giuditta voit e hini...(V.137)

...me cias *cilne* ghojen, e lavd, e nner...(V.144)

...jau *lscuenpor* kur i *mytne* e ju sckote giaku erkai.(V.179)

...e ia *nisne* babs vet... \ ...e *scitne* rescpert Sefin n'Misir...(V.37)

...e si ju *kapne* breghut...(V.194)

**Forma joveprore e foljeve ne kohen e kryer të thjeshtë** ndertohen duke marrë përpara foljes pjesëzën –u:

...u *nis* Giakobbi, e muer me vedi t'giç scka kiscte...(Va.48)

...u *stolis* me petka e icgii ...u *nis* me hysmegiare t'vet Abra...(V.137)

...u *diftue* gni scplaak doret n'fagie t'murit...(V.145)

...e me Zotin u *kap* tue ççan uraat. (V.182)


...u *rritne* ujnate barken e ciuene pezuł.(V.16)

...me gni her u *mloç* hałk i maç...(V.195)

### Kohët e përbëra.

### Koha e kryer.

Kjo kohë përsa i përket ndërtimit nuk ka ndryshime nga standardi. E ndeshim në veprën e autorit të formuar nga folja ndihmëse kam dhe pjesoren e shkurtuar geqe .



Më konkretisht kemi formimet:

#### **Veta e parë njëjës:**

...sa mreku<sup>h</sup>isc gi *kam baa* ner syy...(V .71)

Me kyvet tem e *kam zier* vedin ( V. 80)

*Kam marr* vesct se ajo ka zan scum burra.(V.126)

...i zbloi gith punt e mia gi *kam baa* ...ai m'ka kalëue t'giç scka *kam punue*.(V.191)

#### **Veta e dytë njëjës:**

... gi n'diit t'sodit *kee çunue*...ti jee em biir, sod prei mejet ti *kee daal*.. (V.97)

...ti m'*kee vuu* mue hysmegiarin ( V. 102)

...pse me dor tanne veet ma *kee ciue* travajen...(V .128)

#### **Veta e tretë njëjës:**

...*ka laan* venin por pse *ka dasct* me hieek dor prei popu<sup>h</sup>it...(V.137)

...vascat i *ka mlue* hije e eeee e veet...(V.140)

...Assalonni a *kaa psctue*? (V.101)

... ai ju *ka urçnue* egnive vet me t'paas nn'dor...(V.183)

#### **Veta e parë shumës:**

...scka na t'dy *kena liiçme n'emem* (V. 92)

...po na as *kemi liiç* giit miedis t'ziermit...(V.141)

... pse vet na *kemi nnie* e *kemi paa*.(V.191)

#### **Veta e dytë shumës:**

...i *keni giit* n'gen ann urçnimet e Eëotit, e *keni sckue* mrapa Baalit.(V.112)

### **Veta e tretë shumë:**

...gnai nieri t'zilit ja *kan daa* dielt, e e *kan lan* pa to ...gi kemi gieet ner ççaaas, na *kan scti* ktu.( V. 44)

...*kan birue* duert e mia e kamt e mia. *Kan gneeh* t'gith esctnat e mii..(V..97)  
...merren vesct fmiit gi nuk *kan marr* menn alaa.(V.121)

### **Forma joveprore e foljeve në të kryerën e dëftores.**

Përsa i përket diatezës joveprore të foljeve në të kryerën e dëftore ndërtuar me foljen gjysmëndihmëse jam dhe me pjesoren e folje p.sh :

### **Veta e tretë njëjës:**

...me vedi tue mennue se dita e deks i *asct afrue* fort...(V.124)

### **Veta e tretë shumë:**

...*jan lidh* e giit miedis ..(V.144)

Si mâa *jan rzue* trimat ( V. 94)

### **Më se e kryera.**

Më se e kryera e dëftores formohet me anë të foljes ndihmëse kam (veprore), jam (joveprore), në kohën e pakryer dhe me pjesoren e foljes që tregon veprimin. Kjo kohe perdoret per te shprehur veprime te perfunduara para nje çasti te caktuar te se ardhmes.

Ndryshe nga autorët e tjerë, kjo kohë e mënyrës dëftore zë vend në përdorim vetëm tek Babi, ndërsa tek dy autorët e tjerë jo. Më konkretisht e gjejmë në vetat:

### **Veta e dytë njëjës:**

...m'ep t'pii ti belda *kisce lyy*p prei si...(V.190)

### **Veta e tretë njëjës:**

(Zgjedhimi i parë):...e zija alaa nuk *kiscte sckue*...(V. 136)

...nuk ja bani dyysc fialen pse e *kiscte ghusctue* keg fort zija e buks...(V.113)

...prei hałkut maç *kiscte lscue* si nuk muitne venn me gieer.(V.175)

...raa n'at venn ku *kiscin sckrue*...(V. 191)

...e ja giti t'giçça t'eeeat gi *kisc punue* ajo...(V.190)

raa n'at venn ku *kiscte sckue* Scpirti .(V.191)

### (Zgjedhimi i dytë):

...me forzade n'at dhee gi *kiscte sghieeç* Lot.... Zuer robt e giian e tyne gi ju *kiscin plackiit* edhe t'nipin e vet...(V. .20)

...Giakobbi e vuu per rrugh gi *kiscte marr*...(V.48)

...si maroi boregin e vet, *kiscte daal* jasct schrit...(V.120)

me vooit n'venn, kah *kiscte daal* me sckrue..(V.175)

### (Zgjedhimi i tretë)

...per pa marue at pun gi i *kiscte laan* n'dor Abrami per me bitiis.(V.28)

...*kiscte vuu* nen scpat e pree gçççi sa *kiscin dasct*...(V.136)

...e si u afruene *kiscin zan* venn e me hitaat..(V.175)

### **Zgjedhimi i parregullt:**

Bergieti, gi *kiscin pruu* prei Misirit maroi.(V.f44)

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Veta e tretë shumës:

Tobiin gith far halesc e *kiscin maarr*.(V.124)

...u afruene prei vennit ku Davidi *kiscite daal* prei sarajet regit. (V. 86)

...gi ja *kiscin myyt* ghryken me ghuur ... / ...per afer si i *kisci raa* tri vaççna delesc(V.32)

...e si u afruene *kiscin zaan* venn.(V. 32)

...me harcg *kiscin blee* me higher (V. 175)

...Zoti ja *kiscite pruu* asai...(V.137)

u afruene prei vennit ku *kiscin raa*. ( V. 81)

### Forma joveprore e më se të kryerës

Ndërtohet duke i paraprirë foljes ndihmëse jam pjesores së foljes. Gjatë vështrimit të paradigmës vihet re se haset vetëm veta e tretë njëjës dhe shumës.

E si vuu mir oroe se giçç *iscin fieet*.. ( V. 92)

...ksctu *iscte mûusc* mennia se po i cillvedit rugh. (V.119)

Gni her *iscin sctyy* lerg h fort prei konakut.

...ai *iscte daa* e larghue prei s'kegies.(V.37)

...nuk kiscite haber, *iscte sctrii* n'funn t'barks. (V. 119)

### Koha e kryer e tejshkuar

Tregon një veprim të përfunduar para çastit të së shkuarës. Forma veprore ndërtohet duke i paravendosur pjesores së shkurtuar të foljes ndihmëse *kam* në të kryerën e thjeshtë dhe *jam* në të kryerën e thjeshtë për foremen joveprore.

Koha e kryer e tejshkuar e  
deftores

Foljet ndihmëse kam, jam  
në të kryerën e thjeshtë

pjesore

pat  
patne

kie

kallzue  
marr  
than

Konkretisht dallojmë rastet:

**Veta e dytë njëjës.**

E t'giçç pse t'*pat marr* ty... (V.128)

**Veta e tretë njëjës.**

Ne na *pat baa* bee ai ... \....sikhur m'*pat bisedue* ather (V.44)

...Solomonin't'giçç *yszdyhaar* gi *pat pass* kurr nuk e *pat vescen* si ato t'miir.(V.199)

### **Veta e tretë shumës**

...kag sa gni me gni ata *patne kalzue* (V. 111)  
...at hał *patne vooit* dikuur. (V. 166)  
...se besune per ather se para *patne besue*.(V.128)  
...Gioni *pat msue* discepuit e vet.(V.236)  
...asi Giudeisc gi *patne paa* t'gnałunin e sc'Laerit.(V.245)  
...pse sikur *pat* *ççan* apostułi...(V.187)  
...hogne dor prei giçç *scka patne*.(V.194)

### **Forma joveprore:**

...e per dores *kien cue* ...e *kien vorrue*.(V.233)

### **Koha e ardhme.**

Përdorimi i kohës së ardhme përdoret shumë në veprën e Pashko Babit. Autori përdor dy konstrukte ku mbizotërues shihet përdorimi i së ardhmes së gegërishtes të tipit *kam me ba* në raport me formën *do + e tashme e lidhores*. Kemi ndërtimet:

*Me formën e ngurosur do dhe me të tashmen e mënyrës lidhore*

E nuk *do t'kemi* keg per sceher t'Ninives...(V.121)  
...na si *do t'ja scperblyeim* atii...(V.128)  
...edhe Kriscti fmii *do t'perzihei* me tier e *do t' rezighohei*.(V.179)  
...iscte afrue vakti n't'zilin *do t'delte* Kriscti meidan.(V.181)

*Të tashmen e dëftores të ndihmëses kam dhe me paskajore*

...giççmon *kam me keen* n'fai ...(V.44)  
...perse *ka me arç* vakti n't'zilin giçç...(V.207)

### **Koha e ardhme e përparme përdoret me dy trajta foljore:**

*Formë e ngurosur due(do) dhe me infinitivin e foljes tjetër.*

...emnin Adam gi *don me ççan* nieri çeut.(V.9)  
...gni çunti gi po *due me ta lan*...(V.117)  
...gnasctu sikur nuk *do me ta baa* tyğ kusc edhe ti ruju...(V.124)  
...nuk *do me ççan* se besuene por ather ...(V.182)

*Ndërtimi kam dhe forma e paskajores për të baam*

...paitim ner miet tyğ me ghruë s'*kam per t'lan* \ ...t'giçça dit e motit tann dhe *kee per t'hagher* \ ...ti *kee per t'hiek* travai scum...e pluhun prep *ke per tu kthye*.(V.12)  
...per ne kioft gi pesçet veet t'dreit *kam per ti gieet* n'Sodoma...(V.24)  
...ti *kee per ta vuu* doren tanne mi krye t'enmigve tuu....*kan per tu permyyz* t'birt e babs...e ai *ka per t'ken* uzdaja...(V.49)  
...por giççmon *kena per t'ken* t'pasun..(V.125)  
...*keni per t'avrue* por *ka per t'arç* vakti n't'zilin avruesit e pa hiile *kan per ta açrue* Aatin ...e sikur ...(V.190)

### **Mënyra lidhore.**

Mënyra lidhore shpreh kryesisht modalitetin e mundësisë, por ka raste kur ajo mund të shprehë edhe modalitetin e dëshirës apo të detyrimit. *Mënyra lidhore ka dy kohë themelore: të tashmendhe të shkuarën , ku e shkuara ka tri nëndarje: të pakryerën, të kryerën, më së të kryerën.*<sup>159</sup>

Këto forma kohore të mënyrës lidhore kanë të paravendosur pjesëzën –t’, ku siç vihet re identifikohet me apostrof, e cila në veprat që kemi në studim, ashtu sikurse në arealin gegë, zanorja ë nuk shkruhen dhe nuk shqiptohen në këtë pozicion.

### **Koha e tashme.**

*Kuptimi themelor i kesaj kohe eshte te tregojë nje veprim , kryerjen e te cilit folësi e paraqet si të mundshëm a të dëshirueshëm.*<sup>160</sup>

Duke veçuar foljet kam e jam, format foljore të kohës së tashme të lidhores janë të njëjta me temën e së tashmes së dëftores. Gjatë paradigmës së zgjedhimit vihet re edhe disa ndryshime si:

Në veten e dytë e të tretë njëjës, mbaresat janë të ndryshme nga e tashmja e dëftores, duke marrë mbaresat –sh, -j.

Foljet e zgjedhimit të dytë, gjatë paradigmës, dalin pa ndryshime në temë si: t’dal, t’dalim etj.

Tri vetat shumësit të zgjedhimit të dytë dalin me mbaresat –im,-ni,-in ndryshe nga vetat e zgjedhimit të parë që dalin –ëm, jo –in.

Këto folje përdoren edhe të shoqëruara me foljet modale mund, duhet.

### ***Veta e parë njëjës***

..nuk *ta fali* jeten.(V.59)

...e une tasc po t’kalzoi se kusc jan ato gi i ka dia*li*...(V.127)

### ***Veta e dytë njëjës:***

...mas sodit t’pare her *t’ m’ dalsh* perpara...(V.59)

### ***Veta e tretë njëjës:***

...per ta naal popu*lin* mos *t’ sckoin* n’ sckretii me i faal...(V.58)

...e kuur *t’ viin* ai ka per t’na vuu per rrugh.(V.141)

...e most a *t’ diin* dora e errmait...(V.198)

...ket fi*lgi* gi*çç* ta *nneroin*...(V.201)

### ***Veta e dytë shumë.***

Gjendet e përdorur vetëm në veprën e Pashko Babit në formën: ...bekue keni per t’keen si kû *t’ sckoni* si ku *t’ vini*. (V. 76)

...mos *t’ ju kapin* praa kurr gni eori.(V.199)

... mannei kuur *t’ gninoni* mos u duhni n’cehre t’priscun.(V.198)

...n’ t’zilin do konak gi *t’ bini*...(V.215)

...kah *t’ merrni* me dal jasct o prei asi konakut...(V.215)

### ***Veta e tretë shumë:***

...kusc *t’ sccian* belda.... ka per t’ma kgiyyr hatrin tem.(V.100)

...ani kuur *t’ gikoin* eemra sikur ban sinaghaghare pa t’paa kusc...(V.198)

---

<sup>159</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I,Morfologjia, Tiranë,2002,f.320.

<sup>160</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I,Morfologjia, Tiranë,2002, f. 321.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

...kusc *t'piin* asi ujit gi un kam per t'i çan... (V.190)

### **Forma joveprore**

Ilustrojmë formimin jovepror në veprën e Babit.

...por *t'a mysim* e *ta giesim* n'gni saranc t'vieter...(V.36)

...po *t'lutem* praa me ma begheniis çgni unti gi po due me ta laan.(V.117)

### **Shoqërimi me folje modale.**

Folja në të tashmen e lidhores shoqërohet edhe me foljen modale mund si...prep ma bisedoni, *muun ta marr* gni aan o ne e diaççt...(V.28)

...ani maa tieter rrugh *t'kapei* per ato pun.(V.66)

### **E pakryera.**

Kuptimi themelor i kesaj kohe eshte te tregoje nje veprim te mundshem te se shkuares. Edhe kjo kohë ndërtohet meparavendosjen e pjesëzës *t'* te foljes përkatëse. E gjejmë vetëm në këto raste tek vepra e Pashko Babit në vetën e tretë njëjës dhe shumës:

#### ***Veta e tretë njëjës:***

..*ta doite ...e t'sckoite* eotnia em me u piek n'profeten...(V.117)

#### ***Veta e tretë shumës:***

...i nepni dy gije, e *ta sghieçin* ato gnenin, e *ta zoptoin* e *ta veen* syfri druuve.(V.115)

### **Forma joveprore:**

Babi:

...biri em *t'marrscin* me t'mir bakgiit ti mos puno.(V.104)

### **Kohët e përbëra të mënyrës lidhore.**

Përsa i përket përdorimit të kohëve analitike, është shumë më i reduktuar. Veta më e përdorur në këtë rast është veta e tretë njëjës dhe shumës, gjë që do ta shohim edhe nëpërmjet shembujve ilustrues.

### **Më se e kryera.**

Kuptimi themelor i kesaj kohe eshte te tregoje nje veprim qe mund te jete kryer para nje çasti te caktuar te se shkuares. Kjo kohë e lidhores ndërtohet me foljet ndihmëse *kam* dhe *jam* në të pakryerën e lidhores dhe pjesoren e foljes që tregon veprimin e kryer. Ndeshim vetëm këto formime në vepra:

#### ***Veta e parë njëjës.***

...as une *t'kisce deek* per tyç.(V.100) Siç vihet re në këtë formë foljore, autori nuk përdor mbaresën –a të vetës së parë, por –e, që zakonisht është karakteristikë e vetës së dytë njëjës.

#### ***Veta e tretë njëjës:***

...gni fije flak *t'krees* tyne nuk i *kiscte perziee*.(V.145)

...nuk *kiscte marue* mir Kriscti s'folunit...se vaiea gnimen *kiscte deek* as mennia kuui si skote se Kriscti *kiscte arç* me e gnał s'dekunit.(V.214)

..e ai *kiscte çan* gni uui t'giał.(V.190)

#### ***Veta e parë shumës.***

...edhe se *t'kiscim deek* n'Misir...(V.62)

#### ***Veta e tretë shumës.***

...n'tietren t'tiin *kiscin nnei* dy kerubi...(V.67)



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

...ato burra gi i *kiscin miee* n'fuurr i dog...(V.144)

...e hini ku e *kiscin scetrii t'dekunen*.(V.214)

Mënyra habitore.

Në veprën e Pashko Babit ndeshim shumë pak trajta të foljes në mënyrën habitore dhe vetëm në kohën e tashme.

### **Koha e tashme.**

Kjo kohë e mënyrës lidhore del e ndertuar nga prapangjitja e pjesores së shkurtuar të foljes se formave vetore të së shkuarës të së tashmes me ndihmësen kam.

...gith-gni sikuur *t'vieçke* pse ai e mma giaan e huei cundra...(V.145)

...e se fiala e Zotit *kenka* n'ghoi tanne(V.114)

...eotni si po scof ti *kenke* profet.(V.190)

### **Mënyra kushtore**

Mënyra kushtore shpreh modalitetin e mundësisë. Kohët e kushtores janë homonime me të ardhmen , prandaj kjo çështje ka hapur shumë diskutime rreth formimit të saj. Pavarësisht diskutimeve, të cilat I parashtrua më lart gjatë trajtesës së mënyrës kushtore tek Radoja, është pranuar dhe klasifikuar si mënyrë në gjuhën shqipe.

### **Koha e tashme.**

Tregon një veprim që mund të ishte kryer në të shkuarën, nëse vërtetohet një kusht i dhënë.

...fort i mir *kiscte me ken* ci as nnogni e diele..(V. 164)

...po as ma miir *kiscte mekeen* me e scti rob.(V.36)

Po kështu e tashmja e kushtores shprehet dhe me ndërtimin duke i paravendosur paskajores foljet gramatikore të foljes ndihmëse kam në të pakryerën e dëftore.

...dikuur *kiscin per t'ken* gnasisc gi *kiscin per t'a* liçmartesen por gi thoite se si *kiscteper ta çan* miscin e vet me e higher.(V.219)

### **Koha e përbërë e mënyrës kushtore.**

#### **Koha e kryer.**

Format e se kryeres i ndeshim te ndertuara në formënn: folje kam në të pakryerën dhe me infinitivin me pas punue. Dokumentohet vetem tek “Vakinat e t'ligs herscme e t'ligs ree”.

Davidi, sikur e *kiscte paas fi*lue aso heret gi pat keen cioban. (V. 97)

...sikur e *kiscte paas fi*lue...(V.97)

...nuk i rezighoi asctu sikur veet ja u *kiscte paas gikue*. (V. 120)

...eçe ènt gi Nabucodonosor *kiscte paas marr* prei kiscet. (V. 150)

...e sikur se *kisc paas niis kta dy* e ka dy.(V.228)

### **Mënyra dëshirore.**

Shprehet modaliteti në formën e një dëshirë urimi a mallkimi.

#### **Koha e tashme**

Koha e kryer e dëshirores është një trajtë analitike që shpreh dëshirën e folësit në formë urimi a mallkimi në kohën e shkuar. Formohet nga e tashmja e dëshirores së foljeve ndihmëse dhe nga pjesorja e foljeve në trajtën gege.Shpesh kjo formë dëshirore përdoret edhe me inversion në kohën analitike.

...gnaï gi ka per t' maλkue tyγ veet *kioft maλkue*. ( Va. 30)  
..Pagia *ikioft* ktii konakut! (V.215)  
...e I ζζane: discepuλi i tii *kiosc* ti(V.235)  
..Ashtu *kioft*!( V.236)

### **Mënyra urdhërore.**

*Mënyra urdhërore përdoret për të shprehur modalitetin e dëshirës në formë urdhri, këshille, dëshire, porosie etj.*<sup>161</sup>.

Mënyra urdhërore ka formë gramatikore vetëm për vetën e dytë njëjës e shumës. Ato kanë të njëjtën formë si veta e dytë njëjës e shumës e së tashmes së dëftores, por në këto vepra trajtat foljore dalin pa mbaresë, mëso,lexo,rrëfe ose me mbaresë –ni msoni,lexoni rrefeni etj.

Duke u mbështetur tek Gramatika e gjuhës shqipe mund të dallojmë dhe të bëjmë një klasifikim të këtyre foljve:

Folje të zgjedhimit të parë që dalin me temë në –o-, -e- , -i-, pa mbaresë si: meso, rrëfe, pi, por dhe mbaresë –ni.

...ti mos *puno* per giefi tyne.(V.104)  
..ti tasc na *lezo* pak zoorin e s'kegies...(V.109)  
...scko e dukiu prep Acabbit pse une kam...(V.115)  
...e jut ha ai: Zotin e ciells *bekoni*. (V.128)  
...mos *lakmoni* me baa giaa scum...(V.198)  
...mos *gikoni* per n'mos doni me keen gikue.(V.198)  
\**Laju* e kee per t'ken pasture.(V.117)  
...ruju se ghabohe kurr me ja miratue vedit mkatin....(V.124)

Folje të zgjedhimit të dytë ku përfshihen edhe ato folje të cilat në vetën e dytë njëjës të urdhërores pësojnë ndërrime –e në –i. psh. dal-del; marr-merr;mbjell-mbill; djeg-digj;pjek-piq; etj

...tuk e kee Rebeken; *merre* e scko me gjiζζ te.(V.28)  
...*merrnime* vedi peem ku t'gieeni...(V.44)  
...*falni* e keni per t'pas t'falun..(V.199)  
...*dele ulun*' piscin.(V.200)  
...*lypni* e ka per t'ju ζan...(V.226)  
...sckoni e *deln*iprifnis para.(V.238)  
...ciue e *nisu*: feja jote t'ka ciue n.derman.(V.238)  
...mos *vra*...mos *viç*...mos *delins*paat t'ren...(V.240)

Folje të parregullta, ku përfshihen dhe foljet, jam, kam, tham. Konkretisht kemi trajtat:

...mere e *nepe* per me e per vedi. (V.225)  
...*kii* mscrier per nee.(V.237)

### **Ndue Bytyçi**

#### **Foljet e parregullta të mënyrës dëftore.**

---

<sup>161</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002,f.330.

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

NJËJËS		
Veta I	---	kam
VetaII,	jee	Kee
Veta III	asct	kaa
SHUMËS		
Veta I	----	----
vetaII	----	----
vetaIII	jan	----

### **Veta e parë**

Del vetëm folja kam e formës veprare.

E kam scnneden e kam kyvetin(Urzhnimet f. 12)

**Veta e dytë** njëjës zakonisht del me temë në *e* (jee\kee) si psh:

Ëot i madh , o Ëot ku *jëe?*(Urdhnimet f. 4)

... me prue vedin hak e *kee*(Urdhnimet f. 8)

**Veta e tretë njëjës** e foljes *kam* del kaa ndërsa folja *jam* del e përdorur me formën *asct* (*asht*).

...*kaa* prei ëotit t' maççë rrfëe (Urdhnimet f.5 )

*Asct* (*asht*) binaja e ëotit nieri(Urdhnimet f.7)

s' *asct*(*asht*) insane *asct*(*asht*) bisc...( Urdhnimet f.6)

... pra trii jeet ktu nieri i *kaa*(Urdhnimet f.9)

... je ta e korpit *asct* (*asht*)e dyt...( Urdhnimet f.12)

Veta e parë dhe e dytë shumë tek Bytyçi nuk dokumentohet

**Veta e tretë shumë.** Kjo vetë gjendet e përdorur vetëm tek folja *jam* që del në trajtën *jan*.

N'ta scelbimi e jeta *jan*..( Urdhnimet f.3)

...*jan* do t'kscten te ëëë... e *jan* do tier....( Urdhnimet f.4)

*Jan* giaksort małkue prei ëotit (Urdhnimet f.8)

### **Koha e tashme.**

#### **Folje të zgjedhimit të parë të kohë së tashme.**

Foljet në vetën e parë dhe të dytë njëjës e shumë nuk ndeshen në veprë. Dallojmë vetëm vetën e tretë njëjës dhe shumë.

#### ***Veta e tretë njëjës***

...e nuk *nnron* por si *nnron* moti... (Urzhnimet f. 3)

...pse se *lscon* mi ta ngi rrfëè?/saberlii Ëotyn *vanon*...por gynahin se *harron*...(Urzhnimet . f. 4)

...nner dit festa kusc *punon* ...e gia tietet si *tepronvesce* mcati si e *denon*...(Urzhnimet f. 6)

...e *fiton* prei Ëotit hakun \ ...puscka e ççika korbin *rrzôn*, por scannłuri scpirt *rrënôn*.(Urzhnimet .f. 8)

**Veta e tretë shumë** del me mbaresën *-in*.

...ani sod ne cieł *ghezoin*...e n'tok nierzit I *nneeroin*...

t'maçe fees i *bain* dhunii...  
perse deri m'gnac po *sckoin*...(Urdhnimet . f. 4)

**Folje të zgjedhimit të dytë të kohës së tashme.**

Foljet e zgjedhimit të dytë shfaqen me temë në bashkëtingëllore dhe në tre vetat e para të njëjësit zakonisht dalin me mbaresë zero. Gjenden folje në veten e parë dhe të dytë tretë njëjës që dalin me mbaresë zero: merr, flet, del.

***Veta e parë njëjës***

...e *merr* prinnen neper kaam...(Urçnimet.f. 6)

Zoti vet at gak e *lyp*

vet gaksurit kryyt t'ja *sctyp*..( Urçnimet .f. 8)

***Veta e dytë njëjës:***

Tek Bytyçi veta e dytë njëjës e kemi ndeshur tek folja *flas*, si:

...gneto fial n'Ugniill i *flet*.

... e kio merret kec kur *flet*...(Urçnimet .f. 9)

***Veta e tretë njëjës***

...dro se rrena i *del* meidan...(Urçnimet.f. 5)

...ai ci *vret* per asghanii...(Urçnimet . f. 8)

**Folje të zgjedhimit të tretë të kohës së tashme.**

Në grupin e foljeve të zgjedhimit të tretë gjenden foljet e vetës së dytë e të tretë njëjës dhe vetën e tretë shumës:

***Veta e dytë njëjës***

A thue s'*di* si e nep lajikun.(Urçnimet.f.6)

***Veta e tretë njëjës:***

...se *rri* ځځupra n'deer t'Parrizit...(Urçnimet. f. 7)

***Veta e tretë shumës:***

... perse e *diin* ci s'kee nghtres (Urçnimet .f .5)

**Forma joveprore e foljeve në kohën e tashme të mënyrës dëftore.**

Kemi ndeshur vetëm foljet në vetën e parë dhe vetën e tretë njëjës të zgjedhimit të parë.

***Veta e parë njëjës***

...por *munnohem* me e sceitnnue.(Urçnimet.f.5)

***Veta e tretë njëjës***

Me ket ves ci kreit *verbohet*, mkat në mkat per dit maa *rrzohet*.(Urçnimet.f.10)

Folje të vetës së tretë zgjedhimit të dytë.

***Veta e tretë njëjës***

...e kio *merret* kec kuur flet.(Urçnimet.f.9)

...fiton mkat ci kurr sun *matet*.(Urçnimet.f.8)

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

**Koha e pakryer**, si kohë e shkuar gjendet tek Ndue Bytyçi vetëm tek folja e zgjedhimit të parë punoj në vetën e dytë njëjës:  
...ksctu n'punoisce, ɛoti i vertet ka me t'žanun t'giat jeet.(Urçnimet.f.6)

### **Kohët e përbëra.**

#### **Koha e kryer.**

E ndeshim në veprën e autorit të formuar nga folja ndihmëse *kam* dhe pjesoren e shkurtuar *gege*. Nga një shqyrtim shterrues listojmë shembujt e gjetur.

#### ***Veta e parë njëjës:***

Nelt me cił *kam zghižun* une ... (Urçnimet. f. 13)

#### ***Veta e dytë njëjës:***

...ci me vraas inat *kee cfryy*..(Urçnimet. f. 8)

#### ***Veta e tretë njëjës:***

...ai me ɛotyn n'giak *kaa raa* (Urçnimet . f.7)

...si ne Kriscti na *kaa msue*...(Urçnimet f. 9)

...si *kaa dal* do bii kerkui...(Urçnimet.f 11)

ɛoti Kiscen *kaa vunue*...(Urçnimet .f. 13)

#### ***Veta e tretë shumës***

...ksctu Apostuit *kan punue*...(Urçnimet.f. 3)

### **Koha e ardhme.**

Kjo identifikohet si një kohë analitike që përcakton të njëjtin funksion kohor , por që ndryshon për nga modaliteti. Edhe tek Ndue Bytyçi gjenden të përdorur dy ndërtimet, si do të trajtohen më poshtë.

*Me formën e ngurosur do dhe me të tashmen e mënyrës lidhore*

Kusc do t'jeet o bii, o biir,

N'kioft ci prinnen se hatron...

*Do t'i msoin* me vakt uraat.

...

Me i pas ɛotit t;maçitaat

Rrfeja e ɛotit *do t'kerset*...(Urçnimet f.8)

*Të tashmen e dëftores të ndihmëses kam dhe me paskajore*

*Kaa me t'žanun* te ghat jet.

Per kta žžot ɛoti i vertet

*S'ka me lanun* kenn mas veti

Fara e tyne *s'kaa m'u nnii*

*Kan me pas* sał gnat małkim

Ci pat Kami per t'maç dnm. (Urçnimet f. 6-7)

**Koha e ardhme e përparme** gjendet tek Bytyçi në formë e ngurosur *due(do) dhe me infinitivin e foljes tjetër.*

Per Parriie nuk *do m'u luten*

Parriie tieter *s'do me diit.* (Urçnimet f. 9)

### Mënyra lidhore.

Foljet e mënyrës lidhore gjenden në veprën e Bytyçi vetem vetën e tretë njëjës dhe shumës, konkretisht në foljet: dua, kujton, mbjell, korr.

#### **Veta e tretë njëjës.**

...si *t'don* Zoti ti perkulu ...\...por edhe prinia le *t'kuitoin*.(Urdënimet.f.7)

#### **Veta e tretë shumës.**

...s' due ci *t'mieain* tiert e *t'korrin*...(Urdënimet.f.12)

### **Forma joveprore**

Në formën joveprore të lidhore në veprën e Bytyçi ndeshen vetën foljet *t'cbihet*, *t'i nnihet*, *t'masctrohet*.

kreit ky mkat prei jusc le *t'cbihet*

e kurr emni mos *t'i nnihet*.(Urdënimet.f.10)

mos *t'masctrohet* mennia e sekret.(Urdhnimet.f.12)

### Mënyra dëshirore.

Kjo mënyrë që shpreh modalitetin e dëshirës, urimit a mallkimit shprehet tek Ndue Bytyçi me inversionin :

Praa *maakue kioft* (*mallkue kioft*) flicitija

E *maakue kioscin* (*mallkue kioshin*)fialt e kcija

*Maakue kioscin, kioscin hiekun*.(Urdënimet.f.10-11)

### **Mënyra urdhërore.**

Kjo mënyrë ndeshet vetëm tek foljet dua ( duje) dhe gabo (ghabo) dhe tek foljet e parregullta *nepe*, *dunie*, *duni*, në veprën e Ndue Bytyçi:

Mi gjith eemer *duje* eotin(Urdënimet.f.3)

Fen e Krisctin tama *duje*.(Urdënimet.f.5)

Mos *ghabo* me t'sctremta fial.(Urdënimet.f.10)

Folje të parregullta, ku përfshihen dhe foljet, jam, kam, tham. Konkretisht kemi trajtat:

Ndue Bytyçi:

Jeten *nepe* edhe per fee (Urdënimet.f.3)

*Dunie* scocin si vetveten, giççkenn *duni* edhe anmikun ...(Urdënimet.f.9)

### **Përdorimi i formave të pashtjelluara.**

Sistemi foljor në botimet e autorëve shkodranë të shekullit XIX, Ëngjëll Radoja me “Dotrina e kerscten me msime e me scpjegim” Ndue Bytyçi me “Urçnimet e Tenëot e t’sceites Kisc”, Pashko Babi “Vakinat e t’lig’s herscme e t’ligs t’ree” është mjaft i larmishëm edhe sa i takon ndërtimeve të formave të pashtjelluara të foljes.

Gjuha e këtyre autorëve është një gegërishte ku gjenden të përdorura me gjithë larminë e tyre format e pashtjelluara: pjesorja, paskajorja, përcjellorja dhe mohorja.

### **Ëngjëll Radoja.**

#### **Pjesorja.**

*Pjesorja është një formë foljore e ngurosur e cila nuk ka kategorinë gramatikore të mënyrës, numrit, vetës, as të diatezës, as të kohës*.<sup>162</sup> Kjo formë foljore nuk na shfaqet me një përdorim të konsiderueshëm në vepër. Këtu duhet të kemi parasysh se: Në foljet e zgjedhimit të parë që dalin me temë në zanore shpesh e zërthejnë formantin zero në togun zanor **ue**. Kështu kemi format: largue (f.10) predikue (f. 26) librue (f.60) rrue (f. 66) discrue (f. 69) kunnescue (f. 70)

Foljet e zgjedhimit të tretë ndërtojnë pjesoren nga tema e kohës së tashme me temë të zgjeruar në –n-, me dyfishimin e zanores së gjatë: zaan, laan p.sh.: zâan (f.52/125); lân (f. 94/132)

Një grup më vete janë foljet e parregullta supletive apo josupletive që ndërtohen me prapashtesën trjateljformuese n. : than, laan p.sh. ççan(f.15); paa(f 75/93); raa(f.69); arç(f.91); bart(f.91);

Ndeshim edhe pjesoren me –un: rrahun (f. 30); arçun (f.31); ikun(f.56); lutun (f.60); ççanun (f. 61); sctumun (f. 67);

#### **Paskajorja.**

*Forma e pashtjelluar paskajore jep një veprim si proces, pa iu referuar një vete të caktuar dhe përdoret në shumicën e rasteve në funksionin e përcaktorit, por edhe në disa nga funksionet si : të kryefjalës dhe ai i kundrinorit*<sup>163</sup>.

Lidhur me përdorimin e saj shprehen studiuesit A.Çerpja dhe E.Lafe duke theksuar se: “...paskajorja ekziston në të dyja dialektet, por dallon në mënyrat e ndryshme të ndërtimit dhe të përdorimit: paskajorja e tipit për të punuar është tip i vetëm në të gjithë toskërishten ndërsa paskajorja e tipit me punue kryen më shumë funksionet e lidhore dhe mbizotëron në të folmet e gegërishtes veriore e qendrore.”<sup>164</sup>

Tek Radoja ndeshim të përdorura format e paskajores: *me punue, per me punue dhe per t’punue*. Përdorim më të dendur ka paskajorja e tipit *me punue* (me + pjesore gege) që e kemi ndeshur në 837 folje.

...mos *me gabue* kún kurr..( D.C.43)

Na psë s’jena t’ëott *me e lvdue* ëotin? (D.C. 63)

---

<sup>162</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia, Tiranë 2002, f.300.

<sup>163</sup>ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë 2002, f.539

<sup>164</sup> A.Çerpja, E.Lafe, *Sistemi foljor te vepra “ lohrbuch der albanischen sprache” dhe “ Albanian grammar with exercises crestomathy and glossaries”*, Studime shqiptare 17, Shkodër 2011, f.211.



## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

...*me perbuit* scteghtart..*me paa t'smutit*... *me paa t'hapsit*...*me vorrue t'dekunit*...(D.C. 62)

...*me nnie* kusc na ban kec... *me durue t'kciat e baame* (D.C. 93)

*Me çan me pii* atynve, ci kan et; *me vescium* atá, ci jan scdesciun; *me perbûit* scteghtart; *me paa t'smutit*; *me paa hapsit* (atá ci ja eán ne burgh); *me vorrue t.dekunit*; *me çan ksciil t'mir atyne* ci kan nevoi; *me msue t'paa-diiscmit* ; *me ciortue bâa-kciit e mcatnort*. (D.C.93)

Siç vihet re edhe nga shembulli i ilustruar më sipër, Radoja brenda një periudhe të shkurtër përdor radhazi paskajore disa edhe me funksione të ndryshme sintaksore.

Një vend të rëndësishëm zë dhe përdorimi i disa ndërtimeve foljore formuar nga folje modale që i paraprihen paskajores që haset shumë shpesh në vepër.

Foljet modale mund (munn), duhet, do realizojnë kuptimin e tyre vetëm kur shoqërohen nga një formë e pashtjelluar. Në veprën e Radojës këto folje hyjnë në relacion me paskajoren gege *me +pjesore*. Folja *do* e përdorur në vetën e tretë njëjës ka përdorim si folje gjysmëndihmëse (modale) me kuptimin e detyrimit, ndersa kur lidhet me paskajoren merr me tepër kuptimin e dëshirës. Është me interes të vihet në dukje se autori nuk është konsekuent pasi foljen *do* e përdor herë me mbaresë-n e herë pa mbaresë.

Kuive n'scekul *dona dasct me u ghiaa?* (D.C.73)

... scka *don me ççan*.(D.C. 90)...

... Scka *do me ççan* me hatrue baben...(D.C.121)

Kjo gjë ndodh edhe te foljet modale *mund, duhet*, të cilat në veprën e autorit në vend që të ndiqen nga një folje në lidhore<sup>165</sup>, gjenden te shoqëruara me paskajoren e tipit “me ba”, të cilat në vepër përdoren 96 herë.

...*duhet m'u rueit* n'ato ditt? (D.C.119)

... *duhet me i nnighiue* teneot ma fort se nierevet? (D.C. 123)

...*Duhet me besue* sceiten Kisc Katolike.(f. 132)

...t'ziliti i *duhet me i pelcye* pa kurr far kunnersctimit.( D.C.43)

*Duhet me u lut* me gairet n'eemer...( D.C. 57)

...*munnena me kerkue* t'mirat e ksai jet?(D.C.56)

...e ma kalai *munn me zierr* prei Zotit...(D.C. 73).

Paskajorja e tipit *me ba* zë një vend dominues në ligjërimin e folur dhe të shkruar gegë. Prof. Tomor Osmani shprehet : “... *duke qenë se ka një lëvizje për paskajoren e tipit me ba, studimi i saj për t'u përfshirë në standardin e sotëm do të ishte një element i domosdoshëm dhe dobiprurës për vetë pasurimin e sistemit foljor të gjuhës sonë, për funksionet e shumta sintaksore që ajo kryen, për vetë nevojat praktike që ajo mbulon.*<sup>166</sup>

Paskajorja shërben edhe për ndërtimin e së ardhmes (kam + paskajore gege *me ba*). Ky ndërtim i së ardhmes përdoret jo rrallë në veprën e Radojës. Siç duket autori mund të jetë ndikuar nga përdorimi i shpeshtë i këtij konstrukti *kam + paskajore* në ligjërimin e folur gegë.

...perseri *ka me arçun* prei cielet (D.C.131)

<sup>165</sup> Sipas Gramatikës së gjuhës shqipe, Tiranë 2002 këto folje modale ndiqen nga lidhorja psh mund të punoj.

<sup>166</sup> T.Osmani, *Disa konsiderata rreth gjuhës së Migjenit*, Buletini shkencor, nr.63, Shkodër 2013, f,253

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Kan m'u gniał me vyrıtyt t'gniatti Țotit. (D.C.47)

...kena me e nnėerue si duhet e kena me ken t'gheum e t'nghusclũem per giȚımın e jets.(D.C.63)

Pas kėtij pėrdorimi tė paskajores ndeshim edhe ndėrtimin e dytė **pėr me +pjesore** ( *per me hii, per me scelbue*, per me mennue) etj, qė ėshtė njė kontinim i dy formave tė pashtjelluara, dhe qė nė vepra ka njė pėrdorim tė konsiderueshėm. Tek "Dotrina e kerscten me msime e me scpjegime" e Radojės e ndeshim tė pėrdorur nė rreth 81 folje.

...pėr me lút mir tenȚon \ ...pr me i zee tiert, ci t'veproin mir.....( D.C. 57)

.. per me hii ma fort n'dasctnii t'Tenzot..( D.C. 80)

...per me scelbue a s'na mmaston me paas Feen...(D.C.89)

...per me pass nevoitari prei ssi paret, ci i duhen. (D.C. 144)

Siç shihet nga trajtimi i mėsipėrm paskajorja e tipit *per me punue* ėshtė mė e kufizuar se tipi i parė *me punue* megjithėse ėshtė njė veçori e gegėrishtes veriperėndimore.


Nė veprėn e Radojės gjejmė tė pėrdorur edhe tipin e tretė tė paskajores **pėr tė +pjesore** (per t' punue) qė i afrohet mė shumė normės sė pėrbashkėt, por qė kėtu ka njė pėrdorim tė rrallė, vetėm nė 13 folje.

:...sen s'i asct vsctiir per t'baa miir...( D.C.47)

...ci jan t'nevoiscme per t'u dit, jan kto.(D.C.14)

...e s'ka per t'hii kuurr n'Parriz.(D.C.22)

### Statistikė pėr trajtat e pashtjelluar paskajore.



Tab.1

(Dotrina e kerscten me msime e me scpjegim)

### Pėrcjellorja

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Përcjellorja është trajtë e pashtjelluar e foljes që shpreh një veprim i cili shoqëron atë veprim të foljes drejtuese me të cilin kryhet zakonisht në të njëjtën kohë.

Kjo formë e pashtjelluar është e ndërtuar duke i pavendosur pjesores së foljes formantin *tui*, *tu' dhe tue*. Dendurinë më të madhe në përdorim e ka përcjellorja e ndërtuar nga formanti ***tui*** + ***pjesore geqe*** që përdoret në 104 folje.

...sckòì me menn tem e *tui kuitue* atò temeìe.( D.C.80)

...scpsc *tui mennue* e *tui fol* per te...*tui m'arç* kec fort....*tui baa* me cief giçç scka urdhnue ...*tui bart* me gaemen c'do travai...(D.C. 92)

Njëkohësisht ndeshim edhe përcjelloren me formën *tu' atëherë kur mes pjesëzës e pjesores vihet një trajtë e shkurtër e rasës kallëzore me funksion kundrinor*. Por kemi edhe *rastin pa trajtë të shkurtër*. Këtë tip të përcjellores në të cilën është apostrofuuar zanorja fundore autori e përdor në 26 folje.

...me i scerbÿe *tu' mmait* urçnimet...( D.C.64)

... *tu' e marr* nneper goi sceitnisc...*tui baa* bee si asct udha ... (D.C.105)

...por edhe o *tu' e urçnue*, o *tu' e msue*, o *tu' e kshilue*...( D.C.131)

...me i scerbÿe *tu' mmait* urçnimet...( D.C.64)


...por edhe o *tu' e urçnue*, o *tu' e msue*, o *tu' e kshilue*...( D.C.131)

Tek dotrina e Radojës është me interes të theksohet se ndeshim të përdorur edhe përcjelloren e ndërtuar nga formanti *tue* dhe pjesorja e gegërishtes që e ndeshim në tri folje. Siç shihet autori tashmë ka filluar të mos e reduktojë togun *ue* por ta shkruajë të plotë. Vihet re gjithashtu prirja që ka filluar të ndeshet te ky autor për t'iu afruar gegërishtes letrare.

...*tue lut* na Zotin ci t' degnohet me i beghenniss...(D.C. 212)

...nnogni mecat, marrun *tue baa* scpsc.(D.C.228)

### Statistikë për trajtat e pashtjelluar përcjellore.



Tab.2 (Dotrina e kerscten me msime e me scpjegim)

### Mohorja

Forma e pashtjelluar mohore ndërtohet me paravendosja e pjesës parafjalore *pa* pjesores së foljes e tipit *punue*, që mund ta quajmë si një pjesore e shkurtuar. Bokshi, është i mendimit se “... *pjesorja e mbarë shqipes ka qenë e shkurtuar fillimisht, mirëpo me krijimin e mbiemrave përpjesorë toskërishtja e ka barazuar temën e mbiemrit me atë të pjesores duke e zgjeruar kështu temën e pjesores*”<sup>167</sup>.

Tek Radoja mohorja si formë e pashtjelluar përdoret vetëm në 12 folje.

..duhet me u lut me gairet *pa u loç* kurr.(D.C.57)


Pse *paa ngran, paa pii, paa u vesc* nuk múnna me i scerbye...( D.C.65)

A munnet nnokusc *paa hii* n’mcat me nnam e me true berret. ( D.C.115)

Ndryshe nga pjesorja, e cila nuk ka asnjë kategori gramatikore, trajta e pashtjelluar mohore ka kategorinë e diatezës.

...me u lut me gairet n’zembr *paa u lodh*.( D.C.57)

### NUMRI I FOLJEVE GJITHSEJ 1076



Tab.3

(“Dotrina e kerscten me msime e me scpjegim”)

Siç dallohen nga shifrat përkatëse dhe paraqitja grafike, trajta *me punue* është ndër më të parapëlqyerat e Radojës. Pas saj vijnë edhe paskajoret *per me punue* e shumë më

<sup>167</sup> B. Bokshi, *Paskajorja shqipe,(Vështrim diakronik)*ASHKA, Prishtinë, 1998

rrallë forma e tretë *per t'punue*. Ndër format e pashtjelluara bi në sy edhe përdorimi i tri formave të përcjellores ku trajta me *tui punue* është më e përdorura e cila pasohet me përdorimin e formës tu'punue dhe vetëm në tri folje me formën *tue punue*. Ndër këto forma të pashtjelluara autori përdor edhe 12 folje në formën mohore. Nga analiza e materialit të vjelë nga vepra arritëm në këtë rezultat të cilin po e paraqesin nëpërmjet kësaj statistike.

### **Pashko Babi.**

Vepra e Pashko Babit “Vakinat e t’ligs t’herscme e t’ligs ree” paraqet interes në lidhje me përdorimin e formave të pashtjelluara. Autori shkruan veprën me një vëllim prej 323 faqesh. Ne, për të qenë sa më të saktë në të dhënat statistikore me qëllim vëzhgimin e intensitetit të përdorimit të këtyre trajtave të pashtjelluara, punuam vetëm me pjesën e parë të Vakinës që përfshin 167 faqe.

### **Pjesorja.**

Përdorimi i pjesores në vepër është i rrallë. Ndërtimet më të shpeshta pjesorja e realizon nëpërmjet prapashtesës *ue*: ghatrue (f.26); scikue (f.55); Babi përdor edhe foljet e parregullta supletive apo josupletive që ndërtohen me prapashtesën trjatëformuese *n*: lan (f.55); *ξξan*(than) (f.74); *ξan* (dhan) (f.120) Pjesorja gjendet e shoqëruar me folje të tjera duke ndihmuar në formimin e kohëve të përbëra të foljeve si dhe formave të tjera të pashtjelluara.

### **Paskajorja.**

Pashko Babi përdor formën e pashtjelluar paskajore të ndërtuar me format *me + pjesore*, *per me + pjesore* dhe shumë rrallë *per te + pjesore*. Forma më e përdorur është *me + pjesore gege*. Në faqet që kemi vjelë të dhënat gjendet e përdorur në rreth 562 folje. Po sjellim disa raste ilustruese:

... e sckoiscin n'Ruzalem **me baa** pascken...(V. 179)

...ju lutne **me u nal** ner to...a do t'jeet mir para Zotit **me punue** na per fial tuei...(V. 285)

...a ke se sin a **me e pas** sctri doren...(V.46)

...**me baa** fial per me e εan n'gabim kastan...(V.250)

... ma par doite t'gien **me e daa** me to se **me ju ghzue** t'mirave... e Mosei **me psctue** si .... **Me ju ξanme pü** ghrigve gi kiscte baba ....(V.55)

Autori brenda një fjalie bashkërendit dy paskajore që mund të jenë ose jo të së njëjtës trajtë.

...**me i daal** atii hakut gi kiscte bâa mos **me ja naal** por **me ja ξan**. (V.33)

...**me i ξξan** si **me m'dasct** ti e **me m'pas** n'hate kξξγene ginia e tii. (V.33)

...per εakon **me kerkue** e **me bâa** t'pa feet.( V.75)

..na ka luut **me e laan me mleeç** kalzii mas korrzaresc. (V.82)

Kjo paskajore formën joveprore e bën me formantin *u*.

...*me e zierr* taftin e *me u vuu* veet n'kam t'tii (V.91)

...*me sa per para nuk u* ççye *me u looç*. (V.57)

...*pse eçe me u damue* giysa e neve ato nuk ciarsin fort pun.(V.100)

Paskajorja e tipit *me punue* shërben edhe për ndërtimin e së ardhmes shoqëruar me format vetore të kohës së tashme të foljes ndihmëse *kam*. Ky ndërtim i së ardhmes ndeshet mjaft shpesh në këtë pjesë të parë të veprës. Siç duket edhe tek ky autor mund të kemi ndikimin nga përdorimi i shpeshtë i këtij konstrukti *kam + paskajore* në ligjërimin e folur gegërishtes.

...*giççmon kam me keen* n'fai ... (V.44)

...*me t'scepit ka per t'arç* n'kisc. (V.164)

Në veprën e Babit ndeshim edhe tipin e dytë të paskajores **për me +pjesoren e foljes**. Në raport me trajtën *me + paskajore* ka një përdorim më të reduktuar. E kemi ndeshur në 64 folje.

... iscte vuu mrapa ***per me vuu*** oroe se si po del puna... \ ...*gi i sckoiscin* mrapa ***per me e maarr***.(V. 55)

... *me kreena t'gith kabileve per me scku e per me maarr* arken...(V.106)

...*e nuk ja priti kerkunn rughen per me sckue* ku t'dote veet. (V.122)

*Kuur kto u liçne per mos me scti* kascaiat ghooi asi héjet.(V.141)

Forma joveprore e kësaj paskajoreje ndërtohet me formantin *u* e cila i paravendoset kësaj trajte.

...*e bija e Faraonit u uul per me u laa* n'at ui. (V.55)

Ato *gi per mos me u harrue* murne ujin me grusct me e pi...(V.80)

Në shembullin e mësipërm vemë re se mohimin kjo formë e pashtjelluar e ndërton duke përdorur pjesëzën *mos* që e vendos në mes të trajtës.

### **Paskajorja e tipit per t'ba.**

Në veprën e Radojës dhe Babit gjejmë të përdorur edhe tipin e tretë të paskajores **per t' +pjesore** (per t' punue). Kjo trajtë ka një përdorim të rrallë, vetëm në 3 folje.

... sckopi i pariis ***per ti daal*** doret Giuds...e ***per t'keen*** uzdaja gi presin nahijet.... (Vakinat.f.167)

Në të gjitha rastet e tjera kjo paskajore ndërton format e së ardhmes *kam+paskajore e tipit per t'ba*.


...*ato a'kan per t'm'zan* bees e *kan per t'ççan*. ( V. 56)

...*t'giçç sa jan fmii ka per ti marr* deka e *ka per t'ken* vighm e giâam e maçe. (V.59)

...*kam per t'ju* bâa sikur ju desct eemra. (V.71)

...*kan per t'pas po neper sckretii kan per tu sieł* deri sa mos t;jesc. (V.71)

Statistikë për trajtat e pashtjelluar paskajore.



(“Vakinat e t’lig’s herscme e t’ligs t’ree”)

Tab.7

**Përcjellorja.**

**Përcjellorja** është trajtë e pashtjelluar e foljes që shpreh një veprim i cili shoqëron veprimin e foljes drejtuese me të cilin kryhet zakonisht në të njëjtën kohë<sup>168</sup>.

Siç do ta dallojmë edhe nga shembujt e dhënë, përcjellorja shfaqet e ndërtuar nga paravendosja pjesores formantin *tui*, *tu’* ndërsa ndërtimin me pjesëzën *tue* nuk e kemi ndeshur. Që të jemi më të saktë, nisur edhe nga dëshira jonë për t’u informuar rreth përdorimit të këtij konstrukti, pohojmë se në gjithë veprën autori nuk e përdor përcjelloren *tue+pjesore*.

Dendurinë më të madhe në përdorim e ka përcjellorja e ndërtuar nga formanti ***tui*** + ***pjesore*** *gege* si:

... e *tui iik* me anei i duel para... \ ... e aty vier *tui u rraah* me çan scpirt... \ ...i pat keg fort, e *tui vaitue* ξξa:...(V. 100)

...*tui hieek* n’turp t’vet kag ξiim t’forta... \ ....e vite dijen e vet *tui e diftue* maa fort...(V.179)

Paa i pa misct e vet *tui raa* zoop zopp e krymat *tui livrue* e *tui scetit* per misc t’trupit vet giçç ugnii. (V.164)


Ndeshim edhe përcjelloren me formën *tu’+ pjesore* *vetëm në një shembull gjatë vjeljes së materialit të pjesës së parë*.

...*tu’ baa* τγγ sebeb haλi e e vesctira me u persckue neper ato prov. (V.128)

<sup>168</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë 2002, f.336.



Statistikë për trajtat e pashtjelluar përcjellore.



“Vakinat e t’lig’s herscme e t’ligs t’ree”

Tab.8

### **Mohorja**

Forma e pshtjelluar mohore ndërtohet me formantin pa. Ajo përdoret në 42 folje.

...pa e gniâat as pak hysmegiari u ciue..(V.26)

...pa marue ai mir s’lutunit kuur gie duul Rebeka...9V.27)

...Giakobbi pa vanue aspak u bâa ghadi. (V.33)


... pa priit u lscue mmi te me asgier t’raan... \ ...e urçnimet e Ëotit i ruiti pa i fye kurr.(V. 119)

Forma mohore e ndërton joveproren me anë të pjesëzës u.

...pa u harrue u nis Abrami me ghrue t’vet..(V.20)

...nuk e lâa pa u myyt me tem vλaa Giakobin. (V.31)

Nga të dhënat e realizuara u konkludua statistika:



(“Vakinat e t’lig’s herscme e t’ligs t’ree”)

### Ndue Bytyçi

#### Piesorja.

Ndue Bytyçi nuk përdor pjesoren si gjymtyrë fjalie. Kjo pjesore shërben vetëm në ndërtimin e formave të tjetra të pashtjelluara. Me këtë funksion ndihmës pjesoret e ndeshim në vepër të ndërtuar me prapashtesa *ue*: *punue* (f.4) *fitue* (f.5) *true*(f.7) *dnue*(f.7) *rrzue*(f.7) *mkatnue*(f.12) *vnnue*(f.13) *kreemue* (f.13) *kuughue*(f.14). Kemi edhe foljet e zgjedhimit të tretë (klasa e parë) që ndërtojnë pjesoren nga tema e kohës së tashme me temë të zgjeruar në –n-, me dyfishimin e zanores së gjatë :zâan(f.5); lâan (f.7); diit (f.11)

Pjesoren me –n e ndeshim tek disa folje të parregullta ;bâamun (f.4); (batisun (f.4); pasun(f.5);

#### Paskajorja.

Tek Bytyçi përdoret vetëm paskajorja gege *me punue* dhe *per me punue*. Mbizotëruese është trajta *me punue*, që gjendet e përdorur në 81 folje.

*Me i batisun* n’ferr .(Urçnimet.f.11)

Praa m’ket dit jo *me fitue*

Praa m’ket dit jo *me punue*

Praa *me i desc*t e *me i nighiue*.(Urçnimet.f.5)

E ke borg , e *me i hatrue*

T’miren ksctu *me jau scperblye*

Jo *me e nemun* e *me i true*

Kusc *me rrzue* ghuzon ...insaan *me vraa*.

Tui fol kec *me i vuumun* (Urçnimet.f.6-7)

Mohimin kjo formë e pashtjelluar e shpreh me pjesëzën *jo* që i paravendoset kësaj trajtë foljore.

Praa m’ket dit jo *me fitue*

## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Praa m'ket dit *jo me punue*.(Urçnimet.f.5)

Ndue Bytyçi përdor edhe ndërtimin e dytë **për me +pjesore** që tek vepra “Urçnimet e Tenëot e t'sceites Kisc” gjendet në 4 folje. Në tre prej këtyre ndërtimeve në mes pjesëzën dhe pjesores vendoset një trajtë e shkurtër me funksion kundrinor.

...*per me ezun* mar n'ket jet (Urçnimet.f.3)


...*per me t'rrit* jan lodh e meten (Urçnimet f.6)

...*per me i fal* at ate sckret (Urçnimet f.11)

...*per me m'maitun* muu si corrin(Urçnimet f.12)

Formatin e trete të tipit *per t'punue* nuk e ndeshim në këtë botim të autorit.

### Statistikë për trajtat e pashtjelluar paskajore.



Tab.4  
("Urçnimet e Tenëot e t'sceites Kisc")

### **Përcjellorja.**

Përcjellorja është forma e pashtjelluar e cila tek Bytyçi gjendet e ndërtuar me dy t...  
por tasc nnryscei *tui punue...tui pevett, tui baamun* mgnii...(Urçnimet.f.4)

*tu e levdue* sckoje motin. (Urçnimet.f.3)

saλ ižninin *tui m'e sckue* (Urçnimet.f.7)

Gγγgi i Ɣotit â *tui i prit*

*Tui fol* kec me i vûmun lecen (Urçnimet.f.8)

*Tui scperpaal*, tui mormorue

E ne kryc mâa scpirt *tui çaan* (Urçnimet.f.9)

Por *tui vjeçun* gâan e hui (Urçnimet.f.11)

rajtat: *tui+ pjesore dhe tu'+ pjesore.*


## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

Trajta me *tui dhe pjesoren e foljes* është përdorur në 10 folje ndërsa trajta e shkutuar me *tu' dhe pjesoren e foljes* gjendet vetëm tek një 1 folje. Nuk ka gjurmë të përdorimit të përcjellores me *tue dhe pjesoren* gege pasi mendojmë se ka ruajtur format e vjetra të përcjellores dhe ka ecur në gjurmët e autorëve të vjetër.

Nga shembujt e ilustruar, vihet re se autori përdor rreshtimin e së njëjtës formë të pashtjelluar :... por tasc nnryscei *tui punue...tui pevett, tui baamun mgnii...*(Urdhnimet.f.4)

Të vetmin rast që kemi identifikuar me trajtën *tu' + pjesore gege* ndeshet në fjalinë: O me t'scipifna *tu'* u skarkue. (Urçnimet.f.9) Tek kjo folje autori ka përdorur edhe ndërtimin e formës joveprore të përcjellores.

### Statistikë për trajtat e pashtjelluar përcjellore.




Tab.

5

(“Urçnimet e Tenëot e t'sceites Kisc”)

Siç shihet autori përdor format e pashtjelluara paskajore me *punue* dhe *per me punue*, ku forma e parë është mbizotëruese me 75% . Nuk gjenden gjurmë të paskajores të tipit *per t'punue*. Ndue Bytyçi përdor edhe përcjelloren me formën *tui punue*. Ndërkohë që nuk përdor du trajtat e tjera të përcjellores dhe mohoren. Ky raport për 96 folje të vjela nga vepra paraqitet grafikisht.



Tab.6

(“Urçnimet e Tençot e t’sceites Kisc”)

**Ndajfolja.**

**Ëngjell Radoja.**

Ndajfolja është pjesë e pandryshueshme e ligjëratës, që përdoren pranë një foljeje, pranë një mbiemri e pranë një ndajfoljeje tjetër<sup>169</sup>. Ëngjell Radoja në veprën e tij përdor shumë ndajfolje një pjesë e të cilave me karakter dialektor si: tasc (tash), deri tasc (deri tash), giçher (githher), atie nelt (atje nelt), gnëksctù (njekshtu), ka-pák ka-pák, ( cisctù) çishtu, pergnimëm ( pernjimend) etj

Ndër ndajfoljet e kohës, bie në sy se mbizotërojnë kryesisht ato ndajfolje që mund të tregojnë kohën e kryerjes së veprimit lidhur me çastin e ligjëritimit. Me këtë kuptim përdoren në vepër ndajfoljet tash, deri tash, dje, nesër, sot, gjithher, gjithmon .

...tasc po m' duket tamam i kerscten.. (D.C.49)

...scka kee zâan ti *deri tasc* ? ( D.C. 52)

...sa *sot* giaal e *nesser* dekun. ( D.C.66)

Buken ton te perditscmen epna nee *sot* .(D.C.59)

A kena me nnieh deri *nesser* na s'e diim. (D.C.66)

Njëkohësisht autori përdor ndajfoljet gjithherë (giççher), gjithmonë ( giççmon) që tregojnë një kohë të papërcaktuar me saktësi.

...kto tria *giççher* do t'perpiccien basck.(D.C.107)

...kscctú praa t'lútena ci ai t'jeet *giççher* me nne me hir t'vet. (D.C.63)

Psé kaa me mmet *giççmón* e foort. (D.C.37)

Disa ndajfolje tregojnë vendin ku kryhet veprimi ose vendin e kryerjes së veprimit në një mënyrë të papërcaktuar. Kemi ndajfoljet: nnermiet,(ndermjet) giççkûn,(gjitthkund) atie(atje).

E nner davva ci atá i kiscin *nnermiet*, o me tier, giçget, e ku lypscin...(D.C.42)

Pse ççohet : Ci jee n'Ciel? Eotyn a s'âsct *giççkûn* (*gjitthkun*)?(D.C.61)

...prasctú ky divózion âsct happ *giççkûn*( *gjitthkun*). (D.C.81)

...hçpi n'Ciel per me na i cil dççrt e Parrisit, e *atie(atje)* âsct permîi giççç Eignt. (D.C.31)

Në vepër të tërheqin vëmendjen përdorimi i ndajfoljeve të mënyrës. Pjesa më e madhe e tyre janë ndajfolje të prejardhura të formuara me prapashtesën –isht (-isct), që kanë vlerën të togut të ndërtuar nga parafjala *me + emër* prej të cilit formohet ndajfolja ose të togut *si + emër* mbi kuptimin e të cilit formohet kjo ndajfolje.<sup>170</sup> Si të tilla shkëpusim ndajfoljet: basckarisct (bashkarisht), kscctenisct, scéitnisct (shejtnisht), tineisct (tinzisht), urtisct (urtisht).

...dahen hisse-hisse nnéer giççç t'kerscten e dççrgâs ci i gheoin *basckarisct*. (D.C.45)

...dot lussim Teneon me Urat, ci t'na apin nnim me jetue *kscctenisct* e *scéitnisct*. (D.C.54)

Sidomós n'dç mnçr: nó tuinmarr *tineisct* giâan e húei cundra vulness t'çott. (D.C.109)

...me e mlue, o me e msceh, por *urtisct*, kena iæen, bile e kena borc. (D.C.152)

Ndajfolje të tjera të parme a të përngjitura që shprehin mënyrë veprimi ndeshëm :

...s'flet kûn *kec* per tê, e me i arç per doresc si ban *kec*, por *mir*. ( D.C. 69)

Flasim *acik*: Kusc e bán been mîi gni giâa-senn ci nuk e di *mir*. (D.C.109)

<sup>169</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002,f,357.

<sup>170</sup> Po aty, f. 361.

...nuk do t'epena *teper fort* mas ksó jetet t'rreiscme. (D.C.66)  
Ti a i di *permennesc(permensh)* pes temelet e gaemenit? (D.C.82)  
Radoja përdor në vepër edhe ndajfolje përemërore. Këto ndajfolje, ashtu si edhe përemrat, nuk janë fjalë emërtuese, por treguese. Të tilla janë ndajfoljet përemërore pyetëse: ku, kur, pse, por edhe ndajfolje të tjera, përfshirë edhe ndajfoljet dialektore si: kështu, ashtu, cisctu, tash, tasc te knèi etj.  
*Kusc* t'ka kriue *tyy*, e t'kaa vûu n'ket jet? (D.C.7)  
Nieri *kuur* gnief Teneon, e dó, e i scerben? (D.C.10)  
*Psè* Eotyn âsct fort i mir, e i miscriscm, fort i dreit e besnik.(D.C.53)  
*Psè* ççona, te perdiccmen ? (D.C.66)  
Na bile *ksctú* bâim gni pun t'mir, et vieevscme per vetvedi. (D.C.55)  
*Tasc* po m'kalzó se scka lypim prei Eotit? (D.C.69)  
*Tasc te knèi* permîi scka po hiin me folun? (D.C.120)  
...atá *asctú* s'i bâin temenâa Emnit Teneot..(D.C.108)  
*Cisctú* âsct. Ti me diit se e ciètvsciocin n'selamet...(D.C.109)

### Pashko Babi

Si fjalë emërtuese, ndajfoljet kanë kuptim të mëvetësishëm leksikor. Nga ana kuptimore ata janë mjaft të ndryshme sepse tiparet dhe rrethanat që emërtojnë ato janë të shumta. Ndajfoljet lidhen në mënyrë të veçantë me mbiemrat. Këto dy klasa fjalësh afrohen jo vetëm nga kuptimi, por edhe nga veçori gramatikore<sup>171</sup>.

Përgjithësisht në veprën e Pashko Babit ndeshin ndajfolje, kryesisht vendi, mënyre e kohe. Më të përhapura janë ndajfoljet e parme e të përngjitura pa përjashtuar edhe formimin prapashtesor të kësaj klase fjale.

Ndajfoljet e vendit qëndrojnë zakonisht pranë një foljeje, pranë një emri prejfoljor të nyjzuar, pranë një mbiemri prejfoljor e pranë një pjesoreje<sup>172</sup>. Ndajfoljet e vendit mund të tregojnë vendin ku kryhet një veprim a ku ndodh një ngjarje duke u nisur nga pika orientuese. p.sh. *gnaty (njaty)*, *knnei (knej-këndej)*, *anei (anej)*, *pertei (pertej)*, *kerkah, per mrena, per s' lerghut, per sypri (per sypri)*, *an e kann (an e kand)*.

...e *aty* vûu at fmii e voit e e lscioi ner miet t'kalamave t'breghut. (V.55)

Pa kjo *εγμylin* ner miet t'kalamave e cioi gni asosc gi i sckoiscim *mrapa*, per me e marr. (V.55)

...por *masi* i zûune ato, do tier cioban descetne me i perëan.(V. 55)

...e dulne *perjascta* giçç ato mori mieasc n'tars t'mûscizave. (V.58)

...emra e eeee e tija prep si *perpara* u sueλ (V.58)

Hîgmu *sγysc* e ruju se m'vien e m'del *para* mas sodit. (V.59)

Noemi nuk descet me ja priisc maa, e *basck* murne rrughen prei Betlemmit. (V. 82)

...do ti merrscin kaaght e veta *mrapa* me eae. (V.96)

Prini Giuda i biri i tii *perpara* me i çan haber. (V. 48)

...ju descet me e giit *jasct* me t'kegie t'emres vet. (V. 54)

...e leu me *εγft* e pesckve mos t'hiin uji *mrênn*. (V.55)

...e triçet her aso maset *nelt* per pa vûu essap binaat per reçç, e *dγγ* binnat ne himit. (V.105)

Fagiet e mureve *permrenna* iscin vescu me drasa drujet cedro. (V. 105)

...aso ditet e *permprapa* mieλi kurr nuk maroi n'at veksc. (V.112)

Kriscti si i zuer giçç *perjascta*, muur me vedi por t'aan e t'amen e sai. (V. 124).

<sup>171</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë 2002, f.358.

<sup>172</sup> Po aty, f. 364.



Në vepër ndeshim ndajfolje vendi që tregojnë vendin e kryerjes së veprimit në një mënyrë pak a shumë të përcaktuar. Ndajfolja që ka denduri më të madhe përdorimi gjatë gjithë veprës është : gjithkund ( giççkûnn).

Mloja gi i vescei vënnit sceit *giççkûnn* permrenna iscte e giennisun. (V.62)

...e i ça t'maren *giççkûnn* e i ça besen. (V.97)

Te ndajfoljet e vendit dallohen edhe disa të tilla që përdoren nëpër fjali mohuese si pjesë e dytë përforcuese e mohimit si : *kerkunn*, *kunn*.

...sikur due ûne e *kerkunn* mos u ghabo. (V.22)

Salmi, per me i çan *Ëotit* lavd e nneer, e *kerkunn* nuk i ikte vulnnes *Ëotit*. (V.97)

...e as met *giâa* e *gnoom* n'lâann *kûnn*, as n'fuusc t'giçç *çeut*. ( V. 59)

Më shpesh ndeshim edhe ndajfoljet e kohës që tregon kryerjen e veprimit lidhur me çastin e ligjërimin. Kështu kemi rastet: *tasc* ( *tash*) ( V. 236), *deri tasc* ( *deri tash*) ( v. 82), *citasc* ( *qitash*) ( V. 260), *gnitasc* ( *njitash*) ( V. 272), *giççher* ( *gjithher*) ( V. 104), *per gni her* ( *per një her*) ( V. 200), *sod e pergiççmon* ( *sod e pergjithmon*) ( V. 109), *der me sod* ( V. 252), *n'diit sodit* ( V. 90), *ne nesret* ( V. 91), *masnesriit* ( V. 83), *te e vona* ( V. 88), *mannei* ( V. 10), *gniatie von* ( *njatje von*) ( V.52), *aty e mrapa* ( *aty e mrapa* ( V. 222), *prep e prep* ( V. 122).

...Saulit ju prisc keq fort, e muer peem, e *c'aso ditet e per mrapa* kurr ma nuk i suel syt nga Davidi..( V.90)

...sa kurr s'ka keen c'se âsct zan dÿrgnaja *deri me sode*, as kurr s'ka per t'keen, (V. 252)

Gnimenn *c'aty e mrapa* scum asisc kurr tiera heer nuk i dahescin.(V. 222)

...ke per t'paas misc me higher, e *nneser* nadie ke per tu ghii me buk. (V. 62)

U ciuun *ather* e u nisne disaa mii veet me Zorobabele. (V. 150)

*Sod* ktû as kam per t'hagher, as kam per t'pii. (V.126)

Ndajfolja e kohës *sod* (*sot*) ndeshet e formuar me bashkëtingëlloren e zëshme *d*.

Përdorimin e një ndajfoljeje të tillë formuar me bashkëtingëlloren e zëshme *d* e vëmë re edhe tek “Meshari” i Buzukut.

### Parafjalët.

#### **Ëngjëll Radoja.**

Parafjala shpreh marrëdhënie sintaksore varësie midis një emri, një numërori ose të një përemri në një rasë të caktuar dhe një gjymtyre tjetër në një togfjalësh. Klasifikimi i fjalëve sipas kriterit sintaksor përfaqëson ndarjen e tyre sipas rasave me të cilat përdoren.

Parafjala të rasës emërore tek Radoja ndeshim parafjalën *kah*, që në gramatikën e gjuhës shqipe nuk e gjejmë të klasifikuar. Parafjala *kah* shihet si një dukuri e të folmes së veriut prej së cilës mund të jetë ndikuar edhe autori. B.Bokshi shprehet se *kah* dhe *nga* duhet të trajtohen si dy parafjalë të ndryshme<sup>173</sup>.

Nuk ndeshim raste të përdorimit të parafjalëve nga, te(k).

E para âsct, ci t'sielena kah *Ëoja*... (D.C.79)

...

Mjaft dendur përdor autori parafjalët e rasës kallëzore. Pjesa më e madhe janë parafjalë të thjeshta për nga formimi. Parafjalët kryesore me të cilat është formuar

<sup>173</sup> B.Bokshi, *Periodizimi i ndryshimeve morfologjike të shqipes*, Prishtinë, 2010, f. 181-183.

kallëzorja në këtë vepër janë: *n' (në), me, per, pa, mîi (mbi), nen, nner (ndër), nneper, permîi (permbi)*.

A kee vuú- orôe ci na t'kersctent kuur bâim kryg nuk ðËona *n'emna* por *n'emem*. (D.C.23)

...me t'bâame porsi atá ci jan *n'kam* t'Teneot. (D.C.121)

...t'zilát *me* atê bâin gni vaðË. (D.C.36)

...psè i kerscteni *per* pun t'Pagheimit âsct nieri i bèekuem...(D.C.22)

Jo per dnim por *per* scelbim...(D.C.22)

Gniatá ci jetoín faret *paa* gaile, e *paa* kuides t'scirtit. (D.C.101)

...me baá bee *paa* men. (D.C.112)

Vikar'i Krisctit daan e kput nnogni giâa-sènd *mîi (mbi)* Fee, o *mîi (mbi)* Vepra ci do t'bessohet. (D.C.43)

...ata ci jan *nne* sietul t'ssai, kan gnièni me tietrin basckni. (D.C.32)

...giðË Sakramenet vûum prei ssî *nne* Ciobân t'vertet. (D.C.33)

...massi sdrypi *nner* ta rreia e drita e Spirtit Scèit. (D.C.26)

Kuur e krygeuune *nner* syË t'Ëois Bèkueme e ai dic *nner* gaeppe. (D.C.83)

...perpara se u daane *nneper* scekul...(D.C.26)

...me e marr *nneper* goi kot, e pa arsË. (D.C.105)

...kË massî kie rrahun e koronuem me kunor ferrasc *permîi* krye, kie ciue me gni kryg...(D.C.30)

Radoja në veprën e tij përdor edhe një numër të konsiderueshëm fjalësh shoqëruar me parafjalë të rasës rrjedhore. Gjatë vëzhgimit ndeshim parafjalën e parme prej (prej) si dhe parafjalë kryesisht me origjinë ndajfoljore. Në këtë vepër nuk kemi identifikuar parafjalë me origjinë emërore.

Si parafjala të parme në rrjedhore autori përdor: *prei (prej)*.

Ati nuk rieð prej Birit, as *prei* Scirtit Scèit, por Biri rieð *prei* Atit e Scirtit Scai rieð *prei* Atit e prej Birit. (D.C.16)

...t'vrassin nierin me hièkzii e n'pritt mas garçit sciiimun *prei* dialit ... (D.C.114)

Në vepër gjenden edhe parafjalë të rasës rrjedhore me prejardhje ndajfoljore si: *afër, perpara, mas, mrapa, jasct (jashtë), cundra (kundra)*.

...t'jeen kraila, mretna, eabitlar, atá s'jan tieter *afër* Teneot vec se kryma. (D.C.98)

Por scka do t'baim mâ fort ci urata jon t'jeet e mir *perpara* Ëotit? (D.C.57)

...e n'mos u gietscim bare *perpara* uratet. (D.C.57)

...sidomós n'koh t'Mescs e t'Urátve e *perpara* scèitit Sakramenn. (D.C.101)

...vrassin nierin me hièkzii e n'pritt *mas* garçit sciiimunn prej dialit. (D.C.114)

Kriscti i-a premtói sc'Pietrit e Papve ci vin mrapa ssi, ket hiir. (D.C.43).

...a mmûiti nnoigni assisc ci u gietne *jasct* Barket t'Noelit me psctue? (D.C.38)

...s'kan me pass kurr fuchii *cundra* ssaí. (D.C.37)

### **Pashko Babi.**

Tek vepra e Babit, në rasën emërore ndeshim të përdorur parafjalën *tu*, me vlerën e parafjalës *te* të shoqëruar në disa raste edhe nga pjesëza *deri*. Edhe kjo parafjalë nuk është klasifikuar në Gramatikën e gjuhës shqipe, pasi një parafjalë me karakter dialektor tepër e hershme. Sipas gjuhëtarit B.Bokshi parafjala *tu* është në periudhën midis shekujve XIII-XV<sup>174</sup>. Kjo gjë na bën të mendojmë se autori është ndikuar nga

---

<sup>174</sup> B.Bokshi, vep. e cit. f. 181-183.

shkrimet e mëparshme. Shumë rrallë ka përdorur edhe parafjalën *tek*. Nuk gjejmë gjurmë të përdorimit të parafjalëve *nga*, apo elementit dialektor *kah*.

...t'vlaenit e Sefit si voiten *tu* baba i vet...(V.48)

...Ele mrëni *tu* gni pus, ku t'bijat e Jetro doiscin me ju çan me pii ghriigve. (V.55)

...scko demel *tu* çžneghla e punen e sai kgiyre mir. (V.104)

...ka per ta ciue deri *tu* jeta e pasosune. (V. 190)

...me i sckue n'scpii eže me higher buk *tek* ai. (V.204)

Parafjalë të rasës kallëzore klasifikohen ato sit ë mbarë shqipes, por edhe me karakter dialektor.

Parafjala *pa* është antonimike me parafjalën *me* d.m.th. se“*tregon përgjithësisht mungesën, mosqënien, përjashtimin e një sendi a një dukurie*<sup>175</sup>”.

Tasc e pres deken *me* emmer t'paitueme....pak *me* hahe e nuk i kan vooit motit. (V.49)

...se i zili *pa* eori kapte sa dote veet. (V. 65)

Scum fial nuk bahen *pa* mkat. (V.104)

Parafjalë të tjera në rasën kallëzore ndeshim: n'ner , per, *mîi(mbi)*.

Mosei me psctue si, iku *n'çee* gi i çžoisicin Madian. (V.55)

...u pertriin varrt e mulait t'mlai e t'frigh si *ner* gin asctu *n'baktii* t'vënnit.(V.58)

Per pa u çžirr *tγγ ner sγγ* s'kam per tu duuk. (V.59)

...prei leetit e dasniet gi kiscte *per* të tre mûui e maitit n'scpii mscehun. (V.55)

Mosei mrapa *mas* fialet Eotit, derçi hinin *per* havaa. (V.59)

...e dγγ binaat ne himit t'zilat iscin gnena *per* priftni e tietra *per* popul. (V.105)

...sckuene sctat dit, e Aronni cioi doren e vet *mîi* uina t'Misirit. (V.58)

...sctrije doren tanne per mîi uui t'detit. (V.62)

### Parafjalë të rasës rrjedhore.

#### Parafjalë të *parme*.

...i sckoi lodia *prei sγγsc*, *prei* malit e scënnit gi i pat eemra. (V.49)

Britne ather *prei* s'kegiet gi i rreçžoi. (V.62)

Një dukuri që vëmë re tek vepra e Babit është se disa herë përdoret parafjala *prei* (*prej*) me vlerë sinonimike të parafjalës *drejt*.

...Mosei prep sctrîni doren *prei* Ciellet e Misirin e eaptoi terr i eii. (V. 59)

Noemi nuk desct me ja prisc maa, e basck murne rrughen *prej* Betlemmit. (V. 82)

Sefi ather u ciue me scepit, kapi fmiin e t'amen e tii gnaso nâtet, e mûer rrughen *prei* Misirit. (V.179)

Parafjalë të prejardhura emërore.

...kuur paa Kriscti gni her se i iscte vûu haalk i maçž mrapa, u gnit n'maje t'gni malit. (V. 195)

#### Parafjalë ndajfoljore.

E pveti Kraili mas bisedve gi bane perpara..(V.49)

*Mrënna* sarait i hîine Faraonit. (V.58)

...e *mrënna* konagieve t'giçž populit tii, e mrënna furrave tÿne e sofrave tÿne.(V.58)

Mosri cioi eaan *para* Eotit e ju lut...(V.58)

Po e kah e kam une gi me gieet hater e nneer *para* sγγve tuei? (V. 83)

E Davidi veet gi ezte *para* priftiis saeen e vet nuk e lsciote doret. (V. 96)

<sup>175</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia, Tiranë 2002, f.392.

...gi iscin per hysmet t'sai t'laescme t'mlooive *perpara* soijet e ξξα....( V. 101)  
Na po vim *mas* teje n'zee tann. (V.82)  
Zuer *jascta* ξξesit kryet e Olofernit. (V. 138)  
...gi discin si me u sckoog e me u setγγ *perjascta* murit. (V.105)  
...e kuur ti maroin ajo dit, e motin e vet, vorroje per brfi mejet. (V.124)  
...pse Eoti po lufton per tē *kunnra* nesc. (V.62)  
E si e scdriviloι raa n'at vënn kú iscte sckrue: Scpirti i Eotit âset *syprī* mejet. (V.191)

### **Lidhëzat.**

#### **Ëngjëll Radoja.**

Lidhëza i takon klasës së fjalëve të pandryshueshme dhe si fjalë shërbyese përdoret për të lidhur dy njësi sintaksore. Veçoria themelore e lidhëzave është funksioni lidhës<sup>176</sup>.

Radoja përdor jo shumë shpesh lidhëzat bashkërenditëse. Gjatë analizës ndeshëm lidhëzat:

**Lidhëza këpujore:** e , edhe , as, sikur.

...me liξ *e* me bâa mgñii, e t'bâame e giξξ saa scerrii jan t'dialit. (D.C.103)

Pagheimi pos hirit ci na bân t'birt e Teneot, na nnimón *eξè* me i-a vûu kamen maξsetiis e lakmiis t'ksai jet. (D.C.176)

...psè *sikurse* ξξacc, te tre jan giξξgñi e kan gñi natyr t'paadame...(D.C.16)

...psè asctú s'gniofin *as* Eot, *as* Fee, *as* arsyē. (D.C.128)

**Veçuese:** o...o,

...ci s'i nnighioin assai, *o* ci pastafat largohen prei msimeve t'ssai, *o* ci dahen prei scêtes Fee. (D.C.38)

**Kundërshtuese** por, vecse.

Jó per dnim, *por* per scelbim. (D.C.22)

Jó, s'guzon askusc n'scekuλ, *por* giξξ t'zilit i duhet me i pelciye paa kurr far kunnersctimit. (D.C.43)

...e me giξξ foorz t'scpirtit tēm bessói se s'âsct tieter *vec se* gñi Eot i vetem..(D.C.27)

**Përmbyllëse:** prannèi (prandaj).

...mos t'guzoin me i munghue as m'gñi fial t'vetme: *prannèi* jan dymçet Artikui. (D.C.26)

**Lidhëza nënrënditëse.**

**Ftilluese:** se

A s'e diin *se* Eotyn ξξot: (D.C.128)

**Kohore:** ciγsc se

..nieret t'mirt e t'kciit ci kan ken n'scekuλ *ciγsc se* âsct zâan-fiiλ..(D.C.31)

**Krahasore:** se, porsī, sikur.

..bilè s'kaa ken n'scekuλ kreatyr mâ e dliir *se* kió, e zila kie ruit prei Senēot. (D.C.19)

..atá ci mâ fort i besoin dialit *se* Teneot ci kaa fol giξξmon. (D.C.101)

Eight n'ân t'diaξξt t'Atit pusctúescm *porsī* gñi i vetmi Biri i tii. (D.C.31)

---

<sup>176</sup> ASHSH, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, Morfologjia, Tiranë 2002, f.397.



Ti paske kuitue *praa* mir per mue. (V.149)

**Lidhëza nënrënditëse.**

**Ftilluese:** gi (që), se

Ato *gi* kiene barkut Giakobbit...(V.54)

Ai *gi* e psctet vedin n'nnim t'Ëotit...(V.92)

...mrapa ta diim *se* atii do ti nnighioin. (V.76)

**Kohore:** deri sa, por sa, kur.

Por Giakobbi nuk dote me ju paas bees *deri sa* hîine e ja kalzuene fije per fije t'giçç punen e tii. (V. 48)

Ather *por sa* nnieu, i ctoi fial Esters...(V.153)

*Kuur* prenoi diełi, e fiłoi koha e mrâames, i ciuun para t'giçç t'smutit...(V.194)

Simoni, ato gi ginnescin me tê, ju vûun mrapa, e *kuur* e getne ççane...(V.193)

Zeni vên *deri sa* t'sckoin n'eaman t'korrunit...(V.210)

**Vendore :** ku, aty ku.

...raa n'at vên *kû* iscte sckrue: Scpirti i Ëotit asct sypri tejet. (V.191)

...me gni asi sceherliisc t'atit krahit *kû* isc veet, e ai e ctoi gni katunn. (V.233)

...Ati i jyt gi scf eçe *aty kû* s'mrrîn sγ̇ robit, ka per ta scperblȳe. (V.198)

**Krahasore-mënyrore:** sikur, se sa , si.

E motra e atii fmiis iscte vûu mrapa per me vûu oroe *se si* po del puna e tii. (V.55)

Davidi, *sikur* e kiscte paas fiłue c'aso heret gi pat cioban, *asctu* uidisi do káagh scêite...(V.97)

*Sikur* ban gȳmȳri prusc, e druja eierm, *gnasctu* nieri peemtaar nneee scamaten. (V.105)

Tobia ja zuer, e i dau, *sikur* i çça, n'gnen aan per ilacc. (V.124)

Tobia i rii i bisedoi prinnve vet *se sa* fort i iscte gieet, e *sa* mukajet i iscte bâa...(V.128)

...fiłoi me ja laagh me lod gi i derçescin *si* krue, e ja scîite me flok t'krees vet...(V.204)

Disave kurrsi mennia nuk ja merrte se si Kriscti ju baa vesct? (V.219)

**Shkakore: perse, se**

Frigh mos kii:Ulu n'Misir *perse* atie une krye kam me t'bâa i t'gni nahijês maçe. (V.48)

Mos scikio ti tasc, *perse* ksctû âsct miir per nee me krye t'giçç...(V.182)

Higiu prei mejet, *se* jam nieri mkatnuer. (V.194)

**Lejore:** ndonëse, sikurse, josse

Une po t'nap n'vên t'sai gni eçe ma t'miir, *jose* per ne paasc se t'bieh ma mir po t'ap pare . (V.114)

**Qëllimore:** n'mnȳr ci (në myrë që),

**Rrjedhimore:**

...e kapi t'sctuemit e vet, e n'sγ̇ t'giççve u vûu e sckoi, *kag sa* t'giçç iscin habit. (D.C.195)



### **Përfundime të kreut të shtatë.**

Kreu i shtatë trajton veçoritë dhe kategoritë gramatikore të pjesëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme të ligjëratës që i ndeshim në veprat e tre autorëve.

Gjatë trajtimit të secilës prej pjesëve të ligjëratës janë konstatuar këto përfundime:

Autorët kanë përdorur emra të tri gjinive : mashkullorë, femërorë por me një reduktim të emrave të gjinisë asnjajëse, gjë që vërteton faktin se procesi i zhdukjes së gjinisë asnjajëse në shqipe kishte filluar, dhe gjenden vetëm disa emra abstrakt si : të zezat, të korrumat etj, dhe emrat krye, petka. Dukuri tjetër është edhe dygjinisia, një dukuri e gegërishtes, që emrat e gjinisë mashkullore tema e të cilëve del me prapashtesën *-e* dhe *-ra*, në numrin shumës, përdoren si emra të gjinisë femërore.

Shumësi i emrave është i larmishëm, sidomos tek emrat e gjinisë mashkullore.

Në përdorimi e emrave sipas rasave, veçojmë rastet e rrjedhore pa parafjalë *vath florinit, buk elbit, ark druje* etj apo rrjedhorja që në trajtën e shquar njëjës që formon në të shumtën me *-t prei ftyret toks, prei doret, prei robniet* etj dhe që gjenden mjaft shpesh tek vepra e Pashko Babit dhe më rrallë tek Radoja.

Autorët përdorn mbiemrat në të tria shkallët. Shkallë më përfaqësuese është pohorja. Shkalla krahasore ndërtohet me trajtën *gege ma + mbiemrin përkatësën* ndërsa shkalla sipërore më së shumti ndërtohet me ndajfoljen fort dhe mbiemrin në shkallën pohore.

Në përdorimin e përemrave krahasa trajtave të ngjashme me ato të gjuhës së sotme gjejmë edhe mjaft trajta dialektore sidomos tek përemrat vetorë por edhe tek ata pronor e vetvetorë.

Folja sipjesë e ndryshueshme e ligjëratës është analizuar sipas mënyrave, kohëve e zgjedhimeve përkatëse duke pasqyruar dhe interpretuar format e ndryshme që merr kjo klasë fjale. Numri i foljeve sipas mënyrave dhe kohëve përkatëse ndeshet i reduktuar pasi autorët kanë parapëlqyer të përdorin më shumë format e pashtjelluara, si dukuri i shkrimeve të gegërishtes. Janë shënuar trajtat përfaqësuese të formave të pashtjelluara krahasimisht të përdorura nga tre autorët shoqëruar dhe me statistika përkatëse.

Në pjesën e fundit kemi trajtuar edhe pjesët e pandryshueshme të ligjëratës konkretisht ndajfoljet, parafjalët dhe lidhëzat. Na ra në sy përdorimi i mjaft ndajfoljeve dialektore *gnaty (njaty), knnei (knej-kënde), anei (anej), pertei (pertej), kerkah, per mrena, per s' lerghut, per sypri (per sypri), an e kann (an e kand) etj*. Përsa i përket parafjalëve ndeshim më shumë parafjalëtë rasës kallëzore dhe rrjedhore. Lidhëzat nuk përdoren shumë në këto vepra, prandaj dhe trajtimi i tyre nuk përbën një dimension të gjërë studimi.



### PERFUNDIME

Në punimin kushtuar autorëve veriorë objektivi parësor kishim njohjen dhe analizimi e larmisë së formave dhe kuptimeve gramatikore, sipas mënyrave, mbaresave të tyre që dalin sipas kategorive gramatikore dhe zhvillimet e tyre të brendshme. Zgjedhëm përkatësisht tekstet “*Dotrina e kerscten me msime e scpiegime*” e Ëngjëll Radojës, “*Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree*” të Pashko Babit, “*Urdhnimet e Tenzot e t’sceites kisc*” të Ndue Bytyçit si tekste të një rëndësie të veçantë midis teksteve të vjetra që janë bërë objekt studimi në shkencat albanologjike.

Në fillim të punimit, pasqyruam një vështrim të përgjithshëm mbi historinë e shkrimeve shqipe, ku arritëm në konkluzionin se gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë u krijuan parametra të reja në kulturë art e sidomos në lëvrimin e gjuhës shqipe, ku si pikësypnim i përfaqësuesve u bë një rritje e ndërgjegjës kombëtare.

Me të drejtë Çabej shprehet se botimi i librave në gjuhën shqipe prej klerit katolik shqiptar, është një veprimtari shumë e vyer gjatë disa shekujve dhe i shërbeu mbarë kombit shqiptar.<sup>177</sup>

Tekstet që kemi në studim, kanë një rëndësi të veçantë për vlerat që mbartin në aspektin gjuhësor, që hedhin gjurmë në historinë e shkrimit të shqipes. Botuar në dialektin e gegërishtes, ato mund të konsiderohen si një burim i rëndësishëm për shkencat gjuhësore që studiojnë zhvillimin e gjuhës shqipe në periudha të ndryshme kohore.

Gjatë analizës së teksteve, padyshim që janë konkluduar një sërë çështjesh të rëndësishme, që lidhen më rrafshet gjuhës, duke filluar që nga një vëzhgim fonetik, (alfabetin dhe grafinë e përdorur nga autorët veriorë të shekullit të nëntëmbëdhjetë), leksikor, fjalëformues e morfologjik. Nga një studim yni, por edhe duke u mbështetur tek një literaturë shteruese, arritëm në këto përfundime:

**Grafia e shkrimit** tek autorët Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi, karakterizohet nga grafema polivalente dhe nga grafema të përbëra, të cila e bëjnë që kjo grafi të jetë e rënduar dhe të shfaqë vështirësi edhe në lexim.

Gjatë studimit, vihet re se autorët Radoja, Babi dhe Bytyçi përdorin 23 shkronja të alfabetit latin dhe shenjat e veçanta të cilat i ndeshim tek Bogdani. Autorët kanë përdorur shenja grafike që nuk ekzistonin as në alfabetin latin, as në atë Italian, grafemat *ç* për *dh*, *çç* për *dh \th* ishin huazuar nga alfabeti grek, ndërsa *γ(y)* nga sllavishtja. Këto shkronja të veçanta autorët i kishin ruajtur nga autorët pararendës.

Sipas Çabejt<sup>178</sup>, bazuar mbi të dhënat e historisë së gjuhës dhe shkrimit të shqipes, *shfrytëzimi i këtyre shenjave lidhet me një nismë individuale të autorëve dhe jo me një ndikim kulturor të mirëfilltë*. Mungesa e këtyre shenjave grafike bëri që këta autorë t’i huazonin nga alfabetet e tjera, konkretisht nga ai grek dhe sllav, duke ndjekur kështu traditën shkrimore mbështetur tek njeri-tjetri.

Ndryshe nga autorët pararendës, shkrimtarët e shekullit XIX-të veprat e të cilëve kemi në studim, dallojnë në mënyrë grafike zanoret hundore dukuri që tek autorët e vjetër, sipas studimeve të realizuara, nuk ka qënë gjithnjë i dallueshëm.

Dyfishojnë në mjaft raste zanoret <aa>, <ee>, <ii> <γγ> për të shënuar gjatësinë e tyre.

<sup>177</sup> Çabej, Eqrem, Mëshari i Gjon Buzukut, pjesa e parë, f.22-23.

Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi në sistemet shkrimore që përdorin paraqiten shumë afër njëri-tjetrit, por vërehen dhe ndikime. Kështu Radoja është më afër alfabetit të Bogdanit. Babi dhe Bytyçi alfabeti paraqitet më i stabilizuar pasi autorët dallojnë qartë disa shkronja: *g* nga *gj*, *u* nga *v*, *l* nga *ll*, *r* nga *rr*, dukuri të cilën nuk e vëmë re tek Radoja.

Gjatë **analizës së dukurive fonetike** vështruar në veprat: “Dotrina e kerscten me msime e scpiegime” e Ëngjëll Radojës, “Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree” të Pashko Babit, “Urçnimet e Tenzot e t’sceites kisc” të Ndue Bytyçit vumë re se kanë shumë elemente të përbashkëta mes tyre, duke qenë se autorët shkruajnë në dialektin e gegërishtes.

Por, nuk duhet veçuar edhe fakti se mes këtyre autorëve, ka edhe dallime të veçorive fonetike që karakterizojnë shkrimet e tyre.

-Theksi i cili shfaqet si një fenomen fonetik që ka qenë dhe është një tipar i gegërishtes është i përdorur tek të tre autorët. Ata përdorin në veprat e tyre theksin e mprehtë dhe atë hundor. Tek Pashko Babi vërehet një reduktim i përdorimit të theksit të mprehtë. Nuk mund të themi të njëjtën gjë për theksin hundor i cili përdoret dendur si tek Babi dhe Radoja. Bytyçi përdor më rrallë theksin hundor dhe më shpesh theksin e mprehtë.

Dyfishojnë zanoret për të shënuar gjatësinë si: *pâa*, *bree*, *truun*, *kee*, *viin* etj.

Zanoren *ë* të patheksuar shpesh nuk e përdorin në trup e në fund të fjalës: *prov*, *mbiemër*, *t’verbt*, *kurr*, *un*, *mson* etj. ndonëse grafikisht nuk e dallojnë.

Përgjithësisht shkruajnë të plota grupet e zanoreve të cilat shfaqen më shumë tek foljet, mbiemra: *munnue*, *diftue*, *varrueme*, *sckuene*, *mue*, si dhe tek disa emra prejfoljor: *t’sckruemit*, *t’bessuemit*.

*Togu zanor ie, ye* autorët i shkruajnë të plotë. Ata nuk i reduktojnë në *i* siç ndodh tek një grup autorësh veriorë si: *miel* (*miell*), *dielin* (*diellin*), *kççyene* (*kthyene*), *krye* (*krye*), *nnryeme* (*nnryeme*), *scperblye* (*shperblye*) etj. Këtu përjashtojmë vetëm fjalën *dili* (*dilli*) tek Radoja që autori e asimilon. Nuk mund të themi me siguri nëse kjo është një veçori e autorit apo një gabim gjatë kohës kur vepra është shtypur, pavarësisht se në vepër e gjejmë disa herë të përdorur në këtë trajtë, ndikim i ligjërit të folur të gegërishtes.

Grupet e bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*, *ng*, Radoja herë i shkruan të plotë dhe herë i asimilojnë *mleçç* (*mledh*), *mrâames*, *kamt*, *pesmçet* (*pemdhet*), *ngahtrres*, *cundra* etj. Pashko Babi dhe Ndue Bytyçi grupin *mb* e asimilojnë në *m* dhe nuk e paraqesin me dyfishimin e kësaj bashkëtingëlloreje *mm* siç e paraqet Radoja; grupin *nd* e asimilojnë në *n*, *nn*. Grupin *ng* të tre autorët e shkruajnë të plotë.

Tek Radoja dhe Babi dallohet dukuria fonetike me karakter dialektor ku faringalja *h* buzurizohet në *f*.

Radoja në veprën e tij e përdor edhe grupin *vo* si veçori e dialektit të veriut.

Bashkëtingëlloret *th/dh* përgjithësisht ruhen mirë dhe nuk alternohen me njëra-tjetrën në asnjë rast në veprën e Ndue Bytyçi. Dy autorët e tjerë nuk janë të kujdesshëm në shënimin e kësaj bashkëtingëlloreje.

Ndryshe nga autorët pararendës, tek këta tre autorë të shekullit XIX, dallojmë dy veçori:

1. nuk ndeshim në asnjë shenjë grafike për zanoren /ë/ dhe në përgjithësi vërejmë se në disa pozicione shënohet me grafemën /e/.
2. tek këto autorë bëhet i dukshëm asimilimi i grupeve të bashkëtingëlloreve *mb*, *nd*. që realizohet i plotë tek Babi e Bytyçi.

Në këto vepra kemi të bëjmë me disa veçori fonetike të gegërishtes që përgjithësisht shfaqen me elemente të përbashkëta tek të tre autorët.

Në **aspektin leksikor**, hulumtimi i gjuhës së veprës së tre autorëve në planin gjuhësor, pikërisht në identifikimin e fjalëve neologjizma, atyre me burim të huaj, disa fjalëve krahinore dhe përdorimit të tyre, nxjerr në pah prirjet dhe veçoritë e secilit prej autorëve. Radoja, Babi dhe Bytyçi në krijimtarinë e tyre shfaqin shumë tipare të përbashkëta, nisur kjo edhe nga fakti që këta shkrimtarë kanë shkruar në të njëjtën periudhë kohore.

Studimi ynë konstaton se autorët e kanë të mbingarkuar leksikun e tyre me turqizma por edhe me latinizma e italianizma. Në këtë mes duhen veçuar posaçërisht fjalët me burim turk, të cilat dallohen për vlerat shprehëse në veprat. Konstatojmë fjalë të cilat janë dukuri e të tre autorëve. Kështu mund të përmendim fjalët : *dynja, adet, amanet, reshper* etj që vijnë e përsëriten në tri veprat.

Neologjizmat janë të pakta. Siç e sipërcituam, është e vështirë të përcaktohet saktësisht nëse këto neologjizma u përkasin këtyre autorëve apo mund të gjejmë gjurmë përdorimi edhe tek ndonjë autor tjetër paraardhës. Kjo është edhe arsyeja që jemi shfaqur “të kursyer” në trajtimin e kësaj çështjeje. Pjesa më e madhe e formimit të neologjizmave është krijuar nga bashkimi i dy fjalëve si : *baamirt, hall-keq, gjakbamt*, apo edhe me prapashtesim si: *bestart, trimnon, gojtart, anejshëm trimaç, mentar* etj. Përgjithësisht janë qymtuar në veprat e Ëngjëll Radojës dhe Pashko Babit. Po ashtu pas përdorimit të fjalëve që përdoren edhe sot ndeshim edhe fjalë të leksiku krahinor tek dy autorët e parë ku mund të përfshihen në fjalorin e gjuhës shqipe por, edhe prej atyre që kanë një përdorim të kufizuar dialektor.

Në **rrafshim morfologjik**, gërshëtuar edhe me një përshkrim sinkronik e diakronik të dukurive gjuhësore, punimi ynë u fokusua në pjesët e ndryshueshme dhe të pandryshueshme të pjesëve të ligjëratës.

Që në fillim vihet re mbizotërimi i sistemit *tri gjinish* në vepra, por me një reduktim të emrave të gjinisë asnjajëse. Në vepra, emrat e gjinisë asnjajëse, *uji(ujtë), mish(mishtë)*, I ndeshim si emra të gjinisë mashkullore, gjë që vërteton faktin se procesi i zhdukjes së gjinisë asnjajëse në shqipe kishte filluar, dhe gjenden vetëm disa emra abstrakt si : *të zezat, të korrinat* etj, dhe emrat *krye, petka*. Përsa i përket emrave në gjininë mashkullore vëmë re që tek Radoja gjendet e përdorur trajta arkaike *corp-i* dhe jo trajta më e re *trup-i*. Por që të dyja format e emërtuara përfshihen në emra të gjinisë mashkullore. Mes të tjerash veçojmë disa emra që nuk dalin në vepër në të njëjtën gjini që janë sot. Kështu emri i gjinisë mashkullore *lig-i* në veprën e Pashko Babit nuk e formon trajtën e emrit me mbaresën –i por me mbaresën –a *ligia*. Ndërsa tek Ëngjëll Radoja e ndeshim të përdorur vetëm në rasën kallëzore, si një emër të përveçëm, në trajtën: nuk e ruajmë *Ligen* e tii. Po kështu me trajtat e gjinisë femërore del edhe emri *lot-i* me formën *lodja* ( krishti i satoi *lodja*) Në analogji me emrat e mësipërm edhe emri profeti del në formën profeta (asat ai *profeta*) ashtu sikurse fjalët: *dergia, scordja, druja, cila, droja, scperblesa, shndetja*.

Përsa i përket kategorisë së *shumësit të emrave*, vumë re disa veçori të formimit të shumësit të emrave me prapashtesë, me metaforë, me ndërrim tingujsh etj duke

paraqitur një llojshmëri përdorimesh. Ajo që mund ta quajmë si më të veçantë është dallimi i shumësit të disa emrave si:

a) emrat *ishull-qiell det-i* i cili në pajtim me fenomenin fonetik duhet ta formojnë shumësin me palatalizimin e *ll-së* në *-j* ashtu siç e formojnë këtë shumës një grup emrash si : shekull-shekuj; mashkull-mashkuj; grumbull-grumbuj etj. Këta e formojnë shumësin me prapashtesën *-a* : *ishullat, ciellat, deeta*.

b) emri *Zot-i* që klasifikohet zakonisht si emër i përveçëm e gjejmë në formën shumës me trajtën *Zot-a* (sceitnit nuk i besuam, se janë *zota* por micct e zotit...(D.C.104) ...me aso for dhunsc nneeroiscin *zota*...(Vakinat)

c) Te veprat e autorë në shqyrtim ndeshim shumësin e emrit *petku* të formuar me prapashtesën trajtëformuese *-a petka*.

d) përse i përket emrit *nip-i* i cili shumësin e formon me prapashtesën *-a*, vëmë re se në vepër nuk gjendet asnjëherë në këtë trajtë, por përkundrazi autori Pashko Babi përdor format *t'nip*\ *nipniin* psh ...Giakobbi i puthi *t'nip* e vet...(V.49) \ ...e *nipniin* e vet...(V.49).

Në *sistemin raser*, konkluduar se në shkrimet e këtyre autorëve, ruhet sistemi prej pesë rasash: emërore, gjinore, dhanore, rrjedhore duke lënë jashtë rasën thirrore e vendore. Realisht, rasa vendore është përdorur nga pararendësit e gjuhës shqipe, por do të jenë autorët gegë të shekullit të nëntëmbëdhjetë, të cilët nuk e përdoret emrin në rasën vendore. Rasën rrjedhore në trajtën e shquar njëjës tek vepra e Pashko Babit formohet zakonisht me mbasesën *-t* dhe me parafjalë: *jasct barket* (V.17) *prei robniet* (V.22) Disa prej këtyre emrave të gjinisë femërore në rasën rrjedhore i gjejmë edhe me mbasesën *-s*; *prei gojes tii*... (V.193)

Shumë e përdorur në vepër është edhe rrjedhorja pa parafjalë. Kemi rastet: *vâaçç* (vath florinit) florinit, *takame sermit, florinit, gni duhi eret etj*.

Një vend të konsiderueshëm zënë edhe përdorimi i rasave emërore e kallëzore më parafjalë. Parafjalët *ndaj, me, per, nner, permi*, në këto vepra, sidomos tek Radoja e Babi, janë përdorur të shoqëruar me emra në kallëzore, ndërsa përse i përket rasës rrjedhore Babi përdor parafjalë të ndryshme si: *prej, përpara, jashtë, përreth* etj, ndërsa Radoja shfaq një mbizotërim të përdorimit të parafjalës *prej*, thuajse në çdo rast.

Në vepra ndeshet edhe dukuria me karakter morfologjiko-drejtshkrimor: *rënia e tingullit -t pas mbasesës -ve dhe njëjtësimi formal i gjinore dhe dhanore së shquar shumës me gjinoren dhe dhanoren e pashquar*.<sup>179</sup>

Kështu lakimi i emrave në numrin shumës në gjinore dhanore, tek Radoja dalin me mbasesën *-ve* të cilët mbështetur në rregull e marrin ata emra që dalin me temë në zanore.

...ci i scerbein gni hisse *t'fryteve e t'dobiive* t'kcija i scerbein (D.C. 171)

Ati i miscriscm *i kerctenve* t'mir (D.C.24)

Emrat në gjinore, *t'fryteve e t'dobiive i kerctenve* nga kuptimi janë të shquar dhe qëndrojnë në vend të formave më të vjetra *t'frytevet e t'dobiivet i kerctenvet*.

<sup>179</sup> ASHSH, Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 2002, f. 131.

Ky fenomen nuk ndodh gjithnjë në vepër pasi dallojmë edhe rastet e emrit me mbaresën –vet:

...me gheue Scioccniiin e Scëitnavet (*sheitnavet*). (D.C.36)

...Per Ciobant e scpirtnavet (*shpirtnavet*) tona, per print ton...(D.C.58)

...nima e giçë mcatnorvet (*mkatnorvet*), atyne, ci t' këzëhen me giçë semer .(D.C.77)

....m'gni scpeλ n'miedis dy sctaevet(*shtazvet*). (D.C. 82)

Në raport vihet re se emrat me mbaresën –vet janë më të përdorur se ato me mbaresën –ve. Kjo na rezulton se fenomeni i njëjtësimit të rasave gjinore e dhanore nuk ishte kryer në këtë periudhë.

Një dukuri e tillë ndeshet edhe tek Babi, por ndryshe nga Radoja që shfaq luhatje në përdorimin e mbaresave me –vet dhe –ve kemi rastet:

Pos *t'diilave* a do t'mmahen tiera festa? (V. 116)

...jo me i lakmue *essapeve* tiera.(V.27)

...nuk pescion ag rân sa e kegia e *mkateve* tona. (V.137)

Fagiet e *mureve* permrenna iscin me drasa...(V. 105)

...mannei ju çëa *discepuive* tii...(V.242)

*Mbiemri*, si pjesë e ndryshueshme e ligjëratës, sipas pikëpamjes së strukturës, del më së shumti i përdorur në dy trajta: në të parme e të prejardhur, e shumë më rrallë si të përbërë. Mbiemrat e parmë, sipas pikëpamjes së strukturës së tyre paraqiten në dy trajta: të panyjshëm dhe të nyjshëm.

- Në klasifikimi i mbiemrave sipas formimit dallojmë mbiemra të thjeshtë ( parmë): i mir (f.7 ); sceit(f.17 ); t'maçe (f. 23); e dliir (f. 43); t'foort (f. 44); idet e mira (f.48 ); grig e voghel (f. 53); (fmii) t'gnom (f.104);
- Mbiemra të prejardhur :
  - me prapashtesën –shëm (-scm): *i hiescm* (f.7 ); *t'nevoiscme* (f.14 ); *hyinuscm* (f.17 ); *e kuluescme* (f. 19); *i miscriiscm* (f.30 ) *scëitnuescm* (f. 30); *t'terrscm* *Me prapashtesën –m* (dhe mbaresë).*t'Cois Béekueme* (f.14 ); *prei robniet t'dialit malkuem* (f.18 ); *mcat t'helmuem* (f. 18); *Fee e bekueme* (f. 69)
  - Me parashtesën pa- : *Jan t'paazaanfiil t'paa-sosun...natyr t'paadaame* (f. 16); *jeten e paa-sosme* (f. 18); *me giak t'paa-scmuem* (f. 18); *paa-gabuescme* (f.36 ); *prei dekey s'paa-pritun* (f. 72) *jeten e pasosun* (f.228):*t'pa-terbiete* (f.10) .Mes tyre më të lashtit janë të panyjshmit, pra ata që nuk janë të pajisur me nyje të përparme. Por gjatë vëzhgimit të përdorimit të tyre, mbiemrat me nyje të përparme janë përdorur më shpesh në veprat e studiuara.
- Mes të tjerash, mbiemrat e nyjshëm, shkrimtarët veriorë të shekullit nëntëmbëdhjetë, i kanë shënuar shpeshherë përpara emrave, siç duket kjo dukuri e ndikuar nga latinishtja. Kështu kemi rastet : i maçi Perennii, Ćotyn kriuesi I cieλs...(f.7)...o e amla Virgini Mrii (f 80)...Permii gniat t'maçë urçnim (f 89) / *T'maçe fees* i bain çunii Nnen t'paa fee per haimalii ( çet urçnimet e Scëites Kisc f. 14)/ *Ka prei Ćotit t'maçe rrfee/* Ci pat Kami *per t'maç dnim*( çet urçnimet e Scëites Kisc f. 7)/ *I vnnon scpiritit t'maçe lece.*( çet urçnimet e Scëites Kisc f. 12)



- Një dukuri tjetër është përdorimi në gegërisht i gjinisë asnjajëse të mbiemrave foljor në vend të emrit abstrakt si: *të ardhunit tand, të dashtunit Jezus/...t'biirt* e Tensot, e basc t'dasctunit e Jeeu Krisctit. (D.C .27) *Emnat e nnierëve e t'perbueunit e vogliis (V.97)*

Mbiemrat e skeduar nga veprat shoqërohen në shkallë të ndryshme: pohore, krahasore dhe siperore. Tek të tre autorët shkalla e parë, pohorja, që e difton cilësinë e frymorit, sendit a objektit në mënyrë të drejtpërdrejtë, përfaqësohet me përdorimin më të madh në përdorimit .Shkalla e dytë, krahasorja, e difton cilësinë duke e krahasuar me të tjerët. Në vepra, mbiemri në shkallën krahasore shoqërohet me pjesëzat ma (më), acc, kacc psh:gni drit cacc e maçe (f. 11) nuk asct ma plak, as *ma i maçç*, as *ma i mir*, as *ma i urt*, as *ma i pusctúescm* se Biri...(f.16); bile s'kaa keen n'scekuł kreatyr *ma e dliir* se kio (f.19 ); *urata mâ e mira e mâ e eghieçuna* (f.58 ); me gni Bab *cacc t'dasctun* (f. 60); e t\miscriscm..Coti ci asct *acc i maçç*(f. 68) ; scium *mâ i kêc* e *ma i scemtuum* (f.72). Shkalla e trete, sipërore, shprehet duke e dhënë cilësinë e emrit në shkallën më të lartë. Këtu gjendet i shoqëruar me fjalën përforcuese fort psh:Asct gni temel *fort i nelt* (f.15); I kaa çan dy pusctete *fort t'nalta* e *t'mçaja* (f.37 ); ai do t'jeet nieri *fort i kec* (f. 49 ); Pse Cotyn âsct *fort i mir, e i miscriscm, fort i dreit e besnik*(f. 53); Bab *fort i dasctun*(f.70)

- Përemri, si pjese e ndryshueshme e ligjeratës, nuk ka dallim të veçantë nga e folmja e gegërishtes veriore. Janë vënë re elemente të përbashkëta por edhe dallime tek tre autorët:

a)Te përemrat vetor , numri njëjës në vetën e parë, paraqitet në dy forma apo trajta të ndryshme si : *un* dhe *une*.

Në rasën kallëzore dhe dhanore ky përemër del në formën *mue*. Në pjesën më të madhe të rasteve në rasën kallëzore del e shoqëruar me parafjalë: *per mue*.

Në rasën rrjedhore del në trajtën :mejet.

Veta e parë shumës, që në shqipen standarde del *ne*, tek ndeshet në trajtën *na* si tipar i të folmes geqe.

Në rasën dhanore përemri i vetës së parë shumës del në trajtën *ne na* duke mos e dalluar grafikisht nga rasa kallëzore, por vetëm nga funksioni sintaksor.

Mbizotëruese në përdorim është dhanorja dhe kallëzorja që del me trajtë të shkurtër dhe që ka formën e përemrit të vetë së parë *na*, por që dallohen nga funksioni sintaksor që ata kanë.

Por rasën dhanore në vetën e parë shumës e kemi ndeshur edhe në formën *nee*, të shoqëruar me trajtë të shkurtër.epna *nee* ( epna = ep(folja) + na (trajtë e shkurtër)).

Në vetën e parë shumës në rasën rrjedhore kemi rastin *nesh* që shoqërohet me parafjalë *prei nesh ,cundra nesc*.

Përemri vetor *ti* ndeshet si në normën e gjuhës shqipe por si rast të izoluar kemi ndeshur përdorimin e këtij përemri edhe në trajtën *tine* tek Radoja: Si bân *tine* kryg? (D.C.19)

Karakteristikë këto përemra kanë që në rasën dhanore e kallëzore përdoren pa trajtë të shkurtër: *tyt t'* ku në trajtën e shkurtër bie zanorja ë në fund.

Rasa rrjedhore del me trajtën *tejet: prei tejet*.

Përemrat e vetës së tretë njëjës dhe shumë dalin pa ndryshime nga norma e gjuhës shqipe: *ai ajó*, *atá ató*.

Përemrin vetor të vetës së tretë *ata* tek Radoja, në rasën dhanore e gjejmë në dy forma: *atyne* dhe *atynvet*.

Tui daa Nniest *atyne* (atyne). (D.C.38)

..ai ci ia ven vescin *atynvet* (atynvet) ci promscmoin. (D.C.153)

Autorët përdorin formën e vjetër të rrjedhore së përemrit vetorë: *prei ssi: mrapa ssi, kundra sii, afer sish*.

Kemi rastin kur përemrat e vetës së tretë njëjës dhe shumë rasa kallëzore dhe rrjedhore përdoren edhe pa *a*-nistore, por të shoqëruar me parafjalë.

*me tá, nner tó*.

Tek Pashko Babi në rasën dhanore hasen të përdorur format *atii* për përemrat e gjinisë mashkullore ndërsa në gjininë femërore ndeshen forma *assait*. Theksojmë se autori nuk dallon grafikisht *i* nga *j*, *dukuri që vihet re edhe tek Radoja e Bytyçi*. Në këtë rast zanorja e temës *i* te përemri *atii* është e dyfishuar që ka gjasa që *-i* e dytë mund të jetë një *-j*. *Psh :...e cionia atii pescgiesc*. (V.44) / *...po ju viin assait do rescper*. (V.36)

Në rasën kallëzore del trajta *atê* e ndërsa në rrjedhore kemi trajtën *prei atii/ assai*.

...e hatron *atê* gi m'ka niis mue. (V.216)

...tremniu *prei atii* e *prei assai* gi munn ju rezighoin scpirtin. (V. 216)

Veta e tretë shumë ata/ato del në formën *atyre ju*: *Ju çça atyne* (atyne). (V.228)

Në përdorimin e trajtave të shkurtra të bashkuara (*i+e*), apo qofshin këto edhe me pjësëzën *u* të formës joveprore, Radoja shkruan me vizë në mes.

...nguscλim ci pat kuur Engnli *i-u* fal *prei ânes Teneot*. (D.C.77)

Psè *i-a* ççona *Ëois* ket urat?(D.C.80)

...me *i-u* lutun per dit, e me *i-u* falun-nnèrs (D.C.100)

Tek Pashko Babi ndeshet trajta e shkurtër *i* që bshkohet edhe me format e formës joveprore *u* e cila shkruhet *ju*. Esau *ju* prue per mos me ja naal...(V.34) ...e engli i *Ëotit ju* duk prap *âner Sefit*. (V.179)

Trajta e bashkuar e përemrit vetor ia (*i+e* dhe *i+i*) shkruhen me trajtën *ja*.

Por Eliseu *ja* priti. (V.117) E Natan *ja* priti. (V.98)

...e per n'mos *ja* pac dertin e tii, ai *prei* vedit giççmon ka per t'sctÿÿ.(V.100)

Trajtëne shkurtër e bashkuar me lidhoren(*t' +i*) autori e shkruan pa apostrof.

...e lutiu *ti* nnegin per s'marit. (V.124) ...e kan per *ti* ççan i Biri t'Nêelit. (V. 171)

b) Përemri vetvetor. Përemri vetvetor tek Radoja del në format: *vetvehten*, *vet-vehten*, *vethen*, *vedi* nën ndikimin e dialektit të gegërishtes. Kryesisht kemi ndeshur përdorimin e këtij përemri në rasën kallëzore shoqëruar osë jo me parafjalë. Autori në disa raste shënon në trup të përemri vetvetor faringalen *h*: *vethen*, *vetvehten*, *vet-vehten*. Ky përemër tek Babi del në format: *vedin*, *vedvedi*, sërish nën ndikimin e dialektit të gegërishtes. Ndryshe nga pararendësi i tij Radoja, ky autor përdor përemrin vetvetor pa faringalen *h* në trup të fjalës. Më së shumti ku përemër gjendet në rasën kallëzore e rrjedhore. Tek Bytyçi nuk gjendet i përdorur.

c) Përemri dëftor. Tek Ëngjëll Radoja dhe Pashko Babi dallojmë më shpesh të përdorur përemrat dëftorë *ky* (*ky*), *kio* (*kjo*) kur përdoren për të treguar persona ose sende që ndodhen afer folësit, por mjaftueshëm zënë vend në përdorim edhe përemrat



## Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX

dëftor ai, ajo për të treguar persona a sende që ndodhen larg. Nuk gjenden të përdorur përemrat *i tillë, i atillë, i këtillë*.

c) Përemri pronor. Autorët përemrin të vetës së parë dhe vetës të dytë njëjës të të dyja gjinive *im\ime*, i përdorin në formën *em, eme* ndërsa në rasën kallëzore në trajtën *tem\teme*.

Përemri i vetës së parë në rasën dhanore del në trajtat: *mii \ mia*. Ky përemër në gjininë mashkullore përdoret me dyfishimin e zanores *i*, që mendoj se *i* e dytë shënon një *j*.

Përemrat e vetës së dytë *yt, jote* dallohen në gjininë mashkullore me trajtën *yt* dhe me trajtën e vjetër, konkretisht *tyt* tek Radoja dhe *jyt* tek Babi .

Në rasën kallëzore del në trajtën *tann\e (tand/e)*, *yt( yt)*.

Tek Pashko Babi dukuri që nuk e vejmë re tek dy autorët e tjerë është se përemri pronor i vetës së dytë njëjës në gjininë mashkullore përdoret me nyje të përparme, jo në përdorim me normën e sotme.: *i juui* .

Një dukuri të tillë të shoqërimit me nyje të përparme e gjejmë në disa raste edhe tek përemri i vetës së dytë njëjës të gjinisë femërore: *e jote*.

Njëkohësisht përemrat pronorë të vetës së dytë shumës në gjininë mashkullore e femërore dalin me dy forma: *tuu/tuei; tuja/ tueia*.

Përemrat e vetës së tretë shumës të gjinisë mashkullore e femërore përdoren me mbaresën –a: *e tija, e saja*.

Ndeshim të përdorur edhe përemrin *pronor vetvetor e vet*.

...masannei kçxi n'Nazaret n'scpi t'vet. ( Vakinat. 72)

E mlueç nipiin e vet, e se t'zilin n'vedi e uroi.(Vakinat. 49)

Në vepër e Pashko Babit dallojmë edhe raste kur autori përdor përemrat pronorë në bashkëvajtje me emrat e farefisnisë.

Përemri i vetës së dytë njëjës, të gjinisë mashkullore, rasa emërore e jep në trajtën *jγyt (jyt)*, ndërsa në rasën gjinore në trajtën *tyt (tyt)*.

*Jγyt aat* na ka vûu gni barr fort t'rân. (V. 109)

Sefi *jγyt biir*, fial t'ka ciue. (V.47)

..por ti e konaku i *tyt tet* pse e keni giit n'gnen aan urçnimet e Zotit...(V.115)

Shpesh autori përdor edhe përemrin e vetës së dytë të gjinisë mashkullore e femërore në formën *tuu*:

Scepto, mere fatin tann e *dγγ tuu* bijave. (V.24)

...kgyri a e kan mir pûnen *tuu* vlaæen...(V.36)

d) Përemrat e pacaktuar. Në këto vepra bie në sy përdorimi më i shpeshtë i përemrave të pacaktuar në shkrimet e Radojës dhe Babit dhe më rrallë tek Bytyci. Dallohen trajtat: A kena *nnogni* derman (f .71) \ ...pse kusc ban bee me vraa *nnokenn* (f. 108) \ ...e paa i bâa kec kurkui, bile me niet ci me i vieft *nnokui* (f.109) \ ...muunet *nnokusc* me e scti n'bee? (f.110)

**Sistemi foljor**. Folja si pjesë ligjërata, zë një vend të veçantë në gjithë sistemin e shqipes. Larmia e formave gramatikore të kësaj pjese ligjërata, kushtëzohet nga një përdorim jo i dendur në vepra, pasi këta autorë përdorin masivisht format e pashtjelluara.

Duke analizuar gjuhën e autorëve veriorë Ëngjëll Radoja, Pashko Babi, Ndue Bytyçi, arrijmë në këto përfundime në rrafshin morfologjik ( sistemi foljor):

Folja, si bërthamë kryesore e fjalisë, dëshmohet e përdorur jo vetëm me kuptimin e saj të plotë, por në raste të shumta e gjejmë të përdorur si mjete gramatikore që e humbasin kuptimin leksikor të tyre, duke shërbyer si folje ndihmëse, gjysmëndihmëse të cilat shprehin mënyrën e shprehjes së një veprimi. Kështu kemi përdorimet e foljes ndihmëse *kam* të shoqëruara me formën e tipit *me ba*, e cila shfaq nuance e kohës së ardhme së domosdoshmërisë: *kam me bisedue*; folja ndihmëse *jam* del e shoqëruar me formën e pashtjelluar të përcjellores, duke treguar nuance e kohës së tashme analitike: *jam tue bisedue*; folja me vlerë modale *mund, duhet e do* dalin të shoqëruara me pjesore gege dhe me paskajoren e titpt me *ba*.

### **Format gramatikore të mënyrës dëftore.**

Tek të tre autorët vihen re dukuri të njëjta si:

Sistemi foljor paraqitet sintetik-analitik, ku me format sintetike dalin foljet në kohët: tashme, pakryer, kryer e thjeshtë dhe me formë analitike: e kryera, më se e kryera, e kryera e tejshkuar, e ardhmja dhe e ardhmja e përparme.

-Në zgjedhimin e foljeve *jam, kam, thom* autorët i afrohen në disa raste normës së përbashkët, sidomos në vetën e parë njëjës (*jam, kam*) dhe në vetën e dytë shumës: – *ni(jeni\keni)*, karakteristike e dialektit gegë.

Bëjnë përjashtim vetat e tjera, që janë tipike të gegërishtes. Në temat e këtyre foljeve vihen re disa dukuri të veçanta.

- a. Folja *jam* në vetën e tretë njëjës shfaqet në formën e plotë: *asct* (asht).
- b. Disa folje të tjera të parregullta në vetën e parë shumës dëshmohen me mbaresën –*na* ( karakteristike për gegërishten veriperindimore), si *dona, jena, kena*.
- c. Në vetën e parë shumës foljen **kam** e ndeshim edhe në format e ndërtuara me mbaresën –*mi* që i afrohet standardid.
- d. Po në këtë vetë folja **tham** del e ndërtuar me mbaresën :-*na ;thona*.
- e. Në vetën e dytë shumës gjejmë të përdorura format më të vjetra karakteristike për të folmen e Mbishkodrës : *keni, kini, jeni, jini*.

**Koha e tashme.** Në përgjithësi mbaresat e kohës së tashme dalin me mbaresa si të mbarë gjuhës shqipe: *ban, kungon, maron* (Zgj.I); *merr, përket, padiss* (Zgj.II); *dii, rrii* (Zgj.III).

- a) Këta autorë, në shkrimet e tyre kanë shënuar vetën e parë të foljeve në zgjedhimin e parë në formën e thjeshtuar –*j*, të cilën grafikisht e shënojnë me *i*. Kjo trajtë ka zënë vend në shqipe, më konkretisht në gegërishte, që tek Bogdani, i cili filloi të përdorte mbaresën –*j* krahas formës –*nj*, e cila ishte përdorur në shkrimtarët para tij. Përdorimin e foljeve me mbaresën –*j*, e gjejmë në shkrimet e të gjitha periudhave kohore të mëvonshme deri më sot.
- b) Disa folje të zgjedhimit të dytë në vetën e dytë njëjës dëshmohet me mbaresën –*i*, si veçori e të folmeve të gegërishtes veriore: *lypi, kapi*.

- c) Në foljet e zgjedhimit të dytë të kohës së tashme në vetën e parë njëjës, dallojmë alterimin s/t ku është zevëndësuar me dyfishimin e bashkëtingëllores përkatëse : *padiss*.
- d) Në vetën e dytë e të tretë njëjës disa folje të zgjedhimit të tretë paraqiten me forma të ndërtuara sipas modeleve të foljeve të zgjedhimit të parë, me mbaresën –n si: *dii-diin; pii-piin*.
- e) Folja *nep* në strukturë merr kuptimin e foljes *jap*.

### **Forma joveprore e foljeve në kohën e tashme të mënyrës dëftore.**

Përsa i përket formës joveprore në vepër ndeshet e formuar me mbaresat si të mbarë shqipes, ku më shpesh ndeshim foljet e ndëtuara me mbaresat në vetën e parë dhe të tretë njëjës –(h)em ; -(h)et dhe në vetën e tretë shumës-(h)en.

**E pakryvera.**Përdorimi i foljeve në të pakryerën dëshmohet në veprat që kemi në studim me tipin sigmatik të foljet isha, kisha, thash dhe me tipin asigmatik me –(j)sh<sup>180</sup>, një trajtë e përfutur në gegërisht që dëshmohet tek të gjithë autorët e tjerë të vjetër të veriut. Foljet e të gjitha zgjedhimeve në këtë kohë marrin mbaresat karakteristike si :

Veta e parë njëjës : nuk ndeshet

Veta e dytë njëjës : -(j)she;

Veta e tretë njëjës -(n)te; ( ndersa tek Babi e ndeshim edhe me –tte: predikotte > predikonte)

Veta e parë shumës: -nuk ndeshet

Veta e dytë shumës: -nuk ndeshet

Veta e tretë shumës: -(j)shin.

**E kryera e thjeshtë.** Ndeshen të përdorur dy format e së kryerës së thjeshtë, konkretisht :

-aoristin sigmatik (dhashë, thashë) .Trajtat e aoristit sigmatik i ndeshim në shkrimet e të tre autorëve .

-aoristin asigmatik(mendova, mbylla,etj).Foljet vokalike të zgjedhimit të parë marrin në trup të tyre tingullin antihiatizues –v- si: punova, kuitova.

-Krahas saj ndeshim edhe rastet me temë të pazgjeruar si: plackita -plackis, pjek-poqa, si dhe temen e zgjeruar di-ta\vu-na .

-Zakonisht me mbaresat e së kryerës së thjeshtë dalin foljet me temë në bashkëtingëllore në vetën dytë e të tretë njëjës e kësaj kohe që marrin mbaresat –i\u.

Raste të izoluara përmendim folen **lind** e cila në vetën e tretë njëjës del në formën **leu**: ...leu n’Betlem / ati ci leu perpara. Po kështu edhe folja **kthej**, në vetën e tretë del me mbaresën –i **kthei**, jo-**u ktheu**.

Forma joveprore: Forma joveprore e së kryerës së thjeshtë dëshmohet e ndërtuar nga paravendosja e trajtave vetore të foljes në të kryerën e thjeshtë zgjedhimi vepror i pjesëzës u: **u stolis**, **u mblodh**, **u kap**.

**Kohët e përbëra: e kryer, më se e kryer dhe e kryer e tejshkuar** që gjenden të ndërtuara nga paravënia pjesores së shkuar të foljes që bart veprimin e formave vetore

<sup>180</sup> Po aty, f. 77

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

të kohës së tashme, të pakryer dhe të kryer të thjeshtë të foljes ndihmëse **kam** ( për formën veprorë) dhe **jam** për formën joveprorë) . Në vepra nuk kanë një përdorim të shpeshtë dhe ndërtohen si në normën e përbashkët, por me dallime fonetike. Këto kohë me forma analitike, identifikohen të formuara nga paravendosja e pjesores së shkuar të foljes që mbart veprimin, përkatësisht e formave vetore të kohës së tashme, të pakryer dhe të kryerën e thjeshtë të foljes ndihmëse kam, për formën veprorë dhe jam për foljen joveprorë.

Me forma dialektore me karakter dialektor veçojmë:

- a) E kryera dhe më se e kryera e disa foljeve jokalimtare e formuar me foljen ndihmëse **jam**, si: **asct msue; asct baa**.
- b) Shpesh, tek vepra e Radojës, ndeshim edhe inversionin e këtij ndërtimi, ku folja gjysmëndihmëse jam pozicionohet pas pjesores, si : *beekue jee*.

### **Koha e ardhme .**

**E ardhmja** .Në vepra, si ndërtim i kohës së ardhme përdoret:

- a)me një denduri më të madhe e ardhmja e formuar:me formën e ngurosor *do* dhe me *të tashmen e mënyrës lidhore* që inkuadrohet tek te katërt autorët, veprat e të cilëve studioam.
- b)të tashmen e dëftores të ndihmëses *kam* dhe *me paskajore* (Radoja, Bytyçi, Zarishi).
- c)Shihet një mbizotërim i përdorimit të së ardhmes së gegërishtes të tipit *kam me ba* në raport me formën *do + e tashme e lidhore* tek Radoja, Bytyçi dhe Babi.

**Koha e ardhme e përparme** përdoret me dy trajta foljore:

- a)Formë e ngurosor *due(do)* dhe me infinitivin e foljes tjetër *due me than, due me ta lan* .
- b)Ndërtimin kam dhe forma e paskajores per t'baam *kam per t'ken, kam per t'lan* , *kee per t'hagher* ,ti *kee per t'hiek* ,*ke per tu kthye*.

**Mënyra habitore.** Në shkrimet e autorëve që po studiojmë, paraqiten format foljore të përdorura kryesisht në kohën e tashme ( paskam, qenkam, hapkam etj).Kurse dy kohët e tjera nuk përdoren fare. *E tashmja* e mënyrës habitore del e ndertuar nga prapangjitja e pjesores se shkurtuar te foljes se formave vetore të së shkuares te se tashmes me ndihmesen kam. *zanke, sctike, t'viedhke, kenka, kenke, goditka, lankan, njoftkan , dhankan*

**Mënyra lidhore.** Këto forma kohore të mënyrës lidhore kanë të paravendosur pjesëzën –t', ku siç vihet re identifikohet pa zanoren ë, e cila në veprat që kemi në studim, ashtu sikurse në arealin gegë, nuk shkruhen dhe nuk shqiptohen në asnjë pozicion. Duke veçuar foljet kam e jam, format foljore të kohës së tashme të lidhore janë të njëjta me temën e së tashmes së dëftores.

Vërehet veçori dialektore e gegërishtes rastet e dendura të përdorimit të trajtave të shkurtra shoqëruar me nyjën e lidhore, si: *t'm'dalsh; ta fali; t'ju kapin* .

Forma joveprorë.

Foljet e menyrës lidhore në këtë formë të së tashmes së lidhore dalin me të njëjtat forma të së tashmes së dëftores, vetëm se këtu marrin pjesëzën **t'**, si: *t' bâahet; t'rriihej*.

**Mënyra kushtore.** Në veprat e autorëve shkodranë të shekullit nëntëmbëdhjetë, kjo mënyrë kryesisht është shprehur me dy kohë, përkatësisht koha: **e tashme** dhe **të kryerën**. E tashmja e kushtores (homonime me të ardhmen e së shkuarës), ndërtohet nga e pakryera e foljes ndihmëse kam dhe paskajorja e foljes themelore.<sup>181</sup> Që në krye të herës theksojmë se N.Bytyçi nuk e përdor asnjëherë. Format e se kryeres i ndeshim te ndertuara në formën: folje **kam në të pakryerën** dhe me infinitivin **me pas punue**. Dokumentohet vetëm tek Radoja e Babi: *kiscim me ken, kiscin per t'ken, kiscin per t'a lidh, kiscite per ta dhan, kiscite paas fillue, kisc paas niis*.

**Mënyra dëshirore.** Kjo mënyrë dëshmohej në dy kohë, në të tashmen dhe në të kryerën. Format e kohës së tashme ndërtohen duke i shtuar temës mbaresat vetore të kësaj mënyre.

- a) Ndeshin folje në vetën e tretë ndërtuar me anë të prapashtesës trajtëformuese – **f**, që i prapangjitet temës së të kryerës së thjeshtë: *largoft*.
- b) Me trajta dialektore ndeshim folje *jam* në formën joveprore (qofsh/kjofsh) dhe pjesoren përkatëse, si: *kioft ma/kue, ; kiosk scegnue; kioft bâa!*
- c) Shpesh kjo formë dëshirore përdoret edhe me inversion në kohën analitike. mallkue kioft ,mallkue kioscin,mallkue kioscin, kioscin hiekun, kioft than, kioft, kiosk,paç .

**Mënyra urdhërore.** E veçanta e kësaj mënyre është që nuk mund të krijojë kundërvënien kohore, kështu që foljet në këtë kohë nuk kanë kategorinë gramatikore të kohës. Mënyra urdhërore ka formë gramatikore vetëm për veten e dytë njëjës e shumës. Ato kanë të njëjtën formë si veta e dytë njëjës e shumës e së tashmes së dëftores, por në këto vepra trajtat foljore dalin pa mbaresë, mëso, lexo, rrëfe ose me mbaresë –ni msoni, lexoni, rrefeni etj.Duke u mbështetur tek Gramatika e gjuhës shqipe mund të dallojmë dhe të bëjmë një klasifikim të këtyre foljeve:

- Folje të zgjedhimit të parë që dalin me temë në –o-, -e- , -i-, pa mbaresë si: meso, rrëfe, pi, por dhe mbaresë –ni.: nneero, lakmo, scikio, puno, lezo, scko, bekon, lakmoni , gikoni.
- Folje të zgjedhimit të dytë ku përfshihen edhe ato folje të cilat në vetën e dytë njëjës të urdhërores pësojnë ndërrime –e në –i. psh. *dal-del; marr-merr; mbjell-mbill; djeg-digj; pjek-piq; etj merr ,vidh merre, merrni, falni, del, ulu. lypni mos vra...mos vidh...mos del*.
- Folje të parregullta, ku përfshihen dhe foljet, jam, kam. Konkretisht kemi trajtat: *Nepe, kii , jii,dunie,duni*.

<sup>181</sup> A.Haxhi-T.Topalli, Historia e gjuhës së shkruar shqipe, Shkodër, 2007.f.113

**Format e pashtjelluara.**

**Paskajorja.** Vëmë në dukje se tek Radoja, Babi dhe i gjejmë të përdorura të trija këto forma (paskajore gege *me punue*, *per me punue* dhe në toskërisht *per t'punue* (për të punuar), ndersa tek Bytyçi përdoret vetëm paskajorja gege *me punue* dhe *per me punue*. Sipas statistikave kemi një raport ndërmjet këtyre përdorimeve :

Paskajorja	Radoja	Babi <sup>182</sup>	Bytyçi
Me+ pjesore	837 herë < 78 %	562 herë < 71 %	81 herë < 75 %
Per me +pjesore	96 herë < 8%	64 herë < 8%	4 herë < 9 %
Per t'+ pjesore	13 herë < 1%	3 herë < 0.9%	Nuk ndeshet

Konkludojmë se në veprat e autorëve, përdoret me një denduri më të madhe tipi i paskajores *me punue* (me+pjesore gege), që është formë analitike e formuar duke i paravendosur pjesores së foljes pjesëzën *me*, karakteristike për gegërishten. Paskajorja e tipit me ba zë një vend dominues në ligjërimin e folur gegë, por që dokumentohet dhe në shkrimet shqipe. Me të drejtë prof. Tomor Osmani shprehet se : ”... duke qenë se ka një lëvizje për paskajoren e tipit me ba, studimi i saj për t’u përfshirë në standardin e sotëm do të ishte një element i domosdoshëm dhe dobiprurës për vetë pasurimin e sistemit foljor të gjuhës sonë, për funksionet e shumta sintaksore që ajo kryen, për vetë nevojat praktike që ajo mbulon.”<sup>183</sup>

Pas këtij përdorimi të paskajores ndeshim edhe ndërtimin e dytë *për me +pjesore* (*per me hiip per me scelbue* , *per me mennue*) etj, që është një kontiminim i dy formave të pashtjelluara, dhe që në vepra ka një përdorim të konsiderueshëm, pavarësisht se në gegërishten veriore është e rrallë në përdorim.

Në veprën e Radojës dhe Babit gjejmë të përdorur edhe tipin e tretë të paskajores *për të +pjesore* (*per t’ punue*) që i afrohet më shumë normës së përbashkët, por që këtu ka një përdorim të rrallë, vetëm 13 herë ndërsa tek Pashko Babi gjejmë të përdorur këtë tip të paskajores 3 herë .Bytyçi përdor vetëm dy ndërtimet gege të paskajores (*me +pjesore gege* ; *per me + pjesore gege*), ndërsa tipin e tretë (*per te + pjesore*) nuk e përdor asnjëherë.

**Përcjellorja.** Përcjellorja shfaqet e ndërtuar nga paravendosja pjesores formantin *tui*, *tu’ dhe tue të dokumentuar tek Radoja* . Tek Babi dhe Bytyçi përdor vetëm formantin *tui* dhe *tu’*. Dendurinë më të madhe në përdorim e ka përcjellorja e ndërtuar nga formanti ***tui + pjesore gege si:*** *tui kuitue, tui mennue e tui fol, tui m’ardh, tui baa, tui bart*.

Përcjellorja me formën *tu’* përdoret atëherë kur zakonisht mes pjesëzës e pjesores vihet një trajtë e shkurtër e rasës kallëzore me funksion kundrinor. *Psh... me i scerbye tu’ mmaiturdhnimet*. Tek doktrina e Radojës, shumë rrallë, vetëm tri herë, e ndeshim

<sup>182</sup> Në veprën e Pashko Babit kjo statistikë është nxjerrë nga vjelja e materialit të 167 fq nga 323 fq që ka vepra.

<sup>183</sup> T.Osmani, Disa konsiderata rreth gjuhës së Migjenit, Buletini shkencor, nr.63, Shkodër 2013. f.253



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

të përdorur dhe përcjelloren e ndërtuar nga paravendosja e formantit *tue* (*duke*) të ndjekur nga pjesorja gege si ...*tue lut* na Zotin ci t'degnohet me i beghehniss...(D.C.212) \ ...nogni mcat, marrun *tue baa* scpesc.(V.228)Tek Bytyçi nuk dokumentohet i përdorur ky tip i përcjellores.

Sipas statistikave kemi një raport ndërmjet këtyre përdorimeve :

Përcjellorja	Radoja	Babi <sup>184</sup>	Bytyçi
tui+ pjesore	104 herë < 10 %	123 herë < 16 %	10 herë < 16 %
Tu' +pjesore	26 herë < 2%	1 herë < 0.1%	1 herë < 0.1 %
tue+ pjesore	4 herë < 0.2%	Nuk ndeshet	Nuk ndeshet

**Mohorja.** Në veprat që kemi në studim, kjo formë e pashtjelluar ndërtohet nga forma analitike e njëjtë me atë të shqipes së sotme, me paravendosjen e pjesës parafjalore pa pjesores së foljes e tipit punu(e), që mund ta quajmë si një pjesore e shkurtuar: *paa u lodh, paa ngran, paa pii, paa u vesc.*

Sipas statistikave kemi një raport ndërmjet këtyre përdorimeve :

Përcjellorja	Radoja	Babi <sup>185</sup>	Bytyçi
pa+ pjesore	12 herë < 0.8 %	42 herë < 5 %	Nuk ndeshet

Mes të tjerave në këtë referim vlen të përmendet edhe përdorimi i disa ndërtimeve foljore formuar nga folje gjysmëndihmëse që i paraprihen paskajores që haset shumë shpesh në vepër.

- Foljet modale mund, duhet, do në veprat që kemi në studim, e humbin mëvetësinë për të qëndruar si folje me kuptim të plotë, por realizojnë kuptimin e tyre vetëm kur shoqërohen nga një folje tjetër që luan rolin kryesor. Të shumtën e rasteve në veprat e Radojës dhe Babit këto folje hyjnë në relacion me paskajoren gege me pjesoren. Gjithnjë duke pasur parasysh dhe dialektin në të cilën janë shkruar veprat paraqiten trajtat:
  - a) Duhet +paskajore e tipit “me ba”( *duhet m'u rueit, duhet me i nnighiue* ).
  - b) Do + paskajore e tipit “me ba”( *dona dsctu me u ghiaa, don me than, do me ta baa.* )
  - c) Foljen *mund* e gjejme të përdorur të shoqëruar me paskajoren gege me ba. Në rastin e parë folja modale mbart rolin kryesor duke përcaktuar kategoritë gramatikore (mënyra, koha, veta), ndërsa paskajorja, si formë e ngurosur qëështë, ka vetëm kategorinë e diatezë. Folja modale *mund* e gjejmë të dokumentuar në formën mbizotëruese në vepra si: -*Folje modale mund në të*

<sup>184</sup> Në veprën e Pashko Babit kjo statistikë është nxjerrë nga vjelja e materialit të 167 fq nga 323 fq që ka vepra.

<sup>185</sup> Në veprën e Pashko Babit kjo statistikë është nxjerrë nga vjelja e materialit të 167 fq nga 323 fq që ka vepra.



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

*tashmen +paskajore(mun me zierr,munn bahen, a munn ma ciosc,munn ta perpiin).*

Në kuadër të këtij studimi u munduam të paraqesim një tablo të përdorimit të formave grafike, fonetike, leksikore, fjalëformuese e morfologjike (emir, mbiemri, përemri, folja) në veprat e autorëve të shekullit XIX Ëngjell Radoja Ndue Bytyçi, Pashko Babi e Pjeter Zarishi gjithnjë duke lënë hapësirë për një studim më të thelluar, pasi përse i përket trajtimit të një çështjeje të tillë mendoj se ka shumëçka për të diskutuar, aq më të tepër kur flasim për një grup shkrimtarësh rreth të cilëve nuk ka shumë studime.

**BIBLIOGRAFIA**

**Akademia e shkencave**, Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Tiranë, 1972 .

**Akademia e shkencave**, Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 2002 .

**Akademia e shkencave**, Fjalor i shqipes së sotme, Tiranë, 1954.

**Akademia e shkencave**, Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1980.

**Akademia e shkencave**, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 1995.

**Akademia e shkencave**, Gramatika e gjuhës shqipe I, Tiranë, 2002.

**Akademia e shkencave**, Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976.

Historia e letërsisë shqiptare I-II, Prishtinë, 1968; 1989.

Fjalori enciklopedik shqiptar , Tiranë, 1985.

**Agalliu, F:**

-Rreth përdorimeve të rasës rrjedhore, SF,1,1990.

-Rreth kategorisë së numrit të emrave në gjuhën shqipe, në botimin e autorit

- Çështje të sistemit morfologjik të gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1988.

-*Pjesorja në gjuhën shqipe*, SF, 1972/2.

-*Vëzhgime mbi formimin pa +pjesore*, SF,1983/3.

**Ajeti, I:**

-Historia e gjuhës shqipe (Morfologji historike ), Prishtinë, 1989.

**Ashta,K:**

-*Leksiku i plotë i veprës së Gjon Buzukut (1555)*, Revista shkencore e Insitutit Pedagogjik 1, 1964.

-Da Lecce, Gramatika e parë shqipe, botuar me 1716, Shkodër, 1966.

-*Rreth disa çështjeve të tekstit të Budit*, SF 4,1966.

**Beci,B:**

-*Mbi disa probleme të përvetësimit të sistemit fonologjik të gjuhës letrare*, “Gjuha shqipe dhe letërsia në shkollë”, 1974.

- Rreth tipareve karakteristike të dy dialekteve të shqipes, SF, 1978/4.

- *Gjuha letrare shqipe dhe baza e saj dialektore*, “Seminari XVII ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare “, Tiranë, 1995.

**Bushati,H:**

-Shkodra dhe Motet, Vëllimi I, Shkodër 1998; Vëllimi II, Shkodër 1999.

**Bushati,M. :**

*Në gjurmët e veprimtarisë së fotografit patriot Kel Marubi*, “Jeta e re”, Shkodër, 17 maj 1980.

**Buxheli,L:**

-*Fjalët e përngjitura në gjuhën shqipe*, Tiranë, 2009.

**Cipo.K:**

- Gramatika shqipe, Tiranë, 1949.
- Rreth disa kompozitave, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë 1972.
- Kompozitat determinative, Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, Tiranë, 1972.

**Çabej.E:**

- Studime etimologjike në fushën e shqipes, Tiranë, 1966.
- Meshari i Gjon Buzukut, pjesa I,II,Tiranë, 1968.
- Hyrje në historinë e gjuhës shqipe, Prishtinë, 1970.
- Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe, SF nr.2, 1974 .
- Karakteristikat e huazimeve latine të gjuhës shqipe, SF Nr.2, 1974.
- Studime gjuhësore III, IV, VI, Prishtinë, 1976, 1977.
- Për njështrësim kronologjik të huazimeve turke në gjuhën shqipe, SF Nr.4, 1979.

**Çeliku, M:**

- *Parafjalët emërore të thjeshta në gjuhën shqipe*, SF Nr.2, 1973.
- Format e pashtrëlluara të foljes në gjuhën e sotme shqipe*, Tiranë, 2000.
- Gramatika praktike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2004 .

**Çerpja, A- Lafe, E :**

- Sistemi foljor te vepra: “*Lohrbuch der albaniscen sprache“ dhe “Albanian grammar with exercises erestomathy and glossaries ,,* Studime shqiptare 17, Shkodër, 2011.

**Demiraj,Sh:**

- Gramatika e gjuhës shqipe, Tiranë, 1962 .
- Morfologjia e gjuhës së sotme shqipe, II, Tiranë 1961.
- Rreth huazimeve turke në gjuhën shqipe, SF,nr 1, 1965.
- Rreth disa problemeve të paskajores në gjuhën shqipe, SF Nr.1, 1969.
- Rreth kategorisë së shquarsisë dhe së pashquarësisë në gjuhën shqipe, SF, 1969.
- Gjuha shqipe dhe historia e saj, Tiranë, 1986.

**Demiraj, B:**

- Shkodra-qendër albanologjike në prag të pavarësisë*, Shkodra në shekuj , Shkodër, 2017.

**Dizdari,T:**

- Huazime orientalizmesh në shqipe, SF, nr. 2, 1965.

**Dom, Mahir:**

- Dukuri dhe prirje të zhvillimit të strukturës sintaksore të shqipes së sotme letrare, ‘‘Gjuha jonë’’, 1985, nr. 1, f. 52.

**Dhrimo, A:**

- Formimi i mbiemrave në gjuhën shqipe* , ‘‘Çështje të gramatikës së shqipes së sotme’’ II, Tiranë, 1975.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

-Mbi disa çështje të klasifikimit morfologjik të mbiemrave në shqipen e sotme letrare në “ Çështje të fonetikës dhe gramatikës së shqipes së sotme” I, Tiranë, 1972.

-Shkallëzimi i mbiemrave, në botimin e autorit “ Për shqipen dhe shqiptarët”, I, Tiranë, 1973.

### **Elsie, R:**

-Historia e letërsisë shqiptare, Tiranë-Pejë, 1997.

### **Fullani , N :**

-*Ndue Bytyqi*, revista “Nëndori”, Tiranë, 1941.

### **Gazulli, N :**

-Fjalorth i fjalëve të rralla në Veri të Shqipërisë, Tiranë, 1941.

### **Gjinari,J:**

- Historia e letërsisë shqiptare I, 1959.

-Historia e letërsisë shqiptare I, 1971.

-Dialektologjia shqiptare, Tiranë, 1975.

-*Struktura dialektore e shqipes parë në lidhje me historinë e popullit*, SF nr.3, 1976.

-Dialektet e gjuhës shqipe, Akademia e shkencave RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1989.

Historia e letërsisë shqiptare , 1983.

### **Haxhi, A – Osmani, T :**

- “*Forma të shumës në rrafshin e planifikimit gjuhësor të shqipes*“ në : Shqipja në etapën e sotme: Politikat e përmirësimit dhe të pasurimit të standardit“, Tiranë, 2011.

### **Haxhi, A – Topalli, T :**

-Histori e gjuhës së shkruar shqipe, Shkodër, 2007.

### **Hysa,E:**

--Formimi i ndajfoljeve,Çështje të fonetikës dhe të gramatikës së shqipes së sotme, I, Tiranë, 1972.

Disa çështje të parashtesimit në gjuhën shqipe, “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme“ II, Tiranë, 1975.

-Dukuri e prirje të formimit të fjalëve në shqipen e sotme letrare, Gjuha Jonë, nr. 1,1985.

-Formimet me parashtesën për- në gjuhën shqipe,Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, II, Tiranë, 1975.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

-Elementet turke në strukturën e fjalës në gjuhën shqipe, SF 1998 nr. 3-4.

-*Sindajshitesat dhe vendi i tyre në formimin e fjalëve në gjuhën shqipe*, Studime filologjike 2, 1986.

### **Islamaj, Sh:**

-Gjuha e Jakov Xoxës, Prishtinë, 2000.

### **Ismajli, R:**

- Gjuha shqipe e Kuvendit të Arbënit 1706, Prishtinë 1985.

### **Kastrati, J:**

-Historia e albanologjisë, Tiranë, 2000.

### **Kamsi, W:**

-*Shtrirja e qytetit të Shkodrës në kohën e lashtë dhe të mesme*, Monumentet nr.11, 1976.

-*Kultura e Shkodrës për kombin shqiptar*, Shkodra në shekuj ( 16-17 Nëntor 1998) , vëll I, Shkodër, 2000.

### **Kostallari, A:**

-*Mbi disa veçori të fjalës së përbërë në gjuhën shqipe*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe “I, Tiranë, 1972 .

-*Mbi disa veçori të strukturës semantike të kompozitave pronësore të shqipes*,“Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe“, I, Tiranë, 1972.

-*Mbi disa veçori strukturore e funksionale të gjuhës letrare shqipe të kohës sonë*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe“, Tiranë, 1972.

-Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të drejtshkrimit të saj, Tiranë, 1988.

-Gjuha e sotme letrare shqipe dhe disa problem themelore të drejtshkrimit të saj, Tiranë, 1973.

### **Kole, J:**

-Vendi i ndërkombëtarizmave në shqipe , “Gjuha jonë nr.1, 1987.

-Pjesëzat si kategori leksiko-semantike në shqipen e sotme, SF 1969 nr.3.

### **Lafe, E:**

-Mbi disa terma të klasifikimit të fjalëve sipas përbërjes strukturore dhe sipas fjalëformimit,Studime Filologjike1, 1972.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

-Drejtshtkrimi-ligj i botës së qytetëruar , “Zëri i rinisë” nr.14, 1992.

-Vendi i orientalizmave ndër huazimet e shqipes, SF nr.1-4, 1993.

### **Likaj, E:**

-Analogjia gramatikore në strukturën morfologjike të gjuhës shqipe, Tiranë, 1984.

-Mbi format analitike në gjuhën shqipe, SF, nr.3, 1978.

-Zhvillimi i eptimit në gjuhën shqipe, (morfologjia historike), Tiranë, 2003.

### **Luli, F:**

-Fjalori biblik dhe i termave kishtar,Camaj-Pipa, Shkodër, 2004.

### **Mansaku, S:**

-Ndërtimet me foljet modale mund dhe duhet, SF, nr.3, 1979.

- Ndërtimet me foljen ndihmëse kam+paskajore te autorët e vjetër, SF, nr.3, 1979.

-Paskajorja e shqipes dhe kategoritë gramatikore të saj, SF, nr.1, 1981.

### **Memushaj,R:**

-Morfologji e eptimit të gjuhës së sotme shqipe, Tiranë, 1989.

- Shqipja standard, Tiranë, 2004.

### **Omari, A:**

-Përsëri rreth huazimeve më të vjetra sllave në shqipe, SFnr1-2, 1999.

-Pjetër Bogdani “Cuneus Prophetarum” ,Tiranë, 2006.

### **Osmani,T:**

-Historia e alfabetit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1987.

-Shoqëria e të Shtypurit shkronja shqip, “Gjuha Jonë”, Nr.4, 1989.

-Vëzhgime për gjuhën e veprës së Pashko Vasës, “Gjuha jonë”, Nr.3-4, 1992.

-Udha e shkronjave shqipe, Shkodër, 1999.

-Shoqëria “Bashkimi” dhe ndimesa e saj për lëvrimin e gjuhës shqipe ,“Gjuha jonë”, Nr.1-2, 1999.

-Ngjarje me rëndësi e kulturës sonë: Komisia Letrare shqipe, “Gjurmime Albanologjike”, Prishtinë, 2002.

-Tradita e shkrimit të shqipes në Shkodër, Shkodra në shekuj, vëll III, Shkodër, 2004.

## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

-*Disa konsiderata rreth gjuhës së Migjenit*, Buletini shkencor, nr.63, Shkodër, 2013.

### **Papa, E:**

- Profili i një qyteti mesdhetar: rasti i Shkodrës mesjetare (shek XIV-XV); Hylli i Dritës XXVI, nr. 2, Shkodër, 2006.

### **Priku, M :**

-*Rreth disa ndërtimeve dhe kuptimeve foljore në veprën e Martin Camajt*, në botimin ‘‘Martin Camaj për kulturën shqiptare – Shkrimtari dhe Albanologu’’, Studime shqiptare 17, Shkodër, 2011.

### **Riza,S:**

- Pronorët e shqipes, BUSHT, SSHSH 2, 1959.
- Pesë autorët më të vjetër të gjuhës shqipe, Tiranë, 1966.
- Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit, Tiranë, 1965.

### **Rrokaj, SH:**

- Çështje të gjuhës shqipe, Albatros, 2007.
- Çështje të gjuhës shqipe 2, Tiranë, 2009.

### **Rrota, J:**

- Gjuha e shkrueme ase verejtje gramatikore, Botimi I, Botime françeskane, Shkodër, 2006.
- Analyzimi i rasave t’emnit e zhvillimi historik i tynve, Shkodër, 1931.

### **Samara, M:**

- Parafjalët në gjuhën shqipe ( Vështrimi leksiko-semantik), Tiranë, 1999.

### **Sinani, Sh:**

- Besimi dhe kombësia në një vepër të pabotuar të Gjergj Fishtës, Mendimi shqiptar dhe shkolla shqipe, Aktet, Tiranë, 2009.

### **Shuteriqi, Dh:**

- Shkrimtarët shqiptarë, Tiranë, 1941.
- Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1956.
- *Nëpër shekuj letrarë*, Studime letrare, Tiranë, 1973.
- Humanistët dhe shkrimtarët e letërsisë së vjetër*, Zëri i popullit, 10 nëntor 1983.

### **Shkodra, Z:**



## ***Gjuha në veprat e autorëve veriorë të shekullit XIX***

---

- *Çështje të tregut shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Studime historike, nr.2, Tiranë, 1978.

### **Topalli, K:**

- Sistemi rasor i emrave të shqipes, Tiranë 2009.
- Koha e ardhme e mënyrës dëftore në gjuhën shqipe, SF Nr.4, 1980.

### **Thomai, J:**

- Fjalët me burim turk në leksikun e shqipes, Leksikologjia e gjuhës shqipe, Tiranë , 2006.
- Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme , Tiranë 2001.

### **Xhuvani,A:**

- Mbi prejardhjen e fjalëve, Vepra I, Tiranë, 1980.
- Parafjalët, Vepra I, Tiranë, 1980.

### **Xhuvani,A, -Çabej,E:**

- Parashtesat e gjuhës shqipe në “Çështje të gramatikës së shqipes së sotme, Tiranë, 1975.
- Prapashtesate gjuhës shqipe në “Vepra I”, Tiranë.

### **Zamputi, I:**

- Të dhana të reja mbi gjendjen ekonomike shoqërore e politike të vendit tonë në shekullin XVII, BUSHSH 1, Tiranë, 1957.
- Regjistri i Kadastrës dhe i koncensionëve për rrethin e Shkodrës 1416-1417, Akademia e Shencave e Republikës së Shqipërisë, Insituti i Historisë, Tiranë 1977.

### **Gazeta e revista.**

- “Agimi”, e përmuajshme, Shkodër, 1919-1921.
- “Besa Shqiptare”, Shkodë, 1913-1920.
- “Elçija e Zemres së Jezu Krishtit”, Shkodër, 1913.
- “Hylli i Dritës”, Shkodër, 1913-1914;1924; 1933;1935.
- “Lajmëtari i Zemres se Jezu Krishtit” , Shkodër, 1914-1920.

### **Abstrakt.**

Qëllimi i realizimit të kësaj teme doctorate qëndron në përpjekjen tonë për të realizuar një vëzhgim dhe analizim të rrafshit gjuhësor të veprave të autorëve veriorë që i përkasin konkretisht periudhës së gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Gjatë analizës së teksteve, padyshim që janë konkluduar një sërë çështjesh të rëndësishme, që lidhen më rrafshet gjuhës, duke filluar që nga një vëzhgim fonetik, (alfabetin dhe grafisë e përdorur nga autorët veriorë të shekullit të nëntëmbëdhjetë), leksikor, fjalëformues e morfologjik ku janë dalluar dukuri të përbashkëta por edhe dallime mes tre autorëve. Për trajtimin gjuhësor zgjedhëm tekste të autorëve të shekullit të nëntëmbëdhjetë, konkretisht “*Doctrina e kerscten me msime e scpiegime*” e Ëngjëll Radojës, “*Vakinat e t’ligs herscme e t’ligs ree*” të Pashko Babit, “*Urdhnimet e Tenzot e t’sceites kisc*” të Ndue Bytyçit si tekste të një rëndësie të veçantë midis teksteve të vjetra që janë bërë objekt studimi në shkencat albanologjike. Tekstet që kemi në studim kanë një rëndësi të veçantë jo vetëm për vlerat që mbartin duke hedhur gjurmë në historinë e shkrimit të shqipes në shekullin XIX por edhe në aspektin gjuhësor. Botuar në dialektin e gegërishtes, ato mund të konsiderohen si një burim i rëndësishëm për shkencat gjuhësore që studiojnë zhvillimin e gjuhës shqipe në periudha të ndryshme kohore.

Fjalë kyçe: *gegërishte, shekulli XIX, rrafsh gjuhësor, alfabet, grafi.*

### **Abstract.**

The aim of realizing the topic of this document due to our attempts to fill up a survey and analysis of the linguistic field of the northern authors belonging concretely to the second half of the 19<sup>th</sup> century. During the texts analysis there are without any doubt concluded a series of crucial cases relevant to the linguistic fields beginning from the phonetic survey (alphabet and the adopted authors' graphy), lexical, field word formation and morphological one where there are noticed common things and differences between the three authors too. There are chosen texts of the authors of the 19<sup>th</sup> century for linguistic dealing " *Dotrina e kerscten me msime e scpiegime*" with author Ëngjëll Radojës, " *Vakinat e t'ligs herscme e t'ligs ree*" with author Pashko Babit and " *Urdhnimet e Tenzot e t'sceites kisc*" with author Ndue Bytyçit like texts of special importance between the outdated materials which turned out to be actually study objectives in albanological sciences. The actual studies that we are dealing with have special importance not only for the values they have and the great impact in the history of the Albanian writing in the 19<sup>th</sup> century but even in the linguistic aspect too. Published in geg dialect they may be considered as an important source for the linguistic sciences that study the development of the Albanian language in different periods of time.

*Key word : geg dialect, 19<sup>th</sup> century, linguistic field, graphy.*